

ZYRA E EULEX-it PËR PROGRAME
ZYRA E SHEFIT TË MISIONIT EULEX KOSOVË
MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIMIN E LIGJIT

EULEX RAPORTI PËR PROGRAMET

Korrik 2009

LISTA E SHKURTESAVE

MMK	Monitorim, mentorim dhe këshillim
DRP-të	Dokumentet e realizimit të programeve
PNJA-të	Pakot për njohjen me aktivitetet
TP-të	Treguesit e përmbushjes së punës/performancës
PRM	Pyetëtori për raportim mujor
IRJM	ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
PP	Prokuroria Publike
DFP	Departamenti për Fuqizimin e Policisë
INFOSYS	Sistemi informativ
PK	Prokuroria Komunale
PQ	Prokuroria e Qarkut
SDP	Sistemi i të Drejtës Penale
DAK	Drejtoria për Analizë të Krimet
SI	Sektori i Inteligjencës
PSO-të	Procedurat standarde të operimit
PBI	Puna policore e bazuar në inteligjencë
NJRI	Njësia Rajonale e Inteligjencës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
DKO	Drejtoria për Krimet e Organizuara
DKR	Drejtoria për Krimet e Rënda
DHF	Dhuna në familje
SHKK	Seksioni për Hetimin e Krimeve dhe Korrupsionit
NJRF	Njësia Rajonale për Forenzikë
GRK	Grupet Rajonale për Krime
NJRMO	Njësia Rajonale për Mbështetje Operative
EPK	Ekipet e Policisë në Komunitet
DNJS	Departamenti i Njësive të Specializuara
NJIS	Njësia për Intervenime të Specializuara
NJME/I	Njësia kundër Mjeteve Eksplozive të Improvizuara
NJMA	Njësia për Mbrojtje të Afërt
DSDM	Drejtoria për Siguri dhe Divizioni për Mbrojtje
ECLO	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
DPZH	Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim
DRP	Departamenti për Rendin Publik
DME	Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave
PK	Policia në Komunitet
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
EM	Ekipet Mobile
SHR	Shtabi Rajonal

PeK	Policia e Kufirit
NJI	Njësia për Imigrim
KELDP	Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici
DL PK	Drejtoria për Logjistikë e Policisë së Kosovës
DTIK	Drejtoria për Teknologjinë Informativë dhe të Komunikimit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndhmës për Trajnim në Hetimet Penale
PISCES	Sistemi për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal
KD	Komponenti i Drejtësisë
GJK	Gjykata për Kundërvajtje
GJEQ	Gjykata Ekonomike e Qarkut
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
GP	Grup Punues
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
NJK	Njësia Korrektuese
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
NJN	Ndihma Juridike Ndërkombëtare
OEA	Operatori Ekonomik i Autorizuar
GAP	Instituti për Studime të Larta
ECHR	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
ICCPR	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues
PZH	Persona të Zhvendosur
TAXUD	Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Tatime dhe Unionin Doganor
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
TARIK	Tarifat e Integruara për Kosovën
FAST	Ekipet Fleksibile Kundër Kontrabandës
CEFTA	Marrëveshja Rajonale për Tregti të Lirë
PKA	Pika për Kontrollimin e Automjeteve

PËRMBAJTJA

Parathënie nga Shefi i Misionit EULEX	8
Si punon MMK e EULEX-it?	9
Përmbledhje e konkluzioneve	15
POLICIA	25
LUFTIMI EFEKTIV I KRIMIT – Krimet në Kosovë sipas kontekstit	26
- Llojet e krimeve	28
- Cilësia e të dhënave statistikore	31
- Përkatësia etnike e viktimave të krimit	34
- Menaxhimi i performancës në hetime dhe ndjekjen penale	35
- Marrëdhëniet e Policisë së Kosovës me Prokuroritë Publike	38
KAPACITETET E INTELIGJENCËS PËR KRIMET	46
- Menaxhimi i të dhënave nga Policia e Kosovës	51
- Hetimi i krimeve në nivel të stacioneve	52
- Shtylla për krime e Policisë së Kosovës në Shtabin Qendror – Udhëheqja dhe mbështetja nga qendra	53
PATRULLIMI EFEKTIV DHE SIGURIMI I RENDIT PUBLIK	64
- Funkcionet operative të patrullimeve	64
- Funkcionet mbështetëse të patrullimeve	68
SIGURIMI I KUFIJVE	77
- Vlerësimi themelor i performancës	77
- Zhvillimi i Policisë Kufitare të Kosovës në të ardhmen	90
REKRUTIMI, NGRITJA NË DETYRË DHE MBAJTJA E MË TË MIRËVE	96
- Personeli dhe struktura e Policisë së Kosovës	96
- Departamenti për personel dhe trajnime	107
KRIJIMI I NJË ORGANIZATE TË QËNDRUESHME	108

DREJTËSIA	123
Pasqyra demografike e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë	125
Plani strategjik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	125
Gjykatësit e EULEX-it në fushën penale dhe atë civile	126
Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë dhe barazia gjinore	127
Këshilli i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	128
Infrastruktura e Këshillit Gjyqësor të Kosovës	129
Numri i gjykatësve dhe i prokurorëve në raport me popullatën	129
Personeli mbështetës	131
Pagesa	131
Infrastruktura në nivelin e gjykatave të qarkut	132
Aftësimi i gjykatësve dhe prokurorëve	133
Ngritja në detyrë dhe përzgjedhja e gjykatësve në Kosovë	134
LLOGARIDHËNIA E GJYQËSORIT TË KOSOVËS	136
MBROJTJA E DËSHMITARËVE	137
PROKURORËT DHE VEPRIMTARITË PROKURORIALE	139
- Arrestimi/ndalimi	139
- Procedura e ekzaminimit të dëshmive	140
- Njësitë e specializuara / Ekipet shumë-disiplinore	140
- Strukturat e bashkëpunimit	141
SIGURIA E GJYKATAVE	141

SISTEMI INFORMATIV PËR MENAXHIMIN E LËNDËVE	142
SISTEMI I CAKTIMIT SË LËNDËVE	143
LËNDËT E GRUMBULLUARA	145
MEKANIZMI I ANKESËS PËR QYTETARËT	149
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS	150
- Rishikimi i ligjeve dhe Procedurave Standarde të Operimit	150
- Përcjellja/shoqërimi i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme	151
- Blloku nr. 1 në Dubravë	152
- Njësia e sigurimit	154
- Menaxhimi financiar në Shërbimin Korrektues të Kosovës	155
- Kapacitetet/përfaqësimi i personelit në kuadër të Shërbimit Korrektues	156
MINISTRIA E DREJTËSISË	157
- Departamenti për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore	158
DOGANA	160
LLOGARIDHËNIA	165
- Legjislacioni, politikat dhe procedurat e punës	165
- Ofrimi i paanshëm i shërbimeve	165
- Ankesat dhe parashtresat	167
- Anti-korrupsioni	168
- Përparësitë dhe mangësitë	169
- Konkluzionet	170
QËNDRUESHMËRIA E SHËRBIMIT	171
- Resurset njerëzore	171
- Trajnimet dhe zhvillimi i shkathtësive themelore	172
- Përbushja e detyrave	175
- Resurset tjera (infrastruktura, pajisjet, objektet)	176
- Planet e menaxhimit operativ	177
- Luftimi i krimeve të rënda	180
- Bashkëpunimi	183
- Përparësitë dhe mangësitë	185
- Konkluzionet	187
LIRIA NGA NDËRHJRJA POLITIKE	188

SHUMË-ETNICITETI, TË DREJTAT E NJERIUT DHE ASPEKTI GJINOR	190
SHOQËRIA CIVILE	193

PARATHËNIE

Më 31 janar 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian e miratoi Konceptin e Operacioneve (në tekstin e mëtejshëm CONOPS) për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Ky Mision do të njihet më pas si “EULEX Kosovo”, në bazë të fjalës latine “lex” që do të thotë “ligji”. “EULEX Kosovo” (në tekstin e mëtejshëm EULEX) është operacioni civil më i madh për menaxhimin e krizave i ndërmarrë ndonjëherë në kuadër të Politikave Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP). Në përgjithësi, qëllimi i EULEX-it është që t’ju ndihmojë dhe t’i mbështesë autoritetet kosovare në fushën e Sundimit të Ligjit, veçanërisht në polici, drejtësi (ku përfshihet shërbimi korrektues) dhe në doganë. Në parim ai është paraparë që të jetë një mision monitorues, mentorues dhe këshillëdhënës (MMK), përderisa i mban për vete një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive. Filozofia themelore që i drejton aktivitetet e EULEX-it në MMK njihet si *Qasja Programore* – një metodë e strukturuar dhe sistematike për ta ndihmuar sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë që të arrijë ndryshime pozitive.

Kam kënaqësinë që t’ua paraqes këtë raport, i cili paraqet një analizë të hollësishme të konkluzioneve të gjetura në fushën e Sundimit të Ligjit: ai shënon një moment të rëndësishëm në historinë e EULEX-it dhe sektorit të Sundimit të Ligjit në Kosovë. Siç do të shihet, ky raport i vë në spikamë të arriturat e rëndësishme të policisë, drejtësisë dhe doganës, si dhe i identifikon disa fusha që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm. Duke qenë këto në pronësi të autoriteteve të Kosovës, si dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe organizmat joqeveritar, EULEX-i do të ecë përpara edhe më tej në bazë të këtij raporti për t’i arritur gjashtë qëllimet parësore të këtij Misioni.

Shfrytëzoj rastin që t’i falënderoj partnerët tonë nga fusha e Sundimit të Ligjit në Kosovë për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe shumë monitorues të EULEX-it, përkushtimi dhe puna e madhe e të cilëve është pasqyruar në këto faqe.

Yves de Kermabon

Shef i Misionit

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Si punon MMK e EULEX-it?

Qëllimi i Misionit EULEX është i artikuluar me anë të një numri të synimeve dhe objektivave strategjike. Ajo që parashihet në Deklaratën e Misionit është një proces i reformave: d.m.th lëvizja e Policisë, Drejtësisë dhe Doganës së Kosovës nga “gjendja aktuale” e tyre drejt një “gjendjeje të dëshiruar” të qëndrueshmërisë, llogaridhënies, shumë-etnicitetit, lirisë nga ndërhyrjet politike, si dhe zbatimit të standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane.

Vetë teksti i Deklaratës së Misionit nënkupton se pika fillestare nuk mund të jetë një “gjendje zero”. Me fjalë të tjera, dihet mirëfilli se institucioneve të Kosovës në “gjendjen aktuale” nuk është se u mungojnë këto cilësi të dëshiruara dhe ç’është e vërteta Policia, Drejtësia dhe Dogana e Kosovës janë duke u zhvilluar drejt arritjes së këtyre synimeve që prej themelimit të tyre në vitin 1999 dhe krijimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në vitin 2001. Nën drejtimin dhe autoritetin e përgjithshëm të UNMIK-ut, këto institucione kanë evoluar dhe janë zhvilluar në përputhje me pjesën më të madhe, nëse jo në tërësi, të gjashtë parimeve të EULEX-it. Megjithatë, CONOPS i EULEX-it, gjithashtu vlerëson se në fillim shkalla e autonomisë dhe autoritetit të cilin e kishin këto institucione ishte shumë e kufizuar, e cila u rrit gradualisht me kalimin e viteve. Gjendja përfundimtare e dëshiruar parasheh që institucionet e sundimit të ligjit të jenë në gjendje që të funksionojnë “pa intervenim ose zëvendësim ndërkombëtar”. Pa një shkallë të arsyeshme të autonomisë dhe autoritetit vendor, çfarëdo gjykimi lidhur me shkallën deri në të cilën institucionet mund t’i demonstrojnë këto veti ka gjasa të jetë i paqëndrueshëm. Ishte e qartë se çdo përpjekje reale në lëvizjen drejt synimeve të EULEX-it do duhej të niste me një vlerësim gjithëpërfshirës të “gjendjes aktuale”, deri sa institucioneve të Sundimit të Ligjit t’u lejohet që ta ushtrojnë shkallën maksimale të autoritetit dhe të përgjegjësisë.

Arritja e vizionit

EULEX-i ka përfituar nga investimet e konsiderueshme njerëzore dhe financiare. Mirëpo, edhe përkundër këtyre resurseve, arritja e synimeve kërkon përqendrim dhe një qasje partneriteti. Përveç kësaj, edhe detyra e arritjes së vizionit të përcaktuar në Deklaratën e Misionit kërkon një qasje sistematike. Njësoj si në punën e dirigjentit të një orkestre të madhe, EULEX-i duhet t’i shndërrojë temat e gjëra muzikore në një simfoni koherente. Kjo përfshin një numër të detyrave.

Së pari, hartimi i pjesëve muzikore të hollësishme për pjesët e ndryshme të orkestrës së EULEX-it (ekspertët në polici, drejtësi dhe doganë nga shtetet anëtare dhe vendet kontribuuese).

Së dyti, të sigurohet që secila pjesë e orkestrës të jetë e familjarizuar me pjesën e vet muzikore dhe e zonja për të luajtur në instrumentet e saj (d.m.th secili ekspert i EULEX-it duhet të jetë i njohur me ligjet, politikat dhe procedurat përkatëse dhe me aktivitetet e Programeve të EULEX-it).

Së treti, nevojitet një sistem rigoroz i komunikimit të informatave ndërmjet dirigjentit dhe pjesëve të orkestrës (d.m.th një menaxhim efektiv të programeve, në gjendje që ta bëjë bashkërendimin e aktiviteteve dhe informatave të programeve). Së fundi, secila fazë e këtij procesi duhet të akordohet me kolegët kosovarë të EULEX-it në fushën e Sundimit të Ligjit dhe të jetë e ndarë bashkë me aktorët tjerë ndërkombëtar.

Analogjia e përgatitjes dhe shfaqjes së një simfonie origjinale me një orkestër të sapoformuar paraqet një mënyrë të mirë për ta përshkruar *Qasjen Programore*. Detyra e shndërrimit të pjesëve muzikore themelore – synimet dhe objektivat e Misionit – në një simfoni të plotë ka nisur në mars 2008 në Zyrën e EULEX-it për Programe. Në mënyrë që të ndihmohen këto organizata komplekse në gjendjen e tyre aktuale, u pa e nevojshme që fillimisht të bëhet matja e gjendjes aktuale, të jepet përgjigje në pyetjen se si qëndrojnë aktualisht policia, drejtësia dhe dogana karshi gjashtë synimeve të Misionit. Për këtë kërkohet një proces i përgatitur me kujdes, ashtu që qindra monitorues të EULEX-it, të shpërndarë në tri komponentët, t'i bëjnë vlerësimet e tyre gjatë një periudhe të caktuar kohore.

Në përputhje me nevojat është krijuar një program model për ta bërë vlerësimin e kapaciteteve aktuale në kuadër të sektorëve të Drejtësisë, Policisë dhe Doganës në Kosovë nga ana e personelit të Komponentëve të EULEX-it për Monitorim, Mentorim dhe Këshillim. Ky model nuk ishte i drejtuar në funksionet e tanishme ekzekutive të EULEX-it, si dhe mbështetej nga “kornizat logjike” të Komponentëve të hartuara më parë dhe të miratuara në maj 2008, të cilat kanë siguruar një lidhje specifike dhe të fokusuar ndërmjet rezultateve të MMK-së në terren dhe synimeve e objektivave strategjike të misionit.



Figura 1 – Strategjia themelore e EULEX-it

Në Figurën 1 është paraqitur qasja themelore e miratuar nga EULEX-i. Në fazën nismëtare të funksionimit të tij, EULEX-i e dërgoi personelin e tij për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të performancës aktuale në drejtësi, polici dhe doganë, ashtu që të identifikoheshin anët e forta dhe të dobëta. Pastaj u bë evidentimi i fushave në të cilat performanca e komponentëve që në nivel të kënaqshëm apo më të mirë, si dhe e fushave në të cilat performanca u gjykua të jetë e dobët. Këto të fundit u analizuan me kujdes, me qëllim të gjetjes së arsyeve kryesore për performancën e dobët, ndërsa të dhënat e evidentuara u shfrytëzuan në procesin e formulimit të strategjive reale dhe të arritshme për përmirësimin e performancës. Gjatë procesit të identifikimit të strategjive për përmirësim u përdorën tri parime të rëndësishme.

- Miratimi i strategjive që për qëllim kishin përmirësimin e performancës të bëhet bashkërisht nga ekspertët e EULEX-it dhe kolegët e tyre nga sektorët e sundimit të ligjit.
- Zbatimi i strategjive për përmirësim të drejtohet nga udhëheqësit dhe menaxherët përkatës në sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, e jo nga personeli i EULEX-it. Thënë shkurt, institucionet përkatëse në Kosovë do ta kenë pronësinë e gjithëmbarshme mbi këtë proces reformash.

- Ky proces do t'i merr parasysh në tërësi angazhimet e Komisionit Evropian për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe të organizatave tjera ndërkombëtare dhe donatorëve bilateral. Sipas nevojës dhe mundësive, strategjitë e miratuara bashkërisht për përmirësimin e performancës në mënyrë aktive do të kërkojnë përkrahjen e këtyre organizmave.

Në shtator 2008, qasja e EULEX-it u miratua zyrtarisht nga Kryeministri, Ministrat dhe Shefi i Misionit EULEX në Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit. Donatorët bilateral dhe multilateral, kryesisht Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO), u konsultuan gjithashtu. Si një mënyrë për shtimin e transparencës publike dhe përgjegjësisë operative, rezultatet dhe të arriturat e pritura u bënë publike duke i vendosur të gjitha dokumentet dhe materialet përkatëse të programeve në faqen e internetit të EULEX-it me rastin e fillimit të funksionimit.

Në janar 2009, u dha një prezantim i qasjes programore para Shteteve Anëtare të BE-së në Bruksel, ndërsa një angazhim tjetër për ta shpjeguar esencën e MMK-së u shënuar në shkurt kur Zyra për Programe e mbajti një seminar për gazetarët e televizioneve dhe medieve tjera në Kosovë, ku pjesëmarrja ishte e mirë dhe raportimet për të ishin pozitive.

Siç u tha më sipër, përmbajtja e qartë e monitorimit dhe këshillimit duhet të kontrollohet dhe bashkërendohet si duhet. CONOPS dhe dokumentet përkatëse i përcaktojnë Dokumentet për Realizimin e Programeve (DRP-të) si instrumente me anë të cilave përkufizohen aktivitetet e programit, treguesit e performancës dhe mekanizmat e raportimit. Ndërmjet qershorit dhe gushtit të vitit 2008, Zyra për Programe dhe përfaqësuesit e lartë të Komponentëve i hartuan një varg DRP-sh, që i siguruan personelit të Komponentit të MMK-së kontekstin në të cilin ata punojnë, si dhe mjetet për t'i realizuar përgjegjësitë e tyre nëpërmjet një mori detyrash specifike për mbledhjen e të dhënave. Paralelisht me këto angazhime u realizuan edhe një numër i takimeve konsultative me palët kosovare dhe u formuan grupe punuese të përbashkëta në sektorët specifik për ta siguruar parimin e bashkë-pronësisë. Për secilin sektor të funksionimit u hartuan njëmbëdhjetë DRP tematike, si dhe gjithsejtë 187 rezultate/komente të personelit të MMK-së u miratuan me Komponentët dhe me kolegët përkatës kosovar.



Figura 2 – Cikli i Programeve

Siç është paraqitur në Figurën 2, çdo fazë gjashtë mujore e Misionit EULEX përcaktohet me anë të Treguesve të Performancës (TI) dhe Pyetësorëve për Raportim Mujor (PRM). Nëse i kthehemi analogjisë së orkestrës, këta komponentë themelorë të DRP-ve i përkufizojnë pjesët muzikore për secilën pjesë të orkestrës së EULEX-it.

Sipas nevojës, tre komponentët e Sundimit të Ligjit – policia, drejtësia dhe dogana – janë ndarë në sfera. Secila sferë e ka të përkufizuar tërësinë e aktiviteteve dhe treguesve të performancës së saj.

Arritja e rezultateve

Puna e rreth 400¹ pjesëtarëve për MMK në kuadër të Komponentëve të EULEX-it është përforcuar nga një Sistem Informativ “on-line” (INFOSYS) i krijuar nga Zyra për Programe i cili

¹. 350 pjesëtarë të PSD, 20 pjesëtarë të Doganës dhe rreth 40 pjesëtarë të Drejtësisë, me gjithë që detyrat e këtyre të fundit janë të ndara në funksione ekzekutive dhe të MMK-së.

ishite përkrahur me një program shumë të rëndësishëm për trajnimin e të gjithë personelit të MMK-së (mbi 1800 orë deri më tani).

INFOSYS doli “on-line” pasi misioni filloi punën në dhjetor 2008, si dhe me përshejtimin e ritmeve të aktiviteteve të MMK-së gjatë muajit janar 2009, ky mekanizëm për mbledhjen e të dhënave u dëshmuua veçanërisht i suksesshëm në marrjen e përgjigjeve në kërkesat specifike për mbledhjen mujore të dhënave.

Personeli i **MMK-së** i bashkë-vendosur me kolegët e tyre kosovarë janë në pozitë të mirë për ta skicuar sistemin e Sundimit të Ligjit në Kosovë nëpërmjet prizmit të mandatit të EULEX-it, andaj gradualisht është duke u krijuar imazhi nga të gjitha regjionet dhe sektorët.² Mbi 2500 raporte të hollësishme nga INFOSYS i janë paraqitur Zyrës për Programe, kështu që kjo praktikë ka krijuar një nivel mbresëlënës të suksesit dhe hollësive për sa i përket përparësive, dobësive, karakteristikave dhe trendëve aktuale në kuadër të Sundimit të Ligjit.

Në faqet vijuese të këtij raporti janë paraqitur konkluzionet e gjetura nga Zyra për Programe pas periudhës fillestare gjashtë mujore të vlerësimit të performancës nga monitoruesit e EULEX-it.

Fushat ku janë vërejtur dobësitë janë të ndërlidhura me masat e rekomanduara në formë të “Rekomandimeve të EULEX-it”, të nënvizuara me *ngjyrë të kaltër*.

Sipas nevojës, është paraparë që për disa veprime të caktuara do të nevojitet përkrahja e donatorëve dhe agjencive të jashtme (d.m.th ato për të cilat kërkohen lloje të caktuara të ndihmës teknike, zhvillimit të infrastrukturës dhe të disa masave më formale për ndërtimin e kapaciteteve). Megjithatë, në shumë sfera tjera, ky raport ka identifikuar aspekte të zhvillimit të cilat do trajtohen në mënyrën më të mirë me anë të angazhimit të MMK të EULEX-it.

Roy Reeve

Zëvendës Shef i Misionit

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Alessio Zuccarini

Shief i Zyrës për Programe

EULEX Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

² . *Aktiviteteve të MMK-së në pjesën veriore të Kosovës kanë qenë të pakta dhe të herë pas herëshme për shkak të rrethanave politike që janë jashtë fushëveprimit të këtij raporti.*

PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE

POLICIA

Policia e Kosovës (PK) ka strukturë gjithëpërfshirëse juridike, personel të aftësuar siç duhet dhe mjaft të kualifikuar, buxhet adekuat dhe pajisje të mjaftueshme për t'i plotësuar objektivat ligjore. Megjithatë, ekziston një shqetësim lidhur me cilësinë e udhëheqjes së saj dhe të kapaciteteve për drejtim strategjik, ndërsa këto karakteristika janë me rëndësi vendimtare për suksesin e PK-së në përballjen me sfidat që i paraqesin krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Nuk është gjetur asnjë dëshmi se personeli i lartë komandues i PK-së është duke e zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse. Një strategji e tillë do t'i kishte në objektiv kategoritë specifike të krimit të organizuar dhe do ta përdorte një varg të veprimeve proaktive, përfshirë përpjekjet për parandalimin e krimit në bashkëpunim me komunat dhe agjencitë e tjera, shfrytëzimin e inteligjencës për t'i planifikuar kundërmasat ndaj kriminelëve të caktuar.

Në mbarë PK-në pranohet nevoja për ta zhvilluar plotësisht kryerjen e shërbimeve të policisë të bazuara në inteligjencë, andaj EULEX-i rekomandon me vendosmëri që programi për fillimin e zbatimit të kryerjes së shërbimeve policore të bazuara në inteligjencë duhet të jetë në mesin e prioritetëve kryesorë të komandantëve të lartë të PK-së gjatë tri vjetëve të ardhshëm. Rekomandohet që policia kufitare të jetë pjesë e një sistemi të vetëm të inteligjencës të PK-së, duke ofruar të dhëna për atë sistem dhe duke marrë informata nga ai. Policia kufitare ka potencial të bëhet një komponentë shumë e rëndësishme në këtë sistem të vetëm të inteligjencës: të dhënat lidhur me lëvizjen e personave dhe automjeteve të caktuara nëpër kufijtë e Kosovës janë me rëndësi themelore për t'u marrë me krimet e rënda dhe me krimin e organizuar.

Drejtorja për Analizë të Krimit (DAK) është e pakompletuar sa i përket strukturës së personelit dhe udhëheqjes, duke e privuar PK-në nga mundësia që ta ketë një qendër efikase të sistemit të saj të inteligjencës kriminale. DAK duhet të jetë në qendër të një përpjekjeje të përbashkët për ta zhvilluar plotësisht mandatin, strukturën dhe kapacitetin e saj dhe duhet lejuar ta marrë rolin udhëheqës në lëvizjen drejt kryerjes së shërbimeve policore të 'bazuara në inteligjencë.

Drejtorisë për Krimin e Organizuar (DKO) i mungon një dokument i hollësishëm strategjik që i përkufizon qëllimet dhe objektivat e saj dhe, si rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë politikë e shkruar ose strategji e përgjithshme që i jep formë përpjekjes për t'u marrë me krimin e organizuar. Po ashtu, ekziston nevoja që të shtohet në masë të madhe shfrytëzimi i statistikave për llojet e krimeve të kryera dhe i inteligjencës gjatë planifikimit të aktiviteteve të DKO-së.

Programi aktual i ristrukturimit për organizimin e PK-së duhet të merret me nevojën për shtimin e shfrytëzimit të burimeve të kufizuara dhe të ketë kujdes që të mos ndodhë ndonjë dyfishim i përpjekjeve. Pjesë të organizatës nuk duhet të "garojnë" njëra me tjetrën.

PK-ja duhet ta zhvillojë një strategji të sofistikuar dhe efikase për emigrantët e paligjshëm, si pjesë të zhvillimit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve (MIK). Strategjia duhet të merret me Rregulloren e përmirësuar të Punës, hapësirat e përmirësuara të paraburgimit, nevojat për aftësim të personelit të policisë kufitare dhe pajisjet e specializuara dhe automjetet.

Gjatë zhvillimit drejt MIK, Policia e Kosovës duhet të punojë me doganën, prokurorinë dhe EULEX-in për ta paraqitur një strategji për krimet ndërkufitare. Strategjia duhet të vendosë objektiva të caktuara kryesore për tri vitet e ardhshme, duke u bazuar në të dhënat më të mira në dispozicion të inteligjencës dhe atyre statistikore lidhur me trendët e krimit ndërkufitar në Kosovë dhe në Ballkanin perëndimor.

Komunikimi dhe rrjedha e informatave – si ndërmjet pjesëve të ndryshme të policisë kufitare ashtu edhe ndërmjet kësaj shtylle dhe pjesëve të tjera të PK-së – mbesin një e metë themelore. Kjo e metë ka ndikim dobësimi në funksionimin e policisë kufitare dhe në efikasitetin e saj për arritjen e objektivave.

Përkundër pagesës së ulët në nivelet e saj më të ulëta, PK-ja është relativisht e lirë nga sjelljet korruptuese. Megjithatë, llogaridhënia e PK-së mund të përmirësohet, sidomos lidhur me aftësinë e organizatës për ta sqaruar publikisht kryerjen e detyrave dhe adresimin e pritjeve të komuniteteve në nivelin vendor. Rekomandohet që PK-ja ta mbajë sistemin e regjistrimit të kategorive të caktuara të krimit, siç është vjedhja me thyerje dhe vjedhja e automobilave, si nëngrupe të dalluara apo grumbullime të kategorive të krimit sipas Kodit Penal. Një qasje e tillë do të ndihmojë në menaxhimin e parandalimit dhe të zbulimit të krimit.

Rekomandohet që gjatë tri viteve të ardhshme, detyra e përmirësimit të mbikëqyrjes së linjës së parë të bëhet prioritet kryesor nga ana e komandantëve të lartë të PK-së. EULEX-i do të përpiqet të ndihmojë në këtë punë. Partnerët e tjerë donatorë do të mund të ndihmonin në zhvillimin e menaxhimit të veçantë të patrullimit për PK-në, si edhe në aftësimin e përbashkët për rreshterët dhe togerët.

Ka mungesë të dhënave lidhur me incidentet në të cilat është e nevojshme prania e policëve patrullues të PK-së. Një sistem i kategorizimit dhe i regjistrimit të incidenteve kriminale dhe të atyre pa prapavijë kriminale do t'ju ofronte komandantëve të PK-së informata të bollshme e të dobishme lidhur me atë se si policët patrullues e shfrytëzojnë kohën, llojet e aktiviteteve të kryerjes së detyrave policore dhe pritjet e komunitetit, si dhe një bazë të fortë për planifikimin e shpërndarjes së burimeve.

Niveli i përfaqësimit të pakicave e bën PK-në një organizatë policore shembull, në kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës në tërësi. Kjo e arritur e lavdërueshme në pasqyrimin e shoqërisë të cilës i shërben ka vazhduar si rezultat i pajtimit të disa qindra policëve serbë që të kthehen në punë.

Ekziston një shkëputje ndërmjet Njesisë qendrore të Policisë në Komunitet (NJPK) dhe të policëve në komunitet nëpër rajone. Ka nevojë të bëhet rishikimi i objektivave të shtabit qendror të NJQPK-së dhe të përkufizohet raporti i saj me ekipet rajonale të policisë komunitet.

Po ashtu, ekziston nevoja për një qasje më të strukturuar dhe racionale ndaj patrullave policore dhe të menaxherëve të lartë (në nivel rajonal dhe të stacioneve) të cilët duhet t'i formulojnë qëllimet dhe prioritetet kryesore për patrullat policore, duke u bazuar në këshillime aktive me përfaqësuesit e komuniteteve sidomos në vendet ku banon popullsia jo shumicë.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet prokurorëve publik dhe hetuesve të PK-së që parashihet me ligj shpesh mungon në praktikë. Rekomandohet që zyrtarët e lartë të PK-së dhe Prokurorisë Publike (PP) të fillojnë një angazhim të përbashkët për t'i hulumtuar mënyrat që do t'ua mundësonin prokurorëve dhe hetuesve të bashkëpunojnë më ngushtë në punë ekipore.

Prokurorët publik dhe policët nuk e informojnë opinionin si duhet për efikasitetin e sistemit të së drejtës penale (SDP), sidomos duke i përmendur treguesit themelor të suksesit dhe të dështimit. Sistemi aktual e vështirëson identifikimin e numrit të vrasjeve dhe të krimeve të tjera të rëndësishme në vitin e caktuar, si edhe numrin e rasteve që kanë pasur si rezultat ndjekjen penale të kryerësit të veprës. Pjesë kryesore e menaxhimit të përbashkët të sistemit të së drejtës penale është ekzistimi i një sistemi të përbashkët të mbledhjes dhe të krahasimit të krimeve. PK-ja dhe PP-ja duhet të zhvillojnë bashkërisht statistika për hetimet e krimeve të zakonshme dhe ndjekjet penale.

Hetuesit e PK-së dhe prokurorët publik duhet ta pranojnë që efikasiteti i sistemit kosovar të drejtës penale është rezultat i përpjekjeve të bashkëpunimit dhe bazohet në respektimin reciprok dhe në pranimin e kontributit të dy grupeve. Ekziston nevoja për një raport të përbashkët lidhur me përmbushjen e përgjithshme të SDP, i cili do të publikohej çdo vit nga struktura e përbashkët e menaxhimit. Ky raport duhet të shkruhet në një format dhe gjuhë që i mundëson opinionit ta kuptojë lehtë nivelin e suksesit në luftimin e paligjshmërisë dhe në veçanti të krimin të rëndë të organizuar.

Janë vërejtur dobësi në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK). Të dhënat për nivelin rajonal futen në sistem shpesh 5 – 7 ditë pas ndodhjes së ngjarjes dhe kjo nuk bëhet gjithmonë në mënyrë të drejtë; projekti i bazës së të dhënave është i papërshtatshëm dhe i mungon siguria. SIPK është shumë larg standardeve të kërkuara për mbështetjen e qasjes e cila bazohet në të dhënat nga zbulimi për ta mposhtur krimin në Kosovë.

Rekomandohet që komandantëve të PK-së t'ju ofrohet ndihmë për ta zhvilluar një Procedurë gjithëpërfshirëse të Standardeve të Veprimit për Njësitë Rajonale për Mbështetje Operative (ROSU) në të cilën do të pasqyrohej praktika më e mirë evropiane sa ju përket taktikave për kontrollin e turmave dhe trajtimit të incidenteve të mëdha të trazirave publike.

Ka shqetësim lidhur me menaxhimin e funksioneve të caktuara mbështetëse në kuadër të shtyllës së operacioneve. Ekziston mungesë e llogaridhënies lidhur me vlerësimin statistikor të kryerjes së punës nga ana e njësive (p.sh. NJIS dhe NJME/I) të cilat nuk janë në gjendje të ofrojnë të dhëna të hollësishme statistikore për numrin e incidenteve me të cilat janë marrë.

Herë pas here, ndarjet e buxhetit janë bërë duke u bazuar në prioritetet e menaxherëve të PK-së e jo duke u bazuar në qëllimet strategjike të organizatës. Është vënë re ndryshim i prioritetëve gjatë përgatitjes së buxhetit ose madje edhe pas miratimit të tij. Shuma të konsiderueshme mbesin të pashpenzuara dhe kthehen si suficit në buxhetin e Kosovës.

DREJTËSIA

Në krahasim me Policinë e Kosovës, sistemi penal i drejtësisë dhe gjyqësori si tërësi janë treguar shumë me të dobët në aftësinë e tyre për të mbështetur një ndjekje dhe gjykim të pavarur dhe efikas të rasteve.

Këshilli i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) aktualisht është jo-funksional që do të thotë se njëkohësisht edhe organi thelbësor për llogaridhënien e Gjyqësorit Kosovar - Komisioni Disiplinor i KGJK-së është jo-funksional. Megjithatë, të gjeturat tregojnë se mekanizmat llogaridhënës sipas ligjit për luftimin e korrupsionit janë funksional. Sipas hetimeve të bëra nga kryesuesi i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), është dëshmuar se mekanizmi për verifikimin e nivelit të deklarimit të pasurisë nga ana e gjyqtarëve të Kosovës është funksional. Agjencia Kundër Korrupsionit ka raportuar për një numër rastesh të tilla. Prokurorët e EULEX-it dhe AKK-ja kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi sa i përket bashkëpunimit në këtë fushë.

Të gjeturat e EULEX-it kanë zbuluar dobësi në lidhje me pavarësinë *de jure* të gjyqësisë Kosovare. Sistemi i emërimit dhe i ngritjes në pozitë të gjykatësve kosovarë nuk është i përshtatshëm për ta ruajtur pavarësinë e tyre. Deri tani, procedurat e emërimit nuk kanë siguruar ndonjë standard të lartë të integritetit të gjykatësve kosovarë.

Mungesa e një sistemi për vlerësimin e punës së gjykatësve kosovarë nënkupton se mungon një sistem vlerësues i duhur i karrierës bazuar në meritat e tyre. Përbërja e ardhshme e Këshillit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lë vend për shqetësim për shkak të numrit të madh të anëtarëve që duhet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës, që mund të përfshijë ndikim të vazhdueshëm të pushtetit politik në procesin e vendimmarrjes të Këshillit të KGJK-së.

KGJK-ja, pavarësisht nga këshilla e Kryetares të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, ka treguar mungesë angazhimi në miratimin e një plani për caktimin e lëndëve; përpjekjet për përmirësimin e gjyqësorit kosovar në harmoni me planin strategjik janë të pamjaftueshme.

Më gjithë respektin për pavarësinë *de facto*, janë identifikuar të meta sa i përket sigurisë së gjykatësve kosovar. Nuk ka ndonjë sistem për mbrojtjen e gjykatësve kosovarë në gjykatë, jashtë saj dhe pas orarit të punës. Është shënuar, po ashtu, edhe mungesë masash për garantimin e sigurisë së prokurorëve kosovar. Disa incidente të raportuara e tregojnë nivelin e trysnisë së jashtme ndaj së cilës janë të ekspozuar prokurorët kosovarë; nuk ka as zgjidhje *ad-hoc* as mekanizma institucional për t'i përcjellë incidentet e tilla.

Qasja në drejtësi është e vështirë për faktin se gjykimet shpesh mbahen në zyrat e ngushta të gjykatësve kosovarë dhe pa ndonjë orar të publikuar lidhur me proceset gjyqësore. KGJK-ja duhet ta rishikojë politikën e buxhetit të saj në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Buxhet dhe Financa për të siguruar që gjykatat të mund ta administrojnë në mënyrë autonome buxhetin që ju ndahet atyre ashtu që ta rrisin përkrahjen infrastrukture.

Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML) nuk është integruar plotësisht në veprimtarinë e përditshme të gjykatave.

Ka të meta serioze në aplikimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe në përgjithësi, gjykatat janë të siguruar në mënyrë jo-adekuate. Nga ana EULEX-it janë vërejtur edhe raste të frikësimit të gjykatësve, po ashtu këtyre trysnive u janë ekspozuar edhe prokurorët.

Gatishmëria e prokurorëve kosovarë për të kërkuar masa alternative përveç masës së vazhdimit të paraburgimit është shumë e ulët, po ashtu mungojnë rregullat e përgjithshme mbi procedurat e vërtetimit të dëshmive.

Komunitetet jo-shumicë dhe femrat nuk janë të përfaqësuara në nivelin e duhur në gjyqësorin e Kosovës. EULEX-i e inkurajon Ministrinë e Drejtësisë që të zhvillojë një qasje më pro-aktive në mënyrë që ta promovojë përfshirjen e mëtejme të komuniteteve jo-shumicë në sistemin e drejtësisë.

Vlerësimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) – *mes tjerash* – ka zbuluar sfida në zbatimin e rregullave të sigurisë, në kategorizimin e të burgosurve, në reagimin ndaj incidenteve të rënda, si dhe në bartjen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë.

Mungesa e sekretarit të përhershëm ka ndikim në funksionimin e burokracisë në Ministrinë e Drejtësisë. Me tej, EULEX-i ka vlerësuar nevojën për trajnime të vazhdueshme për personelin e Departamentit për Çështje Ligjore; për më tepër, përpjekjet e identifikuarra për ngritjen e kapaciteteve duket se lëngojnë nga lëvizjet e vazhdueshme të stafit brenda ministrisë.

DOGANA

Legjislacioni i ri bazë ekziston që nga hyrja në fuqi, në fund të vitit 2008, të Ligjit mbi Kodin Doganor dhe të Akcizave në Kosovës. Ky kod është në harmoni me standardet e BE-së, sepse është i frymëzuar nga Kodi i Bashkimit Evropian për Dogana.

Legjislacioni sekondar, p.sh. Udhëzimi administrativ me dispozitat zbatuese dhe udhëzimet pasuese nga ministri i ekonomisë dhe i financave ende nuk janë nxjerrë. Ndonëse nuk është dhënë ndonjë afat për këtë proces, zbrazëtitë ligjore janë reduktuar në masë të madhe me zbatimin e rregullave dhe të rregulloreve të mëparshme të UNMIK-ut. Garantimi i interpretimit të saktë dhe aplikimi i njëjtë i rregullave doganore që janë në pajtueshmëri me praktikën evropiane, është një sfidë e vazhdueshme.

Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme për t'i dhënë publikut të gjerë dhe komunitetit të biznesit informacionin e duhur, ky i fundit nuk është gjithmonë i plotë apo edhe i përditësuar, e po ashtu, nuk ofrohet gjithmonë në të gjitha gjuhët zyrtare nëpër të gjitha pikat kufitare.

Procedurat e ankesave janë të rregulluara mirë. Ankesat, siç duket kanë të bëjnë me disa fusha, kryesisht me vlerësimin e mallrave. Bordi i pavarur për shqyrtim, si organi kryesor ku mund të parashtrihen ankesat lidhur me vendimet e Doganës së Kosovës (DK), pas një ndërprerjeje prej dymbëdhjetë muajve, ka filluar të organizojë prapë seanca dëgjimore. Raportimi i brendshëm lidhur me shkeljen e kodit të sjelljes duket të jetë i kompletuar mirë në kuadër të DK-së.

DK-ja ka plan veprimi për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, po ashtu ekzistojnë edhe masa proaktive.

Burimet njerëzore janë në nivel të mirë. Megjithatë, strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve përmend faktin se numri i stafit nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat ditore.

Plani për trajnime i Doganës së Kosovës përfshinë pjesën hyrëse, profesionale dhe teknike, por fusha më specifike, siç është ajo e zbatimit të ligjit dhe e parandalimit, nuk janë të përfshira gjerësisht. Megjithëse trajnimi në përgjithësi shihet si i dobishëm dhe efikas, ekziston shumë pak hapësirë që stafi t'i shprehë nevojat e veta për trajnime.

Në përgjithësi, detyrat kuptohen mirë nga stafi; ekziston material referues dhe detyrat komunikohen qartë. Ekziston një sistem i vlerësimit të përmbushjes dhe se vlerësimet që bëhen konsiderohen si të drejta nga zyrtarët doganorë. Megjithatë, trajnimi dhe zhvillimi nuk janë të integruar në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Një vlerësim fillestar i infrastrukturës dhe i pajisjeve tregon se godinat në pikat doganore apo edhe në terminale nuk janë gjithmonë në nivel të kënaqshëm për të kryer kontrollimet dhe inspektimet e duhura doganore. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve planifikon t'i korrigojë disa nga këto zbrazëti.

Korniza Strategjike e Operimit 2009-2011 nuk paralajmëron ndonjë ndryshim në objektivat gjithëpërfshirëse të doganës së Kosovës. Megjithatë, në planet operative krimi i organizuar përmendet pak.

Megjithëse ekzistojnë funksionet për hetime dhe zbatim, një rishikim i profileve ekzistuese të rrezikut do të ishte i nevojshëm, e po ashtu edhe analizimi i procesit të rrezikut. Nuk ekziston ndonjë sistem i posaçëm informues që i dedikohet krimit të organizuar. Shpërndarja e informatave nga inteligjenca dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet Drejtorisë për zbatimin e ligjit dhe të asaj për operimin e të hyrave në kuadër të doganës së Kosovës duket të jenë mjaft të kufizuara.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit në përgjithësi është i kufizuar, ndonëse në nivel vendor është realizuar një nivel bashkëpunimi p.sh mes Policisë Kufitare dhe Doganës.

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve do ta rrisë bashkëpunimin në mes të Policisë dhe të Doganës në masë të konsiderueshme në pikat e vendkalimeve kufitare. Ajo do t'i qartësojë mekanizmat për ushtrimin e kontrollit dhe përgjegjësitë dhe do ta intensifikojë kontrollin në kufij për ta parandaluar dhe zbuluar krimin ndërkuftar. Ajo gjithashtu i hap mundësitë për procedura të veprimit të përbashkët dhe për plane emergjente me shërbimet/agjencitë tjera për zbatimin e ligjit në rajon.

Procesi për përzgjedhjen dhe ngritjen në pozitë të stafit të Doganës duket të jetë transparent dhe i drejtë. Sidoqoftë, ka pasur shqetësime lidhur me ndikimet e mundshme nga të cilat mund të pësojë Dogana e Kosovës, për shembull nëse i referohemi zyrtarëve të emëruar të Doganës në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave apo në përbërjen e Bordit të Pavarur Shqyrtues.

Kodi i Mirësjelljes i Doganës së Kosovës bazohet në rekomandimet e Organizatës Botërore të Doganave dhe pasqyron standardet etike dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në bazë të konkurseve për punë, femrat dhe pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë inkurajohen që të konkurrojnë për punësim në Doganë. Rreth 12% e stafit i takojnë komuniteteve jo-shumicë, megjithëse jo edhe në funksione drejtuese. Femrat përbëjnë 23,5 % të stafit në Doganë por në përgjithësi ato nuk janë të përfaqësuara sa duhet në pozita drejtuese.

SHOQËRIA CIVILE/OJQ-të

Në janar 2009, 4952 organizata janë regjistruar në Ministrinë e Shërbimeve Publike (MSHP); autoritetet kanë raportuar një trend të njëtrajtshëm të 20 kërkesave të reja për çdo javë. Kushtet për regjistrim të OSHC/OJQ-ve të përcaktuara me Ligjin për Lirinë e Bashkimit në Organizata Jo-qeveritare të vitit 2009 janë relativisht të lehta për t'i përmbushur. Derisa shumica e OSHC/OJQ-ve pushojnë së vepruari menjëherë pas regjistrimit, organizatat aktive numërohen të jenë rreth 500. MSHP ka identifikuar 185 OSHC/OJQ me anëtarësi shumetnike dhe 546 OSHC/OJQ që i atribuohen komunitetit serb në Kosovë.

Pritjet/konstatimet lidhur me EULEX-in, të cilat janë mbledhur gjatë takimeve me OSHC-të/OJQ-të vendore mund të përmbledhen si vijon:

- 1) Dallueshmëria ndërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it: OSHC/OJQ-të në përgjithësi kanë mirëpritur ndryshimet mes mandatit të UNMIK-ut dhe EULEX-it si dhe rolin e shoqërisë civile të përcaktuar nga strategjia e Misionit.
- 2) Prioriteti – lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: shumica dërmuese e OSHC/OJQ-ve, në veçanti në kontekstin e Kosovës, e konsiderojnë luftimin e korrupsionit si prioritetin numër 1 për EULEX-in. Të gjitha detyrat tjera (p.sh marrja me krimet e luftës dhe me pajtimin ndëretnik) konsiderohen të jenë më pak urgjente.

Ndonëse me disa përjashtime, është shënuar një qëndrim në përgjithësi pozitiv kundruall EULEX-it .

Së fundi, janë publikuar 3 raporte mbi shërbimet korrektuese të Kosovës nga OSHC/OJQ-të: raporti për vitin 2009 nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, (KMDLNU) dhe dy hulumtime nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) të publikuara në vitin 2009. Monitoruesit janë fokusuar në kushtet higjienike, shërbimet shëndetësore, qasjen në informacion, arsimim, punën dhe kohën e lirë për argëtim, vizitat e jashtme, mekanizmat për parashtrimin e ankesave. Kushtet e të miturve, të huajve, të burgosurve nëpër vetmi (çeli burgu për izolimin e të burgosurit) dhe të femrave janë marrë si objekt studimi dhe në rekomandimet janë përfshirë masat që duhet ndërmarrë për ta menaxhuar mbipopullimin në burgjet e Kosovës dhe përmirësimin e kushteve të punës për zyrtarët në Shërbimet Korrektuese të Kosovës (SHKK). OSHC/OJQ-të përkatëse kërkojnë një qasje më të mirë në shërbimin korrektues të Kosovës: në përgjithësi duke e lavdëruar qëndrimin përkrahës të autoriteteve (ndonëse janë vërejtur disa mospajtime me SHKK), monitoruesit nuk kanë qenë në gjendje t'i verifikojnë keqtrajtimet e pohuara të burgosurve, duke i bazuar konstatimet e tyre në keqtrajtime vetëm nga burimet indirekte.

Disa OSHC/OJQ bëjnë monitorim të gjykimeve dhe atë zakonisht në raste specifike. Përpjekjet kryesore për të paraqitur një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi funksionin e gjykatave ka të bëjë me raportin e kryer nga Rrjeti Ballkanit për Gazetari Hulumtuese (BIRN), duke përfshirë këtu edhe një vlerësim të publikuar në qershor 2009 mbi përafërsisht 600 raste në 6 gjykata komunale në Kosovë. Rekomandimet kanë të bëjnë me një respektim më të madh të procedurave, shtimin e investimeve në infrastrukturën e gjykatave dhe më shumë transparencë ndaj shoqërisë civile në të gjitha aspektet e administrimit të sistemit të drejtësisë (përfshirë këtu edhe procedurat e emërimit të gjykatësve dhe të prokurorëve).

OSHC/OJQ-të e përkrahin luftimin e korrupsionit, i cili konsiderohet të jetë pengesa kryesore në kryerjen e punës si duhet nga ana e institucioneve kosovare. Organizatat si QOHU!, Fol'08 dhe Instituti Demokratik i Kosovës (IDK) kanë ndërmarrë fushata të ndryshme kundër korrupsionit dhe kanë monitoruar veprime të caktuara të kundërligjshme.

Përpjekjet institucionale kundër korrupsionit konsiderohen si të pamjaftueshme dhe shpesh me qëllim të fshehjes së përvetësimeve të mirëfillta nga opinioni publik.

Transparenca e të hyrave të zyrtarëve të zgjedhur, financimi i partive politike, marrëdhëniet në mes të menaxhmentit të kompanive private dhe publike me politikën tërheqin vëmendjen e monitoruesve të shumtë nga shoqëria civile dhe këto raporte shpesh mund të gjenden të publikuara nëpër faqet e internetit të OSHC/OJQ-ve të shumta. Disa iniciativa – si ajo e Qendrës për Këshilla Juridike dhe Avokim në IDK – synojnë vetëdijësimin e përgjithshëm mbi korrupsionin.

Perspektiva gjinore mbi qasjen në drejtësi ka gjeneruar botime të shumta nga OSHC/OJQ-të e ndryshme në Kosovë, si mbi kushtet e pjesëmarrjes së femrave në menaxhimin e sundimit të ligjit ashtu edhe në ndërmarrjen e masave për ta luftuar trafikimin dhe dhunën kundër femrave.

Shumë shoqata që punojnë kundër trafikimit dhe dhunës ndaj femrave janë mbledhur nën ombrellën e Rrjetit të Grave të Kosovës; këto organizata në përgjithësi janë të kënaqura me kornizën përkatëse ligjore dhe e konsiderojnë të duhur edhe qasjen e Policisë së Kosovës ndaj këtij problemi, por në anën tjetër ato raportojnë për vështirësi të shumta të gjykatësve dhe të prokurorëve vendorë në zbatimin e ligjit. Shqetësimi kryesor i referohet kontekstit shoqëror në të cilin përshkallëzohet dhuna gjinore, si dhe mungesës së ndihmës për mirëqenien e viktimave nga ana e autoriteteve.

Sektorë të shoqërisë civile janë përpjekur që t'ju garantojnë komuniteteve jo-shumicë qasje efektive në sektorin e drejtësisë. Shembull i mbushjes së boshllëqeve në këtë drejtim është iniciativa e Programit për Dialog të Rinisë që në tremujorin e parë të vitit 2009 ka zhvilluar një fushatë mbi funksionet dhe mandatin e EULEX-it në radhët e komunitetit serb në Kosovë. Çështja e personave të zhdukur dhe e të drejtave pronësore janë identifikuar të jenë fusha me interes me të cilat duhet të merret ky mision.

Policia

LUFTIMI EFEKTIV I KRIMEVE

Krimet në Kosovë sipas kontekstit

Është me rëndësi që nivelet e krimeve në Kosovë dhe performanca e Policisë së Kosovës (PK) lidhur me hetimin e krimeve të shikohen brenda një konteksti më të gjerë të Evropës. Tabela 1.1 paraqet një analizë krahasimtare të dhënave nga viti 2006, vit ky më i afërti për të cilin mund të gjenden të dhëna të besueshme nga një numër shtetesh. Siç është paraqitur, numri i krimeve të evidentuara atë vit në Kosovë ishte nën 3,000 për 100,000 banorë, që është dukshëm më i ulët sesa mesatarja e mostrës nga një grup i përbërë prej njëmbëdhjetë shteteve anëtare të BE-së. Megjithatë, brenda kontekstit të ish-Jugosllavisë, niveli i krimeve të evidentuara në Kosovë duket të jetë relativisht i lartë. Po kështu, është me rëndësi të ceket se, numri i veprave penale në Kosovë është përafërsisht tri herë më i lartë sesa niveli i tyre në territorin fqinjë të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), shtet ky me një numër të përafërt të popullsisë dhe me përbërje të ngjashme urbane dhe rurale. Në të vërtetë, fakti që Kosova ka 30% më shumë krime të evidentuara sesa Kroacia, e cila ka një ekonomi dukshëm më të zhvilluar me mundësi më të shumta për ndodhje të krimeve, jep arsye për shqetësim.

Nivelet e raportimit të krimeve janë të dokumentuara mirë. Shkalla e raportimit të veprave nga ana e viktimave (apo nga palët të treta) në polici është shumë e ndërlidhur me llojin e veprës. Për shembull, në shumë shtete të BE-së raportohen pothuajse të gjitha vjedhjet e veturave apo motoçikletave, si dhe shumica e plaçkitjeve të shtëpive/banesave; rreth dy të tretat e vjedhjeve nga veturat dhe pothuajse më shumë se gjysma e rasteve të vjedhjeve të biçikletave dhe plaçkitjeve; vetëm rreth një e treta e të gjitha sulmeve dhe kërcënimeve raportohen në polici, ndonëse shifra është më e lartë për sulmet me dhunë (45%) sesa për kërcënimet (29%); incidentet seksuale janë rastet që raportohen më së rralli (një mesatare prej 15%)³. Personeli i EULEX-it nuk ka gjetur ndonjë dëshmi se këto trende janë më pak të përhapura në Kosovë. Në të vërtetë, duke pasur parasysh paralelet e forta socio-ekonomike dhe ato demografike me IRJM-në, dhe nivelet e saj të krimeve të evidentuara, mund të argumentohet se kultura e raportimit të krimit është më e avancuar në Kosovë sesa në vendin fqinjë të saj.

³. *Burimi: Vëllimi i krimeve në BE, f. 68.*

Tabela 1.1 – Numri i krimeve të evidentuara – krahasimi ndërkombëtar 2 (2006)⁴

Shteti	Numri i përgjithshëm i policëve	Numri i përgjithshëm i krimeve të evidentuara	Numri i përgjithshëm i krimeve të evidentuara në raport me një polic	Numri i krimeve në 100,000 banorë
Austri	26 623	589 495	34	7102
Belgjikë	38 963	1 012 004	22	9547
Francë	241 998	3 725 588	9	5785
Gjermani	250 284	6 304 223	25	7669
Greqi	48 521	463 750	25	4177
Irlandë	12 954	103 178	15	2399
Itali	324 339	2 771 490	7	4650
Holandë	35 324	1 218 447	8	7429
Portugali	48 082	398 959	8	3799
Slloveni	7 857	90 354	11	4517

⁴.Burimi i të dhënave për shtetet e BE-së, Kroacinë dhe IRJ të Maqedonisë: Tavares, C. & Thomas, G., (2008), *Statistikat në fokus: Krimet dhe drejtësia penale*, EUROSTAT. Marrë më 29 janar 2009 nga: http://ep.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-08-019/EN/KS-SF-08-019-EN.PDF

Angli dhe & Uells (MB)	141 381	5 428 273	38	10184
Mesatarja e mostrës nga shtetet e BE-së			18	6114
Kroaci	19 790	81 049	4	1842
IRJM	9 776	22 024	2.2	1101
Kosovë	7187	64165	8.9	2916

Niveli i krimeve të evidentuara në Kosovë paraqet një sfidë dukshëm më të madhe për pjesëtarët e Policisë së Kosovës sesa për kolegët e tyre në IRJM dhe Kroaci. Çdo polic i Kosovës është përgjegjës për të trajtuar pothuajse 9 krime në vit, krahasuar me 4 në Kroaci dhe vetëm 2.2 krime që trajtohen nga një polic në IRJM. Ndonëse vëllimi i punës së PK-së është vetëm sa gjysma e mesatares në mostrën e grupit të shteteve anëtare të BE-së, megjithatë kjo është një sfidë domethënëse për policinë më të re në Evropë.

Llojet e krimeve

Përveç këtyre vrojtimeve të përgjithshme rreth niveleve të përgjithshme të krimeve të evidentuara në Kosovë, do të ishte e dobishme nëse EULEX-i do të mund të kontekstualizonte kategoritë specifike të krimeve të evidentuara brenda një konteksti më të gjerë të Evropës. Ndonëse nuk është e mundur që të krahasohen të gjitha kategoritë e krimeve të evidentuara me qëllim të evidentimit të tyre, tabela 2 paraqet një analizë të shkurtër të katër llojeve të krimeve më të rënda (vrasjet, grabitjet, plaçkitjet dhe vjedhjet e automjeteve).

Shprehja vrasje, në tabelën 2, përkufizohet si vrasje e qëllimshme e ndonjë personi, përfshirë këtu vrasjen me paramendim, vrasjen pa paramendim, eutanazinë dhe vrasjen e foshnjave⁵. Nga këtu përjashtohet tentim-vrasja (vrasja e pakryer), vdekja si shkak i vozitjes së rrezikshme, aborti dhe ndihma për vetëvrasje. Është e qartë se shkalla e vrasjeve në Kosovë (2.63 në 100,000 banorë) është për t'u shqetësuar, meqë është më e madhe sesa dyfishi i mesatares së mostrës së shteteve anëtare të BE-së. Edhe pse është më afër shkallës në IRJM dhe Kroaci, rastet më të shpeshta të vrasjeve në Kosovë tregojnë se kjo çështje është një fushë me prioritet për sistemin policor dhe atë të drejtësisë penale.

Nga ana tjetër, shkalla e grabitjeve të evidentuara (20 në 100,000 banorë) është shumë nën mesataren e mostrës së shteteve të BE-së (107) dhe dukshëm më e ulët sesa në IRJM (25.1) dhe Kroaci (32.8). Grabitja përkufizohet si vjedhje nga ndonjë person me dhunë apo përmes kërcënimit me dhunë, përfshirë këtu grabitjen e çantave dhe vjedhjen me dhunë, ndërsa në përgjithësi nuk përfshin vjedhjen nga xhepi, zhvatjen dhe shantazhin.⁶

Tabela 1.2 – Numri i krimeve të evidentuara – krahasimi ndërkombëtar 2 (2006)⁷

Shteti	Vrasje	Numri i vrasjeve në 100,000 banorë	Grabitje	Numri i grabitjeve në 100,000 banorë	Plaçkitjet e shtëpive/banesave	Numri i plaçkitjeve në 100,000 banorë	Vjedhja e automjeteve	Numri i vjedhjeve të automjeteve në 100,000 banorë
Austri	60	0.72	5 095	61.38	18 945	228.25	8 959	107.9
Belgjikë	174	1.64	19 903	187.76	67 550	637.26	24 167	227.9
Francë	879	1.36	127 190	197.5	177 840	276.14	243 153	377.5

⁵ Burimi i të dhënave për shtetet e BE-së, Kroacinë dhe IRJM: Tavares, C. & Thomas, G., (2008), *Statistikat në fokus: Krimet dhe drejtësia penale*, EUROSTAT. Marrë më 29 janar 2009 nga: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-08-019/EN/KS-SF-08-019-EN.PDF

⁶ Po aty.

⁷ Burimi i të dhënave për shtetet e BE-së, Kroacinë dhe IRJM: Tavares, C. & Thomas, G., (2008), *Statistikat në fokus: Krimet dhe drejtësia penale*, EUROSTAT. Marrë më 29 janar 2009 nga: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-08-019/EN/KS-SF-08-019-EN.PDF

Gjermani	727	0.88	53 696	65.32	106 107	129.08	90 224	109.7
Greqi	109	0.98	2 598	23.40	32 407	291.95	6 799	61.2
Irlandë	68	1.58	1 250	29.06	15 513	360.76	12 642	294
Itali	663	1.11	71 762	120.40	143 726	241.15	280 167	470.0
Holandë	159	0.96	13 716	83.63	91 235	556.31	22 667	1382.1
Portugali	148	1.40	20 870	198.76	23 314	222.03	24 495	233.2
Sloveni	12	0.6	521	26.05	2 220	111.0	1 091	54.5
Angli & Uells (MB)	755	1.41	101 370	190.18	292 285	548.37	193 410	362.8
Mesatarja e mostrës nga BE-ja		1.14		107.58		327.48		334.6
Kroaci	75	1.70	1 445	32.84	2 981	67.75	2 033	46.2
IRJM	45	2.25	503	25.15	1 367	68.35	365	18.2
Kosovë	58	2.63	441	20.0	4769	216.7	457	20.7

Në kategorinë e plaçkitjeve, shkalla në Kosovë është plotësisht e kundërt me trendin lokal, por më shumë e ngjashme me trendin e shumë shteteve të BE-së. Shprehja plaçkitje përkufizohet si hyrja në ndonjë vendbanim me forcë për të vjedhur gjëra materiale.⁸ Me një numër prej 216

⁸. *Tavares, C. & Thomas, G., (2008), Statistikat në fokus, Krimi dhe drejtësia penale, EUROSTAT. Marrë më 29 janar 2009 nga: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-08-019/EN/KS-SF-08-019-EN.PDF*

plaçkitjeve në 100,000 banorë, ky lloj krimi është 60% më i zakonshëm në Kosovë sesa në IRJM dhe Kroaci, kurse është në nivel të ngjashëm me një numër shtetesh anëtare të BE-së që janë marrë për mostër.

Për sa i përket vjedhjeve të automjeteve, shkalla e këtyre vjedhjeve në Kosovë (20.7 në 100,000 banorë) është shumë e ngjashme me atë në IRJM (18.2), dhe dukshëm më e ulët sesa mesatarja në shtetet anëtare të BE-së të marra si mostër (334.6). Natyrisht, siç edhe shihet në tabelën 2, shkalla e këtij krimi të caktuar ka një dallim të madh nëpër shtetet e BE-së dhe, në kontekst të Kosovës dhe IRJM-së, kjo ndoshta mund të jetë e ndërlidhur me mesataren më të ulët të vlerave të automjeteve në këtë pjesë të Evropës.

Vrojtimet e lartcekura bëjnë që EULEX-i të nxjerrë disa konkludime fillestare rreth ofrimit të shërbimeve policore në Kosovë. Në Kosovë ekziston një vëllim i konsiderueshëm i krimeve të rënda, posaçërisht i vrasjeve. Nëse shikohet në kontekstin e ngushtë të ish-Jugosllavisë ose në atë më të gjerë të Evropës, nivelet e krimeve të evidentuara paraqesin një sfidë domethënëse për një organizatë policore të re.


Cilësia e të dhënave statistikore

Pyetja që ndërlidhet me vëllimin e përgjithshëm të krimeve në Kosovë (krahasuar me pjesët e tjera të botës) është ajo që ka të bëjë me trendin e përgjithshëm: me fjalë të tjera, a është duke u ngritur apo ulur numri i krimeve? Tabela 3 paraqet një përmbledhje të dhënave të marra nga statistikat e përpiluara nga PK-ja (dhe UNMIK-u) gjatë tri viteve të fundit. Edhe pse ka mospërputhje të vogla (+/- 3% deri 0.4%) mes shumave të përgjithshme të dhënave për vitin 2006 dhe 2007, shkalla e përgjithshme e krimeve të evidentuara duket të jetë stabile, rreth 64,000 krimeve në vit.

Tabela 1.3 – Niveli i përgjithshëm i krimeve – krahasimi vjetor					
Statistikat e nxjerra për vitin 2006		Statistikat e nxjerra për vitin 2007		Statistikat e nxjerra për vitin 2008	
2005	2006	2006	2007	2007	2008

67508	64165	66064	61197	61383	65238
-------	-------	-------	-------	-------	-------

Ky vlerësim i trendit të krimeve të evidentuara si stabil brenda një grupi prej 62 – 67,000 krime në vit duket të konfirmohet nga një studim i disa veprave kryesore të caktuara. Diagrami 1 paraqet krimet e evidentuara për katër vepra kryesore mes viteve 2005 dhe 2008. Vrasja dhe dhunimi duket të jenë në nivele konsistente dhe pothuajse identike gjatë periudhës katërvjeçare. Ndonëse vëllimet e tyre janë shumë të ndryshme, grabitjet dhe tentim-vrasjet kanë pasur një trend shumë konsistent. Si përfundim, edhe pse krimet e evidentuara në Kosovë duket të jenë dukshëm më të larta sesa në shtetet e tjera në rajon (siç u cek më lartë), duket se trendi nuk po përkeqësohet.



Diagrami 1.1 – Trendët e veprave kryesore në Kosovë

Këto vërtetime i kanë nxitur këshilltarët e EULEX-it që të kërkojnë një strategji të qartë të PK-së për uljen e vëllimit të krimet në Kosovë, si përpjekje për ta vënë numrin e përgjithshëm të krimeve të evidentuara dhe disa kategori kryesore të krimeve në një nivel që është më shumë konsistent me

IRJM-më dhe Kroacinë. Në këtë drejtim, një strategji gjithëpërfshirëse është duke u hartuar nga personeli i lartë komandues i PK-së. Strategjia e tillë gjithëpërfshirëse do t'i ketë për objektiv kategoritë specifike të krimeve dhe do të parasheh një varg masash proaktive, përfshirë këtu përpjekjet për parandalimin e krimeve në bashkëpunim me komunat dhe agjencitë e tjera, shfrytëzimin e inteligjencës për të planifikuar operacione proaktive që për objektiv i kanë kriminelët e caktuar apo lokacionet specifike, si dhe shfrytëzimin e masave të tjera.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/1/2009

Objektivi: PK, zyrtarët e lartë për hetime të krimeve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit përkatës të PK-së në hartimin dhe zbatimin e një strategjie efektive për uljen e vëllimit të përgjithshëm të krimeve dhe numrit të disa krimeve më të rënda, si përpjekje për uljen e niveleve të krimit në shifra të ngjashme me ato të nivelit të IRJM-së dhe të Kroacisë.

Në vitin 2008, PK-ja filloi me një sistem të ri të evidentimit të krimeve dhe krahasimit të dhënave mbi krimet e evidentuara. Me sistemin e ri krahasohen krimet e evidentuara me listën e veprave penale sipas Kodit të Përkohshëm Penal. Kjo parandalon analizën e saktë të disa kategorive të caktuara të krimeve gjatë pesë viteve të fundit, meqë, para vitit 2008, statistikatat mbi krimet janë bazuar në sistemin e UNMIK-ut. Për shembull, ndonëse plaçkitjet ishin evidentuar si vepra të veçanta deri në fund të vitit 2007, në vitin 2008 dhe në vitet pasuese, këto vepra u vendosën si nëngrup i vjedhjeve të rënda - neni 253 i Kodit Penal. Ndonëse statistikatat e PK-së japin numrin e përgjithshëm të veprave sipas nenit 253, duke përfshirë ato vjedhje që përfshijnë “hyrjen në ndërtesa apo dhoma të mbyllura, hapjen e kutive, bagazhit të mbyllur apo hyrjen në ndërtesa të tjera të mbyllura përmes përdorimit të forcës apo largimit të pengesave me qëllim të përvetësimit të pronës së luajtshme”, nuk është e mundur të identifikohet numri i veprave që përshtatet me kriteret për plaçkitje të shtëpive/banesave. Gjithashtu, nuk është e mundur të identifikohet numri i përgjithshëm i vjedhjeve të automjeteve nga numri i përgjithshëm i vjedhjeve të evidentuara sipas nenit 252 të Kodit. Për sa i përket vrasjeve, statistikatat e vitit 2008 ndajnë numrin e përgjithshëm të krimeve të tilla sipas disa neneve të ndryshme të Kodit: përkatësisht në vrasje (neni 146), vrasje e rëndë (neni 147), vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor (neni 148), vrasje nga pakujdesia (neni 149) dhe vrasje e foshnjave gjatë lindjes (neni 150). Megjithatë, në sistemin e mëparshëm (të UNMIK-ut) nuk është e qartë nëse ndonjë apo të gjitha prej këtyre kategorive janë përfshirë në statistikatat mbi ‘vrasje’.

EULEX-i rekomandon fuqishëm që PK-ja ta ruajë mundësinë e evidentimit të kategorive të caktuara të krimeve, siç janë plaçkitjet e shtëpive/banesave dhe vjedhjet e automjeteve, si

nëngrupe të ndara apo aglomerate të kategorive të krimeve sipas neneve të Kodit Penal. Kjo do të krijonte një numër dobish për sa i përket menaxhimit të parandalimit dhe zbulimit të krimeve. Dobitë e tilla përfshijnë mundësinë e monitorimit dhe publikimit të trendëve të krimeve, gjë që paraqet interes madhor për qytetarët dhe sektorin privat (p.sh. plaçkitjet dhe vjedhjet e automjeteve), azhurnimin e procesit të planifikimit të operacioneve proaktive për uljen e krimeve nga kategori të caktuara dhe ofrimin e të dhënave për studime krahasuese në rajonin e Ballkanit dhe Evropë në përgjithësi.

REKOMANDIMI I EULEX- IT – DFP/2/2009

Objekti: PK, Komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit përkatës të PK-së në hartimin dhe zbatimin e një politike efektive për evidentimin, grumbullimin dhe krahasimin e krimeve sipas kategorive që janë shqetësim i qytetarëve dhe i sektorit privat, si dhe përshtatja e kategorive që përdoren nga shtetet anëtare të BE-së.

Përkatësia etnike e viktimave të krimit

Ofrimi i shërbimeve policore në një shoqëri shumetnike kërkon ndjeshmëri ndaj nevojave të grupeve etnike jo-shumicë, në veçanti aty ku krimet mund të motivohen nga qëndrimet e ndryshme ndaj personave për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Hapi i parë përfshin pranimin se disa krime të caktuara mund të jenë të motivuara etnikisht; me fjalë të tjera, pranimi se disa kryerës të veprave i kryejnë ato për shkak të ndonjë urrejtjeje apo mospëlqimi të dukshëm ndaj ndonjë personi tjetër, në bazë të përkatësisë etnike të atij personi. Pranimi i këtij aspekti të krimit është edhe më i rëndësishëm në një shoqëri të dalë nga konflikti, si Kosova, ku urrejtja etnike ka rezultuar në vrasje masive, shkatërrim të pronave dhe krime të tjera të rënda.

Krimet e motivuara etnikisht dhe nevojat e posaçme të sigurisë të komuniteteve etnike jo-shumicë janë të trajtuara me ligji. Për shembull, në nenet 7, 34 dhe 41 të Ligjit mbi Policinë kërkohet që PK-ja të angazhohet dhe të bashkëpunojë me komunitetet lokale, të sigurojë se përkatësia etnike e policëve të PK-së ta pasqyrojë atë të komunitetit që i shërbejnë dhe të konsultohen në mënyrë aktive me përfaqësuesit e komunitetit lokal lidhur me emërimin e komandantëve të stacioneve lokale policore. Këto parime gjithashtu janë të theksuara në nenin 128 të Kushtetutës. Në nenin 115 të Kodit Penal trajtohen veprat specifike të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik. Në vitin 2007, PK-ja ka evidentuar 3 krime në lidhje me nenin

115 (nxitja a urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik), ndërsa 5 raste janë evidentuar në vitin 2008.

Në kohën e vlerësimit, në vitin 2009, EULEX-i vërejti se PK-ja nuk ka kapacitete për grumbullimin dhe krahasimin e të dhënave që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike të viktimave të krimit, e aq më pak me ato që kanë të bëjnë me krimet e motivuara etnikisht, që nuk ishte në përputhje me nenin 115. Edhe pse cilësia e sistemeve të PK-së për grumbullimin, krahasimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi krimet është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që nga observimet e IPK-së në vitin 2006⁹, nuk ka politikë të evidentimit të përkatësisë etnike të viktimave apo të kategorizimit të krimeve si 'ka mundësi të jetë motivuar etnikisht'¹⁰. Në përputhje me synimin e misionit që ndërlihet me llogaridhënien dhe shumë-etnicitetin, EULEX-i rekomandon fuqimisht që PK-ja të hartojë dhe zbatojë një politikë të evidentimit, grumbullimit dhe krahasimit të dhënave mbi përkatësinë etnike të viktimave të krimit dhe të rasteve të krimeve që ka mundësi të jenë motivuar etnikisht.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/3/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve dhe udhëheqësit e shërbimeve mbështetëse

Mentorimi dhe këshillimi i personelit përkatës të PK-së në hartimin dhe zbatimin e një politike efektive për evidentimin, grumbullimin dhe krahasimin e të dhënave mbi përkatësinë etnike të viktimave të krimit dhe të rasteve të krimeve që kanë mundësi të jenë motivuar etnikisht.

Menaxhimi i performancës gjatë hetimeve dhe ndjekjes penale

Për sa i përket synimeve të EULEX-it për llogaridhënie dhe përputhshmëri me praktikën më të mirë evropiane, është jetike që sistemi i drejtësisë penale të Kosovës të ketë mundësi të paraqesë informata të qarta dhe pa dykuptimësi rreth performancës lidhur me zbulimin e krimit. Kjo kërkesë u përket të gjitha kategorive të krimeve por në veçanti krimeve të rënda. Për shembull, ekziston një pritshmëri legjitime se sistemi i drejtësisë penale ka mundësi që në mënyrë

⁹. Inspektorati i Policisë së Kosovës (2006). Raporti vjetor i vitit 2006, f. 68. Ministria e Punëve të Brendshme.

¹⁰. Krimet e motivuara etnikisht mund të përkufizohen si vepra që ndodhin kur kryerësi vë në shënjestër viktimën për shkak se i përket ndonjë grupi etnik të caktuar. Krimi mund të kategorizohet si 'ka mundësi të jetë motivuar etnikisht' nëse rrethanat janë të atilla ku motivimi i mundshëm ka qenë urrejtja apo mospëlqimi ndaj viktimës për shkak të përkatësisë etnike të tij/saj.

të qartë të paraqesë numrin e rasteve të evidentuara të vrasjeve në ndonjë vit të caktuar, dhe prej atij numri, numrin e rasteve që janë hetuar me sukses dhe kryerësit e identifikuar e të ndjekur penalisht. Kjo në veçanti vlen për Kosovën ku (siç u cek më lartë) numri i vrasjeve në vitet e fundit duket të jetë dukshëm më i lartë sesa në një numër të shteteve anëtare të BE-së.

Tabela 1.4 – Paraqitja e rasteve të vrasjeve lidhur me nenin 146 (2007 dhe 2008)											
Gjendja	Rastet e hapura				Rastet e mbyllura						Gjithsej
	Gjithsej	Joaktive	Nën hetime	Gjithsej	Të papranuara nga prokurori	Të pabaza	Referuar për ndjekje penale	Mbyllur në mënyrë të veçantë	Akuza të ngritura	Nuk ka nevojë për procedurë	
2007	45	11	34	165	-	-	114	5	35	-	210
2008	93	10	83	152	-	-	120	1	29	-	245

Tabela 1.4 paraqet të dhëna statistikore të ofruara nga PK-ja me kërkesë të EULEX-it për informata rreth zbulimit të vrasjeve në vitin 2007 dhe 2008. Formati i përdorur për paraqitjen e të dhënave është identik në të dy vitet, kurse PK-ja kishte mundësinë e paraqitjes së gjendjes së të gjitha krimeve të evidentuara në të njëjtën mënyrë. Gjendja e rasteve të krimeve të evidentuara ndahet në dy pjesë, gjegjësisht në ‘raste të hapura’ dhe ‘raste të mbyllura’. ‘Rast i hapur’ është ai rast që i nënshtrohet hetimeve aktive nga prokurori publik dhe hetuesit e PK-së, apo rasti që është përcaktuar si ‘joaktiv’ për shkak se të gjitha pistat e mundshme të hetimeve janë shteruar, por nuk është identifikuar ndonjë kryerës i dyshimtë. ‘Rast i mbyllur’ është ai rast që më nuk i nënshtrohet hetimeve aktive dhe që ka kaluar përtej fushëveprimit të hetuesve të PK-së. Gjashtë kategoritë e mbylljes janë vendosur në listë, ku të gjitha i referohen vendimit të marrë nga prokurori publik sipas dispozitave të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale. Megjithatë, nuk ka ndonjë referencë për numrin e rasteve ku personi është ndjekur penalisht me sukses dhe procesi është mbyllur.

Për sa i përket qëllimit kryesor të EULEX-it për llogaridhënie, ekzistojnë disa vrojtime që janë relevante. Së pari, ndonëse formati i PK-së e paraqet numrin e krimeve të evidentuara të vrasjeve që ishin në proces çdo vit (210 në vitin 2007 dhe 245 në vitin 2008¹¹) dhe statusin e tyre, nuk është e qartë se sa gjatë këto krime kanë qenë në 'proces'. Statistikat e ndara të krimeve të evidentuara nga Shtylla kundër krimeve e PK-së tregojnë se në vitin 2008 ishin evidentuar 55 vepra të vrasjes sipas nenit 146 (duke mos përfshirë vrasjet e rënda dhe llojet e tjera), në vitin 2007 janë evidentuar 65 vrasje. Në bazë të kësaj mund të përfundojmë se, prej 245 rasteve të hapura dhe të mbyllura në vitin 2008, 190 ishin vepra të evidentuara në vitin e mëparshëm; prej 210 rasteve të hapura dhe të mbyllura në vitin 2007, 145 ishin krime të evidentuara në vitet e mëparshme. Në mënyrë që policët e PK-së dhe prokurorët publik t'i përcjellin ndryshimet dhe ta monitorojnë performancën, do të ishte shumë e dobishme nëse formati do të identifikonte ndryshimet në numrin e rasteve sipas vitit të caktuar apo do të tregonte për vjetërsinë e rasteve.

Së dyti, formati dhe përmbajtja e statistikave për vrasjet në tabelën 1.4 duken të mjegullta dhe të paqarta. Nëse supozohet se secili rresht i referohet statusit të rasteve të vrasjeve në përfundim të çdo viti, konkludimet duket të jenë të pabazuara, në veçanti kur krahasohen me rastet e evidentuara (ndarazi) për çdo vit. Sipas të dhënave, mësohet se nga fundi i vitit 2007, kishin mbetur 45 raste 'të hapura' dhe ato janë bartur në vitin 2008. Megjithatë, nëse numri i rasteve të bartura nga viti 2007 zbritet nga numri i përgjithshëm i rasteve në proces (ato të hapura dhe të mbyllura) në vitin 2008, atëherë del se atë vit ishin 198 raste të reja. Ky konkludim duket relativisht i pabesueshëm, në veçanti nëse krahasohet me 44 rastet e evidentuara të vrasjeve të paraqitura në statistikën e Shtyllës kundër krimeve për vitin 2008. Vlen të ceket që këto vrojtime të zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të dhënave të evidentuara për një numër veprash të tjera që janë me interes për opinionin e gjerë.

Edhe pse mund të ketë shpjegim të arsyeshëm për hutinë e dukshme, parimi i llogaridhënies nuk mbështet me të dhëna mbi performancën që do të ishte i kuptueshëm për qytetarët. Ekziston një pritshmëri e arsyeshme në mesin e komuniteteve të Kosovës se prokurorët publik dhe pjesëtarët e policisë duhet t'i informojnë ata rreth efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale duke ju referuar treguesve themelorë të suksesit dhe të dështimit. Për sa i përket vrasjeve – krimi më i rëndë – këta treguesi duhet të përmbajnë: (a) një regjistër të saktë të numrit të vrasjeve në vit; (b) numrin e përgjithshëm të rasteve të vrasjeve (përfshirë pikën a) që janë evidentuar gjatë periudhës së fundit pesëvjeçare; (c) numrin (dhe përqindjen) e numrit të përgjithshëm të periudhës pesëvjeçare që

¹¹. Kolona e fundit duket të jetë numri i përgjithshëm i kolonës së parë (gjithsej rastet e hapura) dhe kolona katër (gjithsej rastet e mbyllura); megjithatë, për asnjë vit nuk ka kolonë për numrin e përgjithshëm të të gjitha kolonave të rasteve të mbyllura.

janë 'të mbyllura'; dhe numrin (dhe përqindjen) e përgjithshëm të rasteve të 'hapura' të periudhës pesëvjeçare. Shprehjet 'e hapur' dhe 'e mbyllur' (dhe çdo nënkategori tjetër) duhet të përkufizohen me qartësi dhe rezultatet, lidhur me veprat penale kryesore që janë me interes për opinionin e gjerë, duhet të publikohen dhe t'ju jepen medie. Një qasje e tillë ndaj llogaridhënies publike do të ndihmonte në promovimin e një efikasiteti më të lartë dhe do ta informonte më mirë procesin e zhvillimit të politikave për sistemin e drejtësisë penale.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/4/2009


Objektivi : PK, Komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve dhe Prokuroria Publike Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së dhe prokurorëve publikë në hartimin dhe zbatimin e një sistemi më transparent dhe të qartë të informimit të publikut rreth efektshmërisë së sistemit të drejtësisë penale.

Marrëdhëniet e Policisë së Kosovës me prokuroritë publike

Dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale me qartësi theksojnë se prokurori publik është ai i cili merr rolin udhëheqës në hetime penale. Në muajin shkurt të vitit 2009, në Kosovë ishin rreth 88 prokurorë publik, të cilët duhej t'i trajtonin rreth 64,000 krime, që paraqet një normë prej 727 krime për një prokuror. Në praktikë, natyrisht, prokurorët publik përfshihen vetëm për veprat më të rënda. Megjithatë, edhe në kuadër të këtij fushëveprimi më të ngushtë, ngarkesa e punës është shumë e madhe. Në diagramin 1.2 është paraqitur një përmbledhje e analizave të kategorive të rëndësishme të krimit në Kosovë në vitin 2008, dhe gjithashtu është paraqitur një indikacion i sfidave me të cilat përballet numri i caktuar i prokurorëve publikë.

Numri i rasteve të vrasjeve ishte 86 (neni 146, vrasje të rënda, vrasje nga pakujdesia, vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor dhe vrasje e foshnjave gjatë lindjes); 190 raste të tentim-vrasjeve; 447 raste të lëndimeve të rënda trupore; 48 raste të dhunimeve; 6282 raste të vjedhjeve të rënda (kryesisht të ngjashme me plaçkitje); dhe 1417 raste të posedimit apo përdorimit të paligjshëm të armëve. Nëse do të merreshin parasysh vetëm këto kategori të rënda, ngarkesa e mundshme e punës do të ishte mbi 96 raste për çdo prokuror në vit, apo 8 raste për çdo prokuror në muaj. Nevoja e vërtetë për prokurorë individualë ka mundësi të jetë edhe më e madhe sesa kjo që është paraqitur në këtë analizë të thjeshtë, që i jep më shumë peshë argumentit se Kodi parasheh një bashkëpunim të afërt dhe angazhim ekipor nga ana e prokurorëve dhe hetuesve të PK-së.

Diagrami 1.2 – Analizat e krimeve të regjistruara në Kosovë (2008)



Monitoruesit e EULEX-it kanë raportuar se marrëdhëniet mes hetuesve të PK-së dhe prokurorëve publik duhet të përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme. Hetuesit e PK-së tregojnë për vështirësitë e kontaktimit të prokurorëve dhe marrjes së informatave mbi rastet, si dhe për mungesë të informatave rreth rasteve pasi ta kenë kaluar statusin 'e hapur'. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur ndjesi të vërteta për dy subjekte që në masë të madhe veprojnë ndaras njëra prej tjetrës: kontaktet mes prokurorëve publik dhe hetuesve të PK-së janë minimale dhe shumë më të pakta sesa kërkohet për të krijuar një frymë ekipore në hetimet penale.

Duhet të theksohet se perceptimi i PK-së mbi marrëdhëniet me PP-në dallon nëpër rajonet e ndryshme: katër rajone i konsiderojnë marrëdhëniet të jenë të mira, ndërsa dy rajone i kanë

konsideruar këto marrëdhënie diku mes një niveli të dobët dhe të kënaqshëm. Personeli i ekipeve rajonale kundër krimeve në këto rajonet e fundit, pra në Prishtinë dhe Ferizaj, kanë ngritur çështjet në vijim:

1. Prokurorët publik shpeshherë nuk kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes së veprave të rënda;
2. Prokurorët publik rrallëherë marrin rol aktiv në udhëheqjen e ndonjë hetimi që nga fillimi, dhe kanë performancë të dobët për sa i përket udhëzimeve me shkrim dhe atyre me gojë për hetuesit e PK-së;
3. Vonesat e gjata të vendimeve gjyqësore nga prokurorët publik për shkak të për ekspertizave;
4. Vonesat e tepruara të raporteve të autopsisë/mjekësisë ligjore, raporte të cilat shpeshherë janë të paqarta sa i përket konkluzioneve që mund të përdoren si dëshmi;
5. Vonesat e gjata për marrjen e vendimeve për kryerjen apo moskryerjen e autopsive për rastet sipas nenit 186 (vrasjet), gjë që shpeshherë rezulton në konflikte me të afërmit e personit të vdekur;
6. Vonesat e gjata për dhënien e përgjigjeve ndaj shkresave dhe raporteve (nga prokurorët publik dhe gjykatësit e procedurës paraprake);
7. Gabimet e shpeshta teknike, në veçanti lidhur me masat e vëzhgimit të fshehtë;
8. Komunikimet e dobëta me PP-në lidhur me rastet e përfunduara dhe udhëzimet lidhur me dëshmitë, që rezulton në vëllime të tepërta të dëshmive të arkivuara (p.sh. dëshmitë nga rastet e vitit 1999 ende mbahen në arkivin e PK-së, në pritje të ndonjë vendimi për largimin e tyre);
9. Personeli i PP-së refuzon të pranojë dëshmi fizike me raportin për veprën (siç kërkohet nga nenet 197 dhe 207 të Kodit mbi Procedurën Penale) për shkak se kanë mungesë të kapaciteteve për deponimin e tyre;
10. PP-ja nuk bën klasifikim të qartë të veprave sipas Kodit Penal.

Nga disa observime të PK-së, pjesëtarët e policisë veçse e kanë të qartë se problemi thelbësor është numri i pamjaftueshëm i prokurorëve publik dhe vëllimi i madh i punës së tyre.

Shumë nga kompetencat për hetuesi të përshkruara në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale parashohin marrëdhënie të afërta të punës mes prokurorëve publik dhe hetuesve të PK-së; kompetencat më proaktive të vëzhgimit të përshkruara në nenin 256 fuqishëm parashohin ekipe me lidhje të afërta të hetuesve të PK-së, të udhëhequra nga prokurorët publik. EULEX-i rekomandon që nivelet e larta të PK-së dhe Prokuroria Publike të iniciojë një angazhim të përbashkët për hulumtimin e mënyrave për mundësinë e një bashkëpunimi më të afërt ekipor mes prokurorëve dhe hetuesve.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/5/2009

Objekti: PK, komandantët nga Shtylla kundër krimeve dhe Prokuroria Publike Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së dhe i Prokurorisë Publike për projektimin dhe zbatimin e një qasjeje 'ekipore' për punën hetimore dhe të mbledhjes së dëshmive, bazuar në përshtypje të vërtetë se policia dhe prokurorët i shërbejnë një subjekti të vetëm – sistemit të drejtësisë penale.

Në një raport të kohës së fundit nga Ministria e Drejtësisë mbi performancën e Prokurorisë Publike (PP)¹² paraqitet një vështrim më i thellë mbi marrëdhëniet mes prokurorëve dhe PK-së. Në këtë raport (më tej në tekst: Raporti mbi PP i vitit 2008) paraqiten një sërë vrojtimesh që janë relevante për qëllimet e misionit të EULEX-it për qëndrueshmëri dhe llogaridhënie në sistemin e drejtësisë penale të Kosovës, si dhe të përputhshmërisë së tij me praktikën më të mira evropiane.

Është shumë e qartë se në raportin e vitit 2008 mbi PP-në përdoren kategori të caktuara për vlerësimin e performancës gjatë hetimeve dhe ndjekjeve penale që deri diku janë të ndryshme nga ato që përdoren nga PK-ja. Ekzistojë dy ndarje themelore. E para, në raport analizohet numri i rasteve të krimeve (apo 'akuzat penale') në vitin 2007 sipas kategorive të kryerësve 'të njohur' dhe kryerësve 'të panjohur'¹³. Kategoria e parë ndahet në rastet kur i dyshuari i njohur është i mitur

¹². Burimi: S. Shala (2008). Raporti mbi performancën e Prokurorisë Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2007. Ministria e Drejtësisë. Kosovë

¹³. Siç nënkuptohet nga termi, rasti me 'kryerës të njohur' i referohet rastit ku, me evidentimin fillestar të krimit, kryerësi i supozuar është identifikuar nga viktimi apo ndonjë palë e tretë. Ndërsa rasti me 'kryerës të panjohur' është rasti ku, në kohën e raportimit të krimit, viktimi apo personi që e raporton rastin nuk e ka ditur identitetin e kryerësit. Andaj, përpjekjet fillestare të hetimeve mund të jenë shumë më të pakta në rastin e parë

apo i rritur. E dyta, në raportin e vitit 2008 mbi PP-në paraqitet një vështrim mbi ndarjen e punës në vitin 2007 mes punonjësve të vendosur në prokuroritë komunale dhe atyre në prokuroritë e qarkut.

Në faqen 10 të raportit mbi PP-në theksohet se “të gjitha prokuroritë kanë qenë efektive në zgjidhjen e akuzave penale” dhe tregohet se, sipas një mesatareje, çdo prokuror ‘ka zgjidhur’ 88.6 raste gjatë vitit 2007. Megjithatë, mënyra e paraqitjes së të dhënave në raportin e vitit 2008 mbi PP-në e vështirëson vlerësimin e performancës gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë penale në Kosovë. Përmes procesit të ekstrapolimit mund të nxirret një konkludim nga të dhënat e paraqitura në faqen 16 të raportit se, 41.2% e numrit të përgjithshëm të rasteve të trajtuara nga PP-ja në vitin 2007, kanë qenë të ndërlidhura me ‘kryerës të panjohur’ (d.m.th. kur hetimet penale nuk kanë arritur të identifikojnë të dyshuarin). Nëse kjo është e saktë, kjo do të thotë se sistemi i drejtësisë penale të Kosovës me sukses ka ‘zgjidhur’ 58.8% të krimeve të raportuara në vitin 2007 – gjë që tregon për një nivel të efektshmërisë që do ta kishin lakmi një numër shtetesh të BE-së.

Megjithatë, ekzistojnë probleme për sa i përket konkludimeve të raportit të vitit 2008 mbi PP-në. Së pari, shifra bazë për rastet e përgjithshme të trajtuara nga PP-ja është 37,300¹⁴, ndërsa statistikave të PK-së tregojnë se në vitin 2007 ishin mbi 61,000 vepra të evidentuara. Natyrisht, mund të jetë e mundur që PP-ja i kategorizon vetëm 37,300 vepra të evidentuara si ‘akuza penale’; megjithatë, kjo shpie në konkludimin se statusi i pothuajse 24,000 veprave të evidentuara në vitin 2007 mbetet i pashpjeguar nga sistemi i drejtësisë penale të Kosovës.

Tabela 1.6 – Krahasimi i statusit të veprave të evidentuara – PK & PP 2007

‘Statusi i veprave sipas PK-së 2007			‘Statusi e akuzave penale’ sipas PP-së 2007		
Raste të hapura	Joaktive	4541	14,480	PP-ja komunale	Kryerësit e panjohur
	Nën hetime	6331	923	PP-ja e qarkut	
	Nr. i përgjithshëm i rasteve të kategorizuara si ‘të hapura’	10,872	15,403	Gjithsej	

¹⁴. Vini re se ndonëse në tekstin në faqen 16 të raportit thuhet se 37,292 raste janë trajtuar nga PP-ja, diagrami në po atë faqe tregon se numri i përgjithshëm ishte 37,300.

Raste të mbyllura	Të refuzuara nga prokurori	585	17,340	PP-ja komunale	Kryerësit e rritur
	Të pabaza	53	2,346	PP-ja e qarkut	
	Referuar për ndjekje penale	37,589	19,686	Gjithsej	
	Të mbyllura në mënyrë të veçantë	1,793	2,018	PP-ja komunale	Kryerësit e mitur
	Akuzat e ngritura	5,185	193	PP-ja e qarkut	
	Nuk ka nevojë për veprim	7,329	2,211	Gjithsej	
	Nr. i përgjithshëm i rasteve të kategorizuara si 'të mbyllura'	56,298	21,897	Gjithsej nr. i kryerësve 'të njohur'	
Gjithsej rastet	67,170	37,300	Gjithsej rastet		

Ndonëse shifra prej 56,298 është ajo e paraqitur në statistikat e PK-së mbi statusin në vitin 2007 si numri i përgjithshëm i rasteve të 'mbyllura', ky nuk është numri i përgjithshëm i kategorive të rasteve të mbyllura. Për këto mospërputhshmëri nuk është dhënë ndonjë shpjegim.

Në tabelën 1.6 është bërë një krahasim i kategorive të 'akuzave penale' të vitit 2007 të evidentuara në raportin e vitit 2008 për PP-së me kategoritë e 'statusit të veprave të dhëna nga PK-ja në vitin 2007. Një vlerësim sipërfaqësor i të dhënave të krahasuara tregon për një mungesë të theksuar të konsensusit për sa i përket kategorive të përdorura dhe numrit të rasteve. Për sa i përket numrave të përgjithshëm, duket të jetë e pamundur të barazohen të gjeturat apo të krahasohet një pasqyrë e qartë e performancës së sistemit të drejtësisë penale të Kosovës. Pa pasur dëshirë ta shtjellojë këtë pikë, PK-ja tregon se një numër i përgjithshëm prej 37,598 raste ishin 'referuar për ndjekje penale' (që nënkupton praninë e kryerësve të identifikuar), në krahasim me 21,897 rastet që PP-ja i identifikon si raste me 'kryerës të njohur'. Dallimi madhor mes statistikave ka tendencë të ngritë dyshime mbi besueshmërinë e të dyja burimeve.

Problemi i dytë me raportin e vitit 2008 për PP-në ka të bëjë me mosparaqitjen e nivelit të performancës së prokurorëve publik (dhe, si nënkuptim, të sistemit të drejtësisë penale) për sa i

përket peshës së veprave që janë 'zgjidhur'. Për shembull, në mesin e statistikave të dhëna në faqen 28 të raportit gjendet konkludimi se 67 raste të vrasjeve (neni 146 i Kodit) kanë qenë raste pa 'kryerës të njohur'. Duke e pasur parasysh këtë, sipas asaj që është paraqitur në faqen 21 të raportit, një numër i përgjithshëm prej 137 rasteve të vrasjeve sipas nenit 146 ishin evidentuar në vitin 2007, raporti nuk nxjerrë një konkludim të rëndësishëm se sistemi i drejtësisë penale të Kosovës nuk ka arritur të zgjidhë pothuajse 49% të vrasjeve të evidentuara. Kjo moszgjidhje e rasteve të vrasjeve trajtohet vetëm si përqindje e numrit të përgjithshëm të rasteve ku nuk ka mundur të vërtetohet asnjë 'kryerës i njohur', e jo të shikohet si përqindje e numrit të përgjithshëm të rasteve të evidentuara dhe të paraqes një tregues të besueshëm të performancës. Ngjashëm me këtë, suksemi apo mosuksemi i sistemit të drejtësisë penale në trajtimin e veprave tjera të rënda mund të vërtetohet vetëm përmes një procesi të vështirë të ekstrapolimit nga të dhënat.

Observimet e cekura më lartë bëjnë që të nxiten një numër rekomandimesh në kërkim të synimit të EULEX-it për qëndrueshmëri, llogaridhënie dhe pajtueshmëri me praktikën më të mira evropiane. Së pari, PP-ja dhe PK-ja duhet të pranojnë se efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale të Kosovës është rezultat i një angazhimi bashkëpunues – siç ceket në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale – dhe është i bazuar në respektin e dyanshëm dhe njohjes së kontributit nga të dy grupet. Njohja e tillë duhet të dëshmohet me më shumë sesa një miratim të thjeshtë verbal apo i shkruar i asaj që parashihet me ligj. Duhet të demonstronhet nga një numër i strukturave të përbashkëta menaxherike që kërkojnë nga zyrtarët e PK-së dhe PP-së që bashkërisht të ndajnë përgjegjësi për vlerësimin e performancës, për planifikimin dhe për vendimet mbi politikën dhe raportet publike mbi performancën. Ky aranzhim duhet të artikulohet përmes një marrëveshjeje të përbashkët që, sapo të zbatohet, të monitorohet në mënyrë aktive nga EULEX-i.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/6/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve dhe Prokuroria Publike Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PP-së dhe KP-së në projektimin, zbatimin dhe vlerësimin e një sistemi të përbashkët për menaxhimin strategjik të hetimeve të krimeve dhe ndjekjeve penale për tërë territorin e Kosovës. Sistemi, me themelimin e tij, do t'ia mundësojë prokurorëve publikë dhe zyrtarëve të lartë policorë ndarjen e përbashkët të përgjegjësisë për vlerësimin e performancës, planifikimin, vendimet mbi politikën dhe raportet publike mbi performancën e SDP-në.

Së dyti, një vlerësim i efikasitetit të Sistemit të Drejtësisë Penale (SDP) të Kosovës – temë aktuale e raportit të PP-së – duhet të jetë shqetësim i të gjitha palëve në sistem, dhe në veçanti i policisë dhe prokurorëve publik. Si pjesë e menaxhimit të përbashkët të SDP-së (të diskutuar më lartë), një sistem i përbashkët i grumbullimit dhe krahasimit të statistikave të krimeve, të statistikave të

hetimeve të krimeve dhe të ndjekjeve penale duhet të zhvillohet nga PK-ja dhe PP-ja. Sistemi i tillë duhet të sigurojë

marrëveshje për sa i përket numrit të përgjithshëm të krimeve të evidentuara, numrit të krimeve të rënda (që janë shqetësim i qytetarëve) si dhe metoda të qarta të kategorizimit të krimeve 'të zgjidhura' dhe atyre të 'pazgjidhura'. Kjo përpjekje e përbashkët duhet që qytetarët t'i konsiderojë si arbitër përfundimtar të suksesit apo dështimit, si dhe t'i paraqesë të dhënat në një mënyrë që ia lehtëson qytetarëve një gjykim të tillë. Gjithashtu, ky sistemi duhet të pranojë përpjekjet e bëra nga të gjitha palët e SDP-së dhe të paraqesë dështimet si të përbashkëta nga të gjitha palët.

REKOMANDIMI I EULEX – IT DFP/7/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve dhe Prokuroria Publike

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PP-së dhe PK-së për projektimin, zbatimin dhe vlerësimin e një sistemi të përbashkët për grumbullimin dhe krahasimin e statistikave mbi hetimin e krimeve dhe ndjekjet penale. Sistemi duhet të sigurojë marrëveshje lidhur me numrin e përgjithshëm të krimeve të evidentuara, numrin e krimeve të rënda (që janë shqetësim i qytetarëve), si dhe metoda të qarta të kategorizimit të krimeve 'të zgjidhura' dhe atyre 'të pazgjidhura'.

Së treti, llogaridhënia kërkon që personat përgjegjës për menaxhimin e sistemit të drejtësisë penale të Kosovës t'i japin llogari qytetarëve. Një raport i përbashkët mbi performancën e përgjithshme të SDP-së duhet të publikohet çdo vit nga strukturat e përbashkëta menaxherike të cekura më sipër. Raporti duhet të ketë format dhe formulim gjuhësor që ia mundëson qytetarëve kuptimin e shkallës së suksesit në luftimin e krimeve, në veçanti të krimeve të rënda, të organizuara dhe të kategorive të tjera që janë shqetësuese për qytetarët. Të dhënat duhet të paraqiten në atë mënyrë që e bën të qartë vëllimin e krimeve në çdo kategori të rëndë dhe përqindjen e rasteve që janë hetuar me sukses dhe zgjidhur përmes ndjekjes penale apo ndonjë mase tjetër ligjore.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/8/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve dhe Prokuroria Publike

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PP-së dhe PK-së për projektimin, përgatitjen dhe publikimin e një raporti vjetor mbi performancën e sistemit të drejtësisë penale të Kosovës. Të dhënat duhet të paraqiten në atë mënyrë që e bën të qartë vëllimin e krimeve nga çdo kategori e ëndë dhe përqindjen e rasteve që janë hetuar me sukses dhe zgjidhur përmes ndjekjeve penale apo ndonjë mase tjetër ligjore.

Përveç kësaj, raporti duhet të ketë format dhe formulim gjuhësor që do t'i mundësonte qytetarëve një kuptim të lehtë të shkallës së suksesit në luftimin e krimeve dhe në veçanti të krimeve të rënda dhe atyre të organizuara, si dhe të kategorive të tjera të krimeve që janë shqetësim i qytetarëve.

Përgatitja e një raporti të vetëm vjetor mbi sistemin e drejtësisë penale do të ndihmonte për synimet e dëshiruara për një bashkëpunim më të afërt të policisë dhe prokurorëve dhe do të vinte në pah dhe respektonte kontributin e rëndësishëm të bërë nga personeli i të dyja organizatave.

KAPACITETET E INTELIGJENCËS PËR KRIMET

Drejtoria për Analizë të Krimit (DAK) përbëhet prej tri njësive funksionale: sektori i inteligjencës, sektori për analizë dhe statistika të krimit dhe sektori i mbështetjes. Duhet të theksohet se ekziston një mungesë e hollësive të mjaftueshme në përshkrimet e vendeve të punës së DAK-ut për përcaktimin e llojit të aftësive kyçe që kërkohen dhe trajnimet që mund të ofrojnë aftësitë e tilla. Një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve të inteligjencës nuk kanë vijuar ndonjë trajnim formal.

Struktura e personelit dhe e udhëheqjes së DAK-ut është e pakompletuar. Për sa i përket pozitave të rëndësishme menaxherike, drejtori dhe zëvendësdrejtori ende nuk janë emëruar, kurse këto funksione ushtrohen nga zyrtarë të cilët janë 'ushtrues detyre'. Që nga fillimi i funksionimit në vitin 2005, në DAK ka pasur lëvizje të mëdha të personelit dhe ende nuk është stabilizuar si organizatë e qëndrueshme, me zhvillimin e përvojës dhe ekspertizës individuale dhe të përbashkët. Duke e pasur parasysh rolin e saj vendimtar në udhëheqjen e përpjekjeve për zhvillimin e kapaciteteve të PK-së për operacionet policore të 'bazuara në inteligjencë', DAK-ja duhet të jetë qendra e angazhimeve të përbashkëta për zhvillimin e plotë të mandatit, strukturës dhe kapacitetit të saj.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/9/2009

Objektivi: PK, zyrtarët e lartë për hetimin e krimeve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së për zhvillimin e një strukture organizative, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe të efikasitetit të përgjithshëm të DAK-ut si qendër e sistemit të inteligjencës penale të PK-së.

Në të gjitha katër shtyllat e PK-së (krimet, kufijtë, operacionet dhe administrata) DFP i EULEX-it ka vërejtur një mungesë të vazhdueshme të planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe një njohje të pamjaftueshme të vlerave të këtij planifikimi nga ana e zyrtarëve të lartë. Përpjekjet për të shtyrë përpara me shpejtësi PK-në drejt vizionit të saj si një organizatë proaktive, me kapacitete të trajtimit të krimeve të rënda dhe atyre të organizuara, do të ndihmohen nëse zyrtarët e lartë të PK-së i planifikojnë me kujdes aktivitetet dhe burimet e tyre në një afat të gjatë.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/10/2009

Objekti: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve, të operacioneve, të kufijve dhe Shtyllës së administratës

Ngritja e kapaciteteve për një planifikim afatmesëm dhe afatgjatë.

Tabela 1.7 – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtoria për analizë të krimit (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përmbushja		Objekti	Komenti
Struktura e personelit, përcaktimi i roleve dhe trajnimet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Kërkohej zhvillimi i përcaktimit të roleve nevojiten më shumë trajnime për ngritjen e aftësive themelore. Nevojë për përfundimin e shpejtë të procesit të ngritjes së DAK-ut në një organizatë të qëndrueshme.
Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	37.9% femra dhe 3.4% pakica etnike.
Objektet/Pajisjet	Dobët		Kënaqshëm	Komunikimet me radio dhe telefon, pajisjet audio-vizuale dhe ato të vëzhgimit janë joadekuate në shumë fusha. Në disa fusha nuk ka mjaft automjete.
Ligji/DPP/PSO-të	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka ligj për mbrojtjen e të dhënave
Menaxhimi i mungesave	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	N/A		Kënaqshëm	Nuk vlen – nuk ka rol operativ. Nuk ka ligj për mbrojtjen e të

					dhënave
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Mirë		Kënaqshëm		
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm		Nevojë për zhvillim të mëtejshëm për sa i përket planifikimit afatgjatë
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Mirë		Kënaqshëm		
Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	Dobët		Kënaqshëm		Ndonëse ekziston dëshira për shtimin e aktiviteteve proaktive, kapacitetet e tanishme janë të pakta
Marrëdhëniet me PP-në	N/A		Mirë		Nuk ka kontakte pune

Siç paraqitet në tabelën 1.7, nga vlerësimi i bërë DAK-së nga ana e EULEX-it shihet se ekzistojnë një numër i të metave për sa i përket pajisjeve bazike që nevojiten për mbledhjen e informatave dhe zbulimin proaktiv të krimit. Këto observime përfshijnë: (a) në shumë rajone komunikimet me telefon dhe radio janë të një standardi të dobët apo shumë të dobët; (b) vetura, pajisje audio-vizuale dhe të vëzhgimit të pamjaftueshme në shumë rajone; dhe (c) DAK-u përdor rrjete të pasigurta dhe ka mungesë të softuerit për analizë të dhënave. Ndonëse ekspertët e EULEX-it vërejnë se mungesa e pajisjeve dhe teknologjive më të sofistikuara nuk është diçka e pazakontë në kontekst të Ballkanit perëndimor, mungesa e tij në PK është barrierë në zhvillimin e mëtejshëm të mundësive të operacioneve policore proaktive. Me fjalë tjera, synimi i misionit për arritjen e një niveli sipas praktikave më të mira evropiane do të kërkojë investime kapitale të konsiderueshme.

Siç ndodh me funksionet e tjera të specializuara për çështjen e krimeve, mungesa e personelit nga pakicat etnike, në veçanti e serbëve etnik, vazhdon të paraqesë sfida të konsiderueshme për udhëheqësit e PK-së. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur një gatishmëri të sigurtë nga ana e udhëheqësve të PK-së për rritjen e numrit të zyrtarëve nga pakicat nëpër fushat e specializuara, siç është DAK-u. Megjithatë, kjo duhet të bëhet brenda dispozitave të ligjit dhe doracakut për politika dhe procedura, ndërsa kjo kërkon që të gjithë kandidatët t'i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim. Udhëheqësit e PK-së theksuan faktin se shumë serbë etnik preferojnë të punojnë nëpër komunitetet e tyre dhe nuk i tërheqin funksionet e specializuara në Shtabin kryesor të PK-

së. Mungesa e kandidatëve nga pakicat etnike ka bërë që një pjesë e madhe e funksioneve të specializuara të ushtrohen nga personeli shqiptar dhe, duke pasur parasysh mungesën e një politike për karrierë, mundësitë e ardhshme për personelin nga pakicat, në veçanti nëse bëhet zbutja e mosmarrëveshjeve politike, do të zvogëlohen në mënyrë të pashmangshme.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur një përdorim të shtuar të planifikimit nga udhëheqësit e DAK-ut si dhe të përpjekjeve për ndërlidhjen e punës së tyre me objektivat e përgjithshme të përkufizuara në Planin strategjik të PK-së 2008/10 dhe Planin strategjik të DAK-ut, por gjithashtu kanë vërejtur se ka vend të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm. Gjithashtu është vërejtur se udhëheqësit e DAK-ut janë më të shqetësuar lidhur me procesin sesa me atë që procesi ka për qëllim ta arrijë. Me fjalë tjera, udhëheqësit janë më të shqetësuar për punën rreth dokumentacionit sesa me vet rezultatet që dalin nga procesi i planifikimit. Si rezultat i synimeve të misionit të EULEX-it, sugjerohet që personeli i EULEX-it për monitorim, mentorim dhe këshillim të ndihmojë të mënyrë aktive udhëheqësit përkatës të PK-së në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive planifikuese, me theks të posaçëm për menaxhimin e zbatimit dhe vlerësimin e rezultateve.

Ekspertët e EULEX-it e kanë vlerësuar si shumë të dobët mundësinë e PK-së për krijimin e planeve të bazuara në inteligjencë. Është vërejtur se planifikimi afatmesëm dhe ai afatgjatë është një dobësi e përhapur menaxherike në shtyllën e PK-së kundër krimeve. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se në rajone ka zyrtarë me njohuri të kufizuara apo zyrtarë që nuk kanë fare njohuri rreth dobive të mundshme të kësaj aftësie menaxherike. Gjithashtu është vërejtur se këta zyrtarë kishin edhe më pak njohuri rreth hartimit të dokumenteve të tilla planifikuese.

Siç duket DKA-ja shfrytëzohet si 'burim retroaktiv', e jo si qendër e një qasjeje proaktive për trajtimin e krimeve. Të dhënat përdoren për gjetjen e informatave rreth të dyshuarve vetëm pasi të jenë arrestuar dhe hetuar. Është vërejtur se udhëheqësit e lartë të PK-së kanë bërë përpjekje për zbatimin e një sistemi të bazuar në inteligjencë me DAK-un në qendër, por deri më tani kjo gjë ka pasur pak sukses. Ndaj inteligjencës dhe informimit ekziston një qëndrim tejet fanatik: çdo njësi, ekip dhe stacion e ruan korpusin e vet të inteligjencës, kurse rolin e vet e shohin si konkurrencë me pjesët e tjera të organizatës. Monitoruesit e EULEX-it e kanë vërejtur këtë qëndrim konkurrues në nivel të zyrtarëve individual. Rezultati përfundimtar është se DAK-u ka mungesë të dhënave esenciale dhe të sakta, andaj PK-ja nuk mund të arrijë potencial dukshëm më të madh që rezulton nga këmbimi i informatave dhe nga një qëllim i përbashkët. Këto probleme kombinohen me një keqkuptimin të përgjithshëm të qëllimit të DAK-ut në mesin e komandantëve të lartë të PK-së. Sipas monitoruesve të EULEX-it, shumë udhëheqës të lartë nuk mund të bëjnë dallime mes inteligjencës penale (apo për krime) dhe inteligjencës shtetërore për siguri. Me rastin

e demonstratave publike, kapacitetet e Njësisë rajonale të inteligjencës shfrytëzohen nga komandantët rajonal për të plotësuar nevojën për informacione rreth mbledhjes së informacioneve mbi rendin dhe sigurinë publike. Informatat e inteligjencës jepen përmes zinxhirit komandues, e jo përmes strukturave të inteligjencës, duke krijuar kështu mundësinë për zbulim të informatave dhe për rreziqe të ndërlidhura me rrezikimin e burimeve të informatave të inteligjencës.

Policia e Kosovës pranon se ka nevojë për zhvillimin e plotë të operacioneve policore të bazuara në inteligjencë, sipas modelit të përshkruar në një iniciativë të kohës së fundit të OSBE/OMIK. EULEX-i rekomandon fuqishëm që programi për zbatimin e operacioneve policore të udhëhequra nga inteligjenca duhet të jetë në mesin e dhjetë prioritetëve kryesorë të komandantëve të lartë të PK-së në tri vitet e ardhshme. Ajo që kërkohet është e ndërlikuar dhe e vështirë, pra krijimi i një kulture për mbledhjen e informatave në mesin e zyrtarëve të PK-së, sisteme efektive të krahasimit dhe analizimit të dhënave të inteligjencës, dhe mundësia për planifikimin proaktiv të operacioneve në bazë të dhënave. Monitoruesit e EULEX-it, nga fusha e krimeve, të kufijve dhe operacioneve, do t'í ndihmojnë PK-së për një program të shkallës së gjerë për zbatimin e operacioneve policore të bazuara në inteligjencë gjatë kohëzgjatjes së misionit. Synimi do të jetë që komandantët e PK-së të ndihmohen në zbatimin e një sistemi të vetëm në të gjitha shtyllat, duke kontribuar në një rrjet të përbashkët me DAK-un (apo pasardhësin e saj) që do të jetë në qendër dhe duke kontribuar në operacionet proaktive në PK.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/11/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të Shtyllës kundër krimeve, të kufijve, të operacioneve, të shërbimeve të mbështetjes, të personelit dhe të trajnimeve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së në zbatimin e plotë të programit (të sponsoruar nga OSBE-ja) për zbatimin e operacioneve policore të bazuara në inteligjencë në tërë organizatën. Ky program i ndërlikuar do të shtrihet në disa nivele të ndryshme në të njëjtën kohë, dhe përfshinë krijimin e një kulture për mbledhjen e inteligjencës në mesin e të gjithë zyrtarëve të PK-së, përdorimin e formave dhe sistemeve të përbashkëta për mbledhjen e informatave, një rrjet të vetëm me DAK-un (ose pasardhësin e tij) në qendër, kapacitetet për krahasimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe planifikimin e operacioneve proaktive duke u bazuar në të dhënat e tilla të inteligjencës.

Menaxhimi i të dhënave nga Policia e Kosovës

Ekspertët e EULEX-it kanë bërë një numër vrojtimesh të hollësishme lidhur me anët e dobëta të sistemit informativ të Policisë së Kosovës. Çështjet në vijim janë ato më të rëndësishmet: (a) regjistrimet e të dhënave në nivelin rajonal shpesh herë bëhen 5-7 ditë pas ngjarjes dhe

regjistruhen me gabime në sistem; (b) dizajni i bazës së të dhënave është joadekuat dhe ka mungesë të sigurisë (qasja bëhet përmes një intraneti të pasigurt); (c) procedurat standarde të operimit për rregullimin e cilësisë së regjistrimeve janë të pamjaftueshme dhe personeli civil nuk ka trajnime të mjaftueshme; (d) në sistem mund të qasen të gjithë shfrytëzuesit, kurse sistemi nuk ka nivele të kufizimit (ku si pasojë e kësaj drejtoritë kundër krimeve të rënda dhe krimeve të organizuara refuzojnë të regjistrojnë të dhëna); dhe sistemi informativ i Policisë së Kosovës ka mungesë të informatave mbi mënyrën e veprimit, si dhe nuk ka mundësi për t'i pranuar fotografitë e kriminelëve të dënuar. Është vërejtur se udhëheqësit e PK-së duket se nuk janë të gatshëm të përdorin të dhëna statistikore si instrument për analizimin objektiv të performancës, por preferojnë të përdorin statistikën vetëm për t'i mbështetur deklaratat e performancës së suksesshme. Ekziston një përdorim i pamjaftueshëm i analizave krahasimtare për vlerësimin e trendëve për sa i përket krimeve dhe performancës, por nuk ka udhëzime të dokumentuara për përdorimin e këtij instrumenti menaxhues.

Që nga themelimi i PK-së në vitin 1999, nuk është bërë asnjë përpjekje për hulumtimin e nivelit të mundshëm të krimeve të raportuara në Kosovë. EULEX-i ka vërejtur se sistemi i PK-së, në të cilin tani bëhet regjistrimi i krimeve sipas nenit përkatës të Kodit Penal, paraqet një pasqyrë të shtrembëruar të niveleve të krimeve sepse nuk arrin t'i dallojë rastet që përbëjnë më shumë se një vepër. Siç u theksua më lartë, ndoshta vrojtimi më domethënës ka të bëjë me mungesën e simetrisë mes sistemit të PK-së dhe sistemit të dhënave që përdoret nga sektori i drejtësisë, në veçanti në PP dhe gjykata. Kjo ia vështirëson shumë udhëheqësve të PK-së vlerësimin objektiv të performancës në trajtimin e krimeve dhe të kategorive specifike të krimeve.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/12/2009

Objektivi: PK, udhëheqësit e lartë për shërbime mbështetëse dhe komandantët e lartë kundër krimeve, të kufijve dhe të operacioneve.

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së për projektimin dhe zbatimin e një sistemi informativ të qëndrueshëm dhe efektiv, në pajtueshmëri të plotë me praktikën më të mira evropiane. Kjo duhet të përfshijë identifikimin e një donatori për të ndihmuar lidhur me prokurimin dhe instalimin e sistemeve të nevojshme të softuerit dhe me nevojat

Hetimi i krimeve në nivel të stacioneve

Monitoruesit e EULEX-it kanë bërë një vlerësim themelor të performancës së të gjitha stacioneve dhe personelit të tyre për hetimin e krimeve. Ndonëse është e vështirë të bëhen përgjithësime kuptimplote në këtë numër kaq të madh të stacioneve me lloje të ndryshme të

performancës, vrojtime të caktuara mund të bëhen në bazë të raporteve të EULEX-it lidhur me anët e forta dhe të dobëta në këtë nivel të rëndësishëm të hetimit të krimeve.

Në mbi tridhjetë stacione policore në Kosovë, hetuesit e krimeve qëndrojnë në zyra të përbashkëta me kolegët e tyre nga Shtylla e operacioneve. Kushtet e këtyre ndërtesave kanë dallime të mëdha, për sa i përket kapacitetit dhe pajisjeve. Disa stacione paraqesin probleme të caktuara për hetuesit e krimeve. Për shembull, hetuesit që punojnë në stacionin policor në Dragash kanë një ndërtesë me kushte shumë të dobëta, pajisje themelore të dobëta dhe sisteme të dobëta të komunikimit. Mungesa e lidhjeve të zakonshme telefonike (dhe e telefonave mobilë) do të thotë se është shumë e vështirë të kontaktohet PP-ja lidhur me rastet¹⁵. Problemet lidhur me komunikimin e dobët dhe joadekuat telefonik janë parë në një numër stacionesh policore rurale, ndërsa këto probleme duhet të vazhdojnë të trajtohen si pjesë e planit për investime kapitale të PK-së për 3 – 5 vitet e ardhshme. Në disa rajone është parë të ketë vetura të pamjaftueshme për hetuesit e krimeve, ndërsa hapësira e zyrave dhe pajisjet janë konsideruar si të dobëta apo të pamjaftueshme për mbështetjen e operacioneve.

Pavarësisht kushteve shpeshherë të vështira të punës dhe pajisjeve joadekuate, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur një gatishmëri në mesin e hetuesve dhe mbikëqyrësve të tyre për luftimin proaktiv dhe reaktiv të krimeve. Gjithashtu, ekziston gatishmëria për luftimin e grupeve kriminale. Një regjim stabil dhe konsistent i punës është duke funksionuar në shumicën e rajoneve dhe përfshin një sistem të mirë të kontrollimit të cilësisë së raporteve të krimeve dhe dokumentacionit përkatës.

Në shumë sfera ose ka mungesë të plotë të planifikimit afatmesëm (1 – 3 vite) ose, aty ku ka planifikim, cilësia e atij planifikimi është e dobët. Menaxhimi i aktiviteteve ka tendencë të bëhet në baza ditore përmes diskutimeve dhe seancave verbale informuese, e jo në mënyrë të shkruar. Personeli i EULEX-it ka vërejtur një mungesë të dukshme të kuptueshmërisë së dobive që rrjedhin nga planifikimi në mesin e mbikëqyrësve dhe udhëheqësve. Trajnime të mëtejme për këtë aftësi menaxherike janë padyshim të dëshirueshme.

Një sferë tjetër shqetësuese në nivel të stacionit është mungesa e kuptimit dhe praktikës së strategjisë për operacione policore të bazuara në inteligjencë dhe e konceptit të 'ciklit të

¹⁵. Stacioni policor i Dragashit ka një telefon V-Sat, nuk ka faks dhe radiot VHF kanë mbulueshmëri të kufizuar apo jo të plotë.

inteligjencës¹⁶. Për shembull, shumë nga stacionet me shumë punë në rajonin e Prishtinës janë vlerësuar nga EULEX-i si 'të dobëta' në këtë fushë kritike. Ekziston një dëshmi e qartë e mungesës së kuptueshmërisë së ciklit të planifikimit: gjegjësisht të mbledhjes, krahasimit dhe analizimit të dhënave të inteligjencës dhe llojeve të krimeve, pastaj përdorimit të gjeturave për azhurnimin e procesit të gjenerimit të planeve proaktive që kanë për shënjestër kriminelët (apo grupet kriminale) ose të llojeve të krimeve nëpër lokacione të caktuara. Në shumë stacione, udhëheqësit dhe mbikëqyrësit asnjëherë nuk kishin dëgjuar për sistemin e raportimit 5x5 apo për përdorimin e ngjashëm të një qasjeje unike për mbledhjen e të dhënave të inteligjencës. Sistemi i përgjithshëm është se inteligjenca ka tendencë të ndahet bashkërisht në mënyrë verbale dhe ka mungesë të strukturës dhe metodologjisë.

Shtabi i PK-së kundër krimeve – Udhëheqja dhe mbështetja nga qendra

Drejtoria Kundër Krimeve të Organizuara (DKKO) është një projekt në zhvillim e sipër e cila ka mungesë të qartësisë strukturore dhe aktualisht përbëhet prej njësisë ndërkufitare, njësisë për hetuesi financiare dhe njësisë për inteligjencë. Duket se ka problem me përkufizimin e roleve të personelit, dhe vetëm 15% e personelit kanë detyra të përkufizuara në mënyrë të qartë, të cilat mund t'i shpjegojnë. Siç ndodh edhe me fushat e tjera, DKKO-ja ka nevojë për investime të mëtejme për përmirësimin e pajisjeve themelore të saj, siç janë veturat.

Tabela 1.10a – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtoria kundër krimeve të organizuara (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përbushja	Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Kënaqshëm	Kënaqshëm	Struktura është në shqyrtimit

¹⁶. Ndonëse ka qasje të ndryshme të miratuara në praktikën më të mirë evropiane, cikli i inteligjencës zakonisht përfshinë komponentët në vijim: Drejtimin, mbledhjen, krahasimin, vlerësimin, analizimin, shpërndarjen dhe prapë drejtimin.

Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	9% zyrtare femra dhe vetëm një zyrtar etnik serb (2%).
Pajisjet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Pajisjet themelore kanë nevojë për përmirësim
Ligji/DPP/PSO-të	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Mirë		Kënaqshëm	Disa zyrtarë e konsiderojnë pushimin mjekësor si një e drejtë që patjetër duhet të shfrytëzohet
Menaxhimi i përputhshmërisë	Shumë mirë		Kënaqshëm	EULEX ka vërejtur një standard të mirë të sigurimit të përputhshmërisë me ligjin dhe DPP.
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Është vërejtur nuk kontrollohet i tërë dokumentacioni nga mbikëqyrësit .
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	Mungesa e një strategjie të shkruar për luftimin e krimit të organizuar
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Vend të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm
Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	Dobët		Kënaqshëm	Mungesa e një cikli të plotë të inteligjencës ulë efektshmërinë e DKKO-së
Marrëdhëniet me PP-në	Kënaqshëm		Mirë	Marrëdhëniet janë duke u përmirësuar, por jo sipas standardeve të mira që kërkohen

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se udhëheqësit e DKKO-së kanë një standard shumë të mirë që siguron se personeli i tyre është duke vepruar në përputhje me ligjin dhe Doracakun për Politika dhe Procedura (DPP).

DKKO-ja do të përfitonte nga një dokument i hollësishëm strategjik i cili do të përkufizonte synimet dhe objektivat e saj. Kjo ndoshta e shpjegon mungesën e qartësisë lidhur me strukturën e

drejtorisë dhe përkufizimin e roleve të personelit të saj. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se ekziston një mungesë e drejtimit në nivel ministror dhe të komandantëve të lartë të PK-së, si dhe në nivelet më të ulëta të menaxhimit brenda shtyllës së PK-së kundër krimeve – nuk ka politikë të shkruar apo strategji të përgjithshme që formëson përpjekjet për trajtimin e krimeve të organizuara. E ndërlidhur me këtë çështje është nevoja për zgjerimin e madh të përdorimit të statistikave mbi strukturën e krimeve dhe inteligjencës për planifikimin e veprimtarive të DKKO-së. Siç u theksua, mungesa e një cikli plotësisht funksional të inteligjencës (në organizatën e PK-së) për të informuar procesin e planifikimit e zvogëlon efektshmërinë e DKKO-së. Kjo mungesë e inteligjencës ka ulur kapacitetin e DKKO-së për udhëheqjen e operacioneve proaktive për luftimin e grupeve të krimeve të organizuara, dhe kjo duhet të jetë fokusi i zhvillimit të mëtejshëm.

REKOMANDIMI I EULEX-IT DFP/13/2009

Objektivi: PK, zyrtarët e lartë për hetimin e krimeve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit përkatës të lartë të PK-së për zhvillimin e plotë të Drejtorisë kundër krimeve, të organizuara si pikë qendrore e strategjisë proaktive të PK-së dhe qendër të shkëlqesisë për operacione policore të bazuara në inteligjencë. Puna për zhvillimin e potencialit të DKKO-së është drejtpërsëdrejti e lidhur me strategjinë më të gjerë për zbatimin e operacioneve policore të bazuara në inteligjencë.

Drejtoria Kundër Krimeve të Rënda (DKKR) përbëhet prej pesë sektorëve: hetimi i krimeve të rënda, dhuna në familje, hetimi i krimeve ekonomike dhe i korrupsionit, krimet e luftës dhe bashkëpunimi e bashkërendimi me ekipet rajonale kundër krimeve. Sikurse edhe me fushat e tjera, përshkrimet e vendeve të punës së personelit të DKKR-së i referohen përgjegjësive të përgjithshme të posteve të caktuara të PK-së e jo funksioneve të specializuara që kryhen nga policët.

Tabela 1.10b – Tabela 1.10c – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtoria kundër krimeve të rënda (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përbushja	Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Kënaqshëm	Kënaqshëm	Personel i pamjaftueshëm dhe role jo mirë të përkufizuara

Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	27.7% femra dhe 1.7% pjesëtarë nga komunitetet etnike jo-shumicë.
Pajisjet	Mirë		Kënaqshëm	
Ligji/DPP/PSO-të	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësisë së punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Kërkohe më shumë monitorim, mentorim dhe këshillim për vlerësim
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Nevojë për përmirësim
Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	N/A		Kënaqshëm	
Marrëdhëniet me PP-në	Kënaqshëm		Mirë	

Për sa i përket planifikimit strategjik, është vërejtur se drejtoria, që në përgjithësi është më shumë reaktive sesa proaktive, më shumë trajton rastet e raportuara sesa që i lufton kriminelët. Ndonëse e inkurajon përdorimin e sistemit të raportimit të inteligjencës 5x5x5, DKKR-ja nuk e konsideron veten të jetë në majë të sistemit të inteligjencës meqë nuk është proaktive në luftimin e krimeve apo kriminelëve. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se udhëheqësi i sektorit të dhunës në familje ka nevojë për më shumë trajnime për caktimin e prioriteteve dhe detyrave, si dhe planifikimin e duhur të veprimtarive. Ky problem mund të ndërlidhet pjesërisht me mungesën e një deklaratë të qartë të misionit, me qëllime dhe objektiva të përkufizuara për sektorin kundër dhunës në familje.

Për sa i përket marrëdhënieve të komponentëve hetuese të DKKR-së me personelin e PP-së,

vlerësimi i përgjithshëm është 'i kënaqshëm'. Megjithatë, vlen të ceket se personeli i DKR-së ka theksuar se, në raste të shumta, hetuesit e PK-së u tregojnë prokurorëve publik se çfarë të bëjnë sesa që ndodh e kundërta, siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu është raportuar se personeli i PP-së rrallëherë i sigurojnë personelit të DKKR-së informata rreth rasteve që kalojnë në ndjekje penale, kurse shkëmbimi i informatave nga ana e PP-së është i dobët.

Funksioni i specializuar i hetimit të **krimeve financiare** kryhet nga Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (SHKEK) i Drejtorisë kundër krimeve të rënda. Është menduar që ky sektor të përbëhet prej katër njësie: krimet ekonomike, anti-korrupsioni, falsifikimi dhe inteligjenca. Pavarësisht potencialit të konsiderueshëm të një qasjeje të tillë të specializuar ndaj asaj që mund të jetë kërcënim madhor për qëndrueshmërinë e shoqërisë kosovare, ky sektor ende nuk është zhvilluar në atë nivel që të ketë mundësi reale të ndikimit proaktiv. Asnjëherë nuk i ka arritur nivelet e planifikuara të personelit, ka pasur lëvizje të mëdha të personelit dhe ka mungesë të përkufizimit të duhur të roleve (që do të thotë përshkrime të përgjithshme të vendeve të punës sipas posteve e jo përshkrime specifike sipas roleve). Prej muajit tetor 2008, ky sektor përbëhet prej vetëm një njësie, pra prej njësisë kundër krimeve ekonomike (5 zyrtarë), sepse njësitë e tjera janë transferuar për të formuar një pjesë të një "task force" speciale (nën kontrollin e komisionarit) për të punuar kundër kontrabandës dhe shmangies së tatimit.

Përveç problemit të përkufizimit të dobët të roleve, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se personeli i këtij sektori është angazhuar në trajtime gjithëpërfshirëse pavarësisht angazhimeve të punës dhe që shpeshherë kanë pak lidhje me objektivat e sektorit. Ka pasur dëshmi të keqpërdorimit të privilegjeve për pushim mjekësor (ku ditët e pushimit mjekësor zakonisht ndodhin të hënave apo në fund të pushimit vjetor), që përbën mungesë të menaxhimit të mungesave që ndërliken me trajtime.

Tabela 1.10c – Vlerësimi themelor organizativ – Sektori për hetimin e krimeve ekonomike dhe të korrupsionit (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përbushja	Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Dobët	Kënaqshëm	Personel i pamjaftueshëm dhe strukturë e pakompletuar

Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka personel nga komuniteti jo-shumicë dhe është një police femër.
Pajisjet	Dobët		Kënaqshëm	Pajisje të dobëta dhe vetura të pamjaftueshme, telefona të pamjaftueshëm, siguri e dobët e TI-së
Ligji/DPP/PSO-të			Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Dobët		Kënaqshëm	Mungesa të shumta nga puna për shkak të trajnimeve dhe disa dëshmi të keqpërdorimit të së drejtës për pushim mjekësor
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Nevojitet më shumë monitorim
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Shumë mirë		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Mirë		Kënaqshëm	
Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	N/A		Kënaqshëm	Burimet e pakta e kufizojnë SHKEK për të riaktivizuar punën
Marrëdhëniet me PP-në	Mirë		Mirë	Nuk është raportuar për ndonjë problem

Drejtoria e forenzikës përbëhet prej tri sektorëve: vendi i ngjarjes së krimit, fotografimi digjital dhe administrata. Kjo drejtori është pjesë funksionale e organizatës me një strukturë të mirë, me një përfaqësim të mirë të përgjithshëm gjinor dhe etnik. Megjithatë, ndonëse femrat përbëjnë 33% të personelit të Shtabit kryesor, në qendër të organizatës nuk ka policë nga komunitetet etnike jo-shumicë.

Ndonëse intervistat e EULEX-it me udhëheqësit e forenzikës tregojnë për marrëdhënie të 'kënaqshme' të punës me personelin e PP-së, shefi i njësisë rajonale të Prishtinës për forenzikë ka theksuar një numër të çështjeve që fuqizojnë perceptimet e hetuesve të krimeve. Është

theksuar se prokurorët publik shpeshherë paraqiten me vonesë në vendngjarjen e krimit, se është vështirë të kontaktohen prokurorët gjatë orëve të natës dhe se prokuroria publike shpeshherë refuzon të pranojë dëshmi fizike me raportin për krimin. Çështja e fundit, e kombinuar me vonesat e shpeshta të udhëzimeve nga prokuroria publike lidhur me rastet e përfunduara, ka rezultuar që dhomat e dëshmive të PK-së të jenë të stërbushura me materialet e deponuara.

Tabela 1.10d – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtoria e forenzikës (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	E strukturuar siç duhet me personel të trajnuar
Përbërja etnike/gjinore	Mirë		Kënaqshëm	20.6% femra dhe 11.5% nga komunitetet jo-shumicë
Pajisjet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	PK-ja është në proces të përmirësimit së pajisjeve në tërë organizatën.
Ligji/DPP/PSO-të			Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Kërkohet më shumë monitorim
Menaxhimi i përputhshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Mirë		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	N/A		Kënaqshëm	Analizat e trendëve të krimeve mund të përdoren për të përcaktuar shpërndarjen e duhur të personelit nëpër rajone.

Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	N/A		Kënaqshëm	
Marrëdhëniet me PP-në	Kënaqshëm		Mirë	Një numër çështjes sugjerojnë nevojë për përmirësim

Sektori kundër trafikimit të qenieve njerëzore është nën komandën e Drejtorisë kundër krimeve të organizuara dhe paraqet një funksion të rëndësishëm të specializuar. Ky sektor përbëhet nga një zyrë qendrore në Shtabin kryesor të PK-së dhe nga njësitë rajonale nën kontrollin e komandantit përkatës rajonal.

Tabela 1.10e –Vlerësimi themelor organizativ– Trafikimi i qenieve njerëzore (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë		Kënaqshëm	Strukturë e mirë dhe i tërë personeli është i trajnuar siç duhet dhe i vetëdijshëm për rolin e tyre. Plane për të centralizuar njësitë rajonale.
Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	20.6% femra; një polic nga komuniteti jo-shumicë
Pajisjet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Nevojë për pajisje të vëzhgimit të fshehtë për të lehtësuar punën proaktive
Ligji/DPP/PSO-të			Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	

Menaxhimi i performancës/cilësisë së punës	Mirë		Kënaqshëm	Sistem i efektshëm për kontrollimin e dokumentacionit
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Kapacitete të mira për planifikimin afatshkurtër, por ekziston një nevojë për zhvillimin e kapaciteteve të planifikimit afatmesëm dhe atij afatgjatë.
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka përdorim të operacioneve policore të bazuara në inteligjencë. Përdorim i pamjaftueshëm i analizave të trendëve të krimeve.
Kapacitetet dhe gatishmëria për zbulimin proaktiv të krimeve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Tendencë e shtuar për luftimin proaktiv të grupeve kriminale
Marrëdhëniet me PP-në	Kënaqshëm		Mirë	Në shumicën e rajoneve marrëdhëniet janë të mira; megjithatë në Prishtinë janë vërejtur një numër problemesh.

Në këtë sektor janë të punësuar 6 police femra (20.6%) dhe vetëm një polic nga përkatësia etnike jo-shumicë (boshnjak). Ekziston një plan për ta centralizuar kontrollin e njësisve rajonale, ku do të mundësohet një strategji më konsistente dhe unike ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë. Komandantët e PK-së kanë theksuar vështirësinë e funksionimit në anën veriore të lumit Ibër dhe ndikimin dëmtues në strategjinë efektive të luftimit të trafikimit në pjesën veriore të Kosovës.

Ngjashëm me fushat e tjera të specializuara për hetimin e krimeve, udhëheqësit e këtij sektori shfaqin një përdorim të dobët ose joekzistues të operacioneve policore të bazuara në inteligjencë dhe mungesë të përdorimit të strukturuar të analizave të trendëve të krimit. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së një sistemi universal në PK – nëse nuk mblidhen të dhëna të inteligjencës në nivel bazë, është e pamundur që SHTQNJ-ja të veprojë në bazë të tyre. Gjithashtu, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur një dëshirë të mirëpritur dhe shtimin e kapaciteteve në SHTQNJ për t'u bërë më proaktiv në operacionet e veta. Është e ditur se trafikimi i qenieve njerëzore nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive thjesht duke pritur të ndodhin

incidente para se të trajtohen viktimat e trafikuar dhe kryerësit vendor. Operacione më proaktive janë duke u zhvilluar, kurse personeli i EULEX-it do të monitorojë efektshmërinë e tyre, si dhe do t'u ofrojë hetuesve të PK-së mentorim dhe këshillim.

Për sa i përket marrëdhënieve të punës mes personelit të sektorit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe personelit të PP-së, monitoruesit e EULEX-it kanë zbuluar një pasqyrë të ngatërruar. Ndonëse në shumë rajone personeli i PK-së ka folur për marrëdhënie të mira të punës, personeli nga Prishtina ka cekur probleme që i pasqyrojnë komentet e hetuesve të tjerë të krimeve në kryeqytet. Problemet e theksuara nga ky sektor, ndër të tjera përfshijnë: prokurorët publik shpeshherë arrijnë me vonesë në vend të ngjarjes, se kishte vështirësi në kontaktimin e prokurorëve në mbrëmje, se PP-ja shpeshherë refuzonte të pranonte dëshmi fizike me ndonjë raport për krimin dhe se kishte vonesa të shpeshta të udhëzimeve nga PP-ja lidhur me rastet e përfunduara. Perceptimi në mesin e hetuesve të PK-së është se nuk ka personel të mjaftueshëm të PP-së për t'i përmbushur kërkesat, andaj kjo gjë rezulton në vonesa të tepërta dhe performancë të dobët.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se në shumicën e aspekteve **ekipet rajonale kundër krimeve** janë grupe me strukturë të mirë dhe të trajnuara shumë mirë, që funksionojnë me pajisje të standardeve të mira. Ndonëse ERKK-të kanë nivel të lavdërueshëm të përfaqësimit të femrave (14.6%), përfaqësimi i komuniteteve etnike jo-shumicë është i dobët në shumë rajone. Njësitë rajonale kanë vëllim të konsiderueshëm të punës dhe në mungesë të një plani të PK-së për t'i paguar policët për punën jashtë orarit, gjatë vitit krijohet një kohë e konsiderueshme e pushimeve që rrjedhin nga puna jashtë orarit. Kjo bën që të krijohet një sfidë domethënëse për udhëheqësit për sa i përket detyrës së tyre për menaxhimin e mungesave.

Tabela 1.10f – Vlerësimi themelor organizativ– Ekipi rajonal kundër krimeve (Shtylla kundër krimeve)

Treguesi	Përmbushja	Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë	Kënaqshëm	Personel me strukturë të mirë dhe grupe shumë mirë të trajnuara

Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Shumë e dobët në shumë fusha, sipas raportit të DAK-ut
Pajisjet	Mirë		Kënaqshëm	
Ligji/DPP/PSO-të			Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Në mungesë të buxhetit për punë jashtë orarit, policët akumulojnë ditë pushimi kompensuese.
Menaxhimi i përputshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Mirë		Kënaqshëm	Të gjitha raportet kontrollohen në tri nivele për sa i përket cilësisë, para se të dërgohen tek PP-ja.
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Projekt që ende është në zhvillim e sipër
Marrëdhëniet me PP-në	Dobët		Mirë	Një numër problemesh substanciale duhet të zgjidhen

Lidhur me planifikimin e veprimtarive afatshkurtra dhe afatmesme dhe me përdorimin e inteligjencës për udhëzimin e operacioneve proaktive, EULEX-i ka vlerësuar performancën e

udhëheqësve të ERKK-ve si 'të mirë'. Gjithashtu, udhëheqësit e ERKK-ve kanë treguar një nivel të mirë të mbikëqyrjes për të siguruar përputhshmëri me ligjin dhe procedurat e PK-së. Monitoruesit e EULEX-it kanë parë një sistem të mirë për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e raporteve mbi krimin. Performanca, për sa i përket përdorimit të analizave të trendëve të krimeve është vlerësuar si e kënaqshme, duke pasur parasysh mjetet e kufizuara në dispozicion.

PATRULLIMI EFEKTIV DHE SIGURIMI I RENDIT PUBLIK

Funksionet operative të patrullimit

shumica dërrmuese e personelit të PK-së janë policë me uniformë të cilët merren me detyrën rutinë të patrullimit dhe janë të vendosur në shtyllën e PK-së për operacione. Siç edhe është pritur, vlerësimi i nivelit rajonal paraqet një pasqyrë të llojllojshme të qëndrueshmërisë së punës operative patrulluese të PK-së. Gjatë vlerësimit nëpër rajone, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se regjimi për servisimin dhe riparimin rutinor të veturave, kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera është i dobët dhe rezulton në atë që të ketë pajisje themelore të pamjaftueshme për mbështetjen e operacioneve dhe detyrave policore rutinë.

Tabela 2.1 – Vlerësimi themelor organizativ– Niveli i stacionit (Shtylla e operacioneve)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë		Kënaqshëm	
Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	
Pajisjet	Dobët		Kënaqshëm	Disa pajisje të stacionit janë

				joadekuate. Numri i veturave që nuk janë në dispozicion dhe që presin riparim është i lartë në disa fusha.
Ligji/DPP/PSO-të	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Ka nevojë për të qartësuar formulimin e DPP-së për sa i përket pushimit mjekësor me pagesë.
Menaxhimi i mungesave	Dobët		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Dobët		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Dobët		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	
Përdorimi i inteligjencës/statistikave			Kënaqshëm	

Për sa i përket burimeve dhe vëllimit të kërkesave të punës, **niveli i stacionit** të shtyllës së PK-së për operacione mund të jetë pjesa më e rëndësishme e organizatës. Vlerësimi i EULEX-it ka treguar për një numër çështjesh shqetësuese, në veçanti për sa i përket mbikëqyrjes dhe menaxhimit të drejtpërdrejtë. Edhe pse komentet në vijim janë përgjithësim të nxjerra nga të dhënat prej mbi 30 stacioneve policore, gjendja e vërejtur e praktikës së mirë në mesin e mbikëqyrësve të patrullave është e ngarkuar nga trende të konsiderueshme të dobësive. Ka mungesë të planifikimit të veprimtarive të patrullimit si reagim ndaj problemeve policore me prioritet. Në përgjithësi, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se ka tendencë që policët e patrullimit të vendosin sipas diskrecionit të tyre për shfrytëzimin e kohës së patrullimit, me pak apo aspak udhëzime nga mbikëqyrësit e tyre. Shumica e punës patrulluese përbëhet nga reagimet ndaj incidenteve apo ndjekjes së kundërvajtjeve në trafikun rrugor, sipas diskrecionit individual të policëve. Në të vërtetë, diskrecioni individual gjithashtu është vlerësuar po e krijon praktikën që qëndron prapa zbatimit të ligjit për trafikun rrugor. Gjithashtu është vërejtur se shumë policë të patrullimit imponojnë praktika të vetat, bazuar në perceptimet rreth pasurisë relative të vozitësve, gjatë shqiptimit të tiketave ndëshkuese.

Menaxhimi i mungesave, në veçanti i atyre për shkak të sëmundjeve, është vërejtur të jetë i dobët në disa rajone. Nuk ndiqen procedurat lidhur me mungesat në punë për shkak të sëmundjes. Statistikat për mungesë në punë mungojnë apo nuk janë në dispozicion dhe duket të mos ketë llogaridhënie dhe kontroll të duhur nga ana e udhëheqësve përkatës të PK-së. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se formulimi gjuhësor i DPP-së së PK-së lidhur me të drejtën për pushim mjekësor me pagesë ka nevojë të qartësohet¹⁷.

Ndonëse disa pajisje të stacioneve janë të një standardi të kënaqshëm apo më të mirë, të tjerat janë plotësisht joadekuate në aspekte të ndryshme. Është e qartë se PK-ja është duke kaluar nëpër një proces të vazhdueshëm të renovimit të stacioneve ekzistuese dhe të ndërtimit të stacioneve të reja. Në disa rajone EULEX-i ka vërejtur se, në disa stacione, një numër i madh i veturave të PK-së nuk ishin në dispozicion për t'u përdorur për muaj të tërë, si rezultat i funksionimit joadekuate të sistemit për mirëmbajtjen e veturave.

DFP i EULEX-it rekomandon fuqishëm që përmirësimi i mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të bëhet detyrë me prioritet të lartë nga komandantët e lartë të PK-së gjatë tri viteve të ardhshme. EULEX-i do të kërkojë të ndihmojë në këtë çështje dhe sugjeron që të kërkohen partnerë të tjerë donatorë për të ndihmuar në zhvillimin e një sistemi specifik të PK-së për menaxhimin e patrullimit, si dhe për trajnime përkatëse për rreshterët, togerët dhe personelin komandues të nivelit të stacionit. Qëllimi i përgjithshëm duhet të jetë ngritja e lartë e disiplinës në mesin e policëve të patrullimit, përmirësimi i motivimit të tyre përmes ngritjes së vetëdijesimit rreth rëndësisë së punës së strukturuar të patrullimit dhe që, të gjitha mënyrat e patrullimit rutinë të bëhen më efektive në përmbushjen e pritshmërive të komunitetit. Gjithashtu duhet të inkurajohet përdorimi më i shpeshtë i patrullimeve në këmbë.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/14/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të shtyllës së operacioneve

Mentorimi dhe këshillimi i mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë lidhur me një varg të aftësive dhe kompetencave themelore për menaxhimin e patrullimeve. Këto duhet të përmbajnë mbajtjen e sesioneve informuese për policët e patrullimit, përdorimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të inteligjencës për përkufizimin e objektivave të patrullimit, konsultimet me komunitetin lokal dhe përcaktimin e objektivave të patrullimit, monitorimin aktiv të policëve të

¹⁷. Në DPP parashihet se policët e PK-së kanë të drejtë të marrin maksimum 15 ditë të pushimit mjekësor me pagesë në çdo vit kalendarik dhe monitoruesit e EULEX-it kanë identifikuar një perceptim në mesin e disa policëve se kjo klauzolë që e parasheh këtë lloj pushimi krijon të drejtën që gjithsesi duhet të shfrytëzohet

EULEX-i rekomandon që PK-ja të miratojë një qasje më të strukturuar dhe racionale ndaj patrullimeve policore. Siç kërkohet nga ligji¹⁸, udhëheqësit e lartë (në nivele rajonale dhe të stacioneve) duhet të formulojnë synimet dhe prioritetet kyçe për patrullimet policore, duke u bazuar në konsultime aktive me përfaqësuesit e komunitetit. Këto synime duhet të formojnë vendimet e mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë në baza ditore, dhe të udhëheqin udhëzimet e tyre për policët e patrullimeve, NJRMO, njësitë e trafikut dhe ekipet e policisë në komunitet. Shkurtimisht, një qasje e strukturuar për trajtimin efektiv të patrullimeve duhet të përfshijë shndërrimin e brengave të komunitetit lokal në një listë të prioriteteve (të shkruara) të prioriteteve të operacioneve policore, komunikimin e tyre tek mbikëqyrësit dhe sigurimi se ata i bartin ato në veprime policore. Strategjia duhet të jetë sipas praktikave më të mira evropiane dhe rezultatet duhet të vlerësohen plotësisht.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/15/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të shtyllës së operacioneve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së (komandantët rajonalë dhe komandantët e stacioneve) për projektimin, zbatimin dhe vlerësimin e një plani efektiv të patrullimit për një periudhë prej 12 muajve. Çdo komandantë i stacionit duhet të përgatisë një listë të synimeve për të udhëhequr përdorimin efektiv të patrullave unike, duke u bazuar në shqetësimet e përfaqësuesve të komunitetit lokal. Çdo komandant rajonal duhet të përgatisë një listë të synimeve për të udhëhequr përdorimin efektiv të njësisve të trafikut, policëve të NJRMO-së dhe ekipeve të operacioneve policore në komunitet, në pajtueshmëri me shqetësimet e përfaqësuesve të komunitetit lokal.

Monitoruesit e EULEX-it gjithashtu kanë vërejtur mungesën e të dhënave rreth incidenteve që kërkojnë praninë e policëve patrullues të PK-së. Ndonëse shumë nga këto incidente nuk është e domosdoshme të evidentohen si krime, prapë se prapë ato përbëjnë ngarkesë të punës për policët e patrullimit. Një sistem i kategorizimit dhe evidentimit të incidenteve që përbëjnë krime dhe atyre që nuk përbëjnë krime do t'i siguronte komandantëve të PK-së informata të dobishme rreth asaj se si policët e patrullimit e shfrytëzojnë kohën e tyre, rreth llojeve të aktiviteteve policore dhe pritshmërive të komunitetit, si dhe një bazë konkrete për planifikimin e burimeve të PK-së për një efekt më të mirë.

¹⁸. Në nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës (Ligji nr. 03/L-035) parashihet që PK-ja të komunikojë dhe të bashkëpunojë me autoritetet e pushtetit lokal, organizatat civile dhe komunitetet lokale "për qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe ngritjes së sigurisë së të gjitha komuniteteve..." Përgjegjësitë më specifike, për sa i përket konsultimeve me komunitetin lokal janë të vendosura mbi komandantët e stacioneve

REKOMANDIMI I EULEX-IT - DFP/16/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të shtyllës së operacioneve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së lidhur me zhvillimin e një sistemi të kategorizimit dhe evidentimit të gjitha incidenteve që kërkojnë praninë e policëve të patrullimit,

dhe të demonstrimit se si mund të përdoren këto të dhëna për planifikimin e burimeve dhe vlerësimin e performancës. Nëse është gjë e duhur, duhet të gjendet një donator për të ofruar një softuer të përshtatshëm dhe ngritje të kapaciteteve njerëzore për mbështetjen e një sistemi të ri të reanistrimit dhe krahasimit të dhënave mbi incidentet

Funksionet e mbështetëse operative

Departamenti i njësive të specializuara ofron një varg të funksioneve të mbështetjes qendrore. Këto funksione përfshijnë Njësinë K9 (sektori i 'operacioneve me qen'), Njësinë për Intervenime të Specializuara (NJIS), Njësinë kundër Mjeteve Eksplozive të Improvizuara (NJMEI), Njësinë për Mbrojtje të Afërt (NJMA) dhe Drejtorinë për siguri dhe mbrojtje. Departamenti ka 679 punonjës (22 nëpunës civil, 410 zyrtarë të sigurimit, 247 policë) të komanduar nga niveli i kolonelit të PK-së. Pra, zyrtarët e PK-së përbëjnë vetëm 36.3% të departamentit. Në këtë departament janë të punësuar 32 femra ose 12.9%.

Tabela 2.2a – Vlerësimi themelor organizativ– Departamenti i njësive të specializuara (Shtylla e operacioneve)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë		Kënaqshëm	
Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka zyrtarë nga komuniteti etnik jo-shumicë
Pajisjet	Mirë		Kënaqshëm	
Ligji/DPP/PSO-të	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	

Menaxhimi i përputhshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	Funksion krejtësisht reaktiv, planifikimi afatshkurtër është vërejtur të jetë i një standardi të mirë.
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Funksion krejtësisht reaktiv

Secili komponent i departamentit të njësive të specializuara i është nënshtruar vlerësimit themelor organizativ nga personeli DFP-së së EULEX-it. Përmes këtij vlerësimi është bërë shqyrtimi i performancës së PK-së kundrejt një numri kriteresh, të dizajnuara për ta vlerësuar qëndrueshmërinë themelore të njësive (nën-njësive) organizative. Në tabelën 2.2a janë paraqitur të gjeturat e EULEX-it rreth departamentit amë të njësive të specializuara, ku në të gjitha aspektet, përveç asaj të përfaqësimit të pakicave etnike, ky funksion i rëndësishëm menaxherik është vlerësuar të jetë i një standardi të kënaqshëm apo i një standardi më të mirë.

Njësia K9 është një ekip i përbërë prej 20 policëve të PK-së nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e një rreshteri. Siç paraqitet në tabelën 2, nga vlerësimi fillestar i EULEX-it është vërejtur se ekzistojnë shumica e tipareve themelore organizative. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësimin e përfaqësimit të pakicave dhe investimit në pajisje shtesë apo përmirësimin e tyre. Çështjet e menaxhimit për sa i përket Njesisë K9 do të trajtohen nën Departamentin amë të njësive të specializuara. Duke pasur parasysh se shqetësimet themelore organizative të identifikuar nga EULEX-i kanë të bëjnë me Departamentin amë, vendimi për të tërhequr personelin e EULEX-it për KMM nga Njësia K9 mund të shqyrtohet pas periudhës fillestare të vlerësimit.

Siç kuptohet nga emri, **Njësia për Intervenime të Specializuara (NJIS)**¹⁹, ka për qëllim që PK-së t'i sigurojë kapacitete të specializuara taktike dhe për armët e zjarrit, për reagim ndaj incidenteve operative që përfshijnë armët e zjarrit, si dhe të jetë pjesë e operacioneve të planifikuara. NJIS-ja është në zhvillim e sipër. Pavarësisht nga përfaqësimi joadekuat i femrave dhe i komuniteteve etnike jo-shumicë në këtë njësi, si dhe pajisjeve joadequate, nga vlerësimi fillestar i EULEX-it

¹⁹.

Në të kaluarën NJIS është quajtur grupi për intervenime të specializuara/Ekipi i pare për intervenime.

është vërejtur se kjo njësi është duke u zhvilluar në një funksion të qëndrueshëm mbështetës. EULEX-i është duke e monitoruar nga afër një propozim për ta vendosur këtë njësi nën kontrollin e drejtpërdrejtë të drejtorit të përgjithshëm të PK-së, si dhe implikimet politike të këtij propozimi.

Për sa i përket madhësisë, **Njësia për Mbrojtje të Afërt (NJMA)** është njësia më e madhe nga njësitë e specializuara të mbështetjes operative, që ofron mbrojtje personale për një numër personalitetesh të rëndësishëm dhe persona të tjerë të identifikuar se kanë nevojë për mbrojtje speciale nga policia. Kjo njësi është njësi organizative stabile me përvojë dhe ekspertizë në zhvillim të vazhdueshëm.

Me një përfaqësim prej 2% nga komunitetet etnike jo-shumicë dhe me 3% punonjëse femra, NJMA-ja ka një përfaqësim dukshëm të ulët të punonjësve nga komunitetet etnike jo-shumicë dhe të femrave që kërkohet nga një funksion kaq i ndjeshëm. Monitoruesit e EULEX-it kanë vlerësuar si 'të mirë' përcaktimin e udhëheqësve të NJMA-së lidhur me ngritjen e nivelit të njësisë për të pasqyruar shoqërinë e Kosovës. Është shumë e rëndësishme të ftohen më shumë përfaqësues nga pakicat si dhe femra për të aplikuar, andaj kërkohet një përpjekje e përtërirë brenda shtyllës së operacioneve.

Njësia kundër municioneve dhe mjeteve eksplozive/të improvizuara është një tjetër projekt në zhvillim e sipër dhe qëndron mirë në të gjitha fushat përveç në atë të nivelit të përfaqësimit të komuniteteve etnike jo-shumicë dhe të femrave, si dhe gjendjes joadekuate të objekteve dhe pajisjeve të saj. Nevoja për investime të konsiderueshme për pajisje speciale është çështje për t'u shqetësuar dhe ndërlidhet me qëndrueshmërinë afatgjate të kësaj njësie.

Tabela 2.2b – Vlerësimi themelor organizativ– MME/I (Shtylla e operacioneve)

Treguesi	Përmbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë		Kënaqshëm	Njësia është në zhvillim e sipër
Përbërja etnike/gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka punonjës nga pakicat jo-shumicë apo punonjëse

				femra
Pajisjet	Dobët		Kënaqshëm	Nevojë për ndërtesa të përmirësuara dhe investime të mëdha në pajisje
Ligji/DPP/PSO-të	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Mungesa të shumta në trajnime për shkak të funksioneve speciale të personelit të departamentit
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës			Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka statistika për të përcjellë performancën e NJIS dhe MME/I

Për sa i përket kapaciteteve menaxherike, personeli i DFP-së së EULEX-it ka dhënë një vlerësim të kënaqshëm apo më të mirë për kriteret kyçe në tabelën 2.2b. Gjatë periudhës raportuese, personeli i DFP-së nuk ka vërejtur ndonjë fushë domethënëse që ka nevojë për ndryshime. I vetmi përjashtim është mungesa e personelit nga komunitetet etnike jo-shumicë, në veçanti në fushat e ndjeshme të NJMA-së dhe NJIS-së. Lidhur me kapacitetet menaxherike, ka mungesë të dukshme të llogaridhënies për sa i përket vlerësimit statistikor të performancës së njësive të ndryshme. Nga NJIS dhe MME/I ka qenë e pamundur të ofrohen të dhëna të hollësishme statistikore lidhur me llojet dhe numrin e incidenteve ku është kërkuar prania e policëve në vendngjarje.

REKOMANDIMI I EULEX-IT – DFP/17/2009

Objektivi: PK, komandantët e lartë të shtyllës së operacioneve

Mentorimi dhe këshillimi i personelit të lartë përkatës të PK-së lidhur me zhvillimin e një sistemi për kategorizimin dhe evidentimin e të gjitha incidenteve që kërkojnë praninë e burimeve të NJIS-së dhe të MME/I-së, dhe për demonstrimin e si mund të përdoren të dhënat e tilla për të planifikuar burimet dhe vlerësuar performancën.

Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim (DPZH) është vlerësuar nga monitoruesit e DFP-së së EULEX-it të jetë stabile dhe e qëndrueshme. DPZH-ja është pjesë e Departamentit për Rendin Publik (DRP) dhe ndërvepron me sektorët operativ të drejtorive rajonale të policisë dhe stacionet policore dhe me njësitë dhe sektorët e tjerë të PK-së, si dhe me agjencitë e tjera të sigurisë dhe emergjencave siç janë: FSK-ja, EULEX-i, KFOR-i, Departamenti për menaxhim të emergjencave, dhe institucionet e organizatat tjera në Kosovë. Në DPZH, 20% nga të punësuarit janë femra dhe 10% nga komunitetet etnike jo-shumicë.

Drejtoria ka tri komponentë: Njësinë për planifikim, Njësinë për zhvillim dhe Sektorin për planifikim të përhershëm. DPZH-ja është përgjegjëse për planifikimin, organizimin, funksionalizimin, kontrollimin dhe vlerësimin e sektorit operativ brenda veprimtarive policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Njësia për zhvillim është e përfshirë në inspektimin, kontrollimin dhe vlerësimin e angazhimeve, veprimtarive dhe procedurave të sektorit të operacioneve, për shkak të progresit të funksionimit të fusha të ndryshme operative. Një detyrë tjetër shtesë e këtij sektori janë takimet me institucionet jopolicore. Njësia për planifikim është e përfshirë në përgatitjen, organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve policore, në veçanti të atyre që kanë të bëjnë me çështjet madhore të nivelit më të gjerë, apo atëherë kur janë të përfshira dy apo më shumë Prokurori të Qarkut. Si përfundim, Sektori për planifikim të përhershëm vepron si ndërlidhës i shtyllës së operacioneve me njësitë e tjera organizative të PK-së dhe organizatat dhe agjencitë e tjera organizative, si dhe bën planifikimin e përcjelljeve policore për vizitat e personaliteteve të larta.

Tabela 2.2c – Vlerësimi themelor organizativ– Policia në komunitet (Shtylla e operacioneve)

Treguesi	Përmbushja	Objektivi	Komenti
-----------------	-------------------	------------------	----------------

Struktura e personelit, përkufizimi i roleve dhe trajnimet	Mirë		Kënaqshëm	
Përbërja etnike/gjinore	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Pajisjet	Mirë		Kënaqshëm	Pajisjet dhe zyrat janë të mira, por njësia ka mungesë të veturave të dedikuara për punë në teren.
Ligji/DPP/PSO-të	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës			Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	Shfrytëzohet shumë kohë për pjesëmarrje nëpër takime. Nuk ka rol proaktiv vërtetë për policinë rajonale në komunitet
Përdorimi i inteligjencës/statistikave	Dobët		Kënaqshëm	

Njësia e Policisë në Komunitet (PK) në kuadër të Shtabit Qendror është një zyrë e vogël, ndërsa në kuptim të qëndrueshmërisë themelore është vlerësuar të jetë e kënaqshme apo më shumë se e kënaqshme. Planifikimi shënon një pikë të dobët në menaxhimin e Njesisë dhe siç ndodh me funksionet tjera mbështetëse të shtabit qendror, paraqitet nevoja për zhvillim edhe në këtë rrafsh.

Monitoruesit e EULEX –it kanë vërejtur një shkëputje mes Shtabit Qendror të PK dhe policëve të PK nëpër rajone. Këta të fundit i raportojnë menaxherëve të tyre të linjës brenda rajoneve, ndërsa Shefi i Njesisë së PK (Shtabi qendror) nuk ka ndonjë autoritet të mirëfilltë për të ndikuar në përzgjedhjen e strategjisë apo regjimit të punës. Ekziston nevoja për të rishqyrtuar termat e

referencës për Njësinë PK në SHQ dhe për t'i përcaktuar raportet e tyre me ekipet rajonale të PK. Gjithashtu, ekziston nevoja e hulumtimit të lidhjes mes strategjisë për policinë në komunitet të Policisë së Kosovës dhe të obligimit për konsultime me komunitetin lokal sipas ligjit të Kosovës, si dhe rëndësinë që ka ajo në çështjet e policisë në komunitet për komunitetet jo shumicë.

REKOMANDIMI I EULEX-it- DFP/18/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë të Shtyllës së Operacioneve

Mentorimi, këshillimi i stafit përkatës të lartë të PK lidhur me detyrat e punës për Njësitë e Policisë në Komunitet, në SHQ dhe në nivel të rajoneve. Shqyrtimi duhet të ketë parasysh dobinë e ekzistimit të një strategjie të vetme për policinë në komunitet, metodologjinë, vlerësimin dhe mekanizmin raportues. Duhet gjithashtu të hulumtojë nevojën e ndërlidhjes së strategjisë për policinë në komunitet të PK dhe detyrimin ligjor të Kosovës për një konsultim me komunitetin vendas.

Tabela 2.2d – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtorati për Trafik (operacionet)

Treguesi	Përmbushja		Objektivi		Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Mirë		Kënaqshëm		
Përbërja etnike /gjinore	Mirë		Kënaqshëm		Drejtori është me përkatësi etnike serbe
Pajisjet dhe objektet			Kënaqshëm		
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm		
Menaxhimi i mungesave	Dobët		Kënaqshëm		
Menaxhimi i përputhshmërisë			Kënaqshëm		
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës			Kënaqshëm		

Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	

Policia e trafikut rrugor është e organizuar në Njësi Rajonale të Trafikut, ku kompetencat e përbashkëta menaxherike ndahen në mes të **Drejtorisë për Trafik**, PK SHQ dhe komandantëve rajonal. Secila Njësi rajonale për trafik është nën komandën operative të komandantëve përkatës rajonal, ndërsa menaxhimi i automjeteve, pajisjeve dhe mirëmbajtja është i centralizuar. Veç kësaj, përzgjedhja, trajnimi dhe emërimi i policëve të trafikut dhe i stafit civil mbështetës gjithashtu është i centralizuar. Siç shihet në Tabelën 3.9, Drejtoria për Trafikun Rrugor është vlerësuar të jetë e kënaqshme apo më shumë sesa e kënaqshme sipas shumicës së kriterëve mbi performancën themelore.

Siç mund të nënkuptohet edhe nga vet emërtimi, **Njësitë Rajonale për Mbështetje Operative** (NJRMO) kryejnë një mori funksionesh për mbështetje operative dhe janë nën komandën operative të gjashtë Komandantëve Rajonal të PK. E rëndësishme është që këta zyrtarë me trajnim të nivelit të lartë kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë mbështetje të specializuar gjatë incidenteve të prishjes së rendit publik në Kosovë. Njësitë kanë fituar përvojë të madhe gjatë kryerjes së detyrave policore gjatë demonstratave të dhunshme, siç ishte demonstrata e *Vetëvendosjes* në muajin shkurt 2007. Përveç furgonëve të rëndomtë Mercedes, zyrtarët e NJRMO janë të pajisur me pajisje për mbrojtjen e trupit, jelekë anti-plumb, mburoja personale, shkopinj të gjatë dhe maska kundër gazit.

Vlerësimi themelor i EULEX-it mbi organizimin përshkruan një gjendje të ndryshme nëpër rajone. Në disa rajone kryesore, si në Prishtinë dhe Mitrovicë, NJRMO-të janë duke ju nënshtruar një ristrukturimi të stafit. Në disa rajone kushtet e ndërtesave dhe objekteve për stafin e NJRMO janë tërësisht joadekuate. Veç kësaj, pajisjet që përdoren në raste të trazirave dallojnë për nga lloji, standardi dhe cilësia e tyre. Ekzistojnë vetëm tri (0.8%) femra police në NJRMO-të dhe të gjitha janë me gradë të rreshterit.

Përderisa komandantët e NJRMO-ve vlerësohen të jenë shumë të mirë në përgatitjen e planeve afatshkurta (mujore) të punës, ekziston pothuajse një mungesë e plotë e planifikimit afatmesëm (një deri në dy vite) apo planifikimit afatgjatë. Po ashtu, nuk ekziston praktika e shfrytëzimit të të dhënave statistikore apo atyre të inteligjencës gjatë planifikimit të aktiviteteve të NJRMO.

Tabela 2.2e – Vlerësimi themelor organizativ – NJRMO (Operacionet)

Treguesi	Përmbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Dobët		Kënaqshëm	Strukturë e pakompletuar dhe staf kyç që mungon. Trajnimi është i duhur.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Vetëm 3 police femra.
Pajisjet & objektet	Dobët		Kënaqshëm	Ndërtesa dhe objekte joadekuata në disa rajone.
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	RReP e ndryshuar është në zhvillim e sipër
Menaxhimi i mungesave			Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/ cilësia e punës			Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	Nuk ka dëshmi të planifikimit afatmesëm apo afatgjatë.
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	Nuk shfrytëzohen të dhënat statistikore në planifikim.

Gjatë periudhës kohore të vlerësimit, EULEX-i konstaton që Rregullorja e Punës (RReP) po i nënshtrorëj plotësimeve dhe ndryshimeve. Një draft RReP e NJRMO-së ishte shqyrtuar me ç'rast ishte konstatuar si e papërshtatshme në disa aspekte. Me këtë rast rekomandohet që stafi i DFP EULEX të angazhohet plotësisht dhe në bashkëpunim me komandantët përkatës të PK në përpilimin e një RReP gjithëpërfshirëse, e cila do t'i pasqyrojë praktikën më të mirë evropiane në kuptim të taktikave për kontrollin e turmave dhe menaxhimin e incidenteve të prishjes së rendit

publik të një shkalle më të gjerë. Gjithashtu ekziston nevoja e organizimit të ushtrimeve/stërvitjeve në baza vjetore për të testuar kapacitetet reaguese të PK ndaj prishjeve të rendit publik në përmasa më të gjera, përfshirë këtu edhe kompetencat e komandantëve të lartë.

REKOMANDIMI I EULEX-it - DFP 19/2009


Synimi: PK, Shtylla e Operacioneve të Komandantëve të Lartë

Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë përkatës të PK lidhur me zhvillimin e Rregullorës së Standardizuar të Punës për Njësitë Rajonale për Mbështetje Operative, në përputhje të plotë me praktikën më të mira Evropiane dhe standardet e brendshme të miratuara. Posa të finalizohet RReP stafi i EULEX-it duhet të monitorojë implementimin e tij dhe të ofrojë këshilla të ekspertëve për organizimin e së paku një ushtrimi trajnues vjetor, të disenjuar për të testuar në tërësi kapacitetet e PK për t'u përballur me prishjet e rendit publik në shkallë më të gjerë.

SIGURIMI I KUFIJVE

Vlerësimi themelor i performancës

Në periudhën e vlerësimit të EULEX-it, policia kufitare përbënte 15.2% të totalit të përgjithshëm të organizatës së PK. Shtylla për Kufij (SHQ) përbën 6% të organizatës, Policia Kufitare Lindje 32%, Policia Kufitare Perëndim 25% , Policia Kufitare Veri 24.5% dhe Policia Kufitare Aeroport 12.4% . Në disa aspekte, Policia Kufitare duhet t'i luftojë shumë prej lidhjeve ndërmjet krimeve të rënda dhe atyre të organizuara në Kosovës. Kufijtë e gjatë dhe të vështirë të Kosovës u kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë mundësi fitimprurëse personave të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e duhanit dhe karburanteve, tregtinë e paligjshme me narkotikë, përpjekjeve për t'ju shmangur obligimeve doganore dhe akcizës. Niveli i saktë i këtyre problemeve deri tani ka qenë kryesisht objekt i supozimeve dhe i bazuar në të dhëna të pamjaftueshme dhe joadekuate të inteligjencës, si dhe të dhënave të kufizuara mbi konfiskimet. Ndonëse aktualisht nivelet e këtyre aktiviteteve kriminale mund vetëm të përcaktohen me hamendje, nuk ka dyshim në kërcënimin shumë aktual dhe potencial që përbëjnë ato për qeverinë e re të Kosovës dhe ekonominë e saj të dobët.



Është me rëndësi që Policia Kufitare të shënojë progres të dëshmuar drejt katër objektivave të MIK: përkatësisht, të sigurojë kontroll efektiv të kufijve, detektimin dhe hetimin e “krimit ndërkufitar”, duke demonstruar kështu një bashkëpunim ndërmjet agjencive në menaxhimin e kufijve dhe arritjen e bashkërendimit dhe koherencës në nivel nacional dhe transnacional.

Stafi i EULEX-it ka kryer një vlerësim të performancës themelore organizative të **SHQ të Policisë Kufitare**, si edhe në Shtyllat tjera të PK, Policia Kufitare është ballafaquar me problemin e pasqyrimin të përbërjes së ndryshme etnike të Kosovës gjatë punës së saj. Vlen të theksohet që gjatë periudhës raportuese të EULEX-it (dhe 12 muaj para fillimit të punës së Misionit të EULEX-it) nuk është pranuar asnjë ankesë nga ndonjë femër apo pjesëtar i komuniteteve etnike jo-shumicë, lidhur me trajtimin e tyre në vendin e punës.

Stafi i EULEX-it ka identifikuar një mungesë të kulturës proaktive të planifikimit në radhët e menaxherëve të Policisë Kufitare. Për shembull, njësitë për hetim dhe ato të Inteligjencës kanë mundur të flasin vetëm për ekzistimin e tri planeve operative me shkrim për periudhën 12 mujore para muajit shkurt 2009: të gjitha këto kanë të bëjnë me ekzekutimin e urdhërësive të gjykatës për bastisje të objekteve. Dokumentet e planifikimit nuk janë pasuar me një renditje të njëjtë veprimi dhe në disa raste ato plane ishin të mangëta dhe jo të hollësishme sa duhet. Edhe pse stafi i EULEX-it konstaton që Policia Kufitare ishte angazhuar në një numër të madh operacionesh gjatë 12 muajve të kaluar, përkundër kësaj, ata kanë mundur të gjejnë fare pak fakte të dokumentuara të planifikimit apo raportimit. Ekziston nevoja e rritjes së kapaciteteve planifikuese të Policisë Kufitare. Strategjia e nevojshme për ndryshim duhet të adresojë një sërë çështjesh. Fillimisht, përdorimin e një formati të vetëm të planeve operative, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

REKOMANDIMI I EULEX-it – DFP /20/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë të Policisë Kufitare.

Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të Policisë Kufitare për zhvillimin e një Rregulloreje të Punës për planifikimin e dokumenteve dhe vlerësimin e raporteve në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Pasi që kjo të arrihet, stafi i EULEX-it do të monitorojë implementimin e RReP dhe respektimin e saj nga ana e mbikëqyrësve të Kufirit dhe stafit menaxhues.

Udhëheqësit e SHQ të Policisë Kufitare (posaçërisht Hetimet dhe Inteligenca) kanë demonstruar një shfrytëzim të mirëfilltë të dhënave statistikore në vlerësimin e vëllimit të punëve për stafin dhe suksesin në hetimin dhe ndjekjen penale ndaj krimeve në kufij. Të dhënat flasin për një rritje të ekspertizës dhe përvojës, si dhe një lëvizje përpara drejtë ushtrimit proaktiv të detyrave të policisë. Ekspertët e EULEX-it kanë konstatuar që **Shtabet Rajonale të Policisë Kufitare Lindje** janë duke vepruar me një deficit prej 21% të stafit. Po ashtu, ekzistojnë shumë më pak rreshterë (vetëm 40%) sesa kapaciteti i nevojshëm. Njësoj si edhe SHQ i Policisë Kufitare, SHR Lindje duket të jetë i strukturuar mirë dhe niveli i trajnimeve për shumicën e aftësive të specializuara është adekuat. Kjo pjesë e organizimit të Policisë Kufitare ka një nivel të kënaqshëm të përfaqësimit etnik jo-shumicë, gati 19%. Përfaqësimi femrave aktualisht është 6.8%. Në periudhën 12 mujore para muajit shkurt 2009, nuk është shënuar asnjë ankesë për sjellje diskriminuese ndaj fermave apo zyrtarëve nga komuniteti jo-shumicë.

Tabela3.1 –Vlerësimi themelor organizativ – Shtabi rajonal, Lindje (Kufiri)

Treguesi	Përmbushja	Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Kënaqshëm	Kënaqshëm	Ekziston 21% më pak staf nga niveli i autorizuar.
Përbërja etnike /gjinore	Mirë	Kënaqshëm	18.4% jo-shumicë etnike 5.8% zyrtare femra.
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm	Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Mirë	Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Mirë	Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm	Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm	Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm	Kënaqshëm	Standard i mirë i dokumenteve të planifikimit. Puna e mëtutjeshme kërkon një përmirësim të efektivitetit të aktiviteteve të planifikuara.

Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Mirë		Kënaqshëm	
-------------------------------------------------------	------	--	-----------	--

Stafi i EULEX-it ka vërejtur një zhvillim në sipër të aktiviteteve proaktive për planifikim në kuadër të stafit të SHR Lindje. Gjatë vitit 2008, janë zbatuar 48 nga gjithsej 56 aktivitete operative të planifikuara. Në një mostër të zakonit nga dokumentet për planifikim, stafi i EULEX-it konstaton që standardi mesatar është 'i mirë' dhe suksesi i tyre në përmbushjen e objektivave të parapara është vlerësuar të jetë 'i kënaqshëm'.

Stafi i PeK i vendosur në Vendkalimin Kufitar (VK) në rajonin lindor, në përgjithësi është i strukturuar dhe trajnuar mirë, ndërsa rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë të përcaktuara qartë. Por, është vërejtur se ekziston numër i pamjaftueshëm i mbikëqyrësve në disa VK që përcillet me një pamundësi për të siguruar respektimin e ligjit dhe të procedurave. Sa i përket pajisjeve dhe objekteve, performanca në këtë pikë dallon: por në disa VK ndërtesat janë joadekuate, komunikimi/TI është 'i dobët' dhe numri i automjeteve në dispozicion është i pamjaftueshëm për shkak të regjimit jo të duhur të mirëmbajtjes. Shqetësim të veçantë paraqesin kushtet përgjithësisht të dobëta të objekteve për intervistimin dhe mbajtjen e imigrantëve.

REKOMANDIMI DFP/21/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë të Policisë Kufitare

Mentorimi dhe këshilldhënia për stafin e lartë të Policisë Kufitare në zhvillimin e strategjisë afatmesme për përmirësimin e objekteve dhe pajisjeve ekzistuese në të gjitha VKK, duke i kushtuar vëmendje të veçantë objekteve për intervistim dhe mbajtje të imigrantëve. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet ndihmesës së zyrtarëve të PK në përpjekjet e tyre për arritjen e përputhshmërisë me praktikën më të mira evropiane dhe standardet e njohura ndërkombëtare.

Gjatë anketimit në prill të vitit 2009, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur që cilësia e briefingjeve, shfrytëzimi i inteligjencës, kontrollet për sigurinë e cilësisë dhe kontrollet e patrullave mobile nga mbikëqyrësit ishin aspekte me performancë të dobët. Prandaj rekomandohet që "Rekomandimi i DFP 14/2009" të zbatohet njësoj për të gjithë mbikëqyrësit operativ të PeK dhe policëve patrullues. Me fjalë tjera, monitoruesit e EULEX-it duhet të ndihmojnë menaxherët përkatës të PK që të shtojnë vetëdijësimin mbi rëndësinë e punës së strukturuar patrulluese dhe për të kryer të gjitha format e patrullimeve rutinë në mënyrë më efektive duke i përmbushur të priturat e opinionit publik.

Tabela 3.2 – Vlerësimi themelor organizativ – VKK dhe Ekipet Mobile – Lindje (Kufi)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Kënaqshëm		Kënaqshëm	PeK është e strukturuar mirë dhe stafi është i trajnuar në mënyrë të duhur dhe i vëmendshëm për rolin që ka. EM: më pak se 40% të trajnuarve në mënyrë të duhur dhe më pak se 20% që kryejnë detyrat në përputhje me RReP.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	
Pajisjet dhe objektet	Dobët		Kënaqshëm	EM dhe disa VKK: disa ndërtesa, Kom/TI, automjetet dhe pajisjet për forenzikë janë joadekuate. Në përgjithësi objektet për menaxhimin e imigrantëve janë të dobëta.
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	EM: mbikëqyrësit e pamjaftueshëm. Disa VKK me numër të mangët të mbikëqyrësve.
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Mirë		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	EM: Nuk ka aktivitete proaktive.
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur që sistemi i inspektimeve rutinore dhe i atyre të paparalajmëruara nga stafi i Shtabit ishte praktikë për t'u lavdëruar e cila kishte efekt pozitiv në përmirësimin e standardeve. Sidoqoftë, monitoruesit e EULEX-it sugjerojnë që kjo praktikë inspektimi ka vend për përmirësim dhe për të qenë më efektive do të duhej që raportet e përpiluara nga stafi inspektues të botohen dhe të përcillen tek stafi relevant, por jo vetëm tek stafi i lartë i PeK.

Siç shihet në Tabelën 3.3, ekipet mobile të PeK (Lindje) kanë një sërë fushash me dobësi në performancën e tyre. Dhe kjo ka të bëjë me numrin e pamjaftueshëm të mbikëqyrësve për të siguruar respektimin e plotë të ligjit dhe procedurave, trajnimet e mangëta dhe ndërtesat joadekuate si dhe Komunikimin/TI dhe pajisjet për forenzikë. Përkundër mungesës së mbikëqyrësve dhe planifikimit përkatës proaktiv, EM-të kanë zbuluar 12 raste të kontrabandës gjatë periudhës 12 mujore para muajit shkurt 2009. Përkundër mungesës së mbështetjes organizative (si p.sh. mbikëqyrësit, trajnimet dhe pajisjet) EM-të paraqesin një potencial të mirëfilltë dhe mbikëqyrja, në rastet ku është e pranishme, është vlerësuar të jetë 'e mirë'.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur një mungesë të strategjive të shkruara për të informuar dhe drejtuar aspekte proaktive të rajonit. Në mënyrë specifike, nuk ekzistojnë dokumente të strategjisë lidhur me emigrantët ilegal. Gjithashtu është vërejtur që gjatë periudhës së monitorimit, stafi i PeK rajonale nuk ishte vizituar nga Drejtori i PeK apo ndonjë zyrtar i lartë i stafit brenda strukturës komanduese të PeK. Monitoruesit e EULEX-it pohojnë që vizitat e tilla do të mund të prodhonin një sërë përfitimesh. Ato do të mund të kishin ndikim pozitiv në moralin e stafit; të vënin më shumë theks në përmirësimin e performancës dhe ndoshta ajo çfarë është më e rëndësishme, t'ju mundësojë zyrtarëve në terren që të ofrojnë më shumë informata të rëndësishme dhe të dhëna nga përvoja e drejtpërdrejtë për të dhënë sa më shumë informata gjatë procesit të disenjimit dhe strategjisë efektive për kufij.

Shtabet rajonale (SHR) të PeK Veri: Niveli i bashkëpunimit mes SHR Veri dhe policëve serbë të Kosovës (që veprojnë në pjesën veriore të Mitrovicës) sipas monitoruesve të EULEX-it vlerësohet të jetë i dobët. Nga gjithsej 273 policë që veprojnë në PeK (Veri), 33.6% janë pjesëtarë të komunitetit jo-shumicë, përfshirë këtu edhe 30% të policëve serb të Kosovës.

Tabela 3.3 – vlerësimi themelor organizativ – Shtabi rajonal Veri (Kufiri)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Trajnime të pamjaftueshme për inteligjencë për zyrtarët e

roleve dhe trajnimi				Njesisë për hetime dhe Inteligjencë.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	

Stafi i EULEX-it gjithashtu ka vërejtur që nuk është zhvilluar asnjë lloj trajnimi specifik mbi shfrytëzimin e të dhënave të inteligjencës për zyrtarët e Njesisë për Hetime dhe Inteligjencë. Zyrtarët për hetime në SHR punojnë sipas sistemit me dy ndërrime, duke mbuluar kështu orarin e punës prej 06.00 - 20.00 për çdo ditë, me qëllim të gatishmërisë reaguese të drejtpërdrejtë ndaj ndonjë incidenti kufitar. Sido që të jetë, oficerët për Inteligjencë Kufitare punojnë vetëm gjatë ndërrimit të ditës. Përveç brifingjeve të mëngjesit në nivel rajonal nga komandanti rajonal nuk bëhen takim tjera më specifike për këto njësi dhe informacionet rrjedhin në mënyrë personale dhe të paspecifikuar, në vend se të rrjedhin në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar. Monitoruesit e EULEX –it vlerësojnë se qëllimi i inteligjencës sikur nuk është i njohur mirë as nga vet njësia për inteligjencë dhe së këndejmi edhe mbështetja që e ofrojnë Hetimet dhe Inteligjenca për stafin e PeK është e dobët.

Sa i përket nevojave për Menaxhim të Integruar të Kufirit (MIK), akoma mbetet shumë për të bërë në rajonin verior: kontrolli i kufirit (kontrollat dhe vëzhgimi) përfshirë këtu edhe analizën e rrezikut dhe inteligjencën për vepra penale, të cilat po ashtu u vlerësuan të jenë të dobëta, me fare pak mbledhje të informatave dhe analizave përkatëse të tyre.

Në kufijtë e gjelbër, patrullat e përbashkëta (EULEX, KFOR dhe PeK) kanë përmirësuar vëzhgimin e terreneve të vështira kufitare. Meqë ekziston një komunikim i kufizuar mes PeK Rajoni Veri dhe homologëve të tyre në Republikën e Serbisë, ekziston edhe një komunikim i kufizuar sa i përket hetimeve të krimit ndërkufitar apo shkëmbimit të informacionit.

Tabela 3.4 – Vlerësimi themelor organizativ– VKK dhe Ekipet Mobile (EM) - veri (kufiri)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Shumica e stafit janë të trajnuar dhe i njohin detyrat e tyre. Nuk ka përshkrim të detyrave për mbikëqyrës operativ.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	
Pajisjet dhe objektet	Dobët		Kënaqshëm	Nevojë për investime kapitale shtesë në ndërtesa, komunikim dhe pajisje të TI.
Ligji/PPM/RreP	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Numër i pamjaftueshëm i mbikëqyrësve
Menaxhimi i performancës/ cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Performancë e përzier. Planifikim në disa raste është i një standardi të mirë por në disa fusha të caktuara ka nevojë për zhvillim.
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	

Edhe VKK në rajonin Veri duket të ketë numër të pamjaftueshëm të mbikëqyrësve. Është interesant fakti që, monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se nuk ekziston ndonjë përshkrim specifik i detyrave të punës për funksionet e Mbikëqyrësit të Njësisë së Policisë Kufitare dhe Mbikëqyrësit të Ekipit Patrullues. Monitoruesit gjithashtu vlerësuan që udhëzimet/brifingjet e dhëna nga udhëheqësit e ekipeve janë të nivelit (3), të kënaqshme. Brifingjet mbahen në fillim të çdo ndërrimi nga udhëheqësit e ekipeve me ç'rast shpërndahet informacioni i ri dhe organizohet puna e ndërrimit. Niveli i iniciativës në mesin e policëve vlerësohet të jetë i ultë dhe udhëheqësit e ekipeve nuk i inkurajojnë policët që të jenë më aktiv gjatë kontrolleve kufitare. Çfarëdo informacioni që marrin rreshterët dhe që është me rëndësi për funksionet në VKK i kalohet menjëherë policëve kufitar. Pjesa më e madhe e informacionit vjen nga Shtabi Rajonal (Veri). Mbikëqyrësit Kufitar nuk shfrytëzojnë ndonjë burim specifik të informacionit.

Shtabet Rajonale (SHR) të Policisë Kufitare Perëndim në vlerësimin themelor kanë pasur performancë të duhur. Edhe pse përfaqësimi etnik jo-shumicë ishte i kënaqshëm (12.7%), në krahasim me rajonet tjera të Policisë Kufitare, përfaqësimi femëror duket të jetë shumë i ultë (4.3%) dhe kërkon përmirësim. Monitoruesit e EULEX-it kanë studiuar 66 plane operative që i përkisnin periudhës 12 mujore para shtrirjes së Misionit dhe konstatuan që 57 prej tyre ishin realizuar. Cilësia e përgjithshme e planeve operative vlerësohet të jetë 'e kënaqshme'.

Monitoruesit e EULEX-it gjithashtu kanë konstatuar që udhëzimet e dhëna nga rreshterët e ndërrimit ishin të dobëta. Gjatë një anketimi të kryer në muajin prill 2009, monitoruesit e EULEX-it gjithashtu vlerësuan që cilësia e brifingjeve, shfrytëzimi i inteligjencës, kontrollet për sigurimin e cilësisë dhe kontrollet e patrullave mobile nga ana e mbikëqyrësve janë fusha me performancë të dobët. Rekomandohet zbatimi i "Rekomandimit të DFP 14/2009", në mënyrë të njëjtë për të gjithë mbikëqyrësit e Policisë Kufitare dhe policët e patrullave.

Tabela 3.5 – Vlerësimi themelor organizativ- SHQ Rajonal Perëndim (Kufiri)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Përbërja etnike /gjinore	Kënaqshëm		Kënaqshëm	12.7% me përkatësi etnike jo-

				shumicë, dhe 4.3% femra.
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Statistikat duket të jenë jo të besueshme.
Menaxhimi i implementimit	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Dobët		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm	

Monitoruesit e EULEX-it në rajon kanë zhvilluar disa vlerësime preliminare për progresin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Procedurat e inteligjencës brenda VKK janë aktualisht të tilla që informacionet e inteligjencës nga zyrtarët e PK i kalohen Njesisë për Inteligjencë në rajon përmes Komandantit të Stacionit në VKK. Njësia për Inteligjencë shpreson që për çdo VKK në të ardhmen të caktohet nga një Zyrtar për Hetime. Ky vendim do të jetë pjesë e rezultateve të strukturës së re të Policisë Kufitare.

Derisa Njësia për Hetime gëzon bashkëpunim mbi “krimin ndërkufitar” me Policinë Shqiptare për të gjitha format e aktiviteteve kriminale, ajo nuk posedon ndonjë aktivitete të përbashkët të organizuara apo të planifikuara me Departamentin e Doganës në Kosovë apo me autoritetet tjera për zbatimin e ligjit. Njësia për Inteligjencë e Policisë Kufitare Rajoni Perëndim kohë pas kohe ka shkëmbyer informata me Njësinë për Inteligjencë brenda Departamentit të Doganës.

Sa i përket sigurimit të kufirit të gjelbër, PK Rajoni Perëndim ka një nivel të mirë të bashkëpunimit me Shtyllat tjera të PK, KFOR (MNTF-Perëndim dhe MNTF-Jug), Policinë Kufitare Shqiptare, Doganën Shqiptare dhe në një masë edhe me Policinë Kufitare të IRJM. Bashkëpunimi me Doganën e Kosovës (posaçërisht sa i përket Njesisë Mobile të Doganës) ka filluar të zhvillohet së voni, edhe pse akoma është e kufizuar për shkak të mangësive logjistike të Doganës së Kosovës

dhe fokusi tani është i përqendruar tek Rajoni Verior i Kosovës. Kurse, nuk ka bashkëpunim me autoritetet relevante të Serbisë.

Monitoruesit e EULEX-it nuk kanë gjetur të ketë ndonjë strategji të shkruar për përmirësimin e objekteve për menaxhimin e rasteve me imigrant ilegal. Rastet e imigrimit ilegal (Kalimi ilegal i Kufirit) regjistrohen në një raport nga një zyrtar në VKK, pastaj raporti i dërgohet SHR dhe hetimet lidhur me të zhvillohen në nivel të SHR. Imigrantët ilegal transportohen menjëherë në SHR në Gjakovë ku edhe zhvillohen hetimet. Transportimi i emigrantit ilegal kryhet ose nga policët e VKK ose hetuesit e SHR. Edhe pse janë dy çeli për mbajtje në VKK Morinë, ato nuk janë në përdorim dhe nuk kanë qenë të shfrytëzuara me vite. Udhëheqja e PeK në nivel të Shtabit Qendror ka ndaluar shfrytëzimin e këtyre qelive për shkak të kushteve jo të duhura për sigurinë, shëndetin dhe të drejtave të njeriut. Strategjia për zhvillimin dhe përmirësimin e këtyre objekteve mbetet përgjegjësi e Administratës së PK.

Inspektimet në VKK bëhen rregullisht dhe zakonisht jashtë orëve të punës. Inspektimet janë kryer nga Drejtoria e Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shtabi Qendror i PK-së, SHQ i PeK, Komandanti rajonal/Zëvendës Komandanti Rajonal/Shefi i Operacioneve në Rajonin Perëndim të PeK) si dhe komandantët e stacioneve, shefi i operacioneve dhe udhëheqësit e ekipeve për inspektimin e personelit. Dokumentimi i inspektimeve të zhvilluara nga udhëheqësit e ekipeve, Komandanti i Stacionit/Shefi i Operacioneve është gjithëpërfshirës dhe i shkruar në një format të standardizuar të pyetësorit, i cili përmban rekomandimet për veprimet e mëtutjeshme. Dokumentet janë të ruajtura në kasafortën e Komandantit të Stacionit. Komandantët e Stacionit janë 'shfrytëzuesit e fundit' të raporteve të Inspektimit të udhëheqësve të ekipeve. Raportet e Inspektimit të kryera nga komandantët e stacioneve përcillen përmes zinxhirit komandues në SHR.

Raportet e Inspektimit nga niveli i SHR shpërndahen brenda disa ditësh në formë të një shkrese (Memo). Shkresa nuk është një format i standardizuar, por është "tekst i lirë". Raportet zakonisht janë me shkrim nëse ka ndonjë arsye specifike për ankesë; nëse nuk ka ndonjë arsye specifike për ankesë burimi më i rëndomtë i informacionit është një thirrje telefonike nga SHR tek Komandanti i stacionit në VKK që çdo gjë është në rregull. Monitoruesit e EULEX-it vlerësojnë që raportet e inspektimit që janë të shkruara në formate janë zakonisht mirë të menduara dhe gjithëpërfshirëse. Raportet e shkruara "me dorë" nuk janë aq gjithëpërfshirëse dhe gjithmonë përmbajnë ndonjë referencë për mospërbushje dhe japin rekomandime për veprim të mëtutjeshëm.

Monitoruesit e EULEX-it konstatuan që raportet nga të gjitha Ekipet e Inspektimit nga Prishtina kurrë nuk kthehen prapa në VKK: Monitoruesit nuk kanë mundur të gjejnë as edhe një raport nga të gjitha këto Ekipet të Inspektimit në VKK për vitin 2009 apo për vitin paraprak. Duket sikur raportet u dedikohen niveleve të larta komanduese dhe rrallë herë kthehen tek ata që janë inspektuar, duke ngulfatur kështu shansin për zhvillimin e stafit dhe përmirësimin e punës. DFP EULEX rekomandon që sistemi i inspektimit të rishikohet në mënyrë që të sigurohet që raportet të kthehen prapa tek stafi relevant për të ndihmuar kështu përmirësimin e punës.

Janë gjithsej 129 policë që punojnë në **Policinë Kufitare në Aeroport**, porta kryesore e Kosovës për linjat ndërkombëtare. EULEX-i konstaton që, për sa i përket strukturës, trajnimit dhe përkufizimit të rolit individual, kjo fushë e organizimit, në përgjithësi funksionon me një standard të mirë.

Stafi i EULEX-it ka vërejtur nevojën për një informim dhe trajnim mbi vizat dhe shtetet e Shengenit. Kapacitetet e menaxherëve të Policisë Kufitare në Aeroport për të planifikuar aktivitete, reaktive dhe proaktive, janë vlerësuar nga monitoruesit e EULEX të jenë të 'mira', në kuptim të hartimit, implementimit dhe efektivitetit. Duke pasur parasysh rëndësinë e Aeroportit si 'dritarja kryesore e Kosovës për në botë', është shumë me rëndësi që PK-ja të pasqyrojë sa më mirë përbërjen dhe diversitetin etnik dhe gjinor të Kosovës. Niveli i policeve femra prej (9%) duhet gjithashtu të përmirësohet.

Tabela 3.6 – vlerësimi themelor organizativ – Aeroporti (kufiri)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Mirë		Kënaqshëm	Strukturë mirë e definuar, me staf të trajnuar mirë. Disa përshkrime të detyrave të punës mungojnë.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	9% e zyrtarëve femra, më pak se 1% me përbërje etnike jo-shumicë.
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	KPIS kanë nevojë për mirëmbajtje dhe riparime. Ekziston nevoja për një hapësirë të veçantë transiti në ndërtesën e terminaleve të aeroportit.

Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm		
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm		
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm		Ekziston nevoja për më shumë informata dhe trajnime mbi shtetet dhe vizat Schengen.
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Dobët		Kënaqshëm		Numër i pamjaftueshëm i mbikëqyrësve prezent
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm		Mungesë e strategjisë për t'u fokusuar në aktivitetet e Policisë Kufitare të Kosovës në Aeroport.
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Dobët		Kënaqshëm		Trajnim dhe vetëdijesim i pamjaftueshëm mbi rëndësinë e inteligjencës.

Stafi i EULEX-it ka monitoruar mbi 20 ndërrime të ndryshme në Divizionin e Arritjeve/Nisjeve dhe ka konstatuar që mbikëqyrja e zhvilluar nga udhëheqësit e ekipeve në ndërrim ishte e dobët dhe ka dështuar edhe në komunikimin e informatave të dobishme dhe përcjelljen e këshillave të dobishme për ndërrimin vijues. Gjithashtu është vërejtur që nuk ka procedura të pranimit-dorëzimit apo përcjellje të informatave. Në Njësinë e Imigracionit (Terminali i Arritjeve) zyrtarët e PK nuk kanë udhëheqës të përhershëm të ekipit (edhe pse zyrtarisht ekziston zinxhiri komandues) dhe këta zyrtarë zakonisht zbatojnë Rregulloren e Punës (RReP) dhe kryejnë punët sipas gjykimit të vet, pa ndonjë udhëzim nga ana e mbikëqyrësve. Monitoruesit e EULEX gjithashtu kanë konstatuar që shfrytëzimi i inteligjencës nga rreshterët për të bartur instruksionet tek zyrtarët kufitar të Aeroportit ishte shumë i dobët.

Ngjashëm me këto, edhe kontrollet për sigurimin e cilësisë nga ana e rreshterëve (dhe togerëve) në punën për sigurimin e kufirit në Aeroport u vlerësuan të jenë shumë të dobëta. Monitoruesit e EULEX gjetën fare pak dëshmi të procesit të planifikuar dhe sistematik për të verifikuar që stafi Kufitar po kryen punën në mënyrë efektive dhe korrekte. Takimi i AVSEC ka pasur pak ndikim në sigurimin e cilësisë mbi çështje të caktuara të sigurisë. PK, siguri i PK dhe shërbimi i zjarrfikësve takohen çdo muaj për të diskutuar çështje të sigurisë së aeroportit, përfshirë këtu edhe ndonjë dobësi apo fushë që kërkon përmirësim. Monitoruesit e EULEX-it kanë gjetur që niveli i kontrolleve rutinore nga rreshterët në lokacion/puna e policëve patrullues të Aeroportit ishte

shumë i dobët. Duket sikur nuk ka ndonjë strategji për sa i përket çështjeve të hetimeve dhe inteligjencës dhe Stafi i PK nuk po i respekton dispozitat e RreP në lidhje me këto detyra.

Që nga prilli 2008 Stafi i Policisë Kufitare në aeroport është angazhuar në operacionin 'aktivitete ilegale', i zhvilluar dhe i iniciuar nga Njësia për Operacione e PK. Ky plan ishte miratuar nga ushtruesi i atëhershëm i detyrës së Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Operacioneve të PK. Ky operacion synon të përballet me një spektër të gjerë aktivitetimesh të paligjshme në objektet e aeroportit, përfshirë këtu: vjedhjet, tregtia ilegale me duhan dhe mallra të tjera, ofrimi i shërbimeve të taksive pa licencë, kërkimi i lëmoshës dhe kundërvajtjet në trafik. Ndryshe nga kjo iniciativë, monitoruesit e EULEX-it nuk kanë gjetur ndonjë dëshmi për ndonjë strategji, e cila në mënyrë specifike i referohet funksioneve të Policisë Kufitare në aeroport.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur që gjatë periudhës katër mujore të monitorimit, aeroporti nuk është vizituar nga Drejtori i Shtyllës së Policisë Kufitare të PK apo ndonjë zyrtar i lartë komandues. Ndonëse, janë kryer një numër inspektimesh të stafit të PK në aeroport të cilat kanë gëzuar pajtimin e përgjithshëm të monitoruesve të EULEX-it. Këto inspektime kanë përfshirë një inspektim të përgjithshëm nga Departamenti i Shtabit Policor, Inspektorati i Policisë Kufitare dhe inspektimet e udhëheqësve të ekipeve të Policisë Kufitare në ANP. Inspektimi i SHQ ka rezultuar me një raport për komandantin e stacionit me rekomandimet e dhëna për zbatim me qëllim të përmirësimit të performancës. Ky dokument ishte cilësuar si mjaft i mirë dhe që ofron një vlerësim të punës së policisë. Inspektimet e SHQ të Policisë Kufitare janë të paparalajmëruara dhe fokusohen në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe kontrollin e kufijve. Të gjitha të gjeturat e këtyre inspektimeve janë kthyer tek Komandanti i Stacionit dhe ishin vlerësuar nga monitoruesit e EULEX-it të jenë të cilësisë së mirë. Inspektimet e Policisë Kufitare në ANP nga udhëheqësit e ekipeve janë kryer çdo muaj dhe kishin për objekt pajisjet e policisë dhe inspektimet e uniformave. Mes datave 1 dhe 5 të çdo muaji udhëheqësit e ekipeve duhet të bëjnë një raport mbi këto inspektime si dhe një vlerësim vjetor të performancës në ekip për policët nga ana e liderëve të ekipeve. Të gjitha raportet që kanë të bëjnë me inspektimet e udhëheqësve të ekipeve janë të centralizuara në Stacion Policor. Formularët për inspektim dhe formularët për vlerësimin e performancës u vlerësuan të kenë ofruar informata të qarta dhe të mirëfillta.

Zhvillimi i Policisë Kufitare të Kosovës në të ardhmen

Në kuptim të plotësimin të objektivave të Misionit të EULEX-it për qëndrueshmëri, llogaridhënie

dhe respektim të praktikave më të mira evropiane, është gjë e duhur dhe e nevojshme të vlerësohet performanca e Policisë Kufitare të Kosovës karshi parimeve për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) dhe se si ato po zbatohen në rrethana të veçanta në Kosovës. Këto parime kanë të bëjnë me:

1. Kontrollin e Kufirit (kontrollin dhe vëzhgimin) përfshirë këtu edhe analizën e rreziqeve dhe inteligjencën për krime;
2. Zbulimi dhe hetimi i “krimeve ndërkufitare” në bashkëpunim me të gjitha autoritetet për zbatimin e ligjit;
3. Bashkëpunimin ndërmjet agjencive në menaxhimin e kufirit, përfshirë këtu edhe rojat e kufirit, doganën dhe policinë, sigurinë kombëtare dhe autoritetet tjera relevante; si dhe bashkërendimin dhe koherencën në nivel nacional dhe transnacional²⁰.

Secila nga këto çështje duhet adresohet me rend, duke i theksuar edhe fushat të cilat kërkojnë ndryshim dhe zhvillim.

Duhet bërë më shumë për sa i përket kontrollit të kufirit, analizës së rrezikut dhe inteligjencës për krimet. Siç është përmendur në këtë raport, prioritet madhor duhet t'i kushtohet nevojës për një **sistem efektiv të inteligjencës për krimet** gjatë viteve të ardhshme. Kjo nevojë është e pranishme kudo në PK: ajo çfarë duhet të ndodh është një ndryshim në praktikën e zyrtarëve të PK që u mundëson atyre të kenë një qasje për mbledhjen e të dhënave të inteligjencës si pjesë e punës së tyre themelore, pavarësisht se ku punojnë ata, apo nëse janë apo nuk janë në detyrë. Zyrtarët e PK duhet ta dinë faktin se të dhënat e inteligjencës duhet t'i mbledhin ata dhe t'i fusin në një sistem të përbashkët. Ndërsa, përveç këtij ndryshimi në praktikë, PK duhet të zhvilloj një sistem të vetëm të regjistrimit, krahasimit, kontrollit dhe analizës së raporteve të inteligjencës që i ofrojnë oficerët. Një organizatë me 8,000 pjesëtarë, që i shërben një popullate 2.2 milionëshe nuk mund t'i lejoj vetes luksin e veprimit me më shumë se një sistem të vetëm të inteligjencës, sidoqoftë një sistem i tillë i fragmentuar do të çonte në mospërbushjen e objektivit të përgjithshëm të luftimit të krimeve të rënda dhe krimin të organizuar kudo në Kosovë. Monitoruesit e EULEX-it rekomandojnë që Policia Kufitare e Kosovës të bëj pjesë në një sistem të vetëm të inteligjencës në PK, duke e plotësuar atë me të dhëna dhe gjithashtu duke pranuar informacione prej tij. Dihet mirë që Policia Kufitare e Kosovës ka potenciale të bëhet një komponentë e rëndësishme në sistemin e unifikuar të inteligjencës: të dhënat lidhur me lëvizjen e personave dhe automjeteve të caktuara nëpër kufijtë e Kosovës, janë tejet të rëndësishme për të luftuar krimet e rënda dhe krimin e organizuar.

¹⁹ . *Burimi: Këshilli i Bashkimit Evropian, Takimi i 2768-të i Këshillit për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme, Bruksel, Komunikatë për Shtyp, 15801/06*

REKOMANDIMI I EULEX-it – DFP/22/2009

Synimi: PK, Komandantë e lartë të Policisë Kufitare

Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të Policisë Kufitare sa i përket rolit të Policisë Kufitare të Kosovës në kuadër të një sistemi të vetëm të inteligjencës në PK për krime dhe rëndësisë për të kontribuar me të dhëna kyçe nga stafi i Policisë Kufitare të Kosovës për ekipin e inteligjencës. Këshilla të tilla duhet gjithashtu të adresojnë domosdoshmërinë për zhvillim të shpejt të një praktike për mbledhjen e informacionit të inteligjencës në Policinë Kufitare të Kosovës.

E ndërlidhur me ushtrimin e detyrave policore që për bazë kanë të dhënat e inteligjencës është edhe çështja e përmirësimit të rrjedhës së informacionit në Policinë Kufitare të Kosovës. Sipas monitoruesve të EULEX-it komunikimi dhe rrjedha e informacionit, si në mes të segmenteve të ndryshme të Policisë Kufitare ashtu edhe mes kësaj shtylle dhe segmenteve të tjera të PK, vazhdon të jetë një dobësi themelore. Kjo dobësi është shumë e shprehur dhe ndikon negativisht ndaj operacioneve të Policisë Kufitare të Kosovës, si dhe e zvogëlon efikasitetin e përmbushjes së objektivave. Problemi është i pranishëm në disa nivele. Së pari dhe në mënyrë më të dukshme paraqitet fakti që infrastruktura e komunikimit është e pakompletuar ose (në vende të caktuara) nuk ekziston dhe është joadekuate. Sistemi PISCES vazhdon të jetë i pjesshëm dhe jo i plotë; nuk ekziston rrjeti i mbulimit universal me VHF; shumë VKK nuk posedojnë lidhje të telefonisë fikse. E dyta, mbikëqyrësve sikur u mungon trajnimi për aftësim dhe njohuri të nevojshme për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe atyre të inteligjencës dhe për shpërndarjen e informatave zyrtarëve që janë nën komandën e tyre. E treta, Policia Kufitare e Kosovës, si edhe pjesët tjera të organizatës së PK, kanë mungesë të praktikës së mbledhjes së të dhënave të inteligjencës dhe shpërndarjes së tyre. Nuk çmohet sa duhet dobia qoftë edhe e formave më të rëndomta të informacionit të inteligjencës dhe raportit që mund të ketë ky informacion në ushtrimin efektiv të detyrave proaktive policore. Përfundimisht, PK-së i mungon informacioni për natyrën e shpejtë të ndryshimit të dokumenteve të falsifikuara, kontrabandës, narkotikëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore të cilat mund të transferohen shumë shpejt në destinacionin e tyre të kërkuar. Nuk ekziston sistemi i trajnimeve të vazhdueshme për shpërndarjen e informacionit në mënyrë që informacionet si dhe aftësitë e reja të shpërndahen shpejt dhe saktë .

REKOMANDIMI I EULEX-it – DFP/23/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë Kufitar

Objektivi i përgjithshëm: mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të Policisë Kufitare të Kosovës për të përpiluar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e komunikimit dhe rrjedhës së informacionit në kuadër të Shtyllës. Kjo do të adresonte një mori aspektesh të këtij problemi. Në bashkëpunim me agjencitë e donatorëve, do të duhet të kërkohej përmirësimi i infrastrukturës së komunikimit; trajnime të vazhdueshme mbi dokumentet e falsifikuara, mbledhja dhe analiza e informacionit të inteligjencës, kontrabanda, narkotikët dhe çështjet e ndërlidhura me të; dhe aftësitë për informim të mbikëqyrësve.

Në bazë të “Strategjisë Kombëtare” të tanishme, KFOR-i vazhdon të jetë përgjegjës për kufijtë e **gjelbër** ndërsa Dogana e Kosovës ka autoritet ligjor në ushtrimin e kontrollit kufitar të doganës edhe në kufijtë e gjelbër. KFOR-i rregullisht raporton për shkeljet tek autoritetet përkatëse kufitare: siç janë Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Plani është që në mënyrë graduale të kalohen përgjegjësitë për mbikëqyrjen e kufijve tek Policia e Kosovës. Ministria për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me KFOR-in do të krijojë grupe punuese për të zhvilluar një plan të dorëzimit/kalimit, përfshirë këtu edhe të pikave në vijim:

- Patrullat e përbashkëta me KFOR, Policinë dhe Doganën e Kosovës në hapësirat e vijave kufitare, përpara dorëzimit dhe pranimit të përgjegjësive.
- Bartjen (kalimin) e përgjegjësive për të mundësuar kontrollin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përbashkët të vijës kufitare të gjelbër.

Në bashkëpunim me Ministrinë, KFOR-in dhe komandantët e lartë të PK, monitoruesit e EULEX do të ndihmojnë në procesin e bartjes së përgjegjësive për ‘kufirin e gjelbër’ tek stafi i Policisë Kufitare të Kosovës. Stafit të Ministrisë dhe zyrtarëve të PK-së do t’u ofrohen këshilla të veçanta mbi përputhshmërinë dhe harmonizimin me praktikat më të mira të BE-së, me qëllim të lehtësimit të procesit të kalimit të përgjegjësive, që janë në zhvillim e sipër.

Monitoruesit e EULEX gjithashtu kanë vlerësuar që Policia Kufitare e Kosovës ka qasje të pamjaftueshme në qenët e aftësuar të policisë dhe njësitin K-9. Qenët e trajnuar si duhet mund të shtojnë dukshëm kapacitetet e Policisë Kufitare të Kosovës për të zbuluar narkotikët e fshehur, bartjen e paligjshme të valutave, kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Si pjesë e programit të ristrukturimit, PK inkurajohet të merr parasysh shtimin e resurseve të specializuara të K-9 që do të jenë në dispozicion për Policinë Kufitare të Kosovës.

Në kuadër të lëvizjes drejt MIK, PK-ja duhet ta zhvillojë një strategji të sofistikuar dhe efektive për migracionin ilegal, të bazuar në zbatimin e plotë të ligjeve të reja mbi imigrantët. Ekspertët e EULEX-it kanë konstatuar një sërë defektesh strukturore, ligjore dhe procedurale në kuptim të kontrollit të migracionit, përfshirë këtu mungesën e funksionimit të regjimit të vizave; përgjegjësitë e përkufizuara qartë për Drejtorinë për të Huaj dhe Migracion në Departamentin për Kufij, Azil dhe Migracion; mungesën e qendrave për mbajtjen e emigrantëve të huaj; ligjet e mangëta për rregullimin e procedurave të hyrjes, qëndrimit dhe daljes së emigrantëve të huaj; si dhe ankesat që Policia Kufitare nuk posedon staf të mjaftueshëm dhe të aftësuar në mënyrë të duhur. Një strategji e mundshme do të duhej t’i adresojë të gjitha aspektet e kësaj çështjeje të ndjeshme në kontrollin e kufirit, duke përfshirë këtu: Rregulloren e azhurnuar të punës, përmirësimin e

hapësirave për mbajtje, nevojat për trajnim të stafit të Policisë Kufitare të Kosovës, pajisjet dhe automjetet e specializuara. Monitoruesit e EULEX-it do të kërkojnë të asistojnë Policinë Kufitare në këto fusha për zhvillim.

REKOMANDIMI I EULEX-it – DFP/24/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë të Policisë Kufitare

Mentorimi dhe këshillimi I stafit të lartë të Policisë Kufitare të Kosovës në përpilimin dhe zbatimin e një strategjie për emigrantët ilegal, që bazohet dhe zbaton në tërësi ligjet mbi imigrantët ilegal.

Parimi i dytë, ai i zbulimit dhe hetimit të “krimit ndërkuftar” në bashkëpunim me të gjitha autoritetet për zbatimin e ligjit, ngrit çështjet e marrëdhënieve me Prokurorinë Publike (PP) dhe nevojën e racionalizimit të vendosjes së specialistëve të PK-së për hetime.

Stafi i EULEX-it ka raportuar për një mungesë të madhe të veprimeve reaguese nga **Prokuroria Publike** (PP) lidhur me rastet e iniciuara nga Policia Kufitare e Kosovës, në veçanti Njësitë për Hetime dhe Inteligjencë. Ky i fundit, në mungesë të informatave nga PP, shpesh duhet të shikoj raportet në media për të gjetur informacione lidhur me rastet që janë iniciuar. EULEX-i gjithashtu ka vërejtur një ndikim negativ që rrjedh nga perceptimet për PP nga ana e stafit Kufitar dhe efektin e dëmshëm që kjo ka tek morali dhe motivimi i hetuesve kufitar. Këto observime vetëm sa konfirmojnë konstatimet e bëra më herët nga monitoruesit e Sektorit për Krime të EULEX-it dhe nevojën për të fuqizuar ndryshime strukturore në marrëdhëniet mes PK dhe PP. Ndryshimet e tilla duhet të burojnë nga dëshira e sinqertë për të krijuar një vizion për një Sistem Unik të Drejtësisë, të mbështetur nga një numër aktorësh të rëndësishëm së barabartë të cilët informohen nga një sistem i përbashkët dhe i mirëfilltë për informim. (shih Rekomandimin PSD5/2009).

Sa i përket strategjisë së përgjithshme që do të shtynte përpara reagimin e PK ndaj krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, EULEX-i ka konstatuar nevojën për kalimin nga reagimi tërësisht ‘reaktiv’ ndaj krimeve që zbulohen dhe raportohen, drejt një qasjeje më ‘proaktive’. Kjo e fundit kërkon të ketë një sistem efektiv të inteligjencës, për të krijuar kështu një ushtrim të detyrave policore që ‘bazohen në inteligjencë’. Siç u pa më lartë, një sistem i tillë duhet të jetë i përbashkët për të gjitha shtyllat e organizatës së PK: nuk mund të ketë sisteme të ndara të inteligjencës për Policinë Kufitare apo PK për Krime etj. Një qasje efektive ndaj krimit ‘ndërkuftar’ gjithashtu kërkon të ketë një shfrytëzim racional dhe efikas të burimeve njerëzore dhe resurseve tjera në dispozicion në PK. Programi aktual për rikonstruktivitetin e organizatës së PK duhet të jetë i shumë i vëmendshëm ndaj nevojës për të maksimizuar shfrytëzimin e resurseve të kufizuara dhe kujdesin

për të mos pasur punë të dyfishta apo kundërthënëse. Nuk do të duhej të kishte fusha në të cilat komponentë të ndryshme të organizatës të jenë në 'konkurrencë' me njëri tjetrin.

REKOMANDIMI I EULEX -it – DFP/25/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë në Departamentin për Kufij dhe Departamentin për Krime. Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të Policisë Kufitare sa i përket racionalizimit të strukturave të PK, dhe shmangies së punës së dyfishtë dhe kundërthënies të panevojshme. Kjo çështje është tejet relevante për luftimin e 'krimit ndërkufitar' (pjesë e zhvillimit të MIK) dhe shfrytëzimi hetuesve në PK për Krime dhe Departamentin për Kufij.

Si hap i mëtejshëm në zhvillimin e MIK, PK-ja duhet të punojë me Doganën, PP dhe EULEX-in për të zhvilluar një strategji për krimet ndërkufitare. Kjo strategji do të duhej të përcaktonte objektivat kryesore për tri vitet e ardhshme, bazuar në inteligjencën dhe të dhënat statistikore mbi trendet e krimit ndërkufitar në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Për më shumë, strategjia do të duhej të maksimizonte shfrytëzimin e resurseve mes agjencive dhe të eliminonte punët e dyfishta, të panevojshme dhe kundërthënëse si dhe konkurrencën e padobishme. Sikurse me sistemin e drejtësisë, në përgjithësi, krimi ndërkufitar mund të luftohet përmes bashkëpunimit të ngushtë, punës ekipore dhe strategjisë së përbashkët.

REKOMANDIMI I EULEX –it - DFP/26/2009

Synimi: PK, Komandantët e Lartë të PK, Prokuroria Publike dhe Menaxherët e Shërbimit Doganor. Mentorimi dhe këshillimi i stafit përkatës të PK në zhvillimin e një strategjia të përbashkët kundër krimit ndërkufitar në bashkëpunim me Shërbimin Doganor dhe Prokurorinë Publike të Kosovës. Kjo strategji duhet të themelojë objektiva kryesore për tri vitet e ardhshme, të maksimizojë përdorimin e resurseve të agjencive dhe të eliminojë dyfishimin e punës së panevojshme dhe kundërthënëse dhe konkurrencën e padobishme.

Së fundi, monitoruesit e EULEX-it rekomandojnë që Drejtori i Policisë Kufitare të Kosovës dhe stafi tjetër i lartë të bëjnë vizita më të shpeshta stafit të tyre operativ nëpër sektorë. Kjo praktikë i shton përfitimet jo vetëm sasiore, por edhe cilësore në kuptim të përmirësimit të moralit të stafit, rritjes së standardeve dhe shtimin e efektivitetit në përmbushjen e objektivave dhe synimeve të Policisë Kufitare të Kosovës. Komandantët e lartë, në anën tjetër do të mund të mësonin më për së afërmi se cilat janë mendimet e zyrtarëve operativ dhe të përcjellin shqetësimet e komandantëve të lartë stafit të tyre përkatës.

REKRUTIMI, NGRITJA NË DETYRË DHE MBAJTJA E MË TË MIRËVE

Personeli dhe struktura e PK-së

Policia e Kosovës (e njohur si Shërbimi Policor i Kosovës para vitit 2009) ishte themeluar më 1999 dhe ishte ndihmuar në zhvillimin e saj bashkërisht nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) si dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Në pjesën më të madhe të periudhës së formimit të saj, politikat, procedurat dhe legjislacioni i PK-së janë formësuar kryesisht nga UNMIK-u. Derisa bartja përfundimtare e kompetencave mbi politikat në kuptimin e rekrutimit të personelit dhe zhvillimit kishte fituar dinamikë pas vitit 2006, ndërsa parimet aktuale që janë baza e numrit të personelit, strukturës organizative, strukturës së gradave, rekrutimit dhe sistemeve të gradimit, janë vendosur nga UNMIK-u.

Në kuptimin e numrit të përgjithshëm, PK-ja përfaqëson një nga organizatat policore më të vogla në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë në përgjithësi. Në fillim të vitit 2009, PK kishte gjithsej 7076 policë në shërbim të popullsisë së vlerësuar në 2.2 milionë banorë. Siç shihet në tabelën 4.1, kjo do të thotë që ka 321 policë në 100.000 banorë, duke e vendosur atë fuqimisht në kufirin e ultë të raportit polic/banorë në rajon, prapa Kroacisë (449) dhe IRJM-së (488). Brenda grupit mostër të shteteve anëtare të BE-së, PK gjendet diku kah mesi, pas Austrisë (320), Gjermanisë (304), Irlandës (301), Anglisë dhe Uellsit (265), dhe Holandës (215).

Si masë e dobishme e vëllimit të mundshëm të punës, numri total i krimeve të regjistruara mund të jetë tregues krahasimtar i ngarkesës që vihet mbi organizatat policore. Tabela 4.1 në kolonën e fundit tregon numrin mesatar të krimeve për polic (në vit) në secilën organizatë policore. Ngarkesa relative mbi PK-në është e konsiderueshme. Me një mesatare prej 9.2 krimesh për polic, PK-ja ka shumë më tepër punë sesa IRJM-ja (2.2 krime për polic) dhe Kroacia (4). Për më tepër, PK-ja ka më shumë krime për polic sesa 4 nga 11 shtetet e BE-së në grupin e mostrës. Siç diskutohet tek pjesa “Luftimi efektiv i krimin”, përpjesa e lartë e krimeve për polic është ndoshta e ndikuar më shumë nga vëllimi relativisht i lartë sesa numri në dukje i ultë i policëve për 100,000 banorë. Megjithatë, është e qartë që brenda kontekstit të Ballkanit Perëndimor, PK-ja, organizata më e re policore në rajon – përballë me sfida të konsiderueshme dhe kërkon më shumë efikasitet e efektivitet në sigurimin e ligjit dhe rendit sesa disa nga fqinjët e saj.

Tabela 4.1a – Numri i policëve – Krahasim ndërkombëtar²¹

²⁰. *Burimi i të dhënave për Shtetet e BE-së, Kroacinë dhe IRJ të Maqedonisë: Tavares, C. & Thomas, G., (2008), Statistikat në fokus, Krimi dhe Gjykata penale, EUROSTAT. Gjetur më janar 29, 2009 nga: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-SF-08-019/EN/KS-SF-08-019-EN.PDF*

Vendi	Gjithsej policë	Banorë	Gjithsej krime të regjistruara për polic	Numri i krimeve në 100,000 banorë
Austria	26 623	8.3	320	22
Belgjika	38 963	10.6	367	25
Franca	241 998	64.4	375	15
Gjermania	250 284	82.2	304	25
Greqia	48 521	11.1	437	9
Irlanda	12 954	4.3	301	7
Italia	324 339	59.6	544	8
Holanda	35 324	16.4	215	34
Portugalia	48 082	10.5	457	8
Sllovenia	7 857	2	392	11
(MB) Anglia dhe Uellsi	141 381	53.3	265	38
Mesatarja e Mostrës së BE-së			361	18
Kroacia	19 790	4.4	449	4
IRJ e Maqedonisë	9 776	2	488	2.2
Kosova	7076	2.2	321	9.2

Numri total i personelit prej 7076 i referohet numrit total të policëve të rregullt të punësuar nga Policia e Kosovës në janar të vitit 2009, duke përfshirë nëpunësit civil dhe Pjesëtarët e Sigurimit të PK-së.

Shifrat e sakta për popullsinë e Kosovës nuk janë në dispozicion dhe 2.2 milionë banorë është vlerësimi më i mirë i ofruar nga agjencitë ndërkombëtare.

Vlerësimi prej 9.2 krimesh për zyrtar të PK-së bazohet në numrin total të krimeve të regjistruara në Kosovë për vitin 2008, gjegjësisht 65,238 (siguruar nga Shtylla e Krimit në KP).

21 *Burimi: Debati televiziv 'Konfront', transmetuar në Koha Vizion (KTV), të premten më 30 janar 2009.*

Siç shihet në tabelën 4.1b, organizata e PK-së ka arritur kulminacionin në numrin e personelit më 2006, me një numër total prej 8368 pjesëtarësh. Kjo shifër përfshinte 7187 policë dhe 1181 nëpunës civil mbështetës. Edhe pse rekrutimi i policëve nga PK-ja është ngadalësuar që nga viti 2007, numri i përgjithshëm i policëve ka qëndruar stabil. Numri i përgjithshëm i policisë së rregullt (pra duke mos përfshirë pjesëtarët e Sigurimit të PK-së) dhe personelit civil mbështetës ka shënuar një zvogëlim prej 1.9% prej 2006-ës. Përkundër pohimeve të sindikatës policore që një numër i madh i policëve kanë lënë punën në vitet e fundit si rezultat i nivelit të ultë të pagave²², shifrat nuk duken të mbështesin këtë pohim. Personeli policor ka rënë vetëm për 1.5%, si dhe ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të tyre në nivelet e gradave me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë, si Rreshter dhe Toger (5.2%, respektivisht 12%).

Derisa personeli i EULEX-it raporton se pagat janë çështje brengosëse për oficerët e PK-së, kjo nuk mund të merret si kërcënim madhor ndaj qëndrueshmërisë së organizatës së PK-së në klimën aktuale ekonomike në Kosovë. Punësimi i sigurt, pa marrë parasysh a është në sektorin privat apo atë publik, mbetet i pamjaftueshëm për fuqinë punëtore kosovare në rritje, kurse policët kanë mundësi të kufizuara për punësim tjetër nëse ndjehen të pakënaqur me kushtet në shërbimin policor. Fusha tjera brengosëse për EULEX-in janë faktorët tjerë që ndikojnë në motivimin individual dhe grupor brenda gjitha organizatave policore: mundësitë e barabarta në gradim dhe përzgjedhja për role të specializuara, si dhe cilësia e mbikëqyrjes dhe udhëheqjes. Edhe pse oficerët mund të mendojnë që duhet të fitojnë më shumë para si shpërblim i duhur për punën e tyre, ata do të pajtohen që vendimet mbi shkallën e kompensimeve mbesin jashtë fushëveprimit të organizatës.

Në anën tjetër, vendimet për sistemin e gradimit dhe cilësinë e udhëheqësve policor janë gjëra që janë brenda kontrollit të organizatës dhe udhëheqësve të saj.

Tabela 4.1c ofron një analizë të shkurtër të strukturës së përgjithshme etnike të organizatës së PK-së, me krahasimin mes viteve 2006 dhe 2009. Sikur në numrin e përgjithshëm të oficerëve në organizatë (shih tabelën 4.2 më lart), po ashtu, ka pasur pak ndryshime në përbërjen etnike të PK-së në tre vitet e fundit.

Tabela 4.1b – Gradat e Policisë së Kosovës dhe nivelet e personelit – krahasimi mes viteve 2006 dhe 2009

Tetor 2006		Janar 2009		Dallimi
Grada	Numri	Grada	Numri	
Gjeneral Kolonel Nën-	1	Gjeneral Kolone Nën-	1	Nuk ka
Gjeneral Major	4	Gjeneral Major	4	Nuk ka
Kolonel	16	Kolonel	16	Nuk ka
Nënkolonel	28	Nënkolonel	25	- 3
Major	33	Major	31	- 2
Kapiten	93	Kapiten	88	- 5
Toger	263	Toger	299	+ 36 (12%)
Rreshter	790	Rreshter	834	+ 44 (5.2%)
Oficer Patrulle	5959	Oficer Patrulle	5778	- 181 (3%)
Gjithsej policë	7187	Gjithsej policë	7076	- 111 (1.5%)
Personel mbështetës civil	1181	Personel mbështetës civil	1131	- 50 (4.2%)
Gjithsej personel	8368	Gjithsej personel	8207	- 161 (1.9%)

PK-ja, në kuptimin e shifrave të përgjithshme të saj, duket se e pasqyron apo reflekton përbërjen etnike të shoqërisë së cilës i shërben. Edhe pse numri i oficerëve shqiptar është rritur paksa, ndryshimi përbën më pak se 1% të numrit të përgjithshëm. Ndoshta brengë më e madhe ka qenë zvogëlimi i numrit të oficerëve policor serb. Derisa ndryshimi përbën më pak se 1% të numrit të

përgjithshëm, humbja e 39 oficerëve është rënie e konsiderueshme e numrit të tyre fillestar (5.3%).

Tabela 4.1c – Përbërja etnike e policisë së Kosovës (krahasim mes vitit 2006 dhe 2009)				
Përkatësia etnike	Numri i policëve në secilin grup etnik		Grupi etnik si % e numrit të përgjithshëm të policëve	
	2006	2009	2006	2009
Shqiptar	6031	5987	83.9	84.6
Ashkanli	21	20	0.29	0.28
Boshnjak	228	210	3.1	2.97
Çerkez	5	5	0.07	0.07
Kroat	3	3	0.04	0.04
Egjiptas	6	7	0.08	0.10
Goran	38	37	0.53	0.52
IRJM	1	1	0.01	0.01
Malazez	2	0	0.03	0.00
Rom	23	20	0.32	0.28
Serb	740	701	10.3	9.91

Turk	86	85	1.2	1.2
Tjerë	1	0	0.01	0.00
Gjithsej	7185		7076	

Tabela 4.1d – Përbërja etnike e policëv të PK-së sipas gradave

Përkatësia etnike	Gradat								
	Gjeneral nën-kolonel	Gjeneral Major	Kolonel	Nënkolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Oficer Patrulle
Shqiptar	1	4	14	21	27	78	276	701	4868
Ashkanli	-	-	-	-	-	-	-	3	17
Boshnjak	-	-	1	3	1	1	4	41	159
Çerkez	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kroat	-	-	-	-	-	-	-	2	1
Egjiptas	-	-	-	-	-	-	-	3	4
Goran	-	-	-	-	-	-	2	6	29
IRJM	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Malazez	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rom	-	-	-	-	-	-	2	1	17
Serb	-	-	2	1	3	9	13	65	608
Turk	-	-	-	-	-	1	2	13	69
Jo-shumicë %	0	0	17.6	16%	12.9%	12.3%	7.6%	16%	15.7%
	Mbikëqyrje dhe udhëheqje 13.5%								

Sipas një burimi, përbërja e përafërt etnike e Kosovës është 87% shqiptarë etnik, 9% serbë etnik dhe 4% grupe tjera etnike²³. Prandaj, në një situatë ideale përbërja etnike e PK-së do të duhej ta reflektonte këtë përbërje, në numrin e përgjithshëm dhe në secilin nivel të organizatës. Siç shihet në tabelën 4.1c përfaqësimi i shqiptarëve etnik më 2009 është 84.6%, pak më pak sesa përpjesa e vlerësuar e shqiptarëve në popullsi; përfaqësimi i serbëve etnik në PK është 9.9%, pak më shumë sesa përpjesa e vlerësuar e tyre në popullsi; derisa grupet tjera etnike përbëjnë 5.5% të PK-së, pak më lart sesa pjesa e tyre në popullsi. Siç tregohet në tabelën 4.1d, përpjekja për të pasqyruar strukturën etnike të Kosovës në strukturën e gradave në PK gjithashtu duket të jetë relativisht e suksesshme. Serbët etnik dhe pakicat tjera etnike përfaqësohen me 13.5% të gradave mbikëqyrëse dhe menaxhuese (pra mbi gradën e policit patrullues), pak mbi përqindjen e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

Edhe pse gradat më të larta (Gjeneral Nën-Kolonel dhe Gjeneral Major) janë zënë nga pesë oficerë shqiptar, përfaqësimi etnik i pakicave në gradat e ndërmjetme është më se proporcional. Përfaqësimi i pakicave është 17.6% në gradën e Kolonelit, 16% në gradën e Nënkolonelit, 12.9% në gradën e Majorit, dhe 12.3% në gradën e Kapitenit. Me përjashtim të gradës së Togerit, tri gradat e para gjithashtu arrijnë përfaqësi më se proporcional. Ky nivel i përfaqësimit të pakicave ka vënë në pah PK-në si organizatë policore shembullore në kontekstin e Ballkanit Perëndimor

²². *Anketa për matjen e standardit të jetesës (2000), Enti Statistikor i Kosovës.*

dhe Evropës. EULEX-i lëvdon PK-në për arritjen e saj në pasqyrimin e shoqërisë që i shërben, si dhe e inkurajon organizatën që ta ruajë standardin e saj të lartë.

Në kuptimin e pasqyrimin të strukturës gjinore të shoqërisë kosovare, PK-ja, si shumë organizata simotra, është shumë larg nivelit të përkryer të përfaqësimit të femrave. Përkundër kësaj, PK-ja ka vazhduar ruajtjen e një niveli të përfaqësimit femëror shumë më të lartë sesa organizatat tjera policore në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë në tre vitet e fundit. Në shkurt të vitit 2009, femrat përbënin 13.3% të PK-së, në krahasim me shifrën prej 13.6% më 2006. Siç tregohet në tabelën 4.5, shumica e 945 oficerëve kanë gradën e polices patrulluese (87.4%) dhe përfaqësojnë vetëm 9.1% të gradave mbikëqyrëse dhe udhëheqëse të organizatës.

Tabela 4.1e – Përkatësia gjinore e zyrtarëve të PK-së sipas gradave

Gjinia	Gradat								
	Gjeneral Nën-kolonel	Gjeneral Major	Kolonel	Nënkolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Oficer Patrulle
Mashkullore	1	3	15	23	27	83	272	758	4952
% meshkujve	100%	75%	88.2 %	92%	87%	93.2%	90.6%	90.7%	85.7%
Femërore	-	1	2	2	4	6	27	77	826
% femrave	-	25%	11.7 %	8%	12.9%	6.7%	9%	9.2%	14.2%

Gjithsej	1	4	17	25	31	89	299	835	5778
Egjiptase	-	-	-	-	-	-	-	3	4
Gorane	-	-	-	-	-	-	2	6	29
	Femra me grada mbikëqyrëse dhe menaxhuese 9.1%								

Policet i gjejmë të pranishme gati në të gjitha gradat, përveç atyre më të lartat, ndërsa një police është emëruar Zëvendëse e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës në shkurt të vitit 2009. E gjithë kjo tregon se PK-ja është organizatë që ofron një shkallë të mirë të mundësive të barabarta për femrat. EULEX-i e përgëzon PK-në për politikën e saj të mundësive të barabarta dhe e inkurajon atë që ta ruajë dhe zhvillojë këtë arritje krenare.

Në kuptimin e zhvillimit drejt praktikave më të mira evropiane, sistemi i gradimit, i përdorur nga PK-ja, ka hapësirë për përmirësim. Është vërejtur që sistemi do të mund të bëhej më objektiv dhe transparent. Aktualisht, provimi përzgjedhës përdoret si sistemi primar i filtrimit për tri gradat e para mbikëqyrëse (rreshter, toger dhe kapiten). Ky përbëhet nga një Provim me 150 pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe i referohet njohurisë së Doracakut të Politikave dhe Procedurave, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, si dhe fushat tjera të ligjeve. Këto provime nuk përdoren në procesin e përzgjedhjes së gradave të mesme dhe të larta (pra major, nën-kolonel, kolonel, gjeneral major, si dhe gjeneral nën-kolonel). Intervistat përdoren në proceset përzgjedhëse për të gjitha gradat: megjithatë, forma e saktë e veprimit dallon për secilën gradë. Ata që kërkojnë ngritje në gradë të rreshterit pyeten për fushat e aftësive themelore, si komunikimi, udhëheqja, vendim-marrja, njohuria/përvoja profesionale, motivimi dhe gjykimi. Për ata që dëshirojnë të jenë togerë, ka pyetje për fushat e aftësive themelore, si komunikimi, udhëheqja, vendim-marrja, njohuria/përvoja profesionale, motivimi dhe gjykimi, por edhe puna në ekip, mundësitë e barabarta, larmia kulturore, vetëdijesimi për komunitetet, menaxhimi i kohës, planifikimi operativ dhe inovacioni.

Kandidatët për gradën e Kapitenit duhet të bëjnë prezantimin formal të një teme të dhënë dhe të vlerësuar në kuptimin e komunikimit, udhëheqjes, vendim-marrjes, punës ekipore, mundësive të barabarta, larmisë kulturore, vetëdijen mbi komunitetet, motivimin, menaxhimin e kohës, planifikimin operativ dhe inovacionin. Ngjashëm, kandidatët për gradën e Majorit duhet të bëjnë një prezantim formal mbi menaxhimin e një incidenti kritik, të vlerësuar në kuptimin e komunikimit,

udhëheqjes, vendim-marrjes, punës ekipore, mundësive të barabarta, larmisë kulturore, vetëdijen mbi komunitetet, motivimin, menaxhimin e kohës, planifikimin operativ dhe inovacionin. Kandidatët për gradat nën-kolonel dhe kolonel intervistohen nga një panel intervistues dhe nuk duket të ketë ndonjë format të saktë apo përbërje të rekomanduar.

Në nivelin më të lartë, kandidatët për gradat e Gjeneral Majorit dhe Gjeneral Nën-Kolonelit intervistohen nga Komiteti për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore (KELDP), panel i përfaqësuesve komunal dhe sekretarëve të përhershëm²⁴, sipas Ligjit për Policinë e Kosovës. EULEX-i e përgëzon këtë qasje për zgjedhjen e komandantëve më të lartë. Kjo i jep mundësi përfaqësuesve të palëve të ndryshme dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë që të japin kontributin e tyre në përzgjedhjen e komandantëve të lartë.

Përveç filtrave përzgjedhës të përmendur më lart, oficerit i duhet të ketë nota përkatëse gjatë vlerësimit vjetor të tij, si dhe miratimin e mbikëqyrësve të njësisë që është e nënkuptueshme. Edhe pse është e vështirë të vlerësohet plotësisht, ekziston një perceptim mes oficerëve të PK-së që sistemi i gradimit do të mund të ishte pak më objektiv dhe i drejtë. Monitoruesit e EULEX-it rekomandojnë që komandantët e lartë të PK-së të iniciojnë një program të rishikimit dhe reformimit të sistemit të gradimit. Ky program do të realizonte një sondazh lidhur me mendimin e PK-së për sistemin e gradimit dhe perceptimet mbi objektivitetin dhe drejtësinë e tij. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë edhe integritetin e provimeve, vlerësimeve dhe komisioneve aktuale të intervistimit. Duhet marrë parasysh dhe vlerësuar metoda shtesë apo alternative të përzgjedhjes, si dhe të përgatitet një raport gjithëpërfshirës si bazë për masat e mundshme të reformës.

REKOMANDIMI I EULEX-it– DFP/27/2009

Synimi: PK, Oficerët e Lartë dhe Menaxherët e Trajnimeve Mentorimi dhe këshillimi për personelin gjegjës të lartë të PK-së në lidhje me hartimin e një programi të shqyrtimit dhe reformimit të sistemit të gradimit. Programi duhet të hulumtojë mendimin e PK-së në lidhje me aspektet e sistemit të gradimit, perceptimet e objektivitetit të tij si dhe integritetin e provimeve, vlerësimeve dhe paneleve ekzistuese. Metoda shtesë apo tjera të përzgjedhjes duhen marrë parasysh dhe vlerësuar, si dhe duhet përgatitur një raport gjithëpërfshirës si bazë për masa reformuese.

²³. Sekretar i Përhershëm është titulli i shërbyesit më të lartë civil në një Ministri, sipas Ligjit për Shërbimin Publik në Kosovë.

Departamenti për Personel dhe Trajnime

Në nëntor 2007, funksionet e Shtyllës së Administratës u ndanë në Shtyllën e Personelit dhe Trajnimit, si dhe Shtyllën e Shërbimeve Mbështetëse. Kjo e fundit udhëhiqet nga një punëtor civil, derisa Personeli dhe Trajnimi janë nën komandën e një Ndihmës Drejtori Gjeneral. Si tek sektorët tjerë, këto funksione administrative menaxhohen dhe drejtohen nga Shtabi Qendror i PK-së, në Prishtinë. Brenda këtyre dy shtyllave janë grupuar një numër shërbimesh të personelit, administratës dhe mbështetjes.

Shtylla e PK-së për Personel dhe Trajnime ka përgjegjësi për sigurimin e përputhshmërisë me ligjin dhe Doracakun e Politikave dhe Procedurave (DPP) në kuptimin e përzgjedhjes dhe zhvillimit të personelit, si dhe administrimin e mungesave të personelit dhe vlerësimet e punës individuale.

Tabela 4.2a – Vlerësimi themelor organizativ – Personeli dhe Trajnimi

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Mirë		Kënaqshëm	Strukturë e mirë, me rol të definuar dhe personel të trajnuar
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Personel i pamjaftueshëm nga pakicat etnike
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Mirë		Kënaqshëm	

Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Departamenti ka prodhuar raporte tremujore dhe vjetore që përdorin të dhëna statistikore
-------------------------------------------------------	-----------	--	-----------	------------------------------------------------------------------------------------------

Departamenti i Trajnimit ka të autorizuar një personel prej 115 zyrtarësh (civil dhe policor), si dhe në shkurt të vitit 2009 rreth 87.8% e pozitave tanimë ishin zënë. Ekspertët e EULEX-it e kanë gjykuar strukturën aktuale si të mirë, përkundër nevojës për përzgjedhje të personelit për funksione të caktuara (Shef i Trajnimit Bazë, Shef i Njesisë për Zhvillimin e Karrierës, si dhe Drejtor i Administratës dhe Mbështetjes për Trajnime). Departamenti i trajnimit ndahet në tri njësi kryesore funksionale: Drejtoria e Trajnimit Bazë (64 punëtorë), Drejtoria e Trajnimit të Specializuar (19 punëtorë) si dhe Drejtoria e Administratës dhe Mbështetjes për Trajnime (15 punëtorë). Shumica e personelit (81%) është e vendosur në *Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH)*, Vushtrri, që është vendi kryesor për trajnimin e organizatës së PK-së.


Departamenti është i strukturuar mirë, me një nivel të mirë të përcaktimit të rolit dhe trajnimit të stafit. Personeli i EULEX-it ka gjykuar aftësinë planifikuese të Departamentit si të mirë, siç është treguar me Planin Vjetor të Departamentit të Trajnimit për 2008. Kurset dhe materialet e trajnimit janë gjykuar të jenë përqendruar në nevojat e punëtorëve dhe organizatës së PK-së, të hartuara me objektiva të qarta mësimore dhe që ofrohen nga trajnues të kualifikuar.

Vëzhguesit e EULEX-it nuk kanë gjetur fakte të korrupsionit apo ndërhyrjeve politike në aktivitetet e kësaj Shtylle. Marrëdhëniet me Ministrinë e Punëve të Brendshme janë përgjithësisht të mira. Kontakti kryesor i Departamentit me MPB-në është KCSPEZH-i, agjenci ekzekutive e Ministrisë. Vëzhguesit e EULEX-it kanë gjetur që personeli i Departamentit dhe KCSPEZH-it takohen rregullisht dhe gëzojnë një nivel të mirë bashkëpunimi.

KRIJIMI I NJË ORGANIZATE TË QENDRUESHME

Në nëntor 2007 funksionet e Administratës ishin ndarë në Departamentin për Trajnime dhe Personel dhe Departamentin për Shërbimet Mbështetëse. Kjo e fundit menaxhohet nga një nëpunës civil ndërkohë që Personeli dhe Trajnimet janë nën komandën e Ndihmësit të Drejtorit të Përgjithshëm. Si edhe për sektorë të tjerë këto funksione administrative menaxhohen dhe udhëhiqen nga Shtabet e PK në Prishtinë. Një sërë shërbimesh të personelit, shërbime administrative dhe mbështetëse ndërlidhen mes këtyre dy Departamenteve.

Figura 5.1 – Struktura e Shtyllës së re të Shërbimeve Mbështetëse



Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse është vendi ku kryhen shumë funksione mbështetëse teknike, që janë qenësore për qëndrueshmërinë themelore të organizatës ë PK. Ky përfshin pesë drejtori që korrespondojnë me funksione themelore të administratës: buxhet dhe financa, prokurim, logjistikë, pajisje dhe Komunikim/teknologji informative.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa posedon një ekip të stafit të kualifikuar dhe kompetent civil për kryerjen e funksioneve të tyre të specializuara. Planifikimi financiar zhvillohet në përputhje të plotë me ligjin (Ligji mbi Menaxhimin dhe Llogaridhënien Financiare Publike) dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE). EULEX-i në mënyrë aktive ka monitoruar procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2010 në PK.

Tabela 5.1a – Vlerësimi themelor operativ – Drejt. Buxhet dhe Financiar. (Shërbimet mbështetëse)

Treguesi	Përmbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Mirë		Kënaqshëm	Gjithë stafi civil është i kualifikuar dhe kompetent
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Staf i pamjaftueshëm me përkatësi etnike jo-shumicë
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Dobët		Kënaqshëm	Mos ndëshkimi i menaxherëve të PK të cilët kanë thyer rregullat financiare.
Menaxhimi i performancës/ cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Dobët		Kënaqshëm	Nevoja për të lëvizur drejt planifikimit afatgjatë dhe projekteve shumëvjeçare.
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	N/K		Kënaqshëm	

Buxheti dhe Financat janë departament i centralizuar që merret me të gjitha transaksionet në nivelin e Shtabit Qendror, shtabeve rajonale dhe stacioneve të Policisë. Ndarjet dhe shpenzimet tremujore buxhetore për secilin departament, autorizohen, certifikohen dhe miratohen në nivelin qendror. Propozimet e buxhetit për vitin vijues përpilohen në nivel qendror në bazë të kërkesave të dorëzuara nga secili departament. Ka raste kur ndarjet bëhen bazuar në prioritetet e menaxherëve dhe jo të objektivave strategjike të organizatës. Monitoruesit e EULEX-it kanë konstatuar situata kur një komponent ka ndryshuar prioritetet e veta gjatë përgatitjes së buxhetit, madje edhe pas miratimit të tij. Në raste të tjera monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur që

komponentët dorëzojnë projekte shumëvjeçare për financim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, pastaj i bëjnë zotimet ndaj fondit të cilat mandej i ndryshojnë vitin tjetër, kështu mbesin mjetet e fondeve të pashpenzuara dhe kthehen si suficit në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Gjithashtu është konstatuar që shpenzimet gjatë vitit fiskal kanë rezultuar në përqendrimin e shpenzimeve më të mëdha gjatë tremujorit të fundit që tregon për një keq-menaxhim të fondeve apo planifikim të dobët. EULEX ka vërejtur që ekziston një mungesë e masave korigjuese të ndërmarra nga menaxhmenti i PK-së kundër personave përgjegjës për këto keq-menaxhime të fondeve.

Derisa këto raste në njërin anë paraqesin shkelje të ligjeve dhe procedurave të miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, në anën tjetër nuk janë ndërmarrë fare masa kundër menaxhmentit të lartë, prandaj ka fare pak indikacione që organizata të mund të zhvillohet dhe të mësojë nga përvoja në kuptim të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit:

- a) Planifikimi duhet të bazohet në strategji afatgjata të PK-së;
- b) PK-ja duhet të veprojë përmes projekteve shumëvjeçare që përfshijnë këtu edhe një vlerësim të shpenzimeve të përsëritshme (kostoja e mirëmbajtjes) e cila do të shfaqet çdo vit, në mënyrë që të mos paraqitet përmes projekteve vjetore;
- c) Për menaxherët e departamenteve të PK-së që nuk e shfrytëzojnë buxhetin e tyre sipas ndarjeve, duhet ndërmarrë masa disiplinore nga IPK-ja;
- d) Procesverbalet nga të gjitha takimet për planifikim të buxhetit duhet ruajtur në mënyrë që të demonstrojnë llogaridhënien;
- e) Duhet ndërmarrë hapa drejt decentralizimit të buxhetit dhe financave si mënyrë për të rritur efektivitetin dhe llogaridhënien;
- f) Duhet shqyrtuar edhe mundësinë për decentralizimin e pagave dhe ndryshimet në listën e unifikuar të pagesave.

REKOMANDIMI I EULEX-it- DFP – PSD/28/2009

Synimi: PK, Menaxherët e lartë të Shërbimeve Mbështetëse Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të PK-së në programin e përpiluar për përmirësimin e administrimit të buxhetit dhe financave në organizatë. Kjo do të përfshijë edhe zhvillimin e një strategjie afatgjate, projektet shumëvjeçare, vlerësimin e përfitimeve nga decentralizimi dhe nevojën për trajnime shtesë për menaxherët e PK-së që janë përgjegjës për dorëzimin dhe shpenzimin e buxhetit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) është akoma në fazën e hershme të zhvillimit. Për herë të parë kërkesa buxhetore për miratim u dërgua në MPB në vitin 2008. Për sa i përket llojeve të projekteve të propozuara për financim apo për nivelin e shpenzimeve rrjedhëse, nëse ka atëherë ekziston një ndërhyrje e lehtë e MPB-së. Sidoqoftë Ligji për Policinë nuk parasheh ndonjë përfshirje të MPB-së në planifikimin e buxhetit të PK-së. Neni 67 .2 i Ligjit për Policinë thotë se, “Drejtori i Përgjithshëm [i PK-së] do ta përgatis buxhetin për policinë dhe ia dorëzon Ministrisë për shqyrtim dhe përpunim të mëtutjeshëm, në përputhje me procedurat e parapara me ligj”.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur gjithashtu bashkëpunim të paktë të MPB-së në përgatitjen e Udhëzimeve Administrative për shfrytëzimin e fondeve në mirëbesim të PK-së. Sipas Ligjit për Policinë, udhëzimet administrative për këtë fond duhet të përgatiten nga MPB-ja. Konsultimi me PK-në, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, është i nevojshëm në mënyrë që të sigurohet që procedura të jetë në përputhje me procedurat dhe legjislacionin ekzistues. Por këto konsultime nuk janë zhvilluar dhe procesi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ është vështirësuar prandaj ekziston nevoja për ndryshime plotësuese të këtij Udhëzimi.

Drejtoria e ka bërë publik “raportin financiar të fundvitit”, për të cilin monitoruesit e EULEX –it vlerësojnë të jetë i standardit të ‘kënaqshëm’ posaçërisht në kuptim të informacioneve që ofron. Ai e përshkruan përqindjen e shpenzimeve nga kategoritë ekonomike karshi ndarjeve të tremujorit, shpenzimet për tremujorin e parë 2008 të krahasuar me tremujorin e parë 2009. Por nuk ka ndonjë referencë për shpenzimet e bëra nga programet e as referenca ndaj gjendjes së investimeve kapitale të planifikuara për 2009.

Raporti pasqyron edhe njëherë një planifikim të dobët të buxhetit brenda PK-së. Edhe pse buxheti tremujor është ndarë në bazë të nevojave të PK-së për para, përqindja e shfrytëzimit nga kategoritë ekonomike ishte shumë e ultë në krahasim me ndarjet (me përjashtim të pagave dhe mëditjeve të shfrytëzuara 100%). Për shembull, Mallra dhe Shërbime - 59% të ndarjeve të tremujorit; investimet kapitale - 8% të ndarjeve të tremujorit; shërbime komunale - 73% të ndarjeve të tremujorit; subvencioneve - 62% të ndarjeve të tremujorit. Shfrytëzimi total i buxhetit është afër 67%, por ky tregues ndikohet nga shfrytëzimi 100% për Paga dhe Mëditje.

Kategoria më e rëndësishme ekonomike, investimet kapitale, kanë përqindjen më të ultë të shfrytëzimit me vetëm 8%, që tregon se planifikimi për investime kapitale në PK për 2009 ishte shumë i dobët. Ky raport duhet të merret si bazë për të bërë ndryshime në organizim në kuptim të

përmirësimet të menaxhimit financiar të PK-së, ndonëse monitoruesit e EULEX-it kanë konstatuar që kjo situatë vazhdon të ekzistojë që nga viti 2007, nuk është ndërmarrë asnjë masë për ta përmirësuar atë.

REKOMANDIMI I EULEX-it - DFP/29/2009

Synimi: PK, Menaxherët e Lartë në Shërbimet Mbështetëse

Mentorimi dhe këshillimi stafit të lartë të PK në zhvillimin e hetimeve speciale në kushte të performancës së dobët të shpenzimeve për investime kapitale. Hetimet duhet të identifikojnë shkaktarët kryesorë të performancës dhe të sjellin masat e mundshme përmirësuese. Kjo do të përbënte bazën e programit për reformim dhe do të përmirësonte performancën për vitin 2010.

Drejtoria për Prokurim është duke punuar sipas Ligjit për Prokurim Publik dhe udhëzimet përkatëse administrative, sepse nuk ka ndonjë rregullore të brendshme brenda PK-së. Ky legjislacion është në përputhje me parimet e BE-së në fushën e prokurimit, por zbatimi i tij, sipas monitoruesve të EULEX-it, është i një niveli më të ulët krahasuar me praktikat më të mira të BE-së. Për shembull, nuk ka ndonjë strukturë të brendshme në prokurim dhe nuk ka njësi që merren me fusha të caktuara apo me tenderë, ka vetëm disa asistentë dhe një jurist.

Sipas monitoruesve të EULEX-it, Drejtoria ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm të përshkrimeve të detyrave të punës, rregullore të brendshme (RReP), themelim të njësive brenda drejtorisë, bazë të dhënave për tenderë dhe porosi për blerje /kontrata dhe një trajnim bazik të punëtorëve për kompjuterë.

Procesi i planifikimit të prokurimit rezulton nga ai i planifikimit të buxhetit, ndërsa sipas monitoruesve të EULEX-it, parashikimet e prokurimit janë shumë të përgjithësuara dhe nuk e specifikojnë materialin apo shërbimin e blerë. Kjo bën që nevojat e PK-së në të ardhmen të mbulohen pa shkelur parashikimet dhe për rrjedhojë faktorët në treg gjithashtu nuk mund të parashohin mundësitë e tyre në të ardhmen.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur që edhe konsultimet brenda Drejtorisë janë të dobëta, sepse stafi i lartë takohet një herë në javë për të diskutuar projektet për Mbështetje dhe Shërbime dhe është mundësia e vetme zyrtare ku ata mund të diskutojnë çështjet. Për shkaqe të panjohura, drejtorët/udhëheqësit e njësive nuk komunikojnë në mënyrë efektive gjatë javës, përveç takimit javor, mirëpo kërkojnë nga këshilltarët e tyre që t'i informojnë të tjerët. Monitoruesit e EULEX-it gjithashtu kanë vërejtur që nuk zhvillohen takime javore as brenda Drejtorisë, prandaj për pasojë

nëpunësit kanë njohuri të mangëta mbi atë se çfarë po ngjan në Drejtori, si dhe nuk mund të nxjerrin mësim nga të tjerët.

Madje, duket të ketë edhe veprime të kufizuara përcjellëse ndaj njësive që kërkojnë rezultatet e tenderit prandaj edhe ngjan të ketë ankesa nga rajoni. Ka përpjekje që investimet kapitale të konsiderohen prioritet nga Menaxhmenti i Objekteve, ndërsa Drejtori i Prokurimit ka fare pak ndikim, gjë që vitin e kaluar ka ndikuar në vonesa disa mujore. EULEX-i rekomandon që monitoruesit e tij të përcjellin tenderët dhe të veprojnë si menaxherë/menaxherë të projektit cilësor, së bashku me një zyrtarë të emëruar nga PK-ja, i cili e njeh praktikën e prokurimit. Një prej kushteve kryesore në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) është transparenca dhe sipas monitoruesve të EULEX-it kjo nuk është përmbushur plotësisht nga PK-ja. Andaj sugjerohet që menaxherët e projektit të veprojnë si një pikë kontakti për informim sa i përket njësive që bëjnë kërkesa. Ky rol do të përfshinte edhe detyrën e identifikimit të zbrazësive dhe shkaktarët e vonesave në praktikën/procedurat e Drejtorisë, përfshirë këtu edhe planifikimin dhe implementimin e parashikimeve vjetore të prokurimit.

REKOMANDIMI I EULEX-it - DFP/30/2009

Synimi: PK, Menaxherët e Lartë të Shërbimeve Mbështetëse Mentorimi dhe këshillimi i stafit të lartë të PK-së për tenderët në vijim e sipër dhe të veprojnë si menaxherë për cilësi/menaxherë të projektit, së bashku me një zyrtar të emëruar të PK, i cili ka njohuri për praktikën e prokurimit. Menaxheri i projektit duhet të veprojë si pikë kontakti për njësitë të cilat paraqesin kërkesat e tyre dhe të ndihmojnë në identifikimin e zbrazësive dhe shkaktarëve të vonesave në praktikën/procedurat e Drejtorisë, përfshirë planifikimin dhe implementimin e parashikimeve vjetore në prokurim

Kontratat më të reja aktive të PK-së nuk i mbulojnë të gjitha nevojat që dalin me rastin e blerjes së produkteve të caktuara, siç është mirëmbajtja e automjeteve të reja. Sipas monitoruesve të EULEX-it ekziston nevoja që të bëhen edhe kalkulimet e kostos së jetëgjatësisë së produkteve dhe krahas me to dhe të ketë një menaxhim më profesional të kontratave. Kjo do të mund të bëhet përmes krijimit të zyrës për kontrata apo duke zhvilluar një bashkëpunim më të mirë me Logjistikën e PK-së: Veç kësaj, implementimi i LPP duhet të rishqyrtohet edhe përmes procedurave të brendshme të prokurimit. Vetë Ligji është në përputhje me standardet ndërkombëtare, mirëpo jo edhe mënyra e zbatimit të tij.

Drejtoria për Logjistikë është përgjegjëse për menaxhimin e automjeteve të PK-së, transportin, depot e armëve dhe municionit, uniformat dhe pajisjet si dhe për menaxhimin e depove. Ekzistojnë dobësi strukturore: në kohën e vlerësimit, EULEX-i ka gjetur jo më pak se 46 pozita në strukturën e lejuar që kishin mbetur të zbrazëta. Ekziston një numër i konsiderueshëm i policëve

në Departament dhe EULEX-i rekomandon që PK-ja të vazhdojë me politikën e vet ashtu që në Komponentin për Shërbime dhe Mbështetje të ketë vetëm nëpunës civil, gjë që do të pasqyronte praktikat më të mira evropiane dhe do të siguronte që policët e uniformuar të kryejnë vetëm funksione policore.

Tabela 5.1b – Vlerësimi themelor organizativ – Logjistikë (shërbime mbështetëse)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Kënaqshëm		Kënaqshëm	Ekzistojnë 46 vende të lira pune në strukturën e autorizuar
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Staf i pamjaftueshëm me përkatësi etnike jo-shumicë
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	
Menaxhimi i performancës/cilësia e punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Planifikimi i aktiviteteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	Mirë		Kënaqshëm	

Është konstatuar që Drejtoria është ballafaquar me vështirësi të mëdha në përbushjen e standardit për mirëmbajtjen e automjeteve të PK-së me gjithsej 1,521 automjete (përfshirë këtu edhe 63 modele të ndryshme): është mundur në një masë t'i mirëmbajë automjetet përmes shfrytëzimit të punëtorive të veta, mirëpo ka hasur vështirësi gjatë ruajtjes dhe sigurimit të mjaftueshëm të pjesëve rezervë. Njëkohësisht, Drejtoria ka paguar për mirëmbajtje dhe riparim të

automjeteve edhe disa kompani private. Kryesuesi i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse është duke e shqyrtuar strategjinë për mirëmbajtjen e të gjitha automjeteve dhe përfitimet e mundshme nga kontraktimi i këtyre punëve.

Drejtoria për Komunikim dhe Teknologji Informative (DKTI) përbën një funksion qenësor për një organizatë efektive dhe moderne të policisë. Njëkohësisht vlerësimet fillestare të monitoruesve të EULEX –it tregojnë që DKTI-ja akoma nuk është plotësisht e qëndrueshme, për shkak të varësisë nga mbështetja teknike nga jashtë. Dy policë turq do të vazhdojnë të ofrojnë mbështetjen e tyre gjatë verës 2009. Nga gjithsejtë 63 pozita të Kom/TI të parapara me buxhet, 23 sish (36%) kanë ngelur të paplotësuara për shkak të pamundësisë së PK-së për ta mbajtur stafin e trajnuar dhe me përvojë.

Tabela 5.1c – Vlerësimi themelor organizativ – Drejtoria për Kom. dhe TI (shërbime mbështetëse)

Treguesi	Përbushja		Objektivi	Komenti
Struktura e stafit, përcaktimi i roleve dhe trajnimi	Dobët		Kënaqshëm	Stafi aktual akoma nuk është i qëndrueshëm sepse mbështetet në ndihmën direkte të IMM. Shkalla e pozitave të lira është 36%.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Staf i pamjaftueshëm me përkatësi etnike jo-shumicë.
Pajisjet dhe objektet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji/PPM/RreP	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i mungesave	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përputhshmërisë	Mirë		Kënaqshëm	Sistem efektiv për sigurimin e respektimit të rregullave nga gjithë shfrytëzuesit e kompjuterëve në organizatën e PK.
Menaxhimi i performancës/	Kënaqshëm		Kënaqshëm	

cilësia e punës				
Planifikimi i aktiviteteve	shumë mirë		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i të dhënave të inteligjencës/statistikat	N/A		kënaqshëm	

Departamenti u vlerësua të jetë efektiv në sigurimin e respektimit të punës dhe rregullave nga shfrytëzuesit e kompjuterëve kudo në PK: të gjithë softuerët standard janë të licencuar (përmes MPB-së) dhe shumica e kompjuterëve janë të lidhur në rrjetin e pavarur të PK-së. Ndërkohë që kjo e fundit është e ndarë nga rrjeti publik përmes protokolleve për mbrojtjen dhe sigurinë e rrjetave dhe të sistemeve antivirus. Vetëm personat me të drejta të administrimit kanë të drejtë të shkarkimit të softuerëve të rinj në kompjuterët e PK.

Struktura e zgjidhjeve dhe rrjetit për Kom/TI në PK, fillimisht është krijuar nga UNMIK-u dhe udhëhequr me rekomandimet e këshilltarëve të UNMIK-ut prej vendeve të ndryshme. Shumica e sistemeve të TI-së janë donacione prej vendeve të ndryshme dhe për këtë arsye Komunikimi dhe TI-ja janë ndërtuar pjesë-pjesë andaj nuk përbëjnë një strukturë të integruar. Për shembull, në planin për investime për vitin 2009, ekzistojnë dy projekte të dyfishta për kontrollin e vendkalimeve kufitare. Sistemi i TI-së në përdorim në pesë vendkalime kufitare i njohur si PISCES, nuk i përmbush kriteret e Schengen-it, ndërsa projekti që mbështetet nga BE do t'i plotësojë këto kriteret dhe duhet të realizohet në të gjitha vendkalimet kufitare në vitin 2009.

Në kuptim të qëndrueshmërisë, kapaciteti i TI-së i organizatës së PK-së është problematik. Në PK nuk ka personel të mjaftueshëm kompetent teknik për të mirëmbajtur, rritur apo azhurnuar sistemet. Kjo përbën një tjetër problem madhor sidomos kur merren parasysh shkalla dhe importimi i projekteve aktuale të Kom/TI:

(a) Radio sistemi analog. Rreth 7000 radiolidhje të dorës, më shumë se 600 radiolidhje të instaluar nëpër automjete, më shumë se 95 radio baza dhe përafërsisht 60 antena emetuese/repetitorë funksionojnë në frekuencën UHF. PK-ja do të zgjerojë këtë sistem me radio baza të reja, radiolidhje dhe shtylla.

(b) Sistemi telefonik i PK-së (VOIP) është i ndërtuar në bazë të shpërndarjes së sinjaleve të TI-së përmes lidhjeve me mikrovalë (Motorola Canopy Links) PABX-ve për secilin stacion të PK-së. PK-ja do ta zgjerojë këtë sistem dhe do të përfshijë edhe pajisje shtesë për sigurinë e rrjetit.

(c) Rrjeti kryesor i kompjuterëve në PK mbulon 95% të kompjuterëve të organizatës. PK-ja do ta zgjerojë këtë rrjet për të gjitha stacionet policore dhe Pikat Kufitare. Gjithashtu planifikohet të përmirësohet edhe siguria e rrjetit.

(d) Sistemi Digjital i Komunikimit (Matra Radio Tetra Pol) është pronë e UNMIK-ut. PK-ja ka rreth 300 radiolidhje Tetra Pol që shfrytëzohen nga sektorët më sekrete. PK-ja ka bërë kërkesë që ta merr një sistem si donacion nga UNMIK-u dhe ka kërkuar edhe nga BE një donacion prej 2.6 milion euro për mirëmbajtje, trajnim dhe zgjerimin e këtij sistemi. Sistemi aktual nuk i përmbush standardet evropiane.

(e) SIPK (Sistemi i Informimit të Policisë së Kosovës) është i dizajnuar ashtu që ta mbështesë menaxhimin e centralizuar të bazës kryesore të dhënave në PK. Instalimi është kompletuar në këto rajone: SHQ Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe brenda SHQ të policisë kufitare në Lluzhan, Gjakovë, Aeroport dhe Kaçanik. SIPK do të instalohet nëpër stacione policore vetëm me mundësinë e 'leximit.

(e) Sistemi PISCES ²⁵ është një donacion nga SHBA dhe i mbështetur nga ICITAP. Shfrytëzohet për kontrollin e hyrjeve-daljeve të njerëzve në vendkalimet kufitare. Aktualisht, sistemi funksionon në Aeroport, Vërmicë, Han të Elezit, Mutivodë (4) dhe Qafë të Prushit. Sido që të jetë, ky sistem nuk i përmbush kriteret e Schengen-it.

(f) Sistemi i kontrollit të udhëtarëve me sistem të pajtueshëm të Shengenit është projekt i mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian për ta instaluar një sistem bashkëkohor të kontrollimit të udhëtarëve dhe të automjeteve në të gjitha vendkalimet kufitare. Në fazën e parë do të instalohet hardueri (serverët, kompjuterët, skanerët e pasaportave dhe pajisjet e tjera përcjellëse), ndërsa në fazën e dytë përfshihet instalimi dhe përdorimi i softuerit.

(g) Licencimi i kompjuterëve personal dhe i serverëve me programet e nevojshme. PK do të bëhet pjesë e marrëveshjes së arritur nga MPB çdo tri vjet dhe do t'i paguajë tarifën e licencës për çdo vit.

(h) Krijimi i programeve specifike për nevojat e PK-së. Krijimi i programeve të brendshme për departamentet e ndryshme: p.sh. sistemi i faturimit për telefonat ekzistues të PK-së; menaxhimi i sistemit të buxhetit dhe atij të prokurimit; dhe sistemi për arkivimin e dokumenteve dhe për menaxhimin e pasurisë; etj.

²⁴

Sistemi për krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal

(i) Sistemi i furnizimit të pandërprerë me energji elektrike (UPS) për ta stabilizuar furnizimin me rrymë në pikat kryesore të rrjetit të PK-së. Për t'iu shmangur gabimeve dhe prishjeve të pajisjeve për shkak të rrymës jostabile.

(j) Krijimi i një sistemi të centralizuar kundër viruseve – një sistem i centralizuar për mbrojtjen e rrjetit të PK-së nga dëmtimi i viruseve dhe kërcënimet e tjera.

Departamenti i teknologjisë informative/komunikimit i PK-së nuk ka ndonjë plan të përgjithshëm për ta bërë baraspeshimin për projektet dhe detyrat e ndryshme me personel, pajisje, objekte dhe me burime të tjera të mjaftueshme. Në nivelin e planifikimit strategjik, PK nuk ka bërë kërkesa specifike nga departamenti i TI/Komunikimit: departamenti ka bërë çdo gjë të mundshme për të zhvilluar projekte të ndara me anë të mbështetjes së vendeve dhuruese, duke i plotësuar boshllëqet në burimet e papërshtatshme. Monitoruesit e EULEX-it mendojnë që këto sisteme të ndara dhe të ndryshme kurrë nuk mund të integrohen dhe deri në një shkallë ta caktuar nuk i përmbushin standardet evropiane dhe kushtet e Shengenit (p.sh. sistemi digjital i radios TETRA Pol dhe PISCES (Sistemi për Krahasimin e Sigurt Vlerësimin e Identifikimit të Personelit).

Monitoruesit e EULEX-it mendojnë që faktorët për racionalizim kërkojnë një qasje të arsyeshme ndaj TI/Komunikimit në PK. Për shkak të territorit të vogël të Kosovës dhe burimeve të saj të kufizuara financiare duhet të ketë më shumë bashkëpunim brenda institucioneve qeveritare dhe ndërmjet atyre institucioneve në mënyrë që të arrihet dobia nga bashkëpunimi.

EULEX-i rekomandon që monitoruesit e tij të kenë mundësi të ndihmojnë në çuarjen e TI/Komunikimit të PK-së drejt qëndrueshmërisë. Kjo mund të bëhet duke mentoruar dhe këshilluar lidhur me gjendjen e regjistrave dhe gatishmërinë për t'i integruar ato në sistemet e kontrollimit (d.m.th. regjistra për qytetarë, kriminelë, armë, pasaporta, patentshoferë, automjete dhe automjete të vjedhura), dhe bashkëpunimin ndërmjet regjistrave. Ata po ashtu duhet të mentorojnë dhe këshillojnë lidhur me strukturën e projekteve të TI/Komunikimit: p.sh. dokumentet e organizatës, llogaritjen e kohës së shfrytëzimit, kërkesat e personelit dhe nevojat e tyre për aftësim, pjesët rezervë dhe mirëmbajtja.

REKOMANDIMI I EULEX-it– DFP/31/2009

Objektivi: PK, menaxherët e lartë të shërbimeve mbështetëse

Të mentorohet dhe këshillohet stafi i lartë përkatës i PK-së lidhur me gjendjen e regjistrave dhe gatishmërinë për t'i integruar ata në sistemet e kontrollimit (p.sh. regjistra për qytetarë, kriminelë, armë, pasaporta, leje për vozitje, automjete dhe automjete te vjedhura), dhe bashkëpunimin ndërmjet regjistrave. Ata po ashtu duhet të mentorojnë dhe këshillojnë lidhur me strukturën e projekteve të TI /Komunikimit: p.sh. dokumentet e organizatës, llogaritjen e kohës së shfrytëzimit, kërkesat e personelit dhe nevojat e tyre për aftësim, pjesët rezervë

Përveç kësaj, do të ketë nevojë që monitoruesit e EULEX-it t'i ndihmojnë çuarjes përpara të plotësisht të numrit të personelit në TI/Komunikimit të PK-së drejt një baze plotësisht të qëndrueshme. Ata do ta mentorojnë dhe këshillojnë personelin e lartë të PK-së lidhur me zhvillimin e strategjisë për rekrutimin, aftësimin dhe – çka është më e rëndësishmja – për mbajtjen e një ekipi të specialistëve vendor për TI/Komunikim dhe t'i japin fund mbështetjes në specialistët e huaj.

REKOMANDIMI I EULEX-it – DFP/32/2009

Objektivi: PK, menaxherët e lartë të shërbimeve mbështetëse

Ta mentorojnë dhe këshillojnë personelin lartë përkatës së PK-së lidhur me zhvillimin e një strategjie për rekrutimin, aftësimin dhe – çka është më e rëndësishmja – mbajtjen e një ekipi vendor të specialistëve të TI/Komunikimit dhe t'i japin fund mbështetjes në specialistët e huaj.

Funksione të caktuara të shtyllave të administratës të PK-së janë të decentralizuara (p.sh. Personeli dhe Aftësimi dhe Shërbimet Mbështetëse). Në secilin **Shtab Rajonal** ekzistojnë ekipe të personelit administrativ për ta lehtësuar rrjedhën e dyanshme të informatave ndërmjet funksioneve qendrore dhe personelit rajonal të PK-së. Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur disa dobësi strukturore në nivelin rajonal, si pjesë të vlerësimit të tyre themelor organizativ. Edhe pse pjesa më e madhe e personelit kanë përshkrim të vendit të punës, asnjë prej dokumenteve nuk janë aprovuar zyrtarisht nga Shtabi Qendror i PK-së dhe një pjesë e personelit (30% në Prishtinë) nuk janë aftësuar për të kryer punë specifike për mbështetje administrative apo logjistike. Është vërejtur që, në përgjithësi, Shtabet Rajonale nuk kanë numër të mjaftueshëm të personelit administrativ për ta kryer punën.

Treguesi	Përmbushja	Objektivi	Komenti
Tabela 6.14 Vlerësimi i Organizimit themelor – Njësitë Rajonale administrative (Shërbimet mbështetëse)			

Struktura e personelit, përkufizimi i rolit dhe aftësimi	Dobët		Kënaqshëm	Personel të pamjaftueshëm, përshkrime të paautorizuara të vendit të punës, aftësim të pamjaftueshëm në disa fusha.
Përbërja etnike /gjinore	Dobët		Kënaqshëm	Numër të pamjaftueshëm të personelit jo-shumicë.
Objektet & pajisjet	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Ligji /PPM/PSO-të	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i koncepteve	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i pajtueshmërisë	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Menaxhimi i përmbushjes /cilësisë së punës	Kënaqshëm		Kënaqshëm	
Aktivitetet planifikuese	Dobët		Kënaqshëm	
Shfrytëzimi i inteligjencës /statistikave	Dobët		Kënaqshëm	

Edhe pse të gjithë mbikëqyrësit rajonal i kanë përfunduar kurset standarde për menaxhim dhe mbikëqyrje në Akademinë Policore (QKSPEZH), monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur shkathtësi shumë të dobëta planifikuese. Dokumentet planifikuese kanë qenë të strukturuar dobët dhe atyre ju kanë munguar objektivat specifike dhe të matshme. Një çështje e lidhur me këtë është shfrytëzimi i dobët i të dhënave statistikore. Nuk kishte ndonjë lidhje ndërmjet objektivave dhe të dhënave të administratës të mbledhura nga rajoni dhe as tregues që menaxherët kishin kapacitet ose vullnet t'i shfrytëzojnë të dhënat në vendimmarrje. Duket se mbledhja e të dhënave përfundon aty dhe nuk ka ndonjë kulturë të analizimit të dhënave dhe të shfrytëzimit të rezultateve për ta ndihmuar vendimmarrjen.

Drejtësia

Kjo pjesë e raportit ju referohet shtyllave të një sistemi funksional gjyqësor në Kosovë, domethënë nëse gjyqësori i Kosovës vendos në bazë të fakteve, zbatimit të ligjit pa ndërhyrje të jashtme të pavend dhe është i pajisur me resurse të përshtatshme. Vlerësimi po ashtu e ka shqyrtuar edhe marrjen e duhur të kompetencave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për ta mbikëqyrur pavarësinë e gjyqësorit të Kosovës.

Parakusht kryesor për sistem funksional gjyqësor është pavarësia e gjykatësve dhe autonomia e prokurorëve në Kosovë. Pavarësia e gjykatësve në Kosovë kërkon ekzistimin e kushteve formale (pavarësinë *de jure*) dhe që kushtet formale të bëhen realitet (pavarësia *de facto*). Pavarësia *de jure* ka të bëjë me procedurën e emërimit, të ngritjes në pozitë dhe të shkarkimit të gjykatësve në Kosovë dhe që gjykatësit e punësuar të jenë profesionistë të cilët posedojnë standardin më të lartë të integritetit, kualifikim dhe aftësim të përshtatshëm, përgjegjësi kjo që i është dhënë Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Për këtë nevojitet që sistemi gjyqësor të mos jetë i politizuar dhe si rrjedhojë të mos ketë elemente politike të cilat mund të kenë ndikim në procedurat e emërimit, të ngritjes në pozitë dhe të shkarkimit. Pavarësia *de facto* përsëri lidhet me faktorët siç janë ekzistimi i ndërhyrjes së pavend nga jashtë dhe ekzistimi i mekanizmave të duhur mbrojtës për t'i parandaluar ndërhyrjet e tilla, por lidhet edhe me pagesën e gjykatësve në Kosovë.


Gjyqësori nuk duhet të jetë vetëm i pavarur, por, po ashtu, duhet t'i nënshtrohet mekanizmit transparent të llogaridhënies për ta siguruar paanësinë e sistemit. Duhet të ekzistojnë institucionet dhe procedurat e përshtatshme që e sigurojnë llogaridhënien e gjyqësorit të Kosovës në sytë e popullsisë të Kosovës. Niveli i llogaridhënies e matë deri në çfarë shkalle vendimet gjyqësore i pasqyrojnë standardet juridike dhe profesionale vendore dhe ndërkombëtare.

Një sistem funksional gjyqësor mbështetet, po ashtu, në një Shërbim Korrektues funksional në Kosovë i cili ka kapacitet dhe integritet të mjaftueshëm që t'i mbajë në arrest dhe menaxhojë të burgosurit dhe t'i kontrollojë incidentet në burgje në mënyrë të njerëzishme. Kuadri do të plotësohet me një Ministri funksionale të drejtësisë e cila e siguron zhvillimin dhe zbatimin e politikës dhe të legjislacionit në fushën e drejtësisë përfshirë ndjekjet penale, shërbimin korrektues, qasjen e drejtë dhe efikase në drejtësi, personat e zhdukur dhe marrëdhëniet e jashtme.


Pasqyra demografike e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë

Statistikat tregojnë që pjesa dërrmuese e gjykatësve dhe e prokurorëve në Kosovë e kanë kryer shkollimin e tyre juridik gjatë kohës së ish-Jugosllavisë.

Siç shihet në tabelën e mëposhtme, moshën e 269 gjykatësve në Kosovë silltet prej 32 deri në 68 vjet, ndërsa mesatarja është 54 vjet. Kjo tregon që 18% e gjykatësve në Kosovë janë mbi moshën 60 vjeçare dhe 27 % prej tyre janë nën moshën 50 vjeçare, ndërsa 2.7 % të gjykatësve janë nën moshën 40 vjeçare.



Siç shihet në tabelën e mëposhtme 21% e prokurorëve në Kosovë janë mbi moshën 60 vjeçare (përveç një gjykatësi i cili është nën moshën 40 vjeçare).



Plani strategjik i KGJK-së

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) e ka miratuar një plan strategjik për ta përmirësuar funksionimin e gjyqësorit (ai ju referohet temave siç është qasja në drejtësi, integriteti i procesit dhe funksioneve gjyqësore, zgjidhja e lëndëve, zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve) dhe aty përfshihet perioda ndërmjet vitit 2007 dhe 2012 dhe ka

tregues të paktë që KGJK-ja është aktualisht duke punuar lidhur me zbatimin e planit strategjik. Disa njerëz brenda Këshillit kanë pohuar që plani strategjik ishte produkt i organizatave ndërkombëtare duke e perceptuar kështu që nuk është i tyre.

Rekomandimi i EULEX-it – JC/1/2009

Objektivi: KGJK

Ta përmirësojë zbatimin e planit strategjik duke i përkufizuar fushat të cilat kanë prioritet

Gjykatësit në fushën penale

Gjykatësit e EULEX-it ua kanë paraqitur me sukses mandatin e misionit kolegëve të tyre në rajonet e Gjykatave të Qarkut (GJQ)²⁶ duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në Ligjin për juridiksionin e EULEX-it . Të gjithë gjykatësit e EULEX-it kanë raportuar për një shkallë të lartë të bashkëpunimit me kolegët e tyre vendor dhe qasje të papenguar në informata, përveç disa hezitimeve në fillim të treguara nga disa gjykatës të vendit. Aktivitetet e MMK-së nuk kanë mundur të fillojnë në GJQ-në e rajonit të Mitrovicës së veriut për arsye të cilat e tejkalojnë qëllimin e këtij raporti, dhe në përgjithësi aktivitetet MMK janë ndërmarrë përkrah funksioneve ekzekutive të kërkuara nga gjykatësit e EULEX-it.

Gjykatësit në fushën civile

Gjykatësit e EULEX-it nga rajonet e GJQ-ve kanë raportuar për një nivel të mirë të bashkëpunimit me homologët e tyre ashtu siç është dëshmuar nga qasja e papenguar në informata. Gjykatësit civil të EULEX-it janë përgjigjur me një shkallë të lartë të profesionalizmit dhe të përkushtimit gjatë marrjes së detyrave si gjykatës (penal) të procedurës paraprake ose kryetarë të panelit.

Të gjitha rajonet e GJQ-ve raportojnë lidhur me fenomenin e gjykimeve të përsëritura të lëndëve civile të cilat kanë për pasojë numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura. Gjykatësit e EULEX-it nga një rajon i GJQ-së (Prizren) kanë bërë një analizë të hollësishme të kësaj gjendjeje për ta përcaktuar numrin e lëndëve civile të përfunduara në nivelin e GJQ-së.

²⁶. *Ligji e rregullon integrimin dhe juridiksionin e gjykatësve dhe të prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.*

Statistikat nga gjykata e qarkut në Prizren kanë zbuluar që më shumë se 61% e lëndëve civile ridërgohen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Me sa duket këto lëndë kategorizohen si lëndë të reja duke e dhënë kështu bazën për statistikat e ardhshme. Statistikat e mbarë Kosovës kanë zbuluara që 43.6 % e të gjitha lëndëve civile të përfunduara ishin lëndë në të cilat vendimi i shkallës së parë ishte tërhequr dhe ishte ridërguar në shkallën e parë. Në teorinë gjyqësore, gjykatësit e shkallës së dytë duhet ta njoftojnë shkallën e parë lidhur me të gjitha gabimet dhe gjërat e harruara të cilat kanë çuar deri te ridërgimi. Nuk ka të dhëna statistikore sa rigjykime mbahen mesatarisht para se aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Duhet përmendur që pjesa më e madhe e ankesave të parashtruara nga qytetarët në këtë rajon të gjykatës së qarkut ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës civile dhe këto ankesa më së shumti kanë të bëjnë me lëndët e filluara në vitin 2000/2001.

EULEX-i raporton që i ka marrë funksionet gjyqësore në 10 lëndë civile të cilat kanë qenë të pazgjidhura për vite me radhë dhe të cilat vijnë nga gjykata komunale e Klinës dhe ajo e Istogut).

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/2/2009

Objektivi: KGJK dhe gjykatësit e Kosovës

Ta (1) shfuqizojnë bazën juridike për rigjykime, (2) KGJK duhet ta nxjerrë një udhëzim që gjykatësit e shkallës së dytë t'i ridërgojnë lëndët civile duke paraqitur arsyetim të qëndrueshëm, (3) gjykatësit e EULEX-it duhet ta krijojnë një model të diskutimeve të rregullta ndërmjet gjykatësve civil të EULEX-it dhe të atyre të Kosovës në mënyrë që ta krijojnë një platformë për diskutime gjyqësore, në të cilat përveç tjerash do të përfshihej edhe tema e rigjykimeve.

Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë dhe barazia gjinore

EULEX-i ka vlerësuar që komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e personelit të gjinisë femërore nuk janë të integruar sa duhet në gjyqësorin e Kosovës.

Prej numrit të përgjithshëm të gjykatësve të punësuar të Kosovës, 31 ju përkasin komuniteteve jo-shumicë (15 serbë të Kosovës, 5 turq të Kosovës, 11 boshnjakë të Kosovës). Kjo afërsisht është e njëjtë me përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në mbarë Kosovën. Megjithatë, sipas informatave të marra, në gjyqësorin e Kosovës janë aktiv dy gjykatës nga komuniteti serb i Kosovës edhe pse mund të shënohen tregues pozitiv në KGJK për ta mbështetur integrimin e komuniteteve jo-shumicë:

Aktualisht në shërbimin e prokurorisë të Kosovës janë të punësuar 89 prokurorë, 5 prej të cilëve ju takojnë komuniteteve jo-shumicë (5,6 %) dhe vetëm 23,6 % të prokurorëve të Kosovës janë femra.

Në mesin e 237 pjesëtarëve të personelit që nuk janë personel gjyqësor 6 % (14 sish) i takojnë popullsisë jo-shumicë dhe 60,3 % janë femra.

REKOMANDIMET E EULEX-it – KD/3/2009

Objektivi: KGJK, KPK dhe kryetarët e gjykatave

- 1) Ta përmirësojnë ri-integrimin dhe përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në sistemin e drejtësisë të Kosovës
- 2) Ta sigurojnë një përkushtim të fuqishëm për politikën e barazisë gjinore.

Këshilli i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

EULEX-i e ka vlerësuar se kapaciteti i Këshillit të KGJK-së për ta siguruar një gjyqësor të pavarur të Kosovës është brengosës për shkak të përbërjes së Këshillit të KGJK-së, i cili nënkupton një përfshirje të konsiderueshme të pushtetit politik në procesin e vendimmarrjes. Meqë Këshilli aktualisht nuk është duke funksionuar, deri tash nuk ka mundur të bëhet asnjë vlerësim praktik.

Sipas parimit 1 c) të rekomandimit të Këshillit nr. R (94) 12 të 'Komitetit të ministrave të shteteve anëtare për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjykatësve' (më tej përmendet si rekomandimet e këshillit), autoriteti i cili e merr vendimin për zgjedhjen dhe karrierën e gjykatësve duhet të jetë i pavarur nga qeveria dhe administrata.

Pas pushimit të zbatimit të UNMIK/REG/2005/52, është miratuar ligji për përbërjen e përkohshme të KGJK-së si një intervenim për ta plotësuar zbrazëtinë në pritje të miratimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ligji për përbërjen e përkohshme të Këshillit e përcakton që autoriteti i pjesëshëm i Këshillit, siç është përgjegjësia për punësimin e gjykatësve dhe të prokurorëve i është caktuar KPGJK-së. Komisioni disiplinor (i cili përbëhet nga gjykatësit e Gjykatës Supreme të cilët janë anëtarë të Këshillit) nuk është duke funksionuar si duhet.

Ndërsa numri i lartë i 9 gjykatësve plus 1 anëtar të Odës së Avokatëve si anëtarë të Këshillit të KGJK-së është element pozitiv për ta garantuar neutralitetin politik të Këshillit, fakti që 4 gjykatës plus një anëtar i Odës së Avokatëve duhet të emërohen nga Kuvendi është element mjaft negativ.

OSHC/OJQ-të po ashtu kanë kërkuar që të shqyrtohet përfshirja e Kuvendit të Kosovës në emërimin e gjykatësve dhe të anëtarit të Odës së Avokatëve në Këshillin e KGJK-së, ashtu siç dëshmohet nga pyetjet që kanë të bëjnë me përfshirjen e autoritetit të emëruar politikisht në procesin vendimmarrës së Këshillit.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/4/2009

Objektivi: KGJK

Ta sigurojë funksionimin e Këshillit të KGJK-së duke i emëruar gjykatësit dhe duke zhvilluar hetime disiplinore.


Infrastruktura e KGJK-së

EULEX-i ka vlerësuar që infrastruktura e përgjithshme, sa i përket hapësirës për zyra dhe pajisjeve teknike në dispozicion, është e mjaftueshme. Megjithatë, KGJK-së i mungon biblioteka që do të mund ta shfrytëzonin të gjithë të punësuarit dhe e cila duhet të jetë e pajisur me tërë literaturën përkatëse juridike siç janë komentaret e ligjeve, tekstet juridike, përmbledhjet e ligjeve dhe materiali për standardet profesionale dhe të etikës. Buxheti i caktuar duket që nuk është i përshtatshëm për t'i siguruar mundësitë funksionale të KGJK-së.

Numri i gjykatësve dhe i prokurorëve në raport me popullsinë


EULEX-i ka vlerësuar që, në krahasim me vendet fqinje dhe ato evropiane, numri i gjykatësve në Kosovë për 100,000 banorë është i ulët.

Sipas informatave të dhëna nga enti statistikor aktualisht janë 269 gjykatës të cilët ju shërbejnë përafërsisht 2,2 milionë njerëzve. Mesatarisht janë rreth 14.19 gjykatës që i kryejnë detyrat e tyre gjyqësore për çdo 100,000 banorë. Megjithatë, buxheti është i mjaftueshëm për emërimin e 392 gjykatësve në Kosovë, gjë që do të siguronte një raport prej 18.66 sish.



Informatat e tabelës të dhëna në: Raporti i Sekretarisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Departamenti për Statistika, “Analizë e punës së gjykatave gjatë vitit 2008”, faqe 2

Në Shërbimin Prokurorial në Kosovë aktualisht janë të punësuar 89 prokurorë, si rrjedhojë janë 3.7 prokurorë për 100.000 banorë.



REKOMANDIMI I EULEX-it- KD/5/2009

Objektivi: KPK

Ta monitorojë nivelin e kushteve të punës për gjykatësit dhe prokurorët në Kosovë dhe ta përcjellë nga afër procesin e punësimit

Personeli (mbështetës) ndihmës

EULEX-i ka vlerësuar që gjykatësit e Kosovës nuk kanë numër të mjaftueshëm të personelit ndihmës për t'i kryer detyrat e tyre gjyqësore.

Informatat e dhëna nga enti statistikor i KGJK-së zbulojnë që gjykatësit e Kosovës nuk kanë numër të mjaftueshëm të personelit ndihmës për t'i kryer detyrat e tyre gjyqësore. Në gjykatat e Kosovës janë të punësuar 1292 pjesëtarë të personelit jo-gjyqësor, 2.24 % prej të cilëve janë personel për mbështetje juridike të cilët duhet t'ju ofrojnë gjykatësve mbështetje të drejtpërdrejtë profesionale. Mesatarisht një pjesëtar i personelit për mbështetje juridike duhet t'i mbështes më shumë se shtatë gjykatës dhe kjo e pasqyron mungesën e kapaciteteve në të cilat duhet të mbështeten gjykatësit për t'i kryer detyrat e tyre.

Pagesa

EULEX-i ka vlerësuar që paga e gjykatësve të Kosovës nuk është e mjaftueshme për ta siguruar pavarësinë e tyre ekonomike.

Paga vjetore e kryetarit të Gjykatës Supreme (përfshirë shtesat mujore prej 81€) është 8,004.00€. Paga vjetore e një gjykatësi të Gjykatës së Qarkut është 6,000 €. Më 2007 në Kosovë, ekonomitë familjare me shkollim fillor apo më të ulët kanë shpenzuar rreth 5.380 €, me shkollim të mesëm kanë shpenzuar 5.718 €, kurse ato me shkollim të lartë kanë shpenzuar 7.472 €. Projektligji mbi gjykatat parashikon një rritje të pagave të gjykatësve të cilat do të ishin të barasvlershme me pagat e nëpunësve të lartë civil dhe të emëruarve politik në nivelet e krahasueshme. Në një letër të datës 30 qershor 2008, drejtuar Ministrisë së ekonomisë dhe të financave, drejtori i KGJK-së e paraqiti një propozim për rritjen e pagave të gjykatësve.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/6/2009

Objektivi: KGJK, Departamenti i administratës së shërbimit civil (MSHP), Ministria e ekonomisë dhe e financave

Ta monitorojnë propozimin aktual të KGJK-së për rritjen e nivelit të pagave të gjykatësve.

Infrastruktura në nivelin e gjykatave të qarkut

EULEX-i ka vlerësuar se infrastruktura, e cila është në dispozicion të gjykatësve të Kosovës të cilët shërbejnë në gjykatat e qarkut, nuk është e mjaftueshme. Fakti që gjykimet mbahen në zyra paraqet shqetësim të drejtpërdrejtë lidhur me respektimin e qasjes në drejtësi, meqë mundësia e njerëzve për t'i përcjellë gjykimet është e kufizuar. Veprimet gjyqësore pengohen drejtpërdrejt nga mungesa e objekteve për ruajtjen e sigurt të dosjeve të lëndëve dhe të dhomave të sigurta për depozitim.

Sipas Parimit III 1d. dhe e. të rekomandimeve të Këshillit duhet të sigurohen kushte të përshtatshme për punë në mënyrë që t'ju mundësohet gjykatësve të 1) punojnë në mënyrë efikase dhe, sidomos, duke ju siguruar në mes tjerash personel ndihmës dhe pajisje të përshtatshme dhe 2) të sigurojnë që gjykatësit mund të veprojnë në mënyrë efikase dhe pa vonesa të tepruara duke ndërmarrë masa të duhura për t'ua caktuar detyrat jo-gjyqësore personave të tjerë në pajtueshmëri me rekomandimin nr. R (86) 12 të Këshillit lidhur me masat për ta parandaluar dhe zvogëluar ngarkesën e tepruar me punë në gjykata.

Disa prej mungesave përvijohen këtu: gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës nuk kanë zyra të përshtatshme në të cilat do të mund të punonin personalisht dhe më sigurt dhe ta kryenin punën e tyre si duhet, pasi që zyrat i ndajnë me nëpunësit ndihmës ose me kolegët e tjerë. Të gjitha rajonet e GJQ-ve kanë raportuar se për shkak të mungesës së sallave të gjykimit, gjykatësit pjesën më të madhe të seancave gjyqësore i zhvillojnë në zyrat e tyre. Një rajon i GJQ-së ka raportuar për ruajtjen e pasigurt të dosjeve të lëndëve në dollapë të pambyllur në korridoret e gjykatave dhe është raportuar që personeli për pastrim kanë qasje nëpër zyra pa qenë të mbikëqyrur. Në një rajon të GJQ-së është raportuar që depoja dosjeve është e pasigurt meqë dera nuk i plotëson standardet themelore të sigurisë dhe thuhet se, kjo kishte mundësuar vjedhjen nga aty të 6 armëve në shtator 2008. Në një rajon tjetër të GJQ-së dhoma e rezervuar për diskutimet e avokatëve mbrojtës me të pandehurit përkatës është aktualisht duke u shfrytëzuar vetëm nga gjykatësit porotë. Gjykatësit nuk kanë personel ndihmës, domethënë zyrtarë ekzekutiv dhe ndihmës ligjor, prandaj janë të detyruar t'i përpilojnë vetë urdhrat ekzekutiv

dhe vetë t'i bëjnë hulumtimet juridik. Është raportuar se ka vonesa nga ana e KGJK-së në kryerjen e pagesave për ekspertët të cilët e japin mendimin e tyre gjatë seancave gjyqësore; kjo shpesh shkakton vonesa të tjera në procedurën penale pasi që ekspertët presin të bëhet pagesa e llogarisë para se t'ua japin mendimin e tyre gjykatave. Është raportuar për vonesa deri në 2 muaj.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/7/2009

Objektivi: KGJK

Ta monitorojë nivelin e përmirësuar të infrastrukturës që është në dispozicion për gjykatat

Aftësimi i gjykatësve dhe i prokurorëve

EULEX-i ka vlerësuar që korniza teorike për aftësim dhe zbatim të tyre praktik për gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës është e mjaftueshme.

Pavarësia e gjyqësorit kërkon që gjykatësit të jenë individë të cilët kanë integritet dhe aftësi me kualifikime në drejtësi dhe procesi i punësimit duhet ta sigurojë këtë kusht. Sipas parimit I 2. c) të rekomandimit të Këshillit, të gjitha vendimet lidhur me karrierën profesionale të gjykatësve duhet të bazohen në kritere objektive dhe përzgjedhja dhe karriera e gjykatësve po ashtu duhet të bazohet në meritë, duke i pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin. Sipas parimit III 1. a) dhe c) të rekomandimit të Këshillit duhet të ofrohen kushte të duhura për t'u mundësuar gjykatësve që të punojnë në mënyrë efektive duke punësuar një numër të mjaftueshëm të gjykatësve dhe duke u kujdesur për aftësim të duhur dhe një strukturë të qartë të karrierës në mënyrë që të punësohen dhe të mbahen gjykatësit e zotë.

Korniza teorike lidhur me aftësimin e gjykatësve të Kosovës ekziston. Prej vitit 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), i cili është një organ i pavarur publik profesional për sigurimin e aftësimit gjyqësor për gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës, ka bërë përpertime të konsiderueshme drejt kornizës pedagogjike për sigurimin e aftësimeve. Më 2008, IGJK e miratoi planin strategjik për periudhën ndërmjet vitit 2008 dhe 2011, rezultatet thelbësore të cilit do të jenë që të sigurojë ofrimin e aftësimit të cilësisë së lartë, përmes hulumtimit, zhvillimit dhe zbatimit të praktikave, standardeve të aftësimit dhe metodave më të mira. Pas zbatimit të planit strategjik dhe si rezultat i procesit të këshillimit me gjykatësit e Kosovës, KGJK, nën mbikëqyrjen e IGJK-së, i filloi dy programe që kishin për qëllim inaugurimin e kornizës pedagogjike në fushën e aftësimit për gjykatësit e Kosovës. U zhvillua një "Program i vazhdueshëm" për gjykatësit e Kosovës që ishin

duke punuar dhe u fut në përdorim si hap themelor drejt krijimit të një sistemi efikas të shkollimit të vazhdueshëm profesional për gjykatësit e Kosovës. Përveç kësaj, shkollimi i 'gjeneratës së re të gjykatësve dhe prokurorëve të Kosovës u mor parasysh duke e filluar "Programin fillestar për gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm të Kosovës" që zgjat 15 muaj. Grupi i parë prej 30 studentëve (prej të cilëve pesë janë femra) e kanë filluar këtë program pasi që e kanë kaluar me sukses provimin pranues të organizuar nga UNDP në Kosovë. Për gjashtë muaj, prej shtatorit 2008 deri në mars 2009, studentët e vijuan aftësimin teorik juridik të lidhur me një aftësim praktik tremujor (për ndërmjetësimin, shkathtësitë e komunikimit, menaxhimin e lëndëve, etj.) ku ishin ndarë në tri grupe të gjykatësve dhe prokurorëve praktikantë. Aftësimi përfundon me kryerjen e praktikës gjashtëmujore në gjykata, në Ministrinë e drejtësisë dhe/ose në KGJK. Është vërejtur që personelit jo-gjyqësor nuk ju ofrohet aftësim i rregullt përveç një aftësimi treditor mbi Sistemin e Menaxhimit të Lëndëve (SML).

Ngritja në pozitë dhe përzgjedhja e gjykatësve të Kosovës

EULEX-i ka vlerësuar që procesi i ngritjes në pozitë dhe i përzgjedhjes së gjykatësve të Kosovës i kryer deri më tani nga KGJK-ja nuk e ka siguruar pavarësinë e gjyqësorit të Kosovës. Mungesa e sistemit të vlerësimit të përbushjes së punës për gjykatësit e Kosovës tregon që ngritja në pozitë nuk mund të bazohet në merita, e cila nga ana tjetër ndikon në shkallën e objektivitetit dhe të transparencës së procedurës së punësimit dhe të ngritjes në pozitë. Mungesa e sistemit për vlerësimin e përbushjes së punës, po ashtu, nënkupton mungesën e mundësive për t'i shtuar kapacitetet e gjykatësve të Kosovës në mënyrë të planifikuar. Aktualisht, Komisioni Ndërkombëtar për Gjykatës dhe Prokurorë (KNGJP) e ka marrë përsipër procedurën e rekrutimit. Megjithatë, pas përfundimit të projektit, punësimi i zakonshëm i gjykatësve të Kosovës përsëri do të bëhet nga KGJK-ja. Prandaj nevojitet të hartohen dispozita të hollësishme lidhur me procedurën e punësimit dhe të ngritjes në pozitë dhe EULEX-i duhet ta përcjellë nga afër zbatimin e tyre.

Korniza teorike për ofrimin e vlerësimit për gjykatësit dhe prokurorët ekziston dhe jep hollësi lidhur me vlerësimin e përbushjes së punës të gjykatësve dhe prokurorëve. Megjithatë, zbatimi praktik i kornizës teorike mbetet i dobët. Prej vitit 1999 nuk është kryer pothuajse asnjë vlerësim i përbushjes së punës për gjykatësit e Kosovës.

Sidoqoftë, një zhvillim pozitiv që mund të vërehet është që, në gusht 2008, KGJK-ja e ka filluar formimin e një grupi punues për përcaktimin e standardeve të brendshme në bazë të cilave do të matej përbushja mujore e punës së gjykatësve të Kosovës. Grupi punues i inkurajoi të gjitha gjykatat në Kosovë të bëjnë propozime për standardet mujore dhe propozimet e tyre i paraqitën 15 gjykata komunale dhe 3 gjykata të qarkut. Propozimi i grupit punues është në pritje të konfirmimit

nga Këshilli i KGJK-së. Megjithatë, kjo nismë konsiderohet si shenjë pozitive se KGJK është proaktiv, pasi që shfaq gatishmërinë për të caktuar kritere objektive me të cilat do të matej përmbushja e punës së gjykatësve të Kosovës dhe e formon bazën për procedurat e ardhshme për vlerësimin e përmbushjes së punës nga ana e gjykatësve të Kosovës. Përveç kësaj, nisma jep shenja të qarta të bashkëpunimit ndërmjet Sekretarisë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjykatave nëpër rajone.

Lidhur me procedurën e përzgjedhjes së gjykatësve të Kosovës, verifikimi i kualifikimeve formale është një proces relativisht i çiltër, ndërsa përcaktimi i integritetit personal është më bishtnues dhe kërkon një metodë të përshtatshme e cila e garanton përzgjedhjen e kandidatëve të duhur. Intervistat e zhvilluara me gjykatësit e Kosovës në të kaluarën nuk kanë qenë të përshtatshme për vlerësimin e kualifikimeve të kandidatit, pasi që të gjithë kandidatët janë intervistuar së bashku në grup. Është vështirë të kuptohet se si procedura e zhvilluar në këtë mënyrë mund t'i vlerësojë me saktësi kualifikimet juridike, motivimin, përkushtimin, standardet personale dhe integritetin e kandidatit. Për më tepër, ka munguar verifikimi i së kaluarës (të dhënat e policisë, etj) të kandidatëve.

Në pajtim me nenin 7 të UNMIK/REG/2006/25 dhe me financimin e Komisionit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara, KNGJP është caktuar prej 1 shkurtit 2009 për ta bërë një shqyrtim gjithëpërfshirës, në mbarë Kosovën, për të gjitha emërimet në pozita të ndryshme nëpër gjykata dhe prokurori. Procedura e rishqyrtimit, e kryer nga KNGJP-ja, do ta ndryshojë rrënjësisht mënyrën e punësimit të gjykatësve të Kosovës.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/8/2009

Objektivi: KGJK

Ta mbështes zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të ngritjes në pozitë dhe të përzgjedhjes për gjykatësit e Kosovës duke u bazuar në kritere objektive

EULEX-i ka vlerësuar që KGJK duhet ta përmirësojë rolin e tij si institucion gjyqësor i orientuar drejt shërbimeve. Pothuajse nuk ekziston ndonjë praktikë e cila ka për qëllim integrimin e gjykatësve të Kosovës në procesin e vendimmarrjes të Këshillit të KGJK-së duke e marrë parasysh mendimin, rekomandimin dhe idetë e gjykatësve të Kosovës.

Procesverbali i disa takimeve të Këshillit tregon qartë që mungon bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të KGJK-së dhe gjykatësve të Kosovës. Nga rajonet e GJQ-ve, po ashtu, raportohet që duhet të rritet bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet KGJK-së dhe Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës.

Mungesa e një qasjeje të orientuar në shërbime vërtetohet edhe nga fakti që ofrimi i mbështetjes teknike për gjykatat është i dobët.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/9/2009

Objektivi: KGJK, kryetarët e gjykatave, gjykatësit e Kosovës dhe shoqata e gjykatësve të Kosovës

Ta rrisin qasjen e orientimit në shërbime dhe të integruar të KGJK-së ndaj gjykatave të Kosovës

LLOGARIDHËNIA E GJYQËSORIT TË KOSOVËS

EULEX-i ka vlerësuar që mekanizmat themelor të llogaridhënies aktualisht nuk janë funksional. Pavarësisht nga kjo, zbatimi i masave të llogaridhënies ashtu siç përcaktohen në Ligjin Kundër Korrupsionit nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe KGJK-ja (procesi i verifikimit të deklarimit të pasurisë nga ana e gjykatësve të Kosovës) është shenjë pozitive që i kontribuon rritjes së llogaridhënies në gjyqësorin e Kosovës.

Pavarësia gjyqësore bazohet në besimin e qytetarëve dhe kjo kërkon që gjykatësit të jenë të përgjegjshëm ndaj qytetarëve. Për këtë nevojitet ekzistimi i masave në mënyrë që të zbulohen, hetohen dhe të sanksionohen praktikatat të cilat janë në kundërshtim me besimin e qytetarëve, siç janë shkeljet e rënda të ligjit ose veprimtaritë korruptuese. Sipas nr. 7 dhe 8 të memorandumit sqarues të rekomandimit të Këshillit nr. R (94) 12 kompetencat të cilat ju jepen gjykatësve balancohen me detyrat e tyre dhe kjo e bën të domosdoshme që gjykatësit të jenë përgjegjës ndaj një sistemi të mbikëqyrjes që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe të detyrave të tyre.

Megjithatë, KNGJP do t'i shqyrtojë rastet e pazgjidhura disiplinore duke i diskutuar pohimet kundër kandidatëve gjatë intervistave me ta. Sidoqoftë, kjo nënkupton që bërthama e masave të llogaridhënies në gjyqësorin e Kosovës aktualisht nuk është duke funksionuar.

Një masë tjetër e llogaridhënies është përcaktuar me Ligjin Kundër Korrupsionit. Ligji, në mesin e masave të tjera, parashikon luftimin e korrupsionit në gjyqësorin e Kosovës, sidomos duke i mbikëqyrur pasurinë financiare të gjykatësve dhe të prokurorëve të Kosovës. Sipas nenit 41 të Ligjit kundër korrupsionit, gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës janë të obliguar të japin informata lidhur me "patundshmëritë, pasurinë e luajtshme në vlerë të madhe, zotërimin e aksioneve në

shoqëritë komerciale, letra me vlerë, para të gatshme të mbajtura në bankë, banka kursimesh dhe institucione tjera kursimi apo kreditore, borxhet, garancitë e ndërmarra dhe detyrimet tjera, dhe të hyrat vjetore”. Nga gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës kërkohet që ta deklarojnë për çdo vit pasurinë para afatit të fundit që është dita e fundit e muajit mars. Në të vërtetë, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe KGJK-ja bashkëpunojnë mes vete për verifikimin e shkallës së paraqitjes së pasqyrave financiare të pasurisë nga ana e gjykatësve të Kosovës.

Prej 14 gjykatësve të raportuar, gjatë vitit 2008, për mosparaqitje të pasqyrave financiare të pasurisë së tyre;

- 3 gjykatës janë shkarkuar për shkak të shkeljes së kodit të etikës,
- 2 gjykatës janë suspenduar pa pagesë në pritje të procedurave disiplinore,
- paga e një gjykatësi është zvogëluar për 20 %,
- për një gjykatës është raportuar që është në burg,
- për shtatë gjykatës është raportuar që i përkasin komunitetit jo-shumicë serb.

Prej 8 gjykatësve të raportuar, gjatë vitit 2009, për mosparaqitje të pasqyrave financiare të pasurisë së tyre:

- prej 1 qershorit pagat e katër gjykatësve janë zvogëluar për 20%,
- për një gjykatës është raportuar që është në pushim mjekësor pa pagesë, dhe
- për katër gjykatës është raportuar se i përkasin komunitetit jo-shumicë serb

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/10/2009

Objektivi: KGJK

Të sigurojë funksionalizimin e komisionit disiplinor të KGJK-së

MBROJTJA E DËSHMITARËVE

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it e kanë vlerësuar si të ulët shkallën e kërkimit të masave mbrojtëse për dëshmitarët e gjykimeve në rastet e krimeve të rënda nga ana e gjykatësve dhe e prokurorëve të Kosovës. Në veçanti prokurorët e Kosovës njoftojnë që janë në dijeni për këto masa, por që nuk i konsiderojnë ato të jenë efikase për sigurimin e mbrojtjes së duhur të dëshmitarëve për shkak të shoqërisë me lidhje të afërta në Kosovë, e cila në përgjithësi konsiderohet që është pengesa kryesore.

Raportohet se gjykatësit e Kosovës janë të njoftuar për masat themelore për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë gjykimeve të cilat zbatohen për dëshmitarët e rrezikuar edhe pse do të mund të shtohet njohuria e tyre për të gjitha masat në dispozicion (sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, KPPPK).

Për gjykatësit e Kosovës në nivelin e gjykatave të qarkut raportohet se kërkojnë mbajtjen e “seancave të mbyllura” si masë mbrojtëse në veprat penale ndaj të miturve, ato seksuale dhe të dhunës në familje. Në nivelin e gjykatave komunale (GJK), numri i rasteve në të cilat nevojiten masat për mbrojtjen e dëshmitarëve është më i vogël. Një GJK ka konsideruar që mungesa e infrastrukturës është njëra ndër dobësitë kryesore e cila e kufizon gatishmërinë e dëshmitarëve për të dëshmuar në gjykatë, duke ardhur deri te pika sa që të “mbulohet fytyra e dëshmitarit me batanije” si masë për mbrojtjen e dëshmitarit. Është raportuar që masat e tjera, si kërkesa për mbrojtje urgjente sipas nenit. 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12, nuk janë duke u zbatuar.

Konsiderohet që niveli i zbatimit të masave për mbrojtjen e dëshmitarëve në rastet e veprave të rënda është i ulët, me përjashtim të një rajoni të GJQ-së, ku gjykatësi i Kosovës i ka zbatuar masat për mbrojtjen e dëshmitarit gjatë gjykimit (kushti i anonimitetit) në tri raste të veprave të rënda (trafikim i narkotikëve, prostitucion dhe kontrabandë e emigrantëve).

Dy rajone të GJQ-ve raportojnë se prej vitit 1999 gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës nuk kanë zbatuar apo kërkuar fare masa për mbrojtjen e dëshmitarëve në rastet e veprave të rënda.

Një rast i pasqyron të metat e zbatimit të masave për mbrojtjen e dëshmitarit të gjykimit: Në një rast, të cilin e kryesonte një ekip i përbashkët i gjykatësve të Kosovës dhe të EULEX-it dhe ku pikat e akuzës ishin trafikimi drogës, prokurori i PSRK-së kërkoi që tre hetues sekretë të përfshirë në hetime të dëshmonin në gjyq. Prokurori i PSRK-së i kishte përmendur në akuzë emrat e plotë të hetuesve sekretë, duke e zbuluar kështu identitetin e tyre para të pandehurit. Gjatë gjykimit, hetuesit sekretë kërkuan që të mos dëshmojnë në gjyq duke e përmendur nevojën për mbrojtjen e identitetit të tyre. Vetëm atëherë prokurori i PSRK-së i kërkoi masat për mbrojtjen e dëshmitarëve për ta.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/11/2009

Objektivi: KGJK, KPK, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës.

Ta shtojnë zbatimin efikas të masave për mbrojtjen e dëshmitarëve në veprat të cilat i përfshijnë dëshmitarët e rrezikuar dhe veprat e rënda

PROKURORËT DHE AKTIVITETET PROKURORIALE

Të gjithë prokurorët e EULEX-it ua kanë paraqitur mandatin e misionit kolegëve të tyre në secilin rajon të GJQ, duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në Ligjin mbi juridiksionin e EULEX-it.

Bashkëpunimi me kolegët ka karakteristika të ndryshme në secilin rajon të GJQ. Duhet përmendur vërejtjen e prokurorëve të EULEX-it në një rajon të GJQ-së, ku nuk është vënë re asnjë “rezistencë e qëllimshme” ndaj këshillave por më tepër është vërejtur një “ngurrim për të ndryshuar” për shkak të kulturave të ngulitura juridike të cilat janë zhvilluar në gjyqësorin e Kosovës.

Arrestimi/ndalimi

Prokurorët EULEX-it në një rajon të GJQ kanë vlerësuar që prokurorët e Kosovës nuk tregojnë gatishmëri për të kërkuar masa alternative në mënyrë që ta sigurojnë praninë e të pandehurit në gjyq.

Raportohet që prokurorët e Kosovës kryesisht i kërkojnë masat e paraburgimit nga gjykatësit e Kosovës pa bërë ndonjë vlerësim nga afër të rrethanave ekzistuese (p.sh. seriozitetin e krimit, rrezikun nga arratisja, rrezikun e kryerjes së veprave të tjera ose kërcënimin e mundshëm të dëshmitarëve). Në shumicën e rasteve, prokurorët e Kosovës nuk e kanë zbatuar obligimin që ta kërkojnë masën më pak të bezdisshme për të pandehurin. Në atë fazë përgjegjësinë për zbatimin e masës më pak të bezdisshme e kanë vetëm gjykatësit e Kosovës.

Në një seminar të përbashkët ndërmjet prokurorëve të EULEX-it dhe atyre të Kosovës, është arritur pajtimi që paraburgimi të kërkohej vetëm në rastet e rënda pavarësisht nga rrethanat personale të pandehurit.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/12/2009

Objektivi: KPK

- 1) Ta rris gatishmërinë e prokurorëve të kërkojnë masa alternative për ta siguruar praninë e të pandehurit në gjyq.
- 2) T'i aprovonë në nivel të gjykatës së qarkut udhëzimet mbi paraburgimin para gjykimit.

Procedurat e ekzaminimit të dëshmime

Prokurorët e EULEX-it në një rajon të GJQ-së kanë vlerësuar se mungojnë rregullat e përgjithshme për procedurën e ekzaminimit të dëshmime, të cilat i zbatojnë prokurorët e Kosovës gjatë vlerësimit të dëshmime.

Raportohet që prokurorët e Kosovës kanë kërkuar që dëshmitarët të dalin para gjyqit përkundër faktit që dëshmitë e tyre ishte e qartë se nuk ishin të rëndësishme për procedurën gjyqësore. Prokurorët e Kosovës e kanë arsyetuar këtë qëndrim me obligimet kulturore ndaj familjeve të palëve të dëmtuara. Përfaqësuesve të familjes ju është dhënë e drejtë morale të marrin pjesë në procedurën gjyqësore duke e dhënë deklaratën e dëshmitarit para gjykatësit, edhe pse përfaqësuesi i familjes nuk ishte dëshmitar i krimit të pohuar dhe dëshmia ishte thashetheme.

Në një seminar të përbashkët ndërmjet prokurorëve të EULEX-it dhe të Kosovës u arrit pajtimi që të krijohet një model i procedurës për ekzaminimin e dëshmime dhe për zbatimin e tij.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/13/2009

Objektivi: Këshilli Prokurorial dhe prokurorët e Kosovës

Ta shtojnë zbatimin e procedurave për ekzaminimin e dëshmime para gjykimit duke i aprovuar dhe zbatuar procedurat për ekzaminimin e dëshmime para gjykimit.

Njësitë e specializuara /ekipet shumë-disiplinore

EULEX-i ka vlerësuar që prokuroritë e qarkut nuk kanë njësi të specializuara për ndjekjen penale të kategorive specifike të krimeve. Vetëm një rajon i GJQ-së e ka caktuar një prokuror për rastet e të miturve dhe të posedimit të armëve dhe si masë alternative njësitë e specializuara/ekipet shumë-disiplinore do të mund t'i ndiqnin penalisht lëndët e ndërlikuara.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/14/2009

Objektivi: KPK dhe prokurorët e Kosovës

Ta zhvillojnë konceptin e specializimit të prokurorëve të Kosovës dhe ta nxisin gatishmërinë për të mbledhur ekipe shumë-disiplinore

Strukturat e bashkëpunimit

EULEX-i ka vlerësuar që niveli i bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve të Kosovës dhe policisë së Kosovës nuk është institucionalizuar.

Raportohet që prokurorët dhe policia e Kosovës bashkëpunojnë mbi bazat e aty për atyshme. Aktualisht nuk ka ndonjë rajon që përfiton nga mënyra e institucionalizuar e bashkëpunimit përmes takimeve të rregullta ku do të mund të diskutoheshin rastet.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/15/2009

Objektivi: KPK, prokurorët dhe Policia e Kosovës

Ta shtojnë bashkëpunimin institucional ndërmjet prokurorëve dhe policëve të Kosovës

SIGURIA E GJYKATAVE

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it kanë vlerësuar që kushtet e përgjithshme në dispozicion për ofrimin e sigurisë për gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës janë të këqija. Vlerësimi ka të bëjë me masat që merren në gjykata dhe ato që ofrohen jashtë gjykatës, përfshirë mbrojtjen pas orarit të punës.

Parakusht themelor i një sistemi funksional gjyqësor është pavarësia e gjykatësve të Kosovës dhe autonomia e prokurorëve të Kosovës. Sipas parimit I d) të rekomandimit të Këshillit, gjykatësit duhet të jenë të pavarur gjatë marrjes së vendimeve dhe duhet të jenë në gjendje të reagojnë pa u ballafaquar me kufizime, ndikim të papërshtatshëm, shtytje, presione, kërcënime apo ndërhyrje, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nga ndonjë sektor apo për ndonjë arsye. Sipas parimit III 2. të

rekomandimit të Këshillit, duhet të merren të gjitha masat në mënyrë që të garantohet siguria e gjykatësve, përmes pranisë së rojeve të sigurisë në ambientet e gjykatës ose duke ofruar mbrojtje policore për gjykatësit të cilët mund të bëhen ose janë viktime të kërcënimeve serioze.

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it kanë vlerësuar se masat e përgjithshme në dispozicion për ofrimin e sigurisë për gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës janë të dobëta. Shqetësim i posaçëm është praktika që qytetarët mund t'ju afrohen gjykatësve dhe prokurorëve të Kosovës pa ndonjë mekanizëm të paralajmërimit. Në rastet e kërcënimeve kundër gjykatësve ose prokurorëve të Kosovës nuk mund të përdoren masat mbrojtëse të institucionalizuara. Në këtë aspekt duhet të shtohet bashkëpunimi me policinë e Kosovës dhe nevojitet të bëhet planifikimi i përbashkët për masat pasuese mbrojtëse të cilat do të zbatoheshin pas orarit të punës dhe jashtë gjykatave.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/16/2009

Objektivi: KGJK, Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të brendshme, Policia e Kosovës T'i shtojnë masat dhe mekanizmat për ta garantuar sigurinë e gjykatësve, të prokurorëve dhe të gjykatave.

SISTEMI INFORMATIV PËR MENAXHIMIN E LËNDËVE

EULEX-i ka vlerësuar që Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve, përkundër përmirësimeve të bëra së voni, nuk është i integruar në funksionimin e përditshëm të gjykatave dhe prokurorive të Kosovës. KGJK nuk ka qenë shumë aktive në marrjen e rolit udhëheqës për ta promovuar zbatimin e sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve (SIML) në rajonet e GJQ-ve.

Sipas parimit I d) të rekomandimit të Këshillit nr. R (94) 12, duhet të ofrohen kushte të duhura për punë, ashtu që gjykatësit të mund të punojnë në mënyrë efikase, sidomos, duke ju siguruar personel të përshtatshëm ndihmës, pajisje, automatizim të zyrave dhe pajisje për përpunimin e të dhënave për të siguruar që gjykatësit mund të veprojnë në mënyrë efikase dhe pa vonesë të tepruar.

Të gjitha rajonet e GJQ-ve raportojnë se nuk bëhet zbatimi i sistemit SIML, prandaj mungon edhe integrimi i sistemit në punën e përditshme të gjykatës. Nuk ka ndonjë mënyrë të kompjuterizuar për kërkimin e lëndëve dhe për përpilimin e statistikave përkatëse. Duket mjaft vështirë që të identifikohen, në mënyrë të besueshme, lëndët kur afrohet skadimi i ndonjë afati të caktuar.

SIML nuk ka mundur të bëhet funksional në rajonet e GJQ-ve qoftë për shkak të mospërshtatjes së sistemit kompjuterik (modelet e vjetra) me softuerin ose për shkak të përdorimit të sistemit SIML si regjistër të dyfishtë, njëfarë hapi i dytë pas regjistrimit me dorë.

Në të vërtetë, prej prillit 2009 Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) e ka përfunduar procesin e instalimit të 616 kompjuterëve të rinj në të gjitha gjykatat, përfshirë softuerin përkatës. Aftësimi është planifikuar të kryhet në fillim të verës 2009, nën ombrellën e ZNKE.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/17/2009

Objektivi: KGJK, gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës

Ta monitorojnë, mentorojnë dhe këshillojnë integrimin e SIML në punën e përditshme të gjykatave

SISTEMI I CAKTIMIT TË LËNDËVE

EULEX-i ka vlerësuar se ka dobësi serioze në zbatimin e një sistemi objektiv dhe transparent të caktimit të lëndëve nga ana e gjykatave dhe prokurorive të qarkut. Edhe pse zyrtarisht raportohet se ekziston sistemi i caktimit të lëndëve, niveli i zbatimit të tij është i dobët dhe përjashtimet që bëhen ka gjasa ta minojnë qëllimin e këtij sistemi. Për më tepër, nuk ka mekanizma të kontrollit që do t'i parandalonin manipulimet e mundshme të këtij sistemit.

Sistemi i caktimit të lëndëve duhet të ofrojë mekanizma për parandalimin e caktimit të detyrave sipas preferencës dhe në këtë mënyrë të sigurojë që të mos u caktohen lëndë atyre gjykatësve që zbatojnë praktika të këqija. Sistemi i caktimit të lëndëve i prekë dy shtyllat kryesore të organizimit të gjykatës: a) pavarësinë dhe paanësinë gjyqësore dhe b) efikasitetin e gjykatës. Procedura për caktimin e lëndëve ka për qëllim ta bëjë baraspeshimin e këtyre dy shtyllave kryesore. Sipas parimit I e) të rekomandimit të Këshillit nr. R (94) 12 në ndarjen e lëndëve nuk duhet të ndikojnë dëshirat e ndonjë palë ose të ndonjë personi që është i interesuar për rezultatin e lëndës. Për

shembull, ndarja e lëndëve mund të bëhet me anë të hedhjes së shortit ose përmes një sistemi për ndarje automatike sipas renditjes alfabetike ose të ndonjë sistemi të ngjashëm. Sipas parimit I f) të rekomandimit nr. R (94) 12 të Këshillit, lënda nuk duhet t'i merret ndonjë gjykatësi të caktuar pa pasur arsye të fortë, siç janë rastet e sëmundjes së rëndë ose konflikti i interesit. Çdo arsye dhe procedurë e tillë për marrjen e lëndës duhet të parashihet me ligj dhe në të nuk mund të ketë ndikim ndonjë interes i qeverisë ose i administratës. Vendimi për marrjen e një lënde nga gjykatësi duhet të merret nga autoriteti i cili e gëzon pavarësinë e njëjtë gjyqësore si edhe gjykatësit.

Në BE ka modele të ndryshme të caktimit të lëndëve. Kriteret për caktimin e lëndëve mund të jenë të ndryshme për nga natyra e tyre, por ato mbesin të bazuara në mekanizmat objektiv.

Sa ju përket GJQ-ve rasti më i mirë është kur, teorikisht, kryetari i GJQ-së e krijon një sistem për caktimin e lëndëve, por zbatimi i këtij sistemi zbulon se ka përjashtime në atë masë sa e rrezikojnë efikasitetin e tij. Rasti më i keq është kur nuk ka kurrfarë strategjie për caktimin e lëndëve. Lëndët ndahen pa kurrfarë sistemi dhe përveç kësaj, gjykatësit i ri-caktojnë lëndët ndërmjet tyre. Kjo mungesë e strategjisë për caktimin e lëndëve përkeqësohet nga fakti se kryetari i gjykatës dhe sekretaria shpesh herë nuk janë në dijeni për ri-caktimin e lëndës.

Sa ju përket prokurorive, vlerësimet tregojnë që të gjitha prokuroritë e qarkut e zbatojnë zyrtarisht sistemin e caktimit të lëndëve, edhe pse janë vënë re disa përjashtime. Një rajon i GJQ-së e zbaton modelin e prokurorit të specializuar për lëndët e të miturve dhe të posedimit të armëve; prandaj të gjitha lëndët që i takojnë këtij klasifikimi juridik i jepen këtij prokurori duke e prishur sistemin numerik. Një rajon tjetër i GJQ-së ka raportuar se, pas caktimit të lëndëve prokurorëve të Kosovës të bërë sipas kriterëve objektive, është e mundur dhe praktikohet ricaktimi i lëndëve dhe prokurorët e Kosovës mund ta kërkojnë një lëndë nga kryeprokurori. Një rajon tjetër i GJQ-së ka raportuar që kryeprokurori i zgjedh disa lëndë dhe i cakton ato vetë. "Dosjet e ndjeshme" ju caktohen një numri të kufizuar prej 2-3 prokurorëve, përfshirë kryeprokurorin.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/18/2009

Objektivi: KGJK, KPK, gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës

Ta nxisin zbatimin e një sistemi objektiv dhe transparent për caktimin e lëndëve, përfshirë mekanizmin që e parandalon manipulimin e mundshëm të caktimit të lëndëve.

LËNDËT E GRUMBULLUARA

EULEX-i ka vlerësuar që mungesa e infrastrukturës së duhur, siç është mungesa e personelit ndihmës, buxhetit dhe numri i kufizuar i sallave për gjykime, i kontribuon rritjes së numrit të lëndëve të grumbulluara në gjyqësorin e Kosovës. Kjo vërtetohet edhe nga statistikat e siguruar nga Departamenti i Statistikave i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilat janë dhënë në tabelën e mëposhtme. Sipas statistikave numri i lëndëve të grumbulluara në gjyqësorin e Kosovës është rritur për 13.90 % prej vitit 2007 deri në 2008 duke e paraqitur numrin e lëndëve të trashëguara nga vitit 2007 në lidhje me numrin e lëndëve të papërfunduara në fund të vitit 2008. Megjithatë, duhet theksuar që këto statistika ka gjasa të jenë më të larta pasi që në to nuk përfshihen informatat nga gjykatat që gjenden në komunat ku jetojnë kryesisht serbët e Kosovës.

		Numri i lëndëve i pranuar nga gjykatat gjatë vitit 2008	Prej tyre		Numri i lëndëve të përfunduara më 2008	Numri lëndëve të pakryera në fund të vitit
			Lëndët e trashëguara nga viti 2007	Të pranuar më 2008		
1	Gjykata Supreme	6595	2889	3706	4196	2399
2	Gjykata Ekonomike	2072	588	1484	743	1329
3	Gjykatat e Qarkut	20356	8993	11363	10003	10353
4	Gjykatat Komunale	460433	150595	309838	278546	181887
<u>Të gjitha gjykatat e rregullta</u>		489456	163065	326391	293488	195968
1	Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	1876	0	1876	1876	0
2	Gjykatat Komunale për Kundërvajtje	254700	70839	183861	184240	70460
<u>Gjykatat për Kundërvajtje</u>		256576	70839	185737	186116	70460

<u>Gjykatat e rregullta & Gjykatat për Kundërvajtje</u>	746032	233904	512128	479604	266428

Zyra statistikore e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka llogaritur që në fund të vitit 2008 numri i lëndëve të grumbulluara në gjyqësorin e Kosovës arrinte në 280.638 lëndë. Prej vitit 2001 deri më 2008 është raportuar për rritje të numrit të lëndëve të grumbulluara për secilin lloj të gjykatave. Shifrat në nivel të gjykatës së qarkut tregojnë një rritje të lëndëve të papërfunduara prej 2964 në 10353 nga viti 2001 deri më 2008.

Vitet kur janë pranuar lëndët nga viti ne vit	Lëndët e papërfunduara sipas gjykatave						Të gjitha gjykatat
	Gjykata Supreme	Gjykata Ekonomike	Gjykata e Qarkut	Gjykata Komunale	Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	Gjykata Komunale për Kundërvajtje	
1 2001	295	56	2946	33538	0	14666	51501
2 2002	747	94	5905	61713	0	24390	92849
<u>Viti 2002 krahasuar me atë 2001 (%)</u>	<u>153.22</u>	<u>67.86</u>	<u>100.44</u>	<u>84.01</u>	<u>0</u>	<u>66.30</u>	<u>80.29</u>
3 2003	777	132	9042	81357	0	34505	125813
<u>Viti 2003 krahasuar me vitin 2002 (%)</u>	<u>4.02</u>	<u>40.43</u>	<u>53.12</u>	<u>31.83</u>	<u>0</u>	<u>41.47</u>	<u>35.50</u>
4 2004	741	152	10517	115350	0	45243	172003

<u>Viti 2004</u>								
<u>krahasuar me vitin 2003 (%)</u>	<u>-4.63</u>	<u>15.15</u>	<u>16.31</u>	<u>41.78</u>	<u>0</u>	<u>31.12</u>	<u>36.71</u>	

5	2005	2048	134	11802	129357	0	55384	198725
---	------	------	-----	-------	--------	---	-------	--------

<u>Viti 2005</u>								
<u>krahasuar me vitin 2004 (%)</u>	<u>176.38</u>	<u>-11.84</u>	<u>12.22</u>	<u>12.14</u>	<u>0</u>	<u>22.41</u>	<u>15.54</u>	

6	2006	2907	653	12342	135245	0	64058	215205
---	------	------	-----	-------	--------	---	-------	--------

<u>Viti 2006</u>								
<u>krahasuar me vitin 2005 (%)</u>	<u>41.94</u>	<u>387.31</u>	<u>4.58</u>	<u>4.55</u>	<u>0</u>	<u>15.66</u>	<u>8.29</u>	

7	2007	2889	588	8993	162485	0	70839	245794
---	------	------	-----	------	--------	---	-------	--------

<u>Viti 2007</u>								
<u>krahasuar me vitin 2006 (%)</u>	<u>-0.62</u>	<u>-9.95</u>	<u>-2.28</u>	<u>13.92</u>	<u>0</u>	<u>10.59</u>	<u>11.73</u>	

2008		2399	1329	10353	181887	0	70460	266428
------	--	------	------	-------	--------	---	-------	--------

<u>Viti 2008</u>								
<u>krahasuar me vitin 2007 (%)</u>	<u>-16.96</u>	<u>126.02</u>	<u>15.12</u>	<u>18.06</u>		<u>-0.54</u>	<u>10.81</u>	

Tabela e mëposhtme tregon që numri i lëndëve të grumbulluara mund të zbërthehet më tej në llojet e ndryshme të gjykatave dhe që gjatë vitit 2008 Gjykata Supreme ka zgjidhur më shumë lëndë se sa që i ka pranuar në vit dhe kështu i ka kontribuar zvogëlimit të numrit të lëndëve të

grumbulluara. Është e qartë që numri i lëndëve të grumbulluara është rritur në gjykatat ekonomike, të qarkut dhe ato komunale.

		Numri i lëndëve në gjykatë të pranuar gjatë vitit 2008	Numri i lëndëve të përfunduara gjatë vitit 2008	Efikasiteti i gjykatës në zgjidhjen e lëndëve të pranuar gjatë vitit 2008 (%)
1	Gjykata Supreme	3706	4196	113,22
2	Gjykata Ekonomike	1484	743	50,07
3	Gjykatat e Qarkut	11363	10003	88,03
4	Gjykatat Komunale	309838	278546	89.90
<u>Krejt gjykatat e rregullta .</u>		326391	293488	89.91
1	Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	1876	1876	100,00
2	Gjykatat Komunale për Kundërvajtje	183861	184240	100,21
Krejt Gjykatat për Kundërvajtje		185737	186116	100.20
<u>Gjykatat e rregullta & Gjykatat për Kundërvajtje</u>		533339	479604	89.92

Në nivel të Gjykatës Supreme, numri i lëndëve të pranuar nga viti 2001 në 2008 është rritur për 136,60 %, dhe në nivel të gjykatave ekonomike është rritur për 368,14 %. Në gjykatat e qarkut ka pasur një rritje prej 33,63 %, në gjykatat komunale 179,61 % dhe në gjykatat për kundërvajtje 82,12%.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet numri i lëndëve në pritje të ekzekutimit: në nëntor 2008 zyra statistikore e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i kishte regjistruar gjithsej 7599 lëndë që ishin në pritje të ekzekutimit prej të cilave 1552 (20,42%) lëndë ishin në pritje të ekzekutimit të dënimit dhe 6047 (79,58%) lëndë ishin në pritje të ekzekutimit të gjobitjes.

Rritja e numrit të lëndëve të grumbulluara është përkeqësuar nga numri në rënie i gjykatësve të Kosovës në gjyqësor. Sipas shifrave aktuale të punësimit ekziston një rënie prej 9.43%.

MEKANIZMI I ANKESËS PËR QYTETARËT

Gjykatësit e EULEX-it kanë vlerësuar se shprehia e qytetarëve për t'i diskutuar lëndët që janë në shqyrtim me kryetarin e gjykatës ose me gjykatësit e Kosovës është qartazi në kundërshtim me procedurat e pavarura dhe të paanshme.

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it të vendosur në rajonet e GJQ-ve kanë marrë ankesa nga popullsia vendore që nga fillimi i punës. Kryetari i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it dhe kryetari i Asamblesë së prokurorëve të EULEX-it, duke bërë përpjekje që të jenë më efikas në pranimin dhe shqyrtimin e ankesave, i kanë nxjerrë Procedurat Standarde të Operimit (PSO-të) për administrimin e ankesave, të kërkesave ose të propozimeve që ju janë dorëzuar ekipeve të gjykatave të qarkut. Po të kishin qenë efikase strukturat llogaridhënëse të gjyqësorit të Kosovës, nuk do të kishte pasur nevojë që qytetarët t'ju drejtonin ankesa gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it. Në këtë aspekt, vlen të përmendet që, as Njësia e Inspektoratit Gjyqësor e as Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk kanë përfaqësues në terren për ta siguruar pranimin e ankesave kundër gjyqësorit nëpër rajone. Në vend të kësaj ankesat duhet të dorëzohen në institucionet përkatëse në Prishtinë.

Në lidhje me këtë, gjykatësit e EULEX-it në një rajon të GJQ-së e kanë mbështetur Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ta formuar një zyrë për informata gjyqësore ku qytetarët mund t'i drejtojnë kërkesat pa i diskutuar rastet që janë duke u shqyrtuar drejtpërdrejt me gjykatësit e Kosovës. Në bazë të kësaj nisme, dy përfaqësues të KGJK-së është dashur të caktohen në rajonin që ishte mostër për zbatim. Një ndihmës administrativ duhet të ofrojë ndihmë në parashtrimin e ankesës dhe e bën vlerësimin e parë të çështjes së pohuar shqetësuese. Një këshilltar juridik duhet ta bëjë vlerësimin juridik të ankesës.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/19/2009

Objektivi: KGJK dhe gjykatësit e Kosovës

T'i zhvillojnë mekanizmat e duhur në mënyrë që popullata vendore të ankohet për gjyqësorin e Kosovës duke ju dhënë fund këshillimeve të drejtpërdrejta të parashtruesve të ankesave me gjykatësit e Kosovës dhe duke e futur në përdorim planin e zyrës kontaktuese për informata në gjykatë.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVË (SHKK)

Njësia Korrektuese e EULEX-it (NJK) ka njoftuar se ka nivel të mirë të bashkëpunimit me kolegët vendor, megjithatë kjo nuk është dëshmuar me qasje të papenguar në informata.

NJK e EULEX-it nuk ka mundur të vendoset në vendin e njëjtë me drejtorinë e SHKK-së. Ftesat që NJK e EULEX-it të merrte pjesë në takimet me SHKK-në shpesh bëheshin në momentet e fundit. Aktivitetet mentoruese të NJK të EULEX-it shpesh janë ballafaquar me mungesë të informatave kthyes nga SHKK-ja.

Në këtë kontekst, duhet përmendur që njësia për siguri e NJK të EULEX-it e ka nxjerrë një vlerësim të plotë të sigurisë në burgun e Dubravës, me propozime konkrete për veprimet pasuese. Vlerësimi i është dorëzuar komisarit të SHKK-së në mars 2009 me kërkesën për diskutime dhe takime pasuese në mënyrë që të arrihet pajtimi për strategjinë për tejkalimin e dobësive të vlerësuara. Ende nuk ka përgjigje nga komisari.

NJK e EULEX-it po ashtu e ka këshilluar komisarin që të vendosë numër më të madh të personelit të njësisë korrektuese të EULEX-it në departamentin e sigurisë në burgun e Dubravës. Kjo këshillë është refuzuar nga komisari përkundër rasteve të shumta të shkeljes së sigurisë në burgun e Dubravës në të kaluarën.

Si rezultat i përpjekjeve të zbulimit, një raport i besueshëm i ka nxjerrë në pah disa rrugë të hyrjes së mallrave kontrabandë në burg dhe të dhënat për pjesëtarët e personelit të cilët dyshohen se merren me kontrabandë apo i furnizojnë të burgosurit me këto mallra. Raporti është dorëzuar përmes zinxhirit komandues të SHKK-së në mars 2009 por deri më sot njësia korrektuese e EULEX-it nuk ka marrë komente.

Shqyrtimi i ligjeve dhe i Procedurave Standarde të Operimit (PSO-të)

NJK e EULEX-it merr pjesë në grupin punues për Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve dhe ka vlerësuar që ndryshimet të cilat aktualisht janë propozuar dhe diskutuar nuk janë në pajtueshmëri me standardet evropiane. Shqyrtimi i PSO-ve nuk është bërë ka një kohë tani. Sipas informatave të siguruar nga kolegët në SHKK, duket se nuk është e qartë kush i ka kompetencat kryesore për marrjen e vendimeve (SHKK-ja, Ministria e drejtësisë, Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi i Kuvendit të Kosovës).

Duhet të miratohen PSO-të e reja mbi: a) Kategorizimin; b) Menaxhimin e të burgosurve të kategorizuar; c) Komandën gjatë incidenteve të rënda; d) Pushimin nga burgu; e) Lirimin e parakohshëm; f) Procedurat për lirim me kusht; g) Vizitat dhe komunikimin tjetër jashtë burgut; h) Përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/20/2009

Objektivi: Shërbimi Korrektues i Kosovës

T'i rishikojë dhe përditësojë politikat ekzistuese dhe PSO-të në fushën e SHKK-së

Përcjellja e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme

EULEX-i i ka vlerësuar disa dobësi operative në sferën e përcjelljes së të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe të atyre me rrezikshmëri të mesme, siç janë ato në fushën e vlerësimit efikas të kërcënimit para se të bëhet përcjellja për shkak të mungesës së sistemit të duhur të klasifikimit të burgosurve, pastaj në sferën e aftësisë dhe të infrastrukturës e cila është në dispozicion.

Të burgosurit kanë nevojë për vlerësim efikas të kërcënimit para se të bëhet përcjellja, në mënyrë që të zhvillohen dhe zbatohen strategjitë e nevojshme të sigurisë gjatë përcjelljes. Është me rëndësi jetike që para se të bëhet përcjellja të sigurohet vlerësimi i përshtatshëm i sigurisë së secilit të burgosur të rrezikshmërisë së lartë. Ky standard kontribuon në garantimin e sigurisë për grupin që e bën përcjelljen dhe për qytetarët gjatë përcjelljes duke e parandaluar arratisjen, por po

ashtu e mbron pajtueshmërinë me standardet për të drejtat e njeriut gjatë përcjelljes. Në parim vlerësimi i kërcënimit i kryer nga grupi për përcjelljen e të burgosurit duhet të bazohet në klasifikimin e të burgosurit që duhet të vlerësohet nga Komisioni për mbikëqyrjen e të burgosurve (i ri-themeluar para do kohe në bazë të këshillës së EULEX-it).

Klasifikimet e të burgosurve të kryera nga Komisioni për mbikëqyrjen e të burgosurve janë ende të kufizuara dhe si rrjedhojë kanë ndikim negativ në vlerësimin/planifikimin e grupit për përcjelljen e të burgosurve.

PSO-të në fuqi parashikojnë që të burgosurit e rrezikshmërisë së mesme duhet t'i kenë duart dhe këmbët e lidhura me pranga. Kjo praktikë është në kundërshtim me standardet të cilat parashikojnë që të burgosurit duhet t'i kenë këmbët e lidhura me pranga vetëm nëse ka arsye të bazuar për të besuar që ekziston rreziku i madh nga arratisja ose niveli i lartë i sjelljes agresive. EULEX-i është duke e monitoruar nga afër që të burgosurit me rrezikshmëri të mesme të mos i kenë këmbët e lidhura më gjatë transportimit individual. Për shkak të mungesës së automjeteve shpesh dy të burgosur me rrezikshmëri të lartë duhet të përcillen në veturën e njëjtë. Njoftohet që njësia për përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë është e pajisur vetëm me pajisjet themelore të sigurisë dhe nuk është në gjendje të garantojë siguri të përshtatshme gjatë përcjelljeve me rrezikshmëri të lartë. Mungojnë pajisjet themelore siç janë armët e gjata, automjetet e blinduara, mjetet për mbrojtjen e trupit dhe sistemi për komunikim në radio (përfshirë aftësimin përkatës).

Vlerësohet që ekziston bashkëpunimi ndërmjet njësive për përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe të gjykatave, edhe pse ende nevojitet të ketë politika për kryerjen e vlerësimeve të duhura të sigurisë në gjykata.

Njësia për përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të mesme ballafaqohet me boshllëqet e njëjta të cilat janë identifikuar në njësinë me rrezikshmëri të lartë: nevoja për aftësim lidhur me shkathhtësitë ndër-personale, teknikat e komunikimit dhe të radios, taktikat e konvojit, vozitja e sigurt, aftësimi për përdorimin e armëve të brezit dhe të armëve të gjata.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/21/2009

Objektivi: Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës

(1) Të bien dakord për një memorandum të mirëkuptimit me EULEX-in për të formuar ekipe të përbashkëta për përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme, (2) Ta rrisin përbushjen e komisionit për mbikëqyrjen e të burgosurve duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në procedurat e klasifikimit të burgosurve, (3) Ta përmirësojnë planifikimin e operacioneve dhe bashkëpunimin me PK-në (Rrezikshmëria e Lartë), (4) Ta përmirësojnë cilësinë dhe nivelin e aftësisë profesionale, (5) T'i rishikojnë dhe zbatojnë procedurat e përmirësuara standarde të operimit.

Blloku (Pavijoni) nr. 1 në Dubravë

EULEX-i ka vlerësuar që menaxhimi ditor i Bllokut nr. 1 në Dubravë ka mungesa të shumta në fushën e standardeve të sigurisë, të marrëdhënieve ndërmjet të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe personelit të burgut dhe në sferën e aftësisë të duhur dhe të infrastrukturës në dispozicion.

Dobësitë gjatë zbatimit të rregullave të sigurisë kanë të bëjnë me kontrollimin e pamjaftueshëm, mos-kontrollimin e lëvizjeve të dëshmitarëve brenda dhe jashtë Bllokut nr. 1, mungesën e kontrollimit të përshtatshëm gjatë vizitave për të burgosurit, mundësinë e pakufizuar të shfrytëzimit të telefonit.

Një faktor i veçantë është raporti ndërmjet të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe personelit të lartë në burgun e Dubravës. Nëse e kërkojnë këtë, të burgosurit mund të takohen drejtpërdrejt me personelin e lartë dhe ta diskutojnë gjendjen e tyre në burg.

Përveç standardeve të sigurisë njoftohet që edhe vetë procedura e klasifikimit të burgosurve është shqetësuese. Njoftohet që vetëm gjysma e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë janë të burgosur në Bllokun nr. 1 të rrezikshmërisë së lartë. Së fundi, të gjithë të burgosurit e Bllokut nr. 1 janë ri-klasifikuar nga "Kat. A" (rrezikshmëri e lartë) në "Kat. E" (rrezikshmëri e mesme), e cila ju jep më shumë liri të burgosurve. Sipas NJK të EULEX-it disa prej të burgosurve të "Kat. A" nuk është dashur të ri-klasifikohen. Njoftohet që drejtoria e SHKK-së, përmes komisarit ose zëvendës-komisarit, ndërhyr drejtpërdrejt në klasifikimin e të burgosurve me rrezikshmëri më të lartë dhe të asaj të lartë në burgun e Dubravës. Ky intervenim i drejtpërdrejtë është në kundërshtim me rregullat ekzistuese për klasifikimin e të burgosurve meqë për ta bërë klasifikimin e të burgosurve komisarit duhet të këshillohet me komisionin për mbikëqyrjen e të burgosurve.

NJK e EULEX-it e ka hartuar një vlerësim gjithëpërfshirës të “strategjisë për mënyrën e menaxhimit të burgosurve me rrezikshmëri të lartë”. Raporti nxjerr përfundimin që vetëm masat e sigurisë nuk ka gjasa t’i zgjidhin sfidat që përsëriten lidhur me menaxhimin e këtij sektori të burgosurve. Raporti rekomandon që ka nevojë të përdoret një qasje më e plotë që i shqyrton të gjitha aspektet e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë, në të cilën do të përfshihej po ashtu edhe administrimi, regjimet, politika e burgut, etj. Me këtë dokument synohet që të ofrohet një model në përpjekje për ta paraqitur një strategji e cila merret me sferën e ndjeshme të funksionimit. Për të qenë i suksesshëm zbatimi i strategjisë nevojitet mbështetja e plotë e MD-së dhe e SHKK-së.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/22/2009

Objektivi: Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë

(1) T’i korrigjojnë dhe zbatojnë PSO-të në fushën e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë (2) ta rrisin bashkëpunimi profesional të personelit të Bllokut nr. 1 në Dubravë në raport me të burgosurit me rrezikshmëri të lartë, (3) ta shtojnë zbatimin e procedurave lidhur me klasifikimin e të burgosurve duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në të burgosurit me rrezikshmëri të lartë, dhe (4) t’i zbatojnë dhe përmirësojnë standardet ekzistuese të sigurisë në Bllokun nr. 1.

Njësia e sigurisë

Shërbimi Korrektues i Kosovës e ka përfunduar planin e tij për reagim të shpejtë për t’u marrë me incidentet e rrezikshme në burgun e Dubravës. NJK e EULEX-it e sheh nevojën për kryerjen e një ushtrimi të përbashkët me të gjitha agjencitë e përfshira për t’i vlerësuar në mënyrë efektive kapacitetet e SHKK-së në rast të ndonjë incidenti të rrezikshëm. Për ta planifikuar ushtrimin e përbashkët nevojitet një plan i Policisë të Kosovës lidhur me mënyrën e mbështetjes së burgut të Dubravës nga ana e policisë në raste urgjente. Meqë KFOR-i nuk është në mënyrë automatike përgjegjës më për situatat urgjente në burgun e Dubravës, NJK e EULEX-it e ka këshilluar PK-në t’i marrë përsipër një numër të konsiderueshëm të detyrave në mënyrë që ta zëvendësojnë KFOR-in si duhet.

NJK e EULEX-it njofton për nevojën e aftësimin të personelit të lartë të SHKK-së në fushën e komandimit të incidenteve të rënda pasi që shumë nga personeli i dikurshëm i lartë të cilët kanë vijuar një aftësim të tillë gjatë kohës së UNMIK –ut janë hequr nga pozita ose janë ulur në pozitë (vetëm 1 nga drejtorët e mëparshëm është ende në atë pozitë).

NJK e EULEX-it po ashtu e sheh nevojën për përditësimin e procedurave në fushën e komandimit të incidenteve të rënda. Dobësitë e tjera kanë të bëjnë me procedurat e kontrollimit (kontrabanda) dhe mbledhjen e duhur të dhënave që kanë të bëjnë me sigurinë.

Të dhënat për mallrat e paligjshme që hyjnë në burgun e Dubravës e nënvizojnë nevojën për trajtimin e kësaj çështjeje: gjetjet tregojnë që gjërat janë futur kontrabandë rregullisht në burgun e Dubravës (siç janë telefonat celularë dhe droga).

Tabela e mëposhtme e tregon numrin e kontrollimeve të cilat kanë pasur rezultate pozitive për secilin muaj të vitit 2007 dhe 2008.

Paraqitja e kontrollimeve të cilat kanë pasur rezultate pozitive në Dubravë 01/01/2007 – 31/12/2008

Parakusht kryesor për parandalimin e incidenteve të sigurisë në burgun e Dubravës është funksionimi i sistemit të raportimit të informatave për sigurinë, i cili nuk është i integruar në mënyrë të mjaftueshme në punën e përditshme të njësisë për siguri të SHKK-së.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/23/2009

Objektivi: Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë

(1) Ta planifikojnë dhe kryejnë një ushtrim të shumë agjencive në burgun e Dubravës dhe në atë të Lipjanit në mënyrë që ta vlerësojnë kapacitetin e SHKK-së për t'u marrë me një incident të rrezikshëm të rremë, (2) t'i zhvillojnë PSO-të në fushën e kontrollimit të kontrabandës dhe ta bëjnë zbatimin e tyre, duke u përqendruar në mbajtjen e duhur të statistikave të besueshme, (3) ta përmirësojnë raportin profesional të personelit të SHKK-së ndaj të burgosurve të rrezikshmërisë së lartë dhe (4) ta zhvillojnë fushën e sigurisë dinamike.

Menaxhimi financiar i Shërbimit Korrektues të Kosovës

NJK e EULEX-it ka vlerësuar që buxhetet për administrimin e burgjeve janë shumë të centralizuara kështu që administratat përkatëse nuk mundën t'i menaxhojnë në mënyrë autonome buxhetet të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në funksionim.

Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2009 i janë ndarë 12.274.186 Euro. 35,2 % e buxhetit ishte caktuar për rroga dhe pagesa, 39,9% për mallra dhe shërbime, 5,3 % për shërbime komunale dhe 19,6 % për shpenzime kapitale. Buxheti i SHKK-së është rritur gradualisht gjatë 3 vjetëve të kaluara nga 11.7 milion euro më 2007 në 12 milion euro më 2008. Për vitin 2010 SHKK-ja ka kërkuar një buxhet prej përafërsisht 15 milion eurove.

Para vitit 2009, drejtoria e SHKK-së e planifikonte buxhetin fillestar pa u këshilluar me administratat përkatëse të burgjeve dhe si pasojë nevojat e administratave individuale të burgjeve nuk merreshin parasysh. Edhe pse në një takim drejtoria e SHKK-së pohoi që drejtorët e burgut ishin këshilluar për hartimin e buxhetit të vitit 2009, kjo informatë nuk u vërtetua nga informatat e siguruara nga menaxhmenti i burgut të Dubravës.

Përveç kësaj, nuk i është dhënë rasti secilit burg që ta bëjë administrimin e buxhetit të tij në mënyrë autonome. Kjo do të thotë që vendimet buxhetore dhe të prokurimit merren në nivelin qendror në Ministrinë e Drejtësisë dhe kjo shkakton mungesë të fleksibilitetit që administrata e burgut të blejë gjëra të cilat janë të domosdoshme për drejtimin e përditshëm të burgut. Kështu që vonesat të cilat shkaktohen nga prokurimi i centralizuar kanë për pasojë mungesën e pajisjeve elementare në burgje.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/24/2009

Objektivi: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës

(1) Ta rrisin përfshirjen e administratës së burgut në planifikimin buxhetor dhe (2) ta transferojnë buxhetimin për burgjet individuale nga Ministria e drejtësisë

Kapacitetet/përfaqësimi i personelit në kuadër të SHKK-së

Shërbimi Korrektues i Kosovës i ka 1534 pjesëtarë të personelit, 306 prej të cilëve janë civilë dhe 1228 janë personel korrektues. Raportohet se aktualisht SHKK-ja nuk funksionon me kapacitet të plotë për shkak të dorëheqjes së 89 pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës. 6 pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë janë rikthyer në pozitat e mëparshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës (4 i përkasin komunitetit jo-shumicë serb të Kosovës dhe 2 i përkasin komunitetit jo-shumicë rom të Kosovës). Njoftohet që 6 përfaqësues të tjerë të komunitetit jo-shumicë serb të Kosovës janë në proces të rikthimit në shërbim.

Përqindja e femrave në kuadër të personelit korrektues aktualisht është 16.38%. Nuk ka statistika brenda SHKK-së të cilat e tregojnë ekuilibrin gjinor në të gjitha nivelet e SHKK-së. Megjithatë, sipas vrojtimit të njësisë korrektuese të EULEX-it, në pozitat e larta nuk ka femra me përjashtim të një rasti të zëvendës drejtorit të administratës së një burgu.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/25/2009

Objektivi: Ministria e drejtësisë

Ta rris ri-integrimin e komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe përfaqësimin e femrave në të gjitha nivelet në SHKK.

MINISTRIA E DREJTËSISË (MD)

Këshilltarët e EULEX-it kanë krijuar bashkëpunim të mirë me strukturat e MD-së. Bashkëpunimi nuk dëshmohet domosdoshmërisht me qasjen e papenguar në informata. Edhe pse këshilltarët e EULEX-it në përgjithësi janë në gjendje të kenë qasje në dokumente relevante, ndodhin vonesa në sigurimin e dokumenteve dhe për këtë arsye duhet të kërkohen me këmbëngulësi. Informatat e dhëna nganjëherë nuk ishin të përshtatshme për ta njoftuar EULEX-in lidhur me zhvillimet aktuale, p.sh. ndryshimet në projektligje janë bërë pas përfundimit të aktiviteteve të grupit punues (siç ka ndodhur me Ligjin kundër korrupsionit). Këshilltarët e EULEX-it po ashtu, raportojnë që vendimet e marra gjatë takimeve ndërmjet EULEX-it dhe kolegëve nuk janë zbatuar si duhet, për këtë arsye ishte e nevojshme që temat e njëjta të diskutoheshin sërish.

Këshilltarët e EULEX-it e kanë vlerësuar nevojën për aftësim të vazhdueshëm të personelit të Departamentit për çështje juridike në fushën e hartimit të ligjeve, të vlerësimit të projektligjeve, formulimit të politikës juridike, analizave të ndikimit të rregullatorit dhe të “acquis communautaire”. Më tej, ekziston nevoja për zhvillimin e shkathësive në fushën e menaxhimit të bibliotekës juridike dhe të njohurive juridike përmes internetit. EULEX-i po ashtu, i ka përkufizuar idetë lidhur me mënyrën e aftësimit dhe të zhvillimit profesional të kolegëve në Departamentin ligjor, siç është p.sh. pilot projekti për formulimin e politikës ligjore ose krijimi i një doracakut për stilin e hartimit në lidhje me kolegët e MD-së. Këshilltarët e EULEX-it dhe të MD-së e kanë identifikuar nevojën për aftësim jo vetëm të zyrtarëve të rinj ligjor por edhe të atyre të lartë.

Përpjekjet e konsolidimit duket që po vuajnë nga lëvizja e vazhdueshme e personelit brenda MD-së.

EULEX-i e ka vlerësuar aftësinë dhe gatishmërinë e MD-së për të zhvilluar politika për garantimin e qasjes së drejtë dhe efikase të gjitha komuniteteve në sistemin e drejtësisë.

Raportohet që ministrja duhet t'i nxis politikat më proaktive në mënyrë që ta përkrahë përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë.

EULEX-i ka vlerësuar që në disa rrethana, zyrtarët ligjorë të cilët merreshin me procesin e hartimit të një ligji nuk ishin të angazhuar vetëm në pjesën teknike të hartimit, por përveç asaj duhej të njoftoheshin me çështjet praktike që duhej rregulluar. Duke e pasur parasysh gamën e madhe të çështjeve që aktualisht duhet t'i mbulojë MD-ja sfida është e qartë.

Para së gjithash MD-ja ballafaqohet me problemin e rritjes së kapacitetit dhe të shkathtësive të zyrtarëve ligjorë për shkak të lëvizjes së madhe të personelit. Mungesa e motivimit për të mbetur në MD i nxitë zyrtarët ligjorë t'i lëshojnë pozitat e tyre për mundësi profesionale që paguhen më mirë. Pjesa dërrmuese e zyrtarëve ligjorë janë mjaft të rinj dhe kjo punë është e para për ta.

Disa sekretarë të përhershëm e kanë trashëguar njëri tjetrin gjatë vitit të kaluar dhe kjo ka pasur ndikim të konsiderueshëm në lidhjen ndërmjet strukturave ministrore dhe administrative të MD-së. Mungesa e sekretarit të përhershëm ka ndikim në funksionalitetin e burokracisë ministrore.

Ministrja e drejtësisë i ka marrë përgjegjësitë në fushën e Ndhmës Juridike Ndërkombëtare (NJNI) në mars 2009 dhe e ka nënshkruar vendimin për marrjen e përgjegjësisë në fushën e gjyqësisë të NJN për ato vende të cilat e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës. Kjo është pasuar nga një Udhëzim Administrativ për gjykatat e Kosovës, duke i përvijuar procedurat për kërkesat dhe përgjigjet ndaj ndihmës ndërkombëtare juridike.

REKOMANDIMI I EULEX-it– KD/26/2009

Objektivi: Ministria e Drejtësisë

- 1) Ta sigurojë ndarjen e duhur të punës ndërmjet ministrit dhe sekretarit të përhershëm
- 2) Ta monitorojë rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve ligjorë për hartimin e ligjeve

Departamenti për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (DPZHML)

Këshilltarët e DPZHML të EULEX-it raportojnë që aktualisht DPZHML nuk ka ndonjë politikë për zhvillimin e personelit dhe krijimin e politikave të mbajtjes së tyre në kuadër të shërbimit të DPZHML-së. Raportohet për lëvizje të mëdha të personelit.

REKOMANDIMI I EULEX-it – KD/27/2009

Objektivi: Ministria e Drejtësisë

1) Ta hartojë një plan strategjik për DPZHML duke e përvijuar vizionin dhe misionin; 2) të krijojë politika të cilat e trajtojnë çështjen e numrit të lartë të lëvizjeve të personelit në DPZHML; 3) ta përmirësojnë nivelin e kushteve të punës për personelin e DPZHML-së duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në buxhetin në dispozicion dhe në aftësitë udhëheqëse të personelit të lartë.

Dogana

LLOGARIDHËNIA

Legjislacioni, politikat dhe procedurat e punës

Ligji për Kodin Doganor dhe të Akcizave në Kosovë (Kodi Nr. 03/L-109) ka hyrë në fuqi më 10 nëntor 2008. Siç thuhet në këtë ligj, neni 1, legjislacioni për doganën do të përbëhet nga ky Kod dhe nga një Udhëzim Administrativ i nxjerrë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e tij. Ai përcakton se do ta bëjë shfuqizimin e çdo dispozite ligjore që nuk është në përputhje me Kodin e ri dhe se, si një dispozitë kalimtare, EULEX-i do t'i ketë ato përgjegjësi në fushën e doganave, të cilat janë paraparë në instrumentet përkatës ligjore që e definojnë mandatin e tij. Përderisa Kodi Doganor dhe i Akcizave ka hyrë në fuqi më 11 nëntor 2008, Udhëzimi Administrativ është ende duke u hartuar. Ky Udhëzim pritet t'i shfuqizojë të gjitha udhëzimet administrative të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm lidhur me procedurat doganore, përcaktimin e vlerës, prejardhjes dhe borxhit doganor, etj. Nuk duket se ekziston ndonjë afat kohor i caktuar për rishikimin progresiv të gjitha rregullave doganore, rregulloreve dhe udhëzimeve apo udhëzuesve në lidhje me legjislacionin e ri doganor (dhe në pajtim me standardet e BE-së). Për momentin, Dogana e Kosovës është duke i zbatuar disa Rregullore dhe Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut, si dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, të cilat e ngushtojnë zbrazëtirën ligjore. Rishikimi dhe procesi i ndryshimit mund të përshpejtohet kur të nis projekti i ri i financuar nga KE për asistencë teknike (që pritet më vonë gjatë këtij vit).

Organizimi dhe struktura e tanishme e Doganës së Kosovës është paraqitur në dokumentin: Skema organizative 2009. Nën Drejtorin e Përgjithshëm veprojnë katër drejtori:

- Drejtoria për Operimin e të Hyrave është e organizuar në tre departamente (një Qendror dhe dy rajone Kufitare); përfshin në vete të gjitha pikat doganore kufitare dhe në brendi të vendit;
- Drejtoria për Zbatimin e Ligjit përbëhet nga tre departamente, atë për (Përmbushje; Kundër – Kontrabandës dhe Hetuesi e Inteligjencë); ekipet fleksibile kundër-kontrabandës janë pjesë e kësaj drejtorie;
- Drejtoria për Financa dhe Sisteme ofron pjesën dërrmuese të shërbimeve për mbështetje dhe ndahet në katër departamente: Burimet Njerëzore, Financat & Logjistika, Prokurimi dhe Teknologjia Informativë;
- Drejtoria Ligjore është më e vogla dhe përbëhet nga një departament prej 4 njësive dhe është përgjegjës për shërbimet këshillëdhënëse, procedurat për rishikimin e vendimeve dhe përfaqësimin në gjykatë.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave dhe përgjegjësi të secilës Drejtori (dhe “sektorëve” përbrenda) mund të gjendet vetëm në gjuhën shqipe. Struktura organizative nuk ka ndryshuar nga struktura e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut; deri në miratimin e Udhëzimit Administrativ dhe duke marrë parasysh zhvillimet si miratimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, në të ardhmen mund të priten ndryshime.


Kompetencat e zyrtarëve doganor rregullohen me Kodin Doganor dhe të Akcizave, Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale dhe Ligjin që është duke u përgatitur për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave mbi Pronën Intelektuale.

Me qëllim të luftimit të krimit ndër-kufitar dhe posaçërisht mashtrimet komerciale dhe me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të masave për fuqizim, ka nevojë të vazhdueshme për ta përmirësuar legjislacionin për Doganën, ashtu që zyrtarëve doganor t'u jepen mjete më të mira dhe kompetenca adekuate për të mbledhur dhe përpunuar informacione të rëndësishme, si dhe të bëjnë analiza moderne të rrezikut.

Marrëdhëniet institucionale në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Doganës së Kosovës rregullohen kryesisht nga Kodi Doganor dhe i Akcizave. Ministri për Ekonomi dhe Financa (MEF) e themelon një komision përzgjedhës dhe e propozon kandidatin për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës (DP), përderisa Kryeministri e bën emërimin e DP-së. Deri në fund të periudhës së mbikëqyrjes ndërkombëtare, procedura e emërimit duhet ta merr pëlqimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. DP i raporton Ministrit për Ekonomi dhe Financa. Ai duhet të konsultohet me MEF për disa çështje; për themelimin e komisionit i cili do të rekomandojë propozimet për Drejtorë, për përcaktimin e kriterëve për pozita të lira për punonjësit e doganës, për caktimin e rregullave për administrimin e Doganës (për shembull, vendi dhe orari i punës i zyrtarëve për vjeljen e obligimeve doganore/taksave), apo në nxjerrjen e udhëzimeve administrative lidhur me qarkullimin e produkteve me akcizë, pagimin e akcizës, përdorimin e pullave fiskale, informacionet që duhet të jepen nga tregtarët që sjellin të hyra, dokumenteve që duhet të mbahen në aeroporte, përcaktimin e vendeve për kontrollimin e mallrave, si dhe hedhjen dhe shënimin e mostrave të mallrave.

Përveç Kodit Doganor dhe të Akcizave, baza për politikën fiskale - posaçërisht pjesa lidhur me Doganën e Kosovës dhe e administruar nëpërmjet Doganës - mund të gjendet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr. 03/L-048). Përderisa janë duke u bërë disa ndryshime për shkak të tranzicionit të Doganës, asnjë nga to nuk mund të përshkruhet si

'të konsiderueshme'. Ligjet për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (Nr. 03/L-114) dhe për Tatimin e Normës së Akcizës (Nr. 03/L-112) mund të ketë një ndikim të dukshëm në vjeljen e të hyrave doganore, duke e ngritur TVSH-në nga 15% në 16% dhe duke ngritur akcizën për duhan, kafe, alkool, benzinë dhe automjetet motorike. Dogana e Kosovës është e një rëndësie shumë të madhe për Kosovën pasi që i siguron rreth 65 % deri në 70 % të hyrave në Buxhetin e Konsoliduar.



Puna e Doganës në vjeljen e të hyrave ka qenë e jashtëzakonshme që nga themelimi i shërbimit: prej 114 milion Euro në vitin 2000, të hyrat vjetore janë rritur vazhdimisht (me një ngecje gjatë viteve 2003 dhe 2005) për të arritur në 604 milion Euro në vitin 2008. Synimi për të vjelë të hyra prej 665 milion Euro gjatë vitit 2009 nga Dogana, konsiderohet si shumë ambicioz dhe jo real nga aspekti ekonomik (përfshirë rëniet e çmimeve të artikuljeve), prandaj duhet që t'i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe rishikimit të rregullt mujor. Siç thuhet në faqen e internetit të Doganës, me një total prej 180 milion Euro të vjela gjatë 19 javëve të para të vitit 2009, të hyrat kanë ngecur me 10% karshi planit.

Kodi Doganor dhe i Akcizave që përgatitur atëbotë nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut në lidhje me Zyrën Ligjore të Shtyllës IV të UNMIK-ut, e pastaj ishte verifikuar nga programi i financuar nga KE për asistencë teknike "TACTA": mostra e përdorur në përgatitjen e Kodit ka qenë "Kodi për Unionin e Doganave". Prandaj ka marrë komente pozitive nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Tatime dhe Union Doganor (TAXUD) dhe pavarësisht nga disa ndryshime të vogla mund të konsiderohet që është në pajtim me standardet e BE-së (Rregullorja e Këshillit (EEC) No 2913/92). Udhëzimi Administrativ i propozuar (dispozitat e zbatueshme) mund të vlerësohet se ka pajtueshmërinë e BE-së, po ashtu, pasi që janë hartuar sipas Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2454/93 duke vënë dispozita për zbatimin e Kodit për Unionin e Doganave.

Pajtueshmëria kryesisht i referohet dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave që i rregullon aspektet procedurale (hyrja dhe dalja e mallrave, procedurat doganore dhe zonat e lira,

ri-eksportim, shkatërrimi dhe braktisja) dhe rregullat për obligimet doganore (tarifat doganore, prejardhja, vlera doganore, lehtësimet doganore dhe borxhi doganor), të cilat përputhen me "acquis communautaire".

Veprimtaritë duhet të bashkërendohen ndërmjet Drejtorisë Ligjore të DK-së, Komponentit të Doganës të EULEX-it dhe një projekti të pritur të KE për asistencë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së rregullave dhe rregulloreve të Doganës dhe përputhshmërisë së tyre me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së.

Legjislacioni i Doganës së Kosovës mbështetet në kriteret e përcaktuara në Planet e Doganave të BE-së edhe pse kërkohet të bëhet përshtatje e mëtejshme (p.sh. zbatimi i AEO-s – Sistemi i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar - dhe sistemin e deklarimeve të bëra para arritjes/para shkuarjes).

Njësia për Këshillimin e Drejtorisë Ligjore të DK-së luanë një rol qenësor në sigurimin se legjislacioni i doganës zbatohet saktësisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë tërë territorit doganor. Njësia u ofron këshilla ligjore punonjësve të doganës, megjithatë shpesh udhëzimet dhe direktivat e dhëna punonjësve të doganës nuk janë gjithëpërfshirëse. Zyrtarët e Doganës informohen shpejtë për legjislacionin e ripunuar së fundmi (me anë të njoftimeve, seminareve dhe trajnimeve), por kuptimi apo interpretimi i rregullave përkatëse doganore të BE-së jo gjithmonë kuptohet si duhet, kështu që punonjësit në Doganën e Kosovës e kanë vështirë t'i zbatojnë apo fuqizojnë ato me saktësi në praktikë.

Edhe pse Kodi Doganor dhe i Akcizave dhe Udhëzimi Administrativ përbëjnë legjislacionin parësor dhe dytësor, legjislacioni i ri për doganën është duke u përgatitur; p.sh. Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave mbi Pronën Intelektuale me qëllim të luftimit të falsifikimit dhe piraterisë dhe kjo bëhet në pajtim me direktivat e Planeve të Doganave të BE-së (duke i pasqyruar praktikat më të mira të BE-së).

Përveç monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të vazhdueshëm, ankesat e dorëzuara tek Drejtori i Përgjithshëm mund të analizohen për të identifikuar se cilat probleme dhe modele ekzistojnë për sa i përket interpretimit ligjor. Mund të organizohen seminare të rregullta me pjesëmarrjen e punonjësve dhe zyrtarëve në Drejtorinë Ligjore të DK nga të gjitha degët doganore me qëllim që të sigurohet një interpretim korrekt i të gjitha rregullave doganore.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/1/2009

Për qëllim: Drejtoria Ligjore e Doganës

Për ta mentoruar dhe këshilluar Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës për një bashkërendim të duhur me asistencën e ardhshme nga Komisioni Evropian dhe projektet tjera me qëllim të përshtatjes së mëtejme të legjislacionit të Doganës dhe aplikimin e praktikave më të mira. Kjo duhet të përfshijë tema sikurse Sistemet e Operatorëve Ekonomik të Autorizuar dhe deklaratimet e bëra para-arritjes/para-shkuarjes, por edhe përpjekjet për të siguruar interpretim dhe zbatim të duhur të rregullave doganore në punën e përditshme.

Ofrim i paanshëm i shërbimeve

Ofrimi i paanshëm i shërbimeve doganore me të vërtet është një element i llogaridhënies edhe pse ka lidhje të forta me qëllimet e shumë-etnicitetit dhe të qëndrueshmërisë. Në këtë aspekt, Këshilltarët dhe Monitoruesit të EULEX-it e kanë vlerësuar aftësinë e Doganës së Kosovës për të qenë në shërbim të gjitha komuniteteve (duke ofruar informacione për publikun në përgjithësi) dhe për komunitetin afarist dhe për të vërtetuar llojin dhe shtrirjen e kontrolleve të brendshme, inspektimeve dhe veprimeve të ekipeve FAST, si dhe kontrolle nga zyrtarët dhe ekipet e doganave në vendkalimet kufitare.

Informacionet dhe komunikimi

Në përgjithësi, përdoren kanale të ndryshme për t'i ofruar informacione qytetarëve: broshura, fletë palosje dhe posterë të cilat janë në dispozicion në zyrat dhe degët e doganës; konferencat për shtyp dhe intervistat organizohen me rastin e arritjes së sukseseve; faqja në internet ofron informacione lidhur me legjislacionin doganor (Kodi i ri Doganor dhe i Akcizave), direktivat për procedurat doganore me ndikim ekonomik, TARIK (Tarifat e Integruar për Kosovën), marrëveshjet për tregti të lirë (CEFTA - Marrëveshja për Tregti të Lirë për Evropën Qendrore), etj. Këshilltarët e EULEX-it raportojnë se, një vëmendje e veçantë i është kushtuar komunitetit afarist së paku sipas planeve (p.sh. plani operativ 2009 i Drejtorisë për Operimin e të Hyrave), duke i përfshirë, p.sh. Odat Ekonomike dhe Shoqatat afariste dhe duke i synuar edhe kompanitë më të mëdha që bëjnë shitblerje të shpeshta afariste ndërkombëtare. Një shembull është ndryshimi i legjislacionit për akciza ku janë themeluar edhe kontakte të avancuara me importues/eksportues/prodhues të caktuar të prodhimeve alkoolike me qëllim të informimit të tyre për rregulloret dhe procedurat e reja dhe për të bërë një zbatim më të lehtë të masave. Raporti vjetor i Doganës për 2008, është me i shkurtër se sa raportet e kaluara, por përdorimi i një terminologjie më të afërt për opinionin në përgjithësi me siguri se do ta përmirësojë kuptueshmërinë e disa pjesëve të tekstit.

Monitoruesit e EULEX-it janë duke raportuar se ka paqartësi në ofrimin e njoftimeve, prospekteve, fletë palosjeve informative apo broshurave për informimin e opinionit dhe tregtarëve për obligimet dhe të drejtat e tyre. Varësisht nga koha e mbikëqyrjes, në disa VKK (Vendkalimet Kufitare) ka pasur informacione të pakta, në të tjerat ka pasur por jo në disa gjuhë ose nuk kanë qenë të dukshme, kurse në disa raste kanë munguar tërësisht. Nganjëherë zyrtarët e Doganës kanë mundur të sigurojnë informacione shtesë, por përshtypjet e Monitoruesve lidhur me informimin publik në pikat kufitare mund të përmbliidhen si jo të standardeve të kërkuara.

Edhe pse është bërë mund për të azhurnuar informacionet e dhëna në faqen në internet, në fletë palosje apo posterë; përshtypja e përgjithshme është se përmbajtja nuk është gjithmonë e plotë apo e azhurnuar. Informimi publik, posaçërisht në pikat apo degët kufitare duhet të përmirësohet më tej: shpesh informacionet e ofruara janë të vjetruara dhe jo të rregulluara në mënyrë sistematike apo si është e nevojshme në të tri gjuhët (shqip, serbisht dhe anglisht). Formularë të veçantë në Doganë, jo gjithmonë ofrohen në gjuhët tjera pos në një gjuhë (shqip), edhe pse angazhimi i MMK të EULEX-it me aktivitetet e tij mbështetëse duket se ka bërë ndikim. Do të duhet një mund që të përtërihen gjithë informacionet publike që kur janë nxjerrë Udhëzimi Administrativ nga MEF, udhëzime, direktiva apo procedura tjera nga Drejtori i Përgjithshëm. Ende mbetet të vlerësohet nëse strategjia për komunikim Doganës së Kosovës është plotësisht në pajtim me kriteret e vëna në Planet e BE-së për Dogana për Marrëdhënie me Publikun dhe Komunikim.

Dogana e Kosovës, duke mos përfshirë pjesën veriore të Kosovës, është duke bërë disa lloje të inspektimeve në tërë Kosovën: në vendkalimet kufitare, Terminale të brendshme doganore dhe pika kontrolluese për automjete (PKA).

Kontrollet në VKK dhe terminale bazohen në veçoritë e dhëna nga TIMS (Sistemi për Menaxhimin e Informacioneve Tregtare) i cili në mënyrë automatike tregon automjetet dhe mallrat që duhet të kontrollohen nga zyrtarët e degëve që kur të bëhen lajmërimet në dogana. Kontrollet arrijnë në 20 deri 30 për qind të qarkullimit; në vitin 2008 janë kontrolluar 33% e mallrave të importuara dhe eksportuara.

Kontrollet në PKA bëhen nga Ekipet Fleksibile të Doganës së Kosovës Kundër Kontrabandës (FAST) të vendosura përgjatë rrugëve. Për shembull, në një periudhë prej 14 ditëve, në pranverë të vitit 2009, FAST ka kryer 51 ndalje në PKA (nga të cilat 16 kanë rezultuar me konfiskimin e mallrave) dhe 80 kontrollime me një skaner mobil (me ndihmën e të cilit janë realizuar edhe 8 konfiskime); raporti vjetor i vitit 2008 përmend 941 shkelje doganore të zbuluara nga FAST dhe

konfiskimin e 91 veturave që kanë bartur mallra ilegale në një periudhë një vjeçare. FAST po ashtu, merr pjesë në aktivitetet dhe patrullimet e "Task Force" (përfshirë vijën kufitare të gjelbër); kjo Task Force është themeluar për ta parandaluar kontrabandën dhe përfshinë Doganën dhe Policinë.

Në parim, aktivitetet e kontrollit nuk varen nga shtrirja gjeografike, por - duke i ndjekur praktikat më të mira - bazuar në kriterin e rrezikut. Në vitin 2009 do të bëhet përpjekje për të zvogëluar nivelin e kontrollit me qëllim të lehtësimit të realizimit të tregtisë së ligjshme, por kontrollet e caktuara do të kenë nevojë për një menaxhim të intensifikuar të rrezikut. Kompanitë e ndryshme do të vlerësohen me rrezik të lartë nëse ato kanë shkelje të regjistruara, nëse dyshohet se veprimtaria e tyre është e rreme apo nëse të dhënat e inteligjencës tregojnë për aktivitete të dyshimta.

Ankesat dhe parashtresat

Mënyra se si një organizatë i trajton ankesat dhe ekzistimi i procedurave për parashtresa janë tregues të llogaridhënies së saj ndaj qytetarëve dhe institucioneve. Këshilltarët e EULEX-it paraprakisht kanë shikuar numrin, natyrën dhe rezultatin e ankesave të regjistruara kundër Doganës së Kosovës dhe punonjësve të saj për mos veprim në përputhje me legjislacionin, rregullat dhe procedurat, apo lidhur me shkeljen e mundshme të Kodit të Mirësjelljes. Kur është fjala për ankesat që bëhen kundër vendimeve të Doganës nga individ apo kompani, atëherë ata mund të dorëzojnë një kërkesë për shqyrtimin e vendimit nga Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës. Parashtresat kundër këtyre vendimeve pastaj është e mundshme të bëhen përmes Bordit të Pavarur Shqyrtues.

Të dhënat paraprake lidhur me 160 kërkesa të pranuar në muajin janar dhe shkurt 2009 duket se konfirmojnë trendin/të gjeturat e paraqitura në raportin vjetor të Doganës së Kosovës për vitin 2008. Rreth 70 % dhe 80 % e kërkesave për shqyrtim nga Drejtori i përgjithshëm janë duke u refuzuar (që do të thotë se mbështetet vendimi fillestar), përderisa shumë nga rastet lidhen me vlerësimin e mallrave.

Pasi që vlerësimi i mallrave mbetet çështja kryesore e kërkesave për rishqyrtim dhe vlerësimi doganor që është një fushë mjaft e komplikuar, duhet të bëhen analiza të mëtejme për të kontrolluar nëse metodat e vlerësimit aplikohen në mënyrë të duhur dhe konsistente. Duhet të ndërmerren veprime të ngjashme për ta mësuar natyrën e kërkesave dhe arsyet themelore

të mundshme e më pas të identifikohen fushat e caktuara brenda Doganës së Kosovës (si dhe cilat) kanë nevojë për t'u fuqizuar.

Bordi i Pavarur për Shqyrtim (BPSH), i cili punon sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Rregullorja Nr. 2005/17), është një organ për paraqitjen e parashtresave kundër vendimeve të Doganës së Kosovës. Nuk ka funksionuar në periudhën mars 2008 dhe prill 2009. Që kur Kuvendi i Kosovës ka caktuar anëtarët e ri të bordit dhe pas një viti ndërprerje, BPSH tash vonë ka filluar të organizojë seanca dëgjimore për parashtresat e bëra nga paguesit e taksës doganore.

Është duke u ngritur bashkëpunimi me Komponentin e Doganave në kuadër të EULEX-it me qëllim të zbulimit të trendëve apo modeleve në apele dhe shënimin e dobësive të mundshme në funksionimin e Doganës së Kosovës.

Brenda Sektorit për burime njerëzore të Drejtorisë për Financa dhe Sisteme, Njësia për Standarde Profesionale (NjSP) është duke hetuar dhe po merret me rastet e shkeljeve të mundshme të Kodit të Mirësjelljes. Rastet e identifikuara si shkelje të vogla zgjidhen duke ndërmarrë masa të parapara; rastet kur dyshohet se ka pasur shkelje serioze të detyrës zyrtare përcillen tek Bordi Disiplinor përderisa rastet e natyrës kriminale/penale i referohen Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë. Sa për ilustrim, gjatë muajve shkurt dhe mars 2009 është nisur procedura për 10 raste në të cilat përfshihen 17 zyrtarë të doganës dhe të klasifikuar nga NJSP ato janë raste lidhur me aksidentet në trafik gjithsej (4), dyshim për keqpërdorim të detyrës zyrtare (5) dhe mospërfillja e detyrës (1). Këshilltarët kanë vlerësuar se nga këto raste, 8 sish janë raportuar nga eprorët përgjegjës, 1 rast është nisur nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në raportin e Auditorit të Brendshëm, dhe 1 rast nga një person i tretë (që është në një vijë me përqindjet mesatare të rasteve të paraqitura në NjSP: rreth 80% nga menaxherët dhe 20% nga burimet jashtë Doganës së Kosovës). Ankesat kanë të bëjnë me shkeljet relativisht të vogla dhe gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar për ndonjë kundërvajtje serioze (për shembull dhënie e mitos), as raste të referuara drejt autoriteteve kompetente për hetime penale.

Anti-korrupsioni

NJSP ka përgatitur një plan pune për vitin 2009 për luftimin dhe parandalimin e korrupsionin brenda Doganës së Kosovës, i cili plan pritet ta përplotësojë Strategjinë dhe Planin e Veprimt Kundër-Korrupsionit të Qeverisë së Kosovës. Ky plan si synime kryesore ka:

- ta rris integritetin e punonjësve të Doganës përmes zhvillimit, plotësimit të zbatimit të Kodit të Mirësjelljes dhe Procedurave Disiplinore si dhe paralajmërimin për efekte negative të korrupsionit dhe informacioneve për masa të mundshme disiplinore në rast të shkeljes së legjislacionit të zbatueshëm;
- ta përmirësojë bashkëpunimin e brendshëm dhe shkëmbimin e informacioneve me qëllim të hetimit të rasteve dhe luftimit të korrupsionit;
- të zhvillojë fushata për t'i inkurajuar qytetarët dhe komunitetin afarist për t'i raportuar sjelljet e mundshme korruptive, të udhëzojë se si të parashtrihen ankesa dhe të garantojë besueshmëri në rast të paraqitjes së rasteve;
- ta përmirësojë bashkëpunimin me institucionet tjera të Kosovës përgjegjëse për zbatimin e ligjit (Policinë, Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit, Administratën Tatimore të Kosovës, Prokurorinë Publike, Gjykatat);
- t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e zbatueshëm në procesin hetues;
- ta monitorojë menaxhimin e burimeve njerëzore (lëvizjen/transferimin e punonjësve) me qëllim për të zvogëluar mundësinë për të mashtruar dhe korruptuar dhe për t'ju shmangur rasteve të mundshme të konfliktit të interesit.

Siç ceket në planin e punës do të duhet të ketë angazhim të vazhdueshëm dhe përkushtim të gjithë punonjësve në Doganën e Kosovës, në veçanti të zyrtarëve të lartë.

As Këshilltarët e EULEX-it e as Monitoruesit nuk raportojnë ndonjë rast të paraqitur të korrupsionit ku mund të jenë përfshirë punonjësit e Doganës së Kosovës gjatë muajve të parë të vitit 2009. Raporti vjetor për vitin 2008 nuk është shumë i hollësishëm kur raportohet kundër korrupsionit pasi që i referohet vetëm procedurave disiplinore të ndërmarra kundër 85 zyrtarëve të doganave dhe 34 masave disiplinore që kanë rezultuar ndër të tjera me paralajmërime (24), raste të dorëzuara në polici (13) dhe/apo në gjykata dhe shkarkime (6).

Fakti që nuk është raportuar asnjë incident i korrupsionit krahasohet me perceptimin publik të korrupsionit në Doganë. Edhe pse Raporti për Paralajmërim të Hershëm për Kosovën nga UNDP për muajin prill 2009 thekson se korrupsioni nuk duket si një problem i madh me të cilin po përballet Kosova (i radhitur si i pesti në grupin prej nëntë), 9-13% nga të pyeturit janë përgjigjur se ata kanë pasur situata kur zyrtarët publik kanë kërkuar ryshfet, dhurata apo shërbime tjera. Për çudi Dogana e Kosovës radhitet e treta në listën e institucioneve të Kosovës ku ndjehet se ekziston "shkallë e lartë" e korrupsionit. Aaktivitetet e mëtejme të MMK (Monitorim, Mentorim dhe Këshillim) do të jenë të nevojshme në të ardhmen me qëllim të identifikimit të fushave më brengosëse, për të përmirësuar bashkëpunimin me Policinë dhe

Prokurorët Publik në identifikimin e veprave korruptive dhe për të zhvilluar strategji për të zvogëluar problemet e mundshme.

Përparësitë dhe dobësitë

Për sa i përket aspekteve të ndryshme të llogaridhënies, përparësitë dhe dobësitë e Doganës së Kosovës mund të përmbliidhen si vijon:

Përparësitë

- Legjislacioni parësor është i miratuar dhe është në pajtim me standardet e BE-së: Kodi Doganor dhe i Akcizave është në pajtim me Kodin për Unionin Doganor.
- Zbrazëtitrat Ligjore janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme pasi që ende zbatohen edhe rregullat dhe rregulloret e UNMIK-ut nga e kaluara.
- Ekziston një organizim i qëndrueshëm në Doganë dhe funksionon mirë.
- Dogana e Kosovës ka një përmbushje të dëshmuar faktike në mbledhjen e të hyrave.
- Ekzistojnë procedurat për ankesa dhe parashtresa për shqyrtimin e vendimeve të trajtuara në kohë të caktuara.
- Njësia për Standarde Profesionale i trajton shkeljet e mundshme të Kodit të Mirësjelljes, përderisa raportimi i brendshëm i shkeljeve të bëra duket se funksionon mirë.
- Dogana e Kosovës ka një Plan Pune për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, dhe kanë të vendosura disa masa proaktive (paraprijëse).
- EULEX-i nuk ka shfrytëzuar përgjegjësitë e veta ekzekutive apo që të ndryshojë vendimet e Doganës së Kosovës të marra në gjashtë mujorin e fundit.

Dobësitë

- Ende nuk ka akte nënligjore për Doganën (Udhëzimi Administrativ i nxjerrë nga Ministri për Ekonomi dhe Financa), dhe nuk ka udhëzim të ri administrativ të nxjerrë nga Drejtori i përgjithshëm siç përcaktohet në Kodin Doganor dhe të Akcizave.
- Ende nuk është caktuar ndonjë afat kohorë për shqyrtimin e rregulloreve ekzistuese, rregullave dhe udhëzimeve.
- Mungesa e koordinimit në mes të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Doganës.
- Ankesat për vendimet e marra nga Dogana duket se në mënyrë të qëndrueshme lidhen me disa fusha të caktuara, posaçërisht me vlerësimin e mallrave.
- Bordi i Pavarur për Shqyrtim nuk është takuar për më shumë se një vit, duke prodhuar kështu punë të pakryer rreth zgjidhjes së apeleve.

- Perceptimi i publikut duket se insiston në ekzistimin e veprimeve korruptive në Doganën e Kosovës.

Konkluzionet

Ndaras nga Kodi Doganor dhe i Akcizave, shqyrtimi i gjithë legjislacionit ekzistues dhe ndryshimit të mundshëm të legjislacionit dytësor: rregulloreve, rregullave, udhëzimeve dhe/apo procedurave operative të cilat zbatohen ende është në faza të hershme, pasi që Udhëzimi Administrativ me dispozitat e zbatueshme ende nuk është nxjerrë nga Ministri për Ekonomi dhe Financa.

Me Kodin Doganor dhe të Akcizave, i cili është në pajtim me “acquis communautaire” besohet se është ngritur baza për legjislacion dhe rregullore që pritet të sajohen sipas standardeve Evropiane. Përderisa procedurat e apeleve duket se po zbatohen mund të bëhen edhe më analiza për të zbuluar arsyet themelore për ankesa.

Duhet të bëhet përpjekje për të zvogëluar perceptimin e korrupsionit brenda organizatës përfshirë këtu edhe komunikimin transparent.

QËNDRUESHMËRIA E SHËRBIMEVE

Resurset njerëzore

Këshilltarët dhe Monitoruesit e EULEX-it kanë grumbulluar informacione rreth rregullit për vlerësimin e aftësisë dhe punës brenda Doganës së Kosovës dhe kuptimi i përkrahjeve të punës nga punonjësit përmes intervistave të bëra në Drejtorin, në VKK dhe në terminale.

Në muajin maj 2009, numri i përgjithshëm i punonjësve në Doganën e Kosovës përfshirë këtu edhe menaxherët, mbikëqyrësit dhe zyrtarët ka qenë 555. Në pajtim me buxhetin e lejuar, struktura organizative e propozuar për vitin 2009 pasqyron një numër maksimal prej 572 punonjësve. Varësisht nga punësimet, niveli i punësimit në administratën e Doganës sillet ndërmjet 540 dhe 560. Pasi që Drejtoria për Operimin e të Hyrave përbëhet nga të gjitha degët doganore dhe pikat brenda vendit, ajo e ka numrin më të madh të punonjësve, rreth 310. Drejtoria për Zbatimin e Ligjit përbëhet nga ekipet fleksibile kundër kontrabandës (FAST) është e dyta për nga numri i punonjësve i cili arrin në 140 zyrtarë. Drejtoria për Financa dhe Sisteme ka rreth 85 punonjës, kurse Drejtoria Ligjore është më e vogla me 18 punonjës që punojnë aty.

Gradat dhe numri i punonjësve në Doganën e Kosovës (19.05.09)

G20	Drejtori i përgjithshëm	1
G10	Drejtor	5
G9	Udhëheqës Departamenti	11
G8	Kreu i Sektorit	42
G7	Udhëheqës ndërrimi	123
G6	Zyrtar i Lartë Doganor	188
G5	Zyrtar Doganor	172
G4	(Zyrtar Doganor me Gradë më të ulët)	13

Totali (të gjitha pozitat): 555

Monitoruesit e EULEX-it në VKK shpesh kanë marrë ankesa për mungesën e numrit të mjaftueshëm të punonjësve. Gjithashtu strategjia MIK (Menaxhimi i Integruar i Kufijve) thekson se numri i tanishëm i punonjësve në agjenci të ndryshme të përfshira në të nuk përmbushin nevojat dhe kërkesat ditore. Niveli i pjesëmarrjes dhe vëmendjes së punonjësve monitorohet për çdo ditë. Në rast të mungesës së punonjësve për një periudhë të shkurtë të kohës, punonjësit mund të rigrupohen në ekipe për të pasur një numër minimal të zyrtarëve për çdo ndërrim por nganjëherë kërkohet edhe ricaktimi i personelit nga apo për në VKK tjetër.

Trajnimi dhe zhvillimi i aftësive thelbësore

Plani për trajnim i Doganës së Kosovës ("Plani i Trajnimit") përgatitet në baza vjetore nga një Komision i përbërë nga Udhëheqësit e Sektorëve, Udhëheqësi i Sektorit për Trajnim dhe Drejtorja për Financa dhe Sisteme përmes një vlerësimi dhe diskutimi të nevojave për trajnime në aftësitë thelbësore dhe kërkesat në nivelin e njësisë organizative. Sipas Doganës së Kosovës, është vënë bazamenti për aktivitete trajnuese dhe përparimtare nga një kornizë afat mesme për trajnim por nuk jepen detaje e as vlerësime shtesë. Plani për Trajnim për vitin 2009 përfshinë një përzgjedhje të trajnimeve fillestare, të avancuara dhe të specializuara në një gamë të gjerë të fushave dhe temave, p.sh. zbatimi i Procedurave Doganore, Njoftim për mënyrën e Parandalimit të Krimit Financiar, Trajnimi Bazë për Hetimin e Krimeve Financiare, Analizave Operacionale, Analizimi i Pajisjeve të TI (Teknologjisë Informative), Hetimi Financiar, Hetimi i Korrupsionit, Hetimi për Shmangie të Tatimeve, Hetimi i Kontrabandës dhe Shmangies së të Hyrave Doganore, Hetimi i Krimeve të kryera përmes TI, kundër Larjes së Parave dhe Hetimi i pasurisë, hetimi i mashtrimeve dhe borxheve të shumta, hetimi i falsifikimit, Udhëheqja e Hetimeve të Krimeve Financiare, Mbajtje e Llogarisë / Auditor Ligjor, Mjekësia ligjore për hetimet e Krimeve Financiare përmes TI.

Vlerësimi paraprak tregon se plani për trajnim nuk është mjaft ambicioz, sidomos në fushën e zbatimit të ligjit nga dogana. Përqendrohet në masë të madhe në procedurat operative, auditimin dhe hetimin në vend të parandalimit apo zbulimit të kundërvajtjeve në doganë. Edhe pse trajnimi aktual për zbatim të ligjit duket të jetë përkatës dhe i duhur dhe do të kërkohet të vihet theks më shumë për trajnim të specializuar, për shembull në vlerësimin përshkrues dhe të avancuar të rrezikut, teknikat e intervistimit, teknika të fshehta vëzhguese apo trajtim i informatorëve dhe posaçërisht nëse Dogana e Kosovës ka qëllim serioz për tu marrë me krimin e organizuar.

Trajnimi përbrenda Doganës së Kosovës kryesisht ofrohet nga instruktorët e tyre të kualifikuar dhe të certifikuar të cilët janë zyrtarë të vetë administratës së doganës. Kjo plotësohet me kurse (të përfshira në Planin për Trajnim) të ofruara nga Qendra e Kosovës për Edukim, Siguri Publike dhe Zhvillim (KCPSED). Kjo qendër është një agjenci ekzekutive brenda Ministrisë për Punë të Brendshme përgjegjëse për ofrimin e aftësimin teknik, zhvillimin e plan programit dhe shërbimet mbështetëse për trajnimin mbi sigurinë publike për nëpunësit civil të Kosovës të punësuar në organet që merren me çështjen e sigurisë publike, p.sh. shërbimi policor, shërbimi korrektues, shërbimi doganor dhe shërbimet emergjente.

Pasi që trajnimi brenda doganës ofrohet nga vet instruktorët e administratës së doganës, kapaciteti i menaxherëve të trajnimit për të siguruar përputhshmërinë me strategjinë, rregullat dhe procedurat e trajnimit për shumicën e trajnimeve themelore në doganë konsiderohen të duhura. Megjithatë, insistohet në nevojën për të pasur trajnime të vazhdueshme të specializuara, deri më tani ato janë ofruar nga jashtë, por duke i parë ndryshimet, sfidat dhe problemet e doganës, sektori i Trajnimit do të përfitojë nga trajnerët shtesë të specializuar (të angazhuar gjatë tërë kohës).

Shumat vjetore të dedikuara për trajnim përfshijnë 2.5% deri në 3% nga shpenzimet vjetore të Doganës së Kosovës. Në vitin 2008, sipas raportit të fundit vjetor, 1.155 persona kanë marrë pjesë në trajnime që do të thotë mesatarisht dy trajnime për një punonjës. Ende nuk është bërë një vlerësim i thellë i përshtatjes së strategjisë së trajnimit, rregullave, strukturës dhe procedurave me treguesit kyç të trajnimit të Planeve të Doganave të BE-së.

Trajnim themelor për punonjësit e rinj të shërbimit doganor është zgjeruar në një periudhë 8 javore dhe i realizuar në dy faza. Trajnimi teorik përfshin një fazë 5 javore; çështjet e caktuara që lidhen me mandatin (rolin, detyrat dhe përgjegjësitë) dhe bazohen në Kodin Doganor. Kjo fazë e trajnimit

përcillet me një test me shkrim dhe mbikëqyret nga sektori për trajnime në kuadër të Doganës, më pastaj trajnimi teorik plotësohet nga faza 3 javore e trajnimit praktik në punë. Sektori për Trajnim vlerëson trajnimet dhe trajnuesit përmes formularëve të cilat duhet të plotësohen nga të trajnuarit, përfshirë mjetet për përcjelljen e mesazhit, përmbajtjen e kursit, efektivitetin dhe shfrytëzimin praktik të trajnimit.

Për sa i përket niveleve të trajnimit dhe zhvillimit të shkathtësive të punonjësve të doganave në shumë fusha të zakonshme të doganave sikurse në fushën e zbatimit të ligjit dhe parandalimin e krimit/mbrojtjes së shoqërisë, mbledhja e të hyrave, auditimi dhe hetimi, menaxhimi i burimeve njerëzore, teknologjia informative dhe infrastruktura duket se - sikurse fillimisht është kategorizuar nga Këshilltarët në Drejtorinë e Doganës së Kosovës - është në nivel të kënaqshëm dhe përputhet me qëllimin. Në përgjithësi Monitoruesit e EULEX-it kanë konfirmuar këto vrojtime, edhe pas propozimit se punonjësit e ri kanë nevojë për trajnime në punë dhe një qasje "mësim duke vepruar" nën mbikëqyrjen e kolegëve të tyre me përvojë dhe atë që kur punonjësit të qarkullojnë me atë rast ata kanë nevojë për trajnim/njoftim për kërkesat/shkathtësitë e nevojshme në vendin e ri të punës dhe në karakterin apo rreziqet në Pozitat në vendet Kufitare.

Edhe pse trajnimi i punonjësve në mënyrë individuale mund të propozohet nga mbikëqyrësit apo eprorët përgjegjës (bazuar në vlerësimin e efektshmërisë së punonjësve), duket se do të iniciohet nga Komisioni i lartë cekur i cili po bënë përzgjedhjen dhe identifikimin e punonjësve për trajnim.

Procesi i vlerësimit dhe diskutimit të efektshmërisë (shih poshtë) në mënyrë eksplicite njeh rolin kyç që do ta luan në identifikimin e nevojave të trajnimit dhe zhvillimit por duket se ka përgatitje dhe vetëdije të vogël të individëve për mundësinë e paraqitjes së nevojave të tyre për trajnim. Monitoruesit e kanë konfirmuar këtë vërtetim. Punonjësit nuk e dinë se si apo cilit ti paraqesin vullnetin e tyre për nevojat e tyre për trajnim dhe se procesi i përzgjedhjes nuk është i qartë dhe shihet se bëhet me propozim nga eprorët përgjegjës. Me sa duket zyrtarët e njëjtë ftohen për të vijuar trajnime se disa të tjerë. Punonjësit e angazhuar në FAST kanë shprehur pakënaqësinë e tyre pasi që ata rrallë herë janë dërguar në trajnime, përfshirë edhe për shfrytëzimin e pajisjeve të veçanta.

Bazuar në intervistat e bëra në Drejtori dhe nga përgjigjet e dhëna në pyetësorët lidhur me programet e veçanta të trajnimit, punonjësit e doganës i perceptojnë trajnimet si të dobishme dhe efektive. Kjo duket që shpesh konfirmohet nga punonjësit në degët doganore qoftë trajnim themelor apo trajnim formal në shërbim. Megjithatë Monitoruesit e EULEX-it kanë vërtetuar se nuk ofrohen doracak për module të trajnimit apo të udhëzuesve për një referim të lehtë për punonjësit e angazhuar nëpër degë.

Përmirësimet megjithatë mund të sugjerohen në përmbajtjet e trajnimit, fushë veprimet, përcjelljes së mesazhit dhe metodologjisë - përfshirë edhe hapësira për trajnim “on line” - për tija dalë me mjedisin të ndryshueshëm ekonomik dhe politik si dhe për t’ju përgjigjur kërkesave për atë rast apo nevojave të shprehura nga individët. Vëmendje e veçantë duhet të jetë për trajnim për shfrytëzimin e pajisjeve speciale.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/3/2009

Për qëllim: Udhëheqësit e Sektorëve, Udhëheqës i Sektorit të Trajnimit, Drejtori për Financa dhe Sisteme

Mentorimi dhe Këshillimi i Drejtorisë për Financa dhe Sisteme në Doganën e Kosovës dhe Udhëheqësit e Departamenteve dhe Njësive për shqyrtimin dhe përmirësimin e strategjive dhe planeve të trajnimit. Kjo duhet të përfshijë trajnim të specializuar në zbatimin e ligjit (parandalimi dhe zbulim të specializuar) dhe në aspektet e menaxhimit të rrezikshmërisë (vlerësimi i avancuar dhe i veçuar i rrezikshmërisë).

Përmbushja e detyrave

Bazuar në intervistat e bëra në Drejtori, në përgjithësi punonjësit janë të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe se përshkrimet e tyre të punës kuptohen në tërësi. Detyrat e njësive dhe sektorëve të tyre janë të komunikuar qartë. Monitoruesit po ashtu kanë raportuar se përshkrimet e punës janë në dispozicion dhe se detyrat kuptohen mesatarisht në degët doganore edhe pse zakonisht ndërmerren veprime të caktuara nga të dhënat e mbikëqyrësve apo bazuar në udhëzimet nga Drejtoria. Në disa raste, Monitoruesit kanë intervenuar për të qartësuar procedurat. Përshkrimet e tanishme janë përcjell nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, por për shkak të ndryshimit të kërkesave dhe përgjegjësive, posaçërisht atyre të nivelit të mesëm menaxherik dhe mund ti nënshtrohen rishqyrtimit. Punonjësit e specializuar sikurse ata në Drejtorinë Ligjore kanë një përgatitje të duhur arsimore apo përgatitje universitare, por janë ende pa përvojë me disa vjet shërbimi në doganë. Gama e gjerë e detyrave për zyrtarët në veprimet për mbledhjen e të hyrave kërkohej të ketë trajnime në disa fusha (shembull: procedura, mbledhja e të hyrave, kontrolli doganor), kështu që nevojitet kohë për rezultatet e reja që të përshtaten me detyrat e tyre.

Monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se materiali referues për punonjësit në degët Doganore që tregon se si të kryhen detyrat, ofrohet si dokument apo në formë elektronike, por një burim i rëndësishëm i informatave rreth legjislacionit dhe procedurave duket të jetë faqja në internet e Doganës së Kosovës. Eprorët e caktuar janë përgjegjës për të siguruar të ketë nivel të duhur të diturisë tek zyrtarët duke i informuar dhe shkëmbyer informacione përmes e-mailit dhe njoftimeve.

Punonjësit në Doganë vlerësohen rregullisht, këtë sipas sistemit për vlerësim dhe diskutim të Punës i cili është konceptuar nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut. Raporti për Vlerësimin e Punës do të përgatitet për çdo vit (pritet të publikohet në muajin nëntor) i cili përfshin një shqyrtim të gjysmë vjetorit (periudhës gjashtë mujore) dhe një shqyrtim në fund të vitit që pritet të realizohet në muajin nëntor. Kriteri i aspekteve të përfshira në vlerësim janë: Aftësitë profesionale dhe teknike, cilësia dhe sasia e punës së realizuar, afatet kohore të punës, nisma, kreativitet dhe aftësi në gjetjen e zgjidhjeve, marrëdhëniet e punës, shprehjet me shkrim dhe me gojë në gjuhën(t) zyrtare, menaxhimi i punonjësve apo burimet, planifikimi dhe organizimi i punës, dhe aftësia për të negociuar dhe për të bindur. Ka direktiva të qarta cilat janë në dispozicion për mbikëqyrësit e drejtpërdrejt se si ti zbatojnë dispozitat e procedurës së vlerësimit. Raportet për Vlerësimin e Punës kanë nevojë që të miratohen nga eprorët përgjegjës/eprorët të cilët i miratojnë dhe se procedurat për apele ekzistojnë. Efektshmëria në punë ka një ndikim në rrogën (të ardhurat) e çdo punonjësi. Në vitin 2008 janë pranuar vetëm tre ankesa lidhur me vlerësimet individuale.

Numri i ankesave tregon se cilësia e vlerësimit të punës shihet si e drejtë. Megjithatë, mund të tregojë po ashtu se procedura ka ra në një formalitet pa pasoja (përfshirë ato financiare) për zyrtarët, as me mundësi për punonjësit për ti shprehur lirshëm brengat e tyre gjatë takimeve vlerësuese. Për shkak të periudhave të caktuara gjatë vitit (qershor dhe nëntor), cilësia e procesit të vlerësimit të punës në praktikë nuk ka mundur të vlerësohet (shembull, mbledhjeve të drejtpërdrejta (interaktive) në mes të mbikëqyrësit dhe zyrtarit) as procedurat për trajtimin e ndonjë ankesë dhe/apo ankesë për diskriminim apo trajtim jo të barabartë gjatë vlerësimit të punës.

Këshilltarët raportojnë se ekziston një sistem themelor automatik për menaxhimin e punonjësve i cili është duke u zbatuar i cili mban të dhënat për punësim, vlerësimet e punës dhe për avancim. Megjithëkëtë të dhënat për trajnim mbahen nga sektori i trajnimit në mënyrë të pavarur dhe ruhen në një bazë të ndarë të dhënave.

Sikurse është vlerësuar edhe më parë, sistemi i tanishëm nuk përmbush kriteret e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Planeve të BE-së për Dogana të cilat thërrasin për sisteme të integruara për punonjës për punësim, mbajtje, menaxhimi i efektshmërisë dhe vlerësimit, promovimi, përparimi në karrierë, trajnimet dhe zhvillimi, transferimi, ndarje, shkarkimi, pensionimi, kompensimi dhe kushtet e punës.

Burimet tjera (infrastruktura, pajisjet, objektet)

Edhe pse vlerësimi detaj i këtyre burimeve mund të mos jetë objektivi i parë në një mision për Sundim të Ligjit dhe të jetë më shumë një përgjegjësi e aktorëve tjerë (ndërkombëtar) në Kosovë, megjithatë është me rëndësi të kemi një përshtypje të gjerë të qasjes dhe cilësisë, pasi që këto janë si kusht paraprak për Doganën e Kosovës për të realizuar detyrat e tyre në mënyrë të qëndrueshme.

Menaxhimi i pajisjeve dhe burimeve operative mund të konsiderohet si i duhur, por nuk është bërë ndonjë vlerësim i plotë i tërë infrastrukurës dhe pajisjeve (në bazë të inventarit të regjistruar në mënyrë manuale). Në disa raste, objektet për bastisje/kontroll detaj në degët e Doganave apo në terminale nuk janë në nivel të kënaqshëm për të kryer një kontroll apo inspektim të mirëfilltë. Disa degë i përmbushin disa nevoja themelore por të tjerave ju mungojnë; për shembull, hapësira (e mbuluar) për kontrollim me qëllim të shmangies të bllokimit të trafikut apo hapësirave për përdorim të automjetit me rreze-X; shenjat për shiritat ku kalojnë mallra “që nuk deklarohen ose duhet të deklarohen” (shiritat me të kuqe/të gjelbër, në VKK më të mëdha) nuk janë gjithmonë të qarta. Njësitë mobile i kanë kompletuar profilet për Vendkalimet Kufitare dhe Terminalet, ku shihet se ka mungesë të pajisjeve apo pengesat në shfrytëzimin e duhur të tyre. Ata kanë raportuar për kohën e gjatë të veprimit nga Drejtoria e Doganës lidhur me rregullimin, riparimin apo zëvendësimin e pajisjeve. Nivelet e pajisjeve janë të ndryshme edhe kur janë në dispozicion nuk shfrytëzohen si duhet deri në kapacitetin e tyre të plotë.

Me qëllim të identifikimit të zbrazëtirave të mundshme në infrastrukturë dhe pajisje, të gjitha pajisjet duhet të regjistrohen në një bazë të dhënave elektronike duke shfrytëzuar bar kode. Hapësirat për kontrollim në disa degë doganore kanë nevojë të rinovohen në mënyrë të konsiderueshme, përfshirë edhe hapësirat dhe pajisjet teknike, p.sh: makinat me rreze-X. Plani për Veprim i Menaxhimit të Integruar Kufitar i Qeverisë së Kosovës ka për qëllim t'i plotësojë disa nga zbrazëtirat.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/4/2009

Për qëllim: Udhëheqësit e Sektorëve, Udhëheqësit e Sektorit të Trajnimit, Drejtori për Financa dhe Sisteme

Mentorimi dhe Këshillimi i Drejtorisë së Doganës për Financa dhe Sisteme në pajtim me kriterin për menaxhim të burimeve njerëzore të Planeve të Bashkimit Evropian për Dogana, ku kjo duhet të përfshijë zhvillimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të punëtorëve.

Një vëmendje e veçantë është e nevojshme që të përfshijë të dhëna për trajnim të cilat mbahen në një bazë të ndarë të dhënave.

Planet për menaxhimin operativ

Këshilltarët e EULEX-it kanë qenë në gjendje që paraprakisht të vlerësojnë cilësinë e planeve për menaxhimin operativ pasi që ende nuk janë të finalizuar (pas raportimit të Doganës në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa).

Korniza e Strategjisë Operative 2009 - 2011 është paraqitur në faqen në internet të Doganës së Kosovës; është e ngjashme me Kornizën Strategjike Operative të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut 2006 - 2009. Informacionet faktike janë azhurnuar (shembull: niveli i punësimit, synimet për mbledhjen e të hyrave, buxheti operativ).

Zhvillimet aktuale, p.sh.: themelimi i Doganës së Kosovës dhe pasojat e shndërrimit të saj në agjenci ekzekutive nën Ministrinë për Ekonomi dhe Financa nuk i jepet ndonjë theks të veçantë, pasi që qëllimet dhe synimet mbesim shumica të njëjta, strategjia e Doganës së Kosovës nuk pritët të ketë ndryshime dramatike.

Planet operative/vepruese të propozuara me qëllime dhe objektiva për vitin 2009 janë përgatitur për dhe brenda çdo drejtorie. Sikurse kanë raportuar këshilltarët e EULEX-it këto plane pritët të diskutohen dhe miratohen nga Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm në një të ardhme të afërt. Ato nuk janë konsoliduar në një Plan për Menaxhim të Doganës për vitin 2009.

Fakti se Kodi i ri Doganor dhe i Akcizave i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2008 dhe Udhëzimi Administrativ që ende nuk është nxjerrë nga Ministri për Ekonomi dhe Finance e që mund të ngadalësojë finalizimin dhe zbatimin e planeve menaxherike apo operative. Pavarësisht nga obligimi i Drejtorit të Përgjithshëm për ti raportuar Ministrin dhe se planet strategjike kanë nevojë të udhëhiqen nga rregullat e përgjithshme të vendosura nga Ministria, duket se ka hapësirë për ndërhyrje politike në selinë qendrore të Doganës të

Kosovës gjatë caktimit të prioritetëve dhe vendimmarrjes, nëse planet operative vërtetë kanë nevojë për një miratim formal nga Ministri.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/5/2009

Për qëllim: Drejtori I Përgjithshëm i Doganës, Drejtoritë

Mentorimi dhe këshillimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorëve të Doganës së Kosovës për azhurnimin e kornizës strategjike dhe planeve operacionale. Kjo do të përfshijë integrimin e planeve të ndryshme të Drejtorive në një plan të konsoliduar i cili definon qartë objektivat dhe përgjegjësitë. Duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë për të përfshirë të gjitha elementet në Strategjinë kombëtare për Menaxhim të Integruar të Kufijve tani të miratuar dhe strategjia e ardhshme kundër krimin të organizuar.

Plani për Veprim për vitin 2009 nga Drejtoria Ligjore ka vënë si objektiva, zhvillimet të mëtejme të kapaciteteve administrative dhe profesionale brenda Drejtorisë; shqyrtimi dhe identifikimi i kërkesave të veçanta për shërbime ligjore brenda Doganës dhe institucioneve tjera; shqyrtimi i ankesave kundër vendimeve të marrë nga Dogana, zhvillimi i kapaciteteve të duhura për përfaqësim të Doganës në Bordin e Pavarur për Shqyrtim dhe në gjykatë; mbështetje e punonjësve në zbatimin e mirëfilltë të Kodit Doganor dhe legjislacionit dytësor edhe harmonizimi dhe përafrimi i legjislacionit të brendshëm dhe procedurave doganore me *Acquis Communautaire*.

Drafti nuk është mjaft i detajuar dhe aktivitetet janë të definuar gjerësisht pa i vendosur rezultate të qarta apo definimin e afateve kohore. Edhe pse disa aktivitete duket se janë detyra dhe përgjegjësi të zakonshme që ka Drejtoria, të tjera varen nga hapa të mëtejme në zhvillimin e legjislacionit (dytësorë) dhe udhëzimeve. Edhe pse Drejtoria Ligjore i raporton për çdo muaj Drejtorit të Përgjithshëm (kryesisht për aktivitete që përmbajnë statistika për këshillat ligjore që janë kërkuar, për apele,...), planifikimi me gjasë do të përfitojë më shumë nga raportimi analitik (dhe më kritik) me qëllim të identifikimit të problemeve lidhur me zbatimin (e njëtrajtshëm) të legjislacionit të doganës.

Projekt-plani për veprim i drejtorisë për zbatim të ligjit 2009, si objektiva ka të theksuar: zvogëlimi i mundësisë së mashtrimit në tatim dhe mbledhjes së taksës doganore, kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara përmes arrestimit, zbulimit dhe hetimit; për të përmirësuar përputhshmërinë nga ana e tregtarëve dhe komunitetit afarist; përmirësimi i detyrave ndërlidhëse, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, si dhe shkëmbimi i inteligjencës me agjencitë tjera për zbatim të ligjit (në Kosovë dhe ato ndërkombëtare); vazhdimisht të zhvillohen kapacitetet administrative, profesionale dhe teknike në zbatim të ligjit brenda Drejtorisë; zbatimi i Kodit të Etikës dhe posaçërisht në shtimin e masave për të luftuar korrupsionin.

Plani është mjaft i detajuar përfshirë këtu edhe treguesit në kuptim të numrave apo statistikave të cilat mund të shfrytëzohen për matjen e progresit apo efektshmërisë. Edhe pse duket shumë i frytshëm, në disa fusha dhe përfshin lista të gjëra me aktivitete pa afate të caktuara kohore, cilësia e planit për zbatim të ligjit në kuptim të përgjithshëm shihet si i kënaqshëm dhe ofron një kornizë të qartë për të udhëhequr aktivitetet e Drejtorisë. Disa nga çështjet e krimit të organizuar/serioz janë paraqitur si rezultat i aktiviteteve të MMK të EULEX-it, megjithatë në përgjithësi shumë pak e përmend krimin e organizuar.

Objektivat e planit të propozuar operativ të Drejtorisë për Operimin e të Hyrave 2009 janë për të siguruar mbledhjen e duhur të hyrave sipas pikësnyimeve të vendosura nga Ministria për Ekonomi dhe Financa; ta ngritë bashkëpunimin me komunitetin afarist dhe me agjenci të tjera për zbatim të ligjit në kornizën e Menaxhimit të Integruar Kufitar duke lehtësuar tregtinë e ligjshme; dhe për të shtuar parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit, larjes së parave dhe kontrabandimit dhe themelimi i sistemeve për të zvogëluar mundësitë për korrupsionin e punëtorëve.

Në përgjithësi duket se nuk ka integrim apo konsolidim të planeve operative në një plan të vetëm me objektiva të qarta për Doganën e Kosovës, gjë që e bën të vështirë të ndiqet progresi dhe të theksohen qartë përgjegjësitë. Shpesh ndodhë të ketë gërshetime, dhe raportimi për këto plane operative bëhet mjaft konfuz.

Luftimi i krimeve të rënda

Luftimi kundër të gjitha formave të krimeve të rënda dhe mbështetja e Institucioneve në këtë kuptim është njëri nga prioritetet kryesore të EULEX-it, siç mund të shihet nga objektivat strategjike të tij. Prandaj, nga këshilltarët e EULEX-it është kërkuar të vlerësojnë se deri në ç'masë janë efikase funksionet hetimore dhe zbatuese lidhur me krimet e rënda, p.sh. procedurat e zbatuara, veprimet ekzistuese të nevojshme për të zbuluar krimin dhe vënia e vazhdueshme në shënjestër të grupeve të dyshuara kriminele (bazuar në analizimin e rrezikut dhe zbulimit të bërë), kapaciteti dhe vullneti i menaxherëve për të zhvilluar strategji paraprijëse për të luftuar krimet e rënda dhe për të vepruar ndaj rasteve të këtyre krimeve.

Edhe pse kjo nuk është e tëra dhe se nuk janë ofruar informacione lidhur me trendët aktuale të krimeve të rënda të regjistruara dhe niveli i zbulimit, të gjeturat paraprake mund të përmbliidhen si në vijim:

Kontrollimi dhe verifikimi i veturave dhe mallrave bazohet në analizën e rrezikut të dalë nga Sistemi për Menaxhimin e Informacioneve Tregtare (TIMS) i cili i nxjerr detyrat për kontrollime nga zyrtarët e angazhuar në degë gjatë deklarimeve doganore. Veturat dhe mallrat që duhet

të verifikohen përzgjidhen në mënyrë automatike nga TIMS, bazuar në analizën e rrezikut, treguesit e rrezikut dhe karakteret e rrezikut. Kategoritë e rrezikut janë: “i lartë” (që kërkon të bëhet verifikim i dokumenteve dhe ai fizik), “i mesëm” (që kërkon verifikim të dokumenteve dhe kontrollim i mundshëm fizik), dhe “i ulët” (që kërkon verifikim të së paku një dokumenti).

Një shqyrtim i tërësishëm mund të jetë i nevojshëm për të kontrolluar gjithë karakteret ekzistuese, procesin e analizimit të rrezikut dhe shfrytëzimi i vetë sistemit TIMS, shembull: kur nuk janë shënuar kapje të ngarkesave apo importuesve në kategori të caktuara të rrezikut dhe nuk ka pasur zbulim të shkeljeve të bëra në doganë apo qarkullim të mallrave ilegale për një kohë të gjatë. Vrojtimit në teren duket se tregojnë se shumë nga masat kontrolluese nuk bëhen në bazë të përzgjedhjes dhe ende nuk është e qartë nëse karakteret janë si rezultat i një vlerësimi të tërësishëm i rrezikut. E njëjta do të vlejë edhe për verifikimin automatik të pasagjerëve të disa nga fluturimet e arritura në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës, përderisa fluturimet tjera në mënyrë sistematike konsiderohen se shfaqin rrezik. Mund të ketë nevojë për të theksuar më shumë aftësimin e punonjësve për vlerësim të veçuar dhe të avancuar.

Brenda drejtorisë për zbatim të ligjit shumica e hulumtimit kryhet në sektorin e inteligjencies dhe në Njësinë për vlerësimin e përmbushjes; megjithatë nuk ekziston ndonjë sistem i veçantë informativ që i dedikohet krimit serioz. Po ashtu, baza e të dhënave e shfrytëzuar në fillim është TIMS, me qasje në bazën e të dhënave për importues, eksportues dhe rrezik përbrenda sistemit.

Edhe pse janë kryer veprime të caktuara, efekti i tyre mund të vlerësohet si fillestar. Duket se kërkohet shumë zhvillim në këtë fushë, meqë Dogana e Kosovës që ka nevojë për bazë të plotë të dhënave që do ti përmbushin nevojat në fushën e zbulimit, pasi ofrimi dhe shfrytëzimi i të dhënave për zbulim të cilat për momentin janë relativisht jo të sofistikuara.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/6/2009

Për qëllim: Drejtoria për Zbatim të Ligjit, Drejtoria për Operimin e të Hyrave Mentorimi dhe këshillimi i Drejtorisë për Zbatim të Ligjit dhe Drejtorisë për Operimin e të Hyrave në Doganën e Kosovës për zhvillimin e komunikimit të brendshëm dhe shkëmbimit të dhënave. Kjo në mënyrë të veçantë i referohet komunikimit dhe shpërndarjes së të dhënave të zbulimit si dhe shkëmbim i të dhënave me qëllim që në mënyrë proaktive të trajtojnë krimin e organizuar dhe për të identifikuar grupe kriminele në shënjestër. Do të duhet të ngrit po ashtu kapacitetin për vlerësimin të avancuar dhe të veçuar të rrezikshmërisë, dhe përzgjedhjes (selektive) të kontrolleve.

- Siç kemi përmendur në pjesët e mëparshme ka referenca të pakta specifike për krim të organizuar në planet operative të Doganës së Kosovës. Megjithatë Drejtoria për zbatim të ligjit ka dëshmuar vullnetin për të zhvilluar strategji të caktuara dhe për të përmirësuar aktivitetet operative që rrjedhin nga zbulimi i sqaruar nga planifikimi për të marrë në shënjestër grupe kriminele të caktuara përmes operacioneve të përbashkëta në kalimet kufitare të gjelbra që përfshijnë Policinë e Kosovës dhe KFOR-i, dhe shfrytëzimi i të dhënave të marra nga portat në Veriun e Kosovës.
- Identifikimi i grupeve kriminele në shënjestër është një detyrë e Sektorit të zbulimit por duket se është jo i sofistikuar në atë fushë. Dogana e Kosovës ka kompetenca të kufizuara për tu marrë me krimin e organizuar dhe ka pak përvojë, si dhe nuk ka plane të caktuara për tu marrë me këtë dukuri.

Caktimi i burimeve për detyra të veçanta më shumë varet nga planet operative se sa nga informacionet e siguruar nga Sektorët e Inteligjencës apo të Matjes së Përmbushjes, prandaj kjo bëhet në formë të reagimit e jo një qasje proaktive.

- Të dhënat rreth zbulimit kryesisht shpërndahen nga sektori i inteligjencës (përmes e-mailit) tek udhëheqësit e degëve të caktuara dhe nga aty i jepen edhe punonjësve të degës sipas nevojës; megjithatë punonjësit në pikat kufitare tregojnë se ata marrin pak informacione nga sektori i inteligjencës. Në anën tjetër përshtypja në Drejtori është se është bërë pak mund nga vendkalimet kufitare për sigurim të inteligjencës. Raportet e Monitoruesve konfirmojnë deri në një masë se zyrtarët dhe mbikëqyrësit nuk e shohin si detyrë të tyre që të mbledhin informacione, vetëm nëse ata marrin informacione apo udhëzime paraprake për këtë. Punonjësit në degë duket se nuk kanë qasje për të azhurnuar informacione në mënyrë të

drejtpërdrejt në bazën e të dhënave dhe nuk e shohin si të duhur nëse informacionet e dërguara në Drejtori që shfrytëzojnë format të caktuar për raportim (shembull, formulari për informacione rreth të dyshuarit) për qëllime të inteligjencës.

Komunikimi, shpërndarja e informacioneve për inteligjencën apo të dhëna të shkëmbyera në mes të drejtorisë për zbatim të ligjit dhe operimit me të hyra duket se është mjaft i kufizuar dhe përmirësimi i komunikimit të brendshëm duhet të shtoj efikasitetin në kontrollet doganore.

Legjislacioni Doganor lidhur me krimin, kryesisht rregullohet me Kodin Doganor dhe të Akcizave, Kodin Penal, dhe Kodin e Procedurës Penale. Një analizë preliminare tregon se nuk ka bazë ligjore për Doganën e Kosovës për të mbledhur, regjistruar dhe zbuluar të dhëna personale lidhur me krimin.

Mbrojtja e të dhënave personale duhet të rregullohet si duhet përndryshe nuk do të jetë e mundshme të shkëmbehen të dhëna me shtete tjera në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe posaçërisht me Shtetet Anëtare të BE-së, pasi që të dhënat personale nga Shtetet Anëtare të BE-së mund ti ofrohen vendeve të treta (sikurse Kosova) nëse ata ofrojnë një nivel të nevojshëm të mbrojtjes.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/7/2009

Për qëllim: Drejtori i Përgjithshëm

Mentorimi dhe këshillimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës së Kosovës për mbrojtjen e mundshme të dhënave brenda Doganës dhe për të zbatuar ligjet e duhura dhe direktivat ligjore me qëllim të rregullimit të shkëmbimit të krimeve lidhur me të dhënat personale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo duhet të përfshijë një vlerësim për mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave dhe dispozitave ligjore të nevojshme për qëllim të shkëmbimit të dhënave sipas marrëveshjeve për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar.

Bashkëpunimi

Bashkëpunimi në mes të agjencive në Kosovë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar është veçanërisht i rëndësishëm për ta luftuar krimin ndërkufitar dhe atë të organizuar. Është kërkuar nga këshilltarët dhe monitoruesit e EULEX-it që të identifikojnë gjendjen e tanishme të mënyrës, strukturës dhe planeve të koordinimit dhe bashkëpunimit të Doganës së Kosovës, përfshirë edhe marrëveshjet me institucionet regjionale dhe ato të Shteteve Anëtare të BE-së.

Vlerësimi paraparak nxjerr në pah se ka pak bashkëpunim për krimin e organizuar me agjenci tjera për zbatimin e ligjit, po ashtu për shkak se Dogana e Kosovës ka pak kompetenca në këtë aspekt. Prokurorët Publik, si dhe Policia e Kosovës deri në një far mase duket se kanë pak apo aspak besim në rolin apo aftësitë e Doganës, kurse i japin pak apo aspak mbështetje apo kompetenca për të hetuar/ndjekur krimin e organizuar. Nuk ka takime të rregullta në mes tyre, por ato janë të organizuara për raste të caktuara; numri i veprimeve të përbashkëta apo të sinkronizuara është i vogël; komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve ditore në nivel lokal (VKK) duket se është i kufizuar. Edhe pse punonjësit në vendkalime vazhdimisht e vlerësojnë se bashkëpunimi në mes të Policisë Kufitare dhe Doganës është i mirë dhe efektiv, gjë që nganjëherë është konfirmuar edhe nga Monitoruesit e EULEX-it, përshtypja është se ka dallime në nivelet e bashkëpunimit. Megjithatë, Monitoruesit kanë parë, po ashtu, mundin e bërë nga Dogana e Kosovës dhe Policia Kufitare për ta përmirësuar bashkëpunimin në terren për shkak të konceptit dhe strategjisë së re të MIK-së, duke e përfshirë edhe metodën “një ndalim - një kontrollim” për ta përmirësuar kështu kontrollin në kufi.

Me qëllim të zhvillimit të kapacitetit brenda Doganës së Kosovës, Drejtoria ligjore ka planifikuar që të themelojë një njësi shtesë, posaçërisht për ndërlidhje dhe bashkëpunim me Prokurorët Publik dhe për të ofruar këshilla ligjore në Doganë lidhur me procedurat që duhet ndjekur para hetimit.

Bashkëpunimi me Prokurorët Publik vlerësohet si çelës për Doganën e Kosovës në arritjen e suksesit në trajtimin e krimin të organizuar në Kosovë. Prokurorët Publik duhet të binden se Dogana ka aftësi që ta hetojë krimin e organizuar dhe në anën tjetër, Dogana e Kosovës duhet të sigurojnë se të gjitha aktivitetet e zbatimit të ligjit dhe të hetuesisë realizohen në mënyrë të konsistente dhe në pajtim me ligjin.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/8/2009

Për qëllim: Drejtoria për zbatimin e ligjit, Drejtoria Ligjore

Mentorimi dhe këshillimi i drejtorisë ligjore dhe asaj për zbatim të ligjit të Doganës së Kosovës për bashkëpunim të rritjen e bashkëpunimit me agjenci tjera për zbatim të ligjit dhe posaçërisht me Prokurorët Publik. Kjo duhet të përfshijë përmirësimin e mundësisë e Doganës për të hetuar krimet e rënda në pajtim me dispozitat ligjore si dhe bashkërendimin e aktiviteteve në kornizën e Strategjisë për Menaxhim të Integruar të Kufijve.

Në muajin maj 2009 Qeveria e Kosovës ka miratuar “Strategjinë Kombëtare për Menaxhim të Integruar të Kufijve”, duke përfshirë Policinë Kufitare, Doganën dhe Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari. Ajo, jo vetëm që e mbulon bashkëpunimin brenda agjencisë, por, përveç marrëveshjeve të mëhershme apo Memorandumeve për Mirëkuptim, krijon bazën për bashkëpunim në mes të agjencive. Drejtoria për operimin e të hyrave ka qenë e përfshirë në

mënyrë aktive në punët përgatitore, kurse Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës do të jetë pjesë e Bordit Ekzekutiv të një strukture koordinuese, e cili do të jetë, mes tjerash, përgjegjës për koordinim me të gjitha administratat shtetërore dhe organet rajonale. Strategjia shoqërohet nga një plan veprimi që e mbulon kornizën ligjore, organizimin dhe menaxhimin, procedurat, burimet njerëzore dhe trajnimi, komunikimi, teknologjia informative, infrastruktura dhe pajisjet që duhet të definojnë më mirë objektivat dhe vendosin prioritete për çdo faktorë.

Kjo, në mënyrë drastike do ta forcojë bashkëpunimin, posaçërisht në mes të Policisë dhe Doganës në vendkalimet kufitare. Në krye të kësaj duhet që, përmes një bashkëpunimi të përmirësuar dhe shkëmbimi të informacioneve, të mundësohen më shumë kontrolle të caktuara dhe selektive. Shpresohet se strategjia e MIK-së do t'i qartësojë mekanizmat dhe përgjegjësitë e kontrollit dhe t'i shpeshtojë kontrollet në kufi me qëllim të ngritjes së një mbrojtjeje efektive të shoqërisë dhe për të parandaluar dhe zbuluar krimin ndër kufitar.

Përkitazi me marrëveshjet ndërkombëtare, aktualisht Dogana e Kosovës ende i ka në fuqi Memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara nga UNMIK-u me Administratën Doganore të IRJM-së, Malit të Zi, Shqipërisë dhe me Administratën Tatimore të Serbisë. Qëllimi është që të shqyrtohen marrëveshjet ekzistuese dhe të arrihen marrëveshje për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë me shërbimet/agjencitë tjera për zbatimin e ligjit të Shteteve të tjera Anëtare të BE-së.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/9/2009

Për qëllim: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja për Operimin e të Hyrave Mentorimi dhe këshillimi i Doganës së Kosovës për zbatimin e Planit të Veprimit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve dhe posaçërisht veprimet nën përgjegjësinë e Doganës. Kjo në veçanti do të përfshijë përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve në degët doganore.

Strategjia Kombëtare e cekur më lartë për Menaxhim të Integruar të Kufijve, në pajtim me Direktivat e Komisionit Evropian për Menaxhim të Integruar të Kufijve në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë evidente përfshin bashkëpunimin ndërkufitar krahas krijimit të planeve të përbashkëta emergjente dhe procedurave të përbashkëta operative të përhershme, të cilat janë shumë të rëndësishme për sa i përket luftimit të krimit ndërkufitar dhe atij të organizuar.

Është me rëndësi të ceket se vendet e tjera (IRJM, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) të cilat kanë përfituar nga asistenca teknike e financuar nga KE lidhur me doganat dhe çështjet tatimore (TACTA) kanë miratuar, po ashtu, Kodin për Union Doganor i cili i shton mundësitë për një bashkëpunim të mirë ndërkombëtar.

Përparësitë dhe Dobësitë

Për sa i përket aspekteve të ndryshme të qëndrueshmërisë, përparësive dhe dobësive të Doganës së Kosovës, mund të përmbliken si në vijim:

Përparësitë

- Ekzistojnë burime njerëzore të duhura, nganjëherë niveli i lejuar i të punësuarve është më i vogël por jo më shumë se 5 %, dhe me disa shenja të demotivimit.
- Ofrohen mundësi për trajnim të organizuara në mënyrë vjetore duke përfshirë trajnim njoftues, avancues, profesional dhe teknik.
- Trajnimi themelor në doganë ofrohet nga trajnuesit e vet përfshirë këtu edhe nga punonjësit me përvojë (zyrtarë të lartë).
- Trajnimi në përgjithësi shihet nga punonjësit si i dobishëm dhe efektiv.
- Në përgjithësi, detyrat duket se kuptohen mirë nga të gjithë punonjësit dhe detyrat komunikohen qartë dhe ofrohet material referues për punonjësit.
- Është krijuar sistemi për vlerësimin e punës dhe ai konsiderohet të jetë i drejtë nga punonjësit e doganës.
- Korniza e Strategjisë Operative thekson se nuk ka ndryshime të mëdha në objektivat e përgjithshme të Doganës së Kosovës.
- Planet Operative ekzistojnë për çdo drejtori dhe formojnë bazën për raportim të brendshëm.
- Kontrolli dhe verifikimi i veturave dhe i mallrave bazohet në analizimin e rrezikut të dalë nga Sistemi për Menaxhimin e Informacioneve Tregtare (TIMS) i cili e përfshin një modul të rrezikshmërisë.
- Ka vullnet nga Udhëheqësit e lartë për të zhvilluar strategji dhe aktivitet operative bazuar në inteligjencë që ka në shënjestër krimet e rënda/të organizua.
- Drejtoria Ligjore do të fuqizohet në vështrim të bashkëpunimit më të mirë me agjenci tjera për zbatim të ligjit dhe posaçërisht me Prokurorët Publik.
- Është miratuar Strategjia e Qeverisë për Menaxhim të Integruar të Kufijve; Dogana e Kosovës në mënyrë aktive ka kontribuar në përgatitjen e tij.
- Ekzistojnë Memorandumet për Mirëkuptim me shumicën e vendeve fqinje, me qëllim të shqyrtimit të tyre gjatë zbatimit të Kodit të ri Doganor dhe të Akcizave.

Dobësitë

- Janë regjistruar ankesa për mungesën e punonjësve në vendkalimet kufitare, megjithatë duket se nuk është bërë vlerësim për këtë nga ana e Doganës.
- Plani i trajnimit nuk është i zgjeruar në shumë fusha të specializuara të zbatimit të ligjit dhe për parandalim (përkitazi me luftimin e krimit të organizuar), dhe se ka mungesë të trajnuesve të specializuar.
- Punonjësit e ri dhe të sapo alternuar nuk njoftohen apo trajnohen sa duhet me të arritur në vendin e ri të punës.
- Në praktikë ka pak përgatitje apo mundësi për punonjësit që vetë ata të tregojnë apo shprehin nevojat e tyre për trajnim.
- Ekziston një rrezik potencial që diskutimi dhe vlerësimi i punës të bëhet një formalitet vjetor.
- Nuk ka të vendosur ndonjë sistem të integruar për menaxhim të burimeve njerëzore i cili përfshinë trajnim dhe zhvillim.
- Niveli i pajisjeve në vendkalimet kufitare dallon; në disa raste hapësirat për bastisje në degë nuk janë në nivel të kënaqshëm për të kryer kontrollet dhe inspektimet doganore në mënyrën e duhur.
- Nëse planet operative kanë nevojë që të miratohen formalisht nga Ministri për Ekonomi dhe Financa ekziston rreziku i ndërhyrjeve politike.
- Planet operative të drejtorive duket se përbëhen nga detyrat rutinë dhe nuk ekziston ndonjë plan operativ i plotë dhe i konsoliduar për Doganën e Kosovës, që i përcakton qartë objektivat që duhen arritur si organizatë.
- Planet operative i referohen shumë pak krimit të organizuar.
- TIMS (Sistemi për Menaxhimin e Informacioneve Tregtare) nuk është i pajisur për sigurimin e informacioneve për krimet e rënda dhe nuk ofrohet ndonjë bazë e të dhënave e cila është përshtatur për nevojat specifike të zbulimit.
- Shkëmbimi në komunikim dhe në zbulim në mes të drejtorive për zbatim të ligjit dhe asaj për operimin e të hyrave është i kufizuar.
- Legjislacioni për Doganën nuk e mbulon apo rregullon sa duhet mbledhjen, regjistrimin dhe paraqitjen e të dhënave personale që lidhen me krimin.
- Bashkëpunimi me agjenci tjera për zbatimin e ligjit në përgjithësi është i kufizuar, edhe pse në nivel lokal është parë se ka më shumë bashkëpunim.
- Shkëmbimi i Informacioneve në mes të Doganës së Kosovës dhe Policisë (Kufitare) të Kosovës nuk është plotë.
- Edhe pse bashkëpunimi rajonal ekziston formalisht, shkëmbimi kryesisht bëhet në formën e shkëmbimit të informacioneve me karakter zyrtar.

Konkluzionet

Punonjësit e Doganës duket se janë të vetëdijshëm për detyrat e tyre, janë mirë të trajnuar dhe rregullisht i nënshtrohen vlerësimit. Megjithatë, në vështrim të sfidave të ardhme të Doganës së Kosovës, ndoshta do të jetë e nevojshme të ketë trajnim në fushat e zbatimit të ligjit.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i trajnimeve duket se nuk janë në pajtim me Planet e BE-së për Dogana.

Infrastruktura dhe pajisjet duhet të përmirësohen në disa lokacione, posaçërisht në pikëpamje të Strategjisë së Qeverisë të Kosovës për Menaxhim të Integruar të Kufijve.

Edhe pse Dogana e Kosovës dëshiron të zhvillojë strategji për të luftuar krimin e organizuar, kjo ende nuk pasqyrohet mjaft mirë në planet operative të saj. Dogana e Kosovës duhet ta vazhdojnë punën në Strategjinë e Qeverisë dhe planin e veprimit (duke u përgatitur) për ta luftuar krimin e organizuar. Funksionet lidhur me krimet e rënda do të duhet të zhvillohen edhe më tej në përputhje me strategjinë e qeverisë që mund të përfshin bazat e të dhënave të sajura sipas nevojave të shërbimit të inteligjencës dhe shkëmbimit aktiv të informacioneve brenda Doganës së Kosovës dhe me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit, posaçërisht me Policinë Kufitare.

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve e miratuar nga Qeveria e Kosovës hap mundësinë e përmirësimit të bashkëpunimit me Policinë Kufitare edhe në vendkalimet kufitare.

LIRIA NGA NDËRHYRJA POLITIKE

Si një institucion i sundimit të ligjit, Dogana e Kosovës duhet t'i përmbahet ligjit dhe t'i shërbejë komunitetit në mënyrë politikisht të paanshme. Edhe pse do të kryejë funksionet e veta në pajtim me politikat e qeverisë, në të njëjtën kohë në vendimmarrje duhet të jetë e lirë nga ndikimet e motivuara politikisht. Ndërhyrja politike është e mundur të bëhet në disa mënyra, p.sh. duke manipuluar me vendime operative apo ndërhyrje në përzgjedhjen e punonjësve dhe vendimet për ngritje në detyrë. Angazhimet e dyfishta të zyrtarëve të Doganës në detyra të përkohshme duhet të monitorohet nga afër.

As Këshilltarët e EULEX-it e as Monitoruesit nuk raportojnë incidente të ndërhyrjeve politike (partiake) në vendimet e marra nga Drejtoria e Doganës së Kosovës (p.sh. lidhur me operimin e të hyrave, fuqizimin, financat, buxhetin, prokurimin apo burimet njerëzore) apo vendimet e punonjësve në vendkalimet kufitare. Duhet pranuar se është mjaft vështirë të zbulohen apo të vështrohen këto lloje të ndërhyrjeve. Disa nga Monitoruesit e Ekipeve Mobile kanë diskutuar

këtë temë dhe pohojnë se zyrtarët e Doganës janë mjaft të matur apo ngurrojnë të raportojnë për (ndonjë) ndërhyrje politike në pikat kufitare nga frika për pasoja të mundshme pasi që janë në pozita ku mund të kenë edhe kërcënime të drejtpërdrejta nga politikanët apo nga udhëheqësit.

Këshilltarët dhe monitoruesit kanë për detyrë që të vlerësojnë nëse punonjësit në Doganën e Kosovës janë duke u përzgjedhur dhe caktuar sipas legjislacionit të aplikueshëm dhe praktikave të mira të vendosura për Shërbimin Civil të Kosovës, se dhe nëse ata janë punësuar dhe graduar bazuar në merita e pa ndërhyrje politike. Që kur Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është shndërruar në Doganë të Kosovës është bërë vetëm një procedurë për punësimin e zyrtarëve Doganor.

Të gjitha të dhënat tregojnë se procesi i përzgjedhjes është i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm. Këshilltarët e EULEX-it në nivel të Drejtorisë së Doganës, përmes intervistave në nivel të udhëheqjes së lartë konfirmojnë se ka nivel të mirë të përputhshmërisë me legjislacionin, rregullat dhe procedurat.

Nuk bëhen punësime të drejtpërdrejta në Drejtorinë për zbatim të ligjit, kurse vendet e lira në shërbimet për hetime, inteligjencë, kundër kontrabandë dhe analizim të rrezikut shpallen përbrenda Doganës së Kosovës. Në këtë mënyrë kandidatët të cilët kanë shërbyer në Drejtoritë tjera - me sa duket shumica e tyre në operimin e të hyrave - identifikohen përmes procesit të trajnimit dhe punës, të përzgjedhur dhe të intervistuar nga një panel i pavarur (i përbërë nga përfaqësues të Sektorëve në Drejtorinë qendrore dhe një Drejtorie të tretë - kryesisht nga operimi me të hyrat). Kjo tregon se edhe për vendet e lira të shpallura përbrenda dhe gradimet, përzgjedhja e punonjësve bazohet në përvojën profesionale, shkathtësitë dhe cilësitë.

Monitoruesit e EULEX-it raportojnë se në nivel të degëve Doganore përzgjedhja dhe procedura e gradimit shihet si e drejtë dhe transparente.

Pasi që në gjashtë muajt e fundit të punës nuk ka pasur ndryshime në pozitat e zyrtarëve të lartë, nuk ka pasur as shpallje të vendeve të lira, nuk kemi mundur të verifikojmë përputhshmërinë me legjislacionin dhe procedurat (dhe mungesën e ndërhyrjes politike) në procesin e caktimit dhe përzgjedhjes për pozitat e nivelit të lartë në Doganën e Kosovës.

Ministria për Ekonomi dhe Financa nuk ka ndonjë departament apo njësi që merret drejtpërdrejt me çështje të doganës e as zyrtar të specializuar për çështje doganore edhe pse ka plane për të caktuar një zyrtarë përgjegjës për marrëdhënie me Doganën e Kosovës.

Ekziston hapësirë për MMK të intensifikuar në këtë çështje pasi punonjësit e Doganës së Kosovës përmes këtyre emërimeve mund ta anashkalojnë zinxhirin komandues dhe strukturën organizative. Duke marrë një rol politik sipas prioritetëve të Ministrit, ata mund të

vijnë në pozita që të ndikohen nga ndërhyrjet politike gjatë trajtimit të çështjeve të natyrës ligjore.

Janë paraqitur brenga lidhur me anëtarët e ri në Bordin e Pavarur Shqyrtues që do të caktohen nga Qeveria. Procesi i caktimit duhet të përjashtojë vlerësimet politike dhe të bazohet në përvojën profesionale të kandidatëve, p.sh. përvojë të gjerë lidhur me doganën dhe çështjet e tatimit përfshirë njohuri të mirë për legjislacionin dhe procedurat doganore. EULEX-i dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë funksionimit të këtij Bordi.

Konkluzionet

Përmes monitorimit të këshilltarëve dhe monitoruesve, edhe pse të kufizuar në shtrirje, përzgjedhja dhe gradimi i punonjësve në Doganë duket se bëhet në mënyrë transparente, të drejtë dhe duke i respektuar procedurat, si dhe në mënyrë të lirë nga ndërhyrjet politike.

Nuk janë regjistruar incidente të ndërhyrjeve politike (partiake) në vendimet e Drejtorisë së Doganës së Kosovës apo vendimeve të punonjësve në vendkalimet kufitare.

Sidoqoftë mundësitë për një ndërhyrje të mundshme janë shtuar, p.sh. Punonjësit e Doganës me detyra të caktuara në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe përmes përbërjes së Bordit të Pavarur Shqyrtues.

SHUMË-ETNICITETI / TË DREJTAT E NJERIUT / ÇËSHTJET GJINORE

Përderisa shumë-etniciteti i institucioneve për sundimin e ligjit është një qëllim i përgjithshëm i misionit të EULEX-it, siç pasqyrohet në mandatin e tij, respektimi i standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështjeve gjinore i përket në mënyrë eksplicite objektivave strategjik të tij. Prandaj, këshilltarët dhe monitoruesit kanë pasur për detyrë në fillim që të vlerësojnë nëse veprimet e tyre respektojnë të drejtat e njeriut dhe nëse janë të udhëhequra në mënyrë jo-diskriminuese (siç pasqyrohet në Kodin e Mirësjelljes), si dhe deri në çfarë niveli përfaqësohen bashkësitë minoritare dhe femrat në Doganën e Kosovës.

Dogana e Kosovës tani ka një Kod të Mirësjelljes, i cili bazohet në rekomandimet e dhëna nga Organizata Botërore e Doganave nga viti 2003 Deklarata Arusha e rishikuar lidhur me integritetin në Doganë e cila i pasqyron standardet etike dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Organizata është duke përgatitur një Kod të ri të Mirësjelljes, i cili do të jetë së paku i një standardi të njëjtë. Janë krijuar disa mekanizma me qëllim të sigurimit të respektimit të Kodit të Mirësjelljes, p.sh. të

gjithë zyrtarët do të kenë nga një kopje të Kodit; është vendosur edhe monitorimi nga eprorët përgjegjës; mundësia për tu ankuar rreth shkeljeve të mundshme të Kodit (përfshirë edhe kutitë e mbyllura në zyrat e doganave). Zyrtarët e Doganës në pikat kufitare kanë nevojë të veprojnë sipas legjislacionit të zbatueshëm, posaçërisht gjatë procedurave të kontrollit; nëse një person ka nevojë ti nënshtrohet një kontrolli të plotë, p.sh. “kontrolle për siguri” dhe “kontrollime personale” kërkojnë angazhimin e zyrtarit të gjinisë së njëjtë sikurse personi i cili kontrollohet. Në rast të një “kontrollimi trupor”, ky kontrollim duhet të kryhet nga personi i autorizuar (mjeku). Sidoqoftë, në praktikë, obligimet dhe të drejtat e zyrtarëve të Doganës nuk janë gjithmonë të qarta: disa raporte të Monitoruesve tregojnë se Procedurat Standarde të Operimit apo udhëzimet në rast të kontrollimit trupor nuk janë gjithmonë të ditura apo të ofruara në VKK.

Lidhur me larminë etnike dhe gjinore në Doganën e Kosovës, aktualisht nuk ka fushata (mediale) të posaçme për të tërhequr kandidatë femra apo ata që vijnë nga komunitete jo-shumicë, e as për promovimin e Doganës së Kosovës si një punëdhënëse që siguron përfaqësim të barabartë gjinor dhe respekton aspektin e shumë-kombësisë. Edhe pse nuk ka veprime eksplicite (proaktive) të ndërmarra, shpalljet për vende të lira tregojnë qartë se kandidatët femra dhe ata nga komunitetet minoritare janë të inkurajuar fuqimisht që të konkurrojnë.

Nga mesi i muajit maj, Dogana e Kosovës kanë pasur 131 punonjës femra dhe 426 meshkuj, në këtë mënyrë femrat llogaritet se përfaqësohen me 23,5% të pozitave brenda shërbimit. Përveç zyrtarëve të Doganës me gradën më të ulët (G4) të cilët llogariten se janë 13 në përgjithësi, femrat janë të nën-përfaqësuara në të gjithë nivelet. Është një drejtor femër nga 6 pozitat në nivelin e udhëheqjes së lartë (G20 - Drejtori i Përgjithshëm dhe G10 - Drejtorët); Në nivelin e udhëheqjes së mesme është një femër që është udhëheqëse e Departamentit (G9), 10 pozita dhe 9 femra si udhëheqëse të Njësive (G8), 33 pozita (21%, edhe pse të gjithë udhëheqësit e G8 të pikave operative janë meshkuj). Femrat llogariten se përbëjnë 21%-23% të numrit të punonjësve në nivelet: Udhëheqës të ndërrimit (G7), Zyrtar të Lartë Doganor (G6) dhe Zyrtar Doganor (G5).

Drejtoria për operimin e të hyrave nën përgjegjësinë e saj ka pika operative kufitare dhe të brendshme dhe në këtë mënyrë ka numrin më të madh të zyrtarëve doganor; përderisa drejtoria e dytë më e madhe është duke punësuar më shumë nga radhët e brendshme (për zbatim të ligjit) ku shumica e punonjësve do të fillojnë të punojnë në operimin e të hyrave. Njëra nga arsyet për pabarazinë gjinore në këtë punë mund të jenë kushtet më të rënda të punës në këto pika që ndikon në numrin e fermave që konkurrojnë.

Në muajin mars 2009 numri i përgjithshëm i punonjësve në Doganën e Kosovës ka qenë 555, me këtë përbërje etnike: 490 shqiptarë apo (88,3%), 31 serbë apo (5,6%), 14 boshnjakë apo (2,5%), 14 turq apo (2,5%), 3 goranë apo (0,5%) dhe 3 të tjerë (romë... 0,5%). Asnjëra nga grupet

minoritare nuk mban pozitë më të lartë se Udhëheqës i ndërrimit (G7), kështu që nuk janë të përfaqësuar në udhëheqjen e lartë apo të mesme, përfshirë udhëheqësit e pikave (operative) Doganore.

Sipas raportit vjetor të Doganës së Kosovës për vitin 2008, 46 zyrtarë nga komuniteti serb kanë lëshuar punën (shërbimin), por gjithashtu janë punësuar edhe 16 zyrtarë të ri serbë. Mos balancimi në pozitat e larta mund ti atribuohet këtyre ndryshimeve pasi zyrtarët me përvojë janë larguar, kurse zyrtarët e rinj janë punësuar në poste më të ulëta. Nuk janë vërejtur shenja se komunitetet jo-shumicë janë përjashtuar apo parandaluar nga ngritja në detyrë, sikundër që nuk është vërejtur diskriminimi pozitiv.

Konkluzionet

Dogana e Kosovës ka një Kod të Mirësjelljes, i cili i pasqyron standardet etike dhe respekton të drejtat e njeriut dhe ka mekanizma të vendosur me qëllim për të siguruar respektimin e tij; megjithatë procedurat operative nuk duket se janë kuptuar apo zbatuar mirë. Kandidatët femra dhe komunitetet minoritare - sipas vendeve të lira të punës - janë të inkurajuar për të aplikuar. Rreth 12% e punonjësve i përkasin komuniteteve etnike minoritare, por nuk përfaqësohen në funksionet udhëheqëse. Punonjësit e gjinisë femërore paraqesin 23,5 % të punëtorëve në Doganë, por në përgjithësi janë më pak të përfaqësuar në pozitat menaxhuese.

REKOMANDIM I EULEX-it - CC/10/2009

Për qëllim: Drejtori i Përgjithshëm

Për të mentoruar dhe këshilluar Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës për rregulla (politika) me qëllim të rritjes së përfaqësimit të komuniteteve etnike jo-shumicë në nivel të udhëheqjes dhe për të lehtësuar realizimin e një përfaqësimi me barazi gjinor në pozitat udhëheqëse. Kjo po ashtu, mund të përfshijë edhe mundin e bërë për ta shtuar numrin e të punësuarve nga radhët e minoriteteve dhe femrave, si dhe mbështetjen e tyre në zhvillimin e karrierës së tyre.

SHOQËRIA CIVILE

METODOLOGJIA

Kjo pjesë do ta ilustrojë gjendjen aktuale në shoqërinë civile kundrejt synimeve të misionit të EULEX-it. Arsyet për krijimin e kontakteve dhe analizimin e shoqërisë civile janë theksuar mjaft qartë në Qasjen Programore të EULEX-it, e cila ka për qëllim ta rris pronësinë vendore mbi proceset përmes shtimit të lidërshiptit vendor dhe pjesëmarrjen e gjerë të shoqërisë civile.

Brenda kësaj kornize, që nga muaji janar 2009, Misioni ka ndërmarrë një sërë aktivitete për ta shtuar vetëdijen për rolin e tij në mes të palëve të ndryshme me interes nga shoqëria civile dhe në të njëjtën kohë, duke vazhduar zhvillimin mbi të arriturat e mëparshme të EUPT-së për ti planifikuar partnerët e mundshëm në aktivitetet e ardhme.

Është me rëndësi që shkurtimisht të jepet një përmbledhje e veprimeve të realizuara deri më tani me qëllim të paraqitjes së metodologjisë si pjesë kryesore e paragrafëve në vijim. Të gjeturat e mbledhura më poshtë nuk dalin nga Sistemi Informativ i EULEX-it, pra jo sikur pjesa tjetër e këtij raporti. Me fjalë tjera, ato nuk kanë të bëjnë me të dhënat e monitoruesve të EULEX-it në tre komponentët tjerë, por bazohen në një sërë burimesh direkt të cilat hollësisht do të përshkruhen më poshtë.

Vëllimi i punës gjatë gjashtë muajve të fundit ka trajtuar përmbushjen e katër rezultateve kryesore:

1. Prodhimi i pakove njoftuese për mandatin e misionit të EULEX-it, objektivat dhe aktivitetet monitoruese të ofruara për OSHC/OJQ-të që janë të angazhuara në fushën e Sundimit të Ligjit.
2. Janë përcaktuar OSHC/OJQ-të përkatëse që kanë të bëjnë me aktivitetet monitoruese të EULEX-it.
3. Zhvillimi i mënyrave për përpunimin e rregullt të informacioneve nga OSHC/OJQ-të.
4. Dialogu i qëndrueshëm në mes të EULEX-it dhe OSHC/OJQ-ve i sinkronizuar me ciklin programor të aktiviteteve monitoruese.

Këto rezultate kërkojnë një sërë aktivitete të krijuar gjatë periudhës gjegjëse, të cilat mundësojnë zbulimin e të dhënave dhe nxjerrjen e konkluzioneve të paraqitura në këtë raport. Zyra për Programe e EULEX-it deri më tani ka arritur që të:

- prodhojë 60 pako informative për synimet dhe aktivitetet monitoruese të EULEX-it.
- krijojë një bazë të dhënave që përmban referenca për 63 OSHC/OJQ që kanë të bëjnë me objektivat e EULEX-it.
- mbajë 18 takime me homologët e tyre nga shoqëria civile.
- merr pjesë në 4 takime në terren me komunitetin serb të Kosovës.
- merr pjesë në një seminar tre-ditor me 23 anëtarë të shoqërisë civile serbe dhe të serbëve të Kosovës.
- organizojë një seminar njoftues në të cilin kanë marrë pjesë 39 OSHC/OJQ.
- mbledh rreth 21 raporte për çështje të sundimit të ligjit të prodhuara nga OSHC/OJQ-të vendore në vitin 2007 dhe 2009
- mbledh 6 formularë për vlerësimin e Qasjes Programore të EULEX-it të plotësuar nga OSHC/OJQ-të vendore.

Të gjitha veprimet janë përmbyllur për të arritur synimin e dyfishtë: informimin e shoqërisë civile për rolin e EULEX-it dhe realizimin e aktiviteteve për monitorim, mentorim dhe këshillim; dhe marrjen e informacioneve për një partneritet të mundshëm me palën vendore. Veç kësaj, misioni ka siguruar një përfytyrim të detajuar të shoqërisë civile në Kosovë duke ju referuar çështjeve të sundimit të ligjit dhe krijimit së kontakteve të dobishme me organizatat joqeveritare të angazhuara me detyra hetuese dhe monitoruese në institucionet publike.

Raporti do t'i përmbahet këtij formati për pjesët që kanë të bëjnë me tre komponentët e EULEX-it: qëllimi i tij është paraqitja e komenteve të marra nga shoqëria civile lidhur me synimet e misionit. Për arsye që lidhen me natyrën e shoqërisë civile në Kosovë, disa pjesë janë më të plota se tjerat, kurse disa janë inkorporuar me të tjerat apo bashkërenduar si duhet. Për këtë shkak, është mirë të ofrohet një përshkrim konciz për shoqërinë civile në Kosovë para paraqitjes së të gjeturave që kanë të bëjnë me interesin e EULEX-it.

SHOQRIA CIVILE NË KOSOVË

Në Kosovë ka një numër të madh të organizatave joqeveritare: regjistri i Ministrisë për Shërbime Publike (MSHP) ka të regjistruara 4952 organizata të evidentuara në arkivin e saj deri në fund të muajit janar 2009, me një mesatare prej 20 aplikuesve të ri për çdo javë. Këto shifra duket të jenë

të pakrahasueshëm me shumë vende të BE-së dhe kërkojnë informacione shtesë me qëllim që të kuptohen si duhet.

Së pari, kërkesa për të paraqitur një organizatë në Departamentin e MSHP për regjistrim dhe ndërlidhje OSHC/OJQ është e thjeshtë, dhe rrallëherë ndodh që të ndonjë aplikues refuzohet. Ligji për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare 2009 (neni. 61-2-3) kërkon nga aplikuesit vendor që ta paraqesin “aktin themelues” që i përmban emrat dhe adresat e organizatës dhe themeluesve të saj së bashku me statutin ku paraqiten qëllimet dhe procedurat e brendshme; kjo nuk duket se i dekurajon qytetarët për të themeluar një organizatë jo-qeveritare dhe ta regjistrojnë në regjistër, ku përfshihen edhe “çdo OJQ e regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/22” (po aty, neni. 26).

Së dyti, një stimulim për të themeluar një OSHC/OJQ e jep edhe statusi i përfituesit publik që i jepet organizatave që kryejnë punë humanitare. Organizatat që gëzojnë këtë statusi janë të lira nga të gjitha obligimet fiskale, përveç nga pagesat për shërbimet publike komunale. Struktura e tanishme e Departamentit për regjistrim dhe ndërlidhje me OSHC/OJQ, ku punojnë 11 punonjës (gjysma e të cilëve punon në analizimin financiar) mund të mos jenë të mjaftueshëm për verifikimin e të gjitha OSHC/OJQ-ve dhe zbulimin e keqpërdorimeve të mundshme të statusit të përfituesit publik. Drejtori i Departamentit i ka thënë përfaqësuesve të EULEX-it se ekipi i tij mund të monitorojë OSHC/OJQ-të me një buxhet të caktuar (mbi 100.000 euro për ato ndërkombëtare dhe mbi 50.000 euro për ato vendore).

Arsyet tjera për numrin e madh të OSHC/OJQ-ve të regjistruara lidhet me kornizën momentale ligjore e cila rregullon çështjen e shoqërisë civile në Kosovë: çfarëdo iniciative e përbashkët e papërfshirë në sektorin publik apo privat njihet si OJQ; regjistri i MSHP-së përfshin shoqata si klubet sportive për afërsisht 350) apo shoqëritë kulturore.

Raporti për vitin 2008 nga Qendra Kosovare për Burime dhe Trajnime për Avokim (ATRC) vlerëson se ekzistojnë rreth 500 OSHC/OJQ aktive. Varësia nga ndihma e jashtme (një burim i të ardhurave i cili është zvogëluar viteve të fundit) dhe kapacitetet e dobëta organizative janë thelbi i plogështisë së shumë OSHC/OJQ-ve.

Qëndrueshmëria financiare është një çështje serioze për shumë organizata, pjesërisht për shkak se shumë OSHC/OJQ ende nuk kanë zhvilluar në mënyrë të suksesshme përbërje të fuqishme siç theksohet nga USAID 2007 - treguesi për qëndrueshmëri të OJQ-ve. Marrëdhëniet në mes të shoqërisë civile dhe opinionit të gjerë publik janë të ndërlikuara dhe të ndikuara nga ndjenjat e përziera në mes të qytetarëve. Përderisa disa OSHC/OJQ (posaçërisht ato që merren me

aktivitetet mbikëqyrëse dhe kundër korrupsionit) kanë një përfshirje të gjerë mediale dhe gëzojnë një reputacion në përgjithësi pozitiv; transparenca dhe llogari dhënia e shoqërisë civile jo gjithmonë shihen si vlera të padiskutueshme.

Disa nga bashkëbiseduesit kanë diskutuar për këtë raport dhe kanë pranuar se një numër i konsiderueshëm i OSHC/OJQ-ve të nxitura nga agjendat e huaja (të ndikuar nga faktorë politik vendor apo të huaj) se sa nga vlerësimi objektiv i nevojave të komuniteteve. Një arsye tjetër për rëndësinë e vogël të shoqërisë civile në Kosovë është shkak i ndarjes së saj, prandaj edhe i mungesës së “racionalizimit”: OSHC/OJQ-të e themeluara si “spin-off”-e të organizatave të mëdha e që kanë anëtarësi të vogël janë të shumta, kurse efikasiteti i tyre është i diskutueshëm. Trendi aktual në themelimin e rrjetave apo platformave të OSHC/OJQ-ve është një zgjidhje për këtë problem dhe do të krijohet në të ardhmen, për shembull duke hyrë në partneritet me platformat e OSHC/OJQ-ve e jo me organizata individuale.

Marrëdhëniet ndëretnike brenda shoqërisë civile kanë shënuar disa rezultate pozitive sipas Ministrisë për Shërbime Publike që i referohet 185 OSHC/OJQ-ve të regjistruara me një anëtarësim shumë-etnik dhe 546 OSHC/OJQ që i atribuohen komunitetit serb të Kosovës (përfshirë disa të themeluara në pjesën veriore të Kosovës). Megjithatë, marrëdhëniet në mes të grupeve etnike përmes shoqërisë civile vazhdojnë të jenë sporadike; Raporti i Progresit i BE-së për vitin 2008 për Kosovën thekson se “organizatat e shoqërisë civile janë ekskluzivisht etnike dhe se vazhdohet të mos ketë bashkëpunim në mes të OSHC/OJQ-ve të ndara në baza etnike në Kosovë”.

Marrëdhëniet në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile në çështjet që lidhen me Mandatin e EULEX-it do të përshkruhen në paragrafët në vijim; në mes tjerash është bërë edhe mund nga të dyja palët për një rregullim efektiv për bërjen e politikave edhe pse rezultatet jo gjithmonë janë lehtë për tu vlerësuar. Në muajt e fundit niveli i bashkëpunimit është treguar nga dy ngjarje të natyrës së kundërt: e para ka të bëjë me miratimin e Ligjit të cekur më lart, Ligji për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare (No. 03/L-134) i cili e ka zëvendësuar Rregulloren e kaluar të UNMIK-ut 1999/22. Ligji mund të shprehet si rezultat i angazhimit të OSHC/OJQ në proces të diskutimeve të cilat kanë sjell ndryshime në projekt ligjin e propozuar sikurse largimin e dispozitës me të cilën i jepet të drejtë Departamentit të MSHP për regjistrim dhe ndërlidhje me OJQ-të për të monitoruar aktivitetet e OJQ-ve. Janë bërë konsultime të ngjashme në raste tjera, për shembull me nënshkrimin e Memorandumit për Bashkëpunim me 2008 në mes të Qeverisë dhe CiviKos - një platformë që mbledhë 200 OSHC/OJQ vendore - për qëllim të strukturimit të dialogut të vazhdueshëm për çështjet e politikë bërjes.

Në anën tjetër, dallimi në mes të Qeverisë dhe deklarimeve të katër organizatave (Çohu, Fol 08, INPO dhe KDI) të dala në muajin shkurt 2009 kur Plani për Veprim kundër Korrupsionit është dhënë për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, ku nga organizatat e cekura më lartë (anëtarë të grupeve punuese për hartimin e Planit për Veprim) është vlerësuar se përmban mangësi thelbësore dhe nuk është i duhur për arritjen e objektivave. Deri më tani, Qeveria ende nuk ka parashtruar një version të ndryshuar të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit për Veprim në Kuvendin e Kosovës dhe nuk është e sigurt nëse rekomandimet e dhëna nga OJQ-të e cekura do të merren në konsideratë me rastin e miratimit të tij. Në anën tjetër, Ligji kundër Korrupsionit është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në leximin e parë me 10 korrik 2009. Luftimi i korrupsionit qëndron si prioritet kryesor për të gjitha organizatat e konsultuara gjatë hartimit të këtij raporti dhe mbetet një fushë e mospajtimeve të shpeshta në mes të shoqërisë civile të Kosovës dhe autoriteteve vendore.

Një thënie e fundit për të definuar më mirë kontekstin që lidhet me shoqërinë civile ku kërkohet veprimi i EULEX-it ka të bëjë me perceptimit të Misionit nga shoqëria civile e Kosovës në gjashtë muajt e fundit. Vërejtjet në vijim janë ripërsëritur pothuaj në të gjitha takimet e mbajtura deri më sot:

a) Mos vazhdimësia nga misioni i UNMIK-ut në EULEX: OSHC/OJQ-të janë në përgjithësi të vetëdijshëm rreth dallimeve në mes të mandateve të UNMIK-ut dhe EULEX-it, dhe e çmojnë dëshirën e Misionit për të punuar ngushtë me to.

b) Prioriteti: lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: gati të gjithë bashkëbiseduesit - posaçërisht shqiptarët - deri më tani kanë theksuar luftën kundër korrupsionit si prioritetin e parë për EULEX-in. Një numër i OSHC/OJQ-ve kanë filluar të dyshojnë në autoritetet vendore për nivelin e lartë të korrupsionit, por situata ende konsiderohet si e papranueshme. Ballafaqimi me korrupsion dhe krimin e organizuar duket të jetë më urgjente se sa për tu marrë me krimet e luftës dhe pajtimin ndëretnik.

Shumica nga OSHC/OJQ-të e konsultuara kanë parë si urgjente nevojën për të pasur një mision për sundimin e ligjit në Kosovë dhe e shohin si të nevojshme praninë e EULEX-it. Shoqëria Civile në Kosovë është shumë e interesuar në mbikëqyrjen e autoriteteve publike duke pasur prioritet të ngjashme me ato të theksuara në nenin 2 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të Evropës 2008/124/CFSP. Megjithatë OSHC/OJQ-të vendore kanë preferencë brenda detyrave të caktuara që ka EULEX-i; është me rëndësi që të caktohet çdonjëra me qëllim të zbulimit se cilat fusha mund të prodhojnë bashkëpunim të frytshëm në mes të zyrtarëve të angazhuar në aktivitetet (MMK) të EULEX-it dhe organizatave jo-qeveritare në Kosovë.

QËNDRUESHMËRIA

Qëndrueshmëria e institucioneve publike relativisht të reja sikurse Gjyqësia e Kosovës, Policia dhe Dogana është një koncept i pikëpamjeve të ndryshme. Një lidhje e menjëhershme do të çojë drejtë bazave financiare të këtyre organeve publike, pas një vlerësimi të kapacitetit të tyre për të bartur burimet të nevojshme me rezultate të dëshiruara. Shoqëria Civile në Kosovë përmban relativisht një numër të kufizuar të grupeve të ekspertëve (“think tanks”) të afta për të realizuar hulumtime të thella teknike në fushën e lartcekur. Megjithatë, ngritja në kapacitetin analitik të disa organizatave jo-qeveritare është bërë bazë për analiza dhe raporte (posaçërisht në fushën e gjyqësisë dhe policisë) të cilat ofrojnë sugjerime interesante për një udhëheqje efikase të autoriteteve për sundimin e ligjit.

Një vërejtje e përsëritur për qëndrueshmërinë e institucioneve publike, përfshirë edhe tri të mbështetura nga EULEX-i, i referohet pagave: Instituti për Studime të Avancuara (GAP) tërheq një paralele ndërmjet dy vendimeve të fundit të marra nga qeveria të hyra në fuqi më 1 janar 2009: 10% e rritjes së pagave mujore të nëpunësve civilë dhe rritja mujore e pensioneve dhe ndihmave sociale nga 5 Euro. Mbetet të vlerësohet se çfarë ndikimi kanë këto vendime në stabilitetin shoqëror në Kosovë, edhe pse pagat e zyrtarëve publik, posaçërisht të gjykatësve dhe prokurorëve konsiderohen një pikë kyçe për efikasitetin e sistemit të sundimit të ligjit në Kosovë. FIQ - Forumi për Iniciativa Qytetare thekson se “pagat e ulëta për gjykatësit mund ti shtyjë njerëzit të mos angazhohen në këtë profesion”. Pagat e ulëta të gjykatësve shihen si nxitja kryesore për dukurinë e korrupsionit në gjyqësi, kurse kur kombinohet kjo me lëndët e shumta të grumbulluara atëherë shihen shembuj të shpeshtë të njerëzve që paguajnë ashtu që lëndët e tyre të shqyrtohen më herët”. Pagat e larta të gjykatësve ndërkombëtar nxisin debate në mesin e shoqërisë civile, ku disa palë me interes besojnë se kjo e parandalon korrupsionin dhe prandaj konsiderohet si pozitive, ndërsa të tjerët argumentojnë se dallimi në paga është një shembull tjetër të standardeve të dyfishta. Sipas FIQ, niveli i mbrojtjes personale të “gjykatësve ndërkombëtar të cilët kanë truproja” shihet si diçka që e “zvogëlon korrupsionin dhe dëshmon se sa të pasigurt mund të ndihen gjykatësit në punën e tyre të përditshme”.

Qëndrueshmëria e institucioneve për sundimin e ligjit në Kosovë gjithashtu varet nga aftësia e OSHC/OJQ-ve për ta monitoruar performancën e këtyre institucioneve. Së këndejmi, janë duke u shtuar analizat dhe hulumtimet, sikurse edhe vetëdijesimi i shoqërisë civile për rolin që e ka në përmirësimin e shërbimeve publike. Vështirësitë për qasje në organet publike të Kosovës – sikurse edhe mangësitë e shkaktuara nga mungesa e transparencës – do të shqyrtohen në kapitullin që flet mbi llogaridhënien; në fokus të këtij paragrafi do të jetë shqyrtimi i kapaciteteve

monitoruese të OSHC/OJQ-ve në dy fusha, të cilat janë të vendimtare për aktivitetet e MMK të EULEX-it: shërbimet korrektuese dhe monitorimi i gjykimeve. E para ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm në mesin e shoqërisë civile, ndërsa kjo e fundit deri më tani nuk ka qenë në fokus të misionit të OSHC/OJQ-ve. Analizimi i përparësive dhe mangësive të performancës së mbikëqyrjes nga OSHC/OJQ-ve të Kosovës përmes këtyre dy shembujve konkret do të mundësoj të kuptuarit më të mirë të çështjeve në fjalë dhe të sugjeroj mënyra për përkushtimet e ardhshme të përbashkëta ndërmjet EULEX-it dhe organizatave joqeveritare.

Shërbimet korrektuese

Janë të lidhura ngushtë me standardet për të drejtat e njeriut, kurse kushtet e të burgosurve në Kosovë kanë ngjallur interesimin e shumë OSHC/OJQ-ve dhe – në disa raste - ka shkaktuar edhe fërkime ndërmjet autoriteteve dhe monitoruesve të pavarur. Raportet e OSHC/OJQ-ve vendore tregojnë për shkathtësi të dukshme të monitorimit të shërbimit korrektues, si për nga metodologjitë e aplikuara, ashtu edhe për nga cilësia dhe sasia e të dhënave të mbledhura. Vizitat nëpër qendrat korrektuese dhe të paraburgimit në gjithë Kosovën ishin bërë të mundshme falë bashkëpunimit me Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), që është shenjë premtuese për pronësinë e paraparë vendore të aktiviteteve të MMK-së. Mirëpo, partneriteti ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve publike nuk duhet të kufizohet vetëm me fazën e monitorimit, por të zgjerohet duke përfshirë edhe realizimin e rekomandimeve të përbashkëta.

Është bërë vlerësimi i tre dokumenteve me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të OSHC/OJQ-ve për monitorimin e shërbimit korrektues: Raporti i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ, 2009) dhe dy hulumtime të bëra nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturuara (QKRVT), të publikuara në vitin 2009 (për hollësi shih referencat). Të dyja organizatat tregojnë njohuri të qëndrueshme të bazës ligjore relevante të nivelit vendor dhe atij ndërkombëtar: monitoruesit i kanë strukturuar hulumtimet e tyre sipas standardeve të cilat burojnë nga dokumentet si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (KKT) dhe Rregullorja Nr. 2004/46, e UNMIK-ut mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Këto dokumente janë shqyrtuar në hollësi dhe kanë shërbyer si standarde sipas të cilave është bërë vlerësimi i kushteve; Në të gjitha rastet, hulumtimet janë kryer në gjithë Kosovën me anë të vizitave periodike që ishin bërë nëpër qendrat korrektuese dhe qendrat e paraburgimit (për kryerjen e këtyre studimeve u nevojitën gjashtë deri në nëntë muaj), intervistat kishin në fokus të burgosurit dhe pjesëtarët e shërbimit korrektues, ndërsa çështjet e trajtuara ishin kategorizuar në mënyrë të duhur dhe ishin paraqitur nëpër raporte.

Në këto gjetje janë përfshirë: kushtet higjienike, ofrimi i shërbimeve mjekësore, qasja në informacion, arsimimi, puna dhe koha e lirë, kontaktet me vizitorë të jashtëm, paraqitja e ankesave; grupet e synuara si, të miturit, të huajt, të burgosurit e izoluar në vetmi dhe gratë ishin në theks të veçantë dhe pa ndonjë çudi rekomandimet ishin të ngjashme: të dyja organizatat u sugjerojnë autoriteteve që të merren në mënyrë më efektive me çështjen e stërngarkimit nëpër burgjet e Kosovës dhe t'i përmirësojnë kushtet e punës për pjesëtarët e SHKK; për më tepër, monitorët e jashtëm dëshirojnë që të kenë një qasje më të thellë në shërbimet korrektuese në Kosovë, pavarësisht nga përkrahja të cilën ata e gëzojnë prej autoriteteve (për çfarë edhe janë lavdëruar nga të dyja organizatat), monitoruesit nga shoqëria civile kanë pranuar se nuk kanë qenë në gjendje që të bëjnë verifikimin e keqtrajtimit të deklaruara të burgosurve, duke i raportuar kështu vetëm në mënyrë të tërthortë burimet e shumta për abuzime të kryera në shërbimet korrektuese.

QKRMT deklarohet të jetë “e shqetësuar për seriozitetin e disa keqtrajtimit që pohohet se janë kryer nga pjesëtarët e stafit të SHKK-së në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Sipas këtyre pohimeve, pjesëtarë të maskuar të SHKK-së, që njihen si “Njësia Delta Bravo”/Njësia Speciale për Intervenim, e cila gjatë natës ose pas ndonjë incidenti hyn nëpër çeli dhe i keqtrajton të burgosurit fizikisht dhe verbalisht”. Ngjashëm, KMLDNJ raporton se “pohimet për ushtrim dhune kundër personave të privuar nga liria nuk janë krejtësisht të pavërteta. Monitoruesit e KMLDNJ-së kanë arritur t'i konfirmojnë pohimet përmes të cilave deklarohet përdorimi i forcës kundër personave të cilët mbahen nën arrest në këto objekte. Në Burgun e Dubravës, përdorimi i forcës lidhet me njësinë intervenuese “Delta Bravo”. Këto intervenime kryesisht bëhen gjatë natës ose pas incidenteve, d.m.th. kjo është njësi për situata emergjente.”

Mundësia që monitoruesit e jashtëm të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informacion për rastet e keqtrajtimit – duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga të burgosurit – paraqet një rëndësi të madhe për përmirësimin e inspektimit të burgjeve nga OSHC/OJQ-ve; për shembull, KMLDNJ i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionerit të Shërbimit Korrektues që të përfshijnë edhe OSHC/OJQ-ve në komisionet për shpërblimin e të burgosurve. Një shqetësim i ngjashëm është shprehur edhe nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), i cili raporton për një mosbesim të evidentuar gjatë sondazhit të kryer mbi përdorimin e dorëzimit në Kosovë, e cila do të “mundësonte që personi i akuzuar të ikë nga vendi, të blejë dëshmitarët ose të manipulojë me ta dhe të shkaktojë zhdukjen e provave.”

Monitorimi i gjykimeve

Nëse shoqëria civile paraqet një burim të sigurt për EULEX-in për vlerësimin e shërbimeve korrektuese në Kosovë, monitorimi i gjykimeve nga OSHC/OJQ-të deri më tani nuk ka dhënë ndonjë rezultat të tillë në këtë drejtim. Monitorimi i gjykimeve bëhet vetëm nga disa OSHC/OJQ dhe zakonisht i referohet rasteve specifike që janë me interes për mandatin e OJQ-së së interesuar. Kjo mund të mos kuptohet lehtë, veçanërisht kur merret parasysht vëmendja që i kushtohet shërbimeve korrektuese dhe raportit ndërmjet procedurave gjyqësore dhe ekzekutimit të dënimit.

Një vështrim më i afërt në iniciativën e shoqërisë civile gjatë monitorimit të gjykatave, megjithatë mundëson vërejtjen e disa pengesave, të cilat aktualisht u pengojnë OSHC/OJQ-ve që në mënyrë efikase t'u ndihmojnë monitoruesve ndërkombëtarë në monitorimin e procedurave gjyqësore. Vërejtja e parë ka të bëjë me kapacitetet: OSHC/OJQ-të e përfshira në përcjelljen e gjykimeve ankohen për mungesën e burimeve njerëzore për të vendosur një monitorim sistematik të gjykatave; për sa i përket këtij këndvështrimi fragmentimi i OSHC/OJQ-ve nuk duhet të shihet si diçka pozitive. Kjo nuk është vetëm çështje e kuantitetit: stafi i përkushtuar për monitorim të gjykatave duhet të posedojë njohuri dhe shkathtësi teknike adekuate, e që aktualisht këto të fundit i tejkalojnë mjetet e një OJQ-je mesatare.

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuëse – BIRN – në qershor 2009 ka publikuar një vlerësim gjithëpërfshirës të gjykimeve të zhvilluara në Kosovë, duke përmbledhur kështu rreth 600 raste nga gjithë Kosovën. Rezultatet e monitorimit të gjykimeve nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuëse – BIRN paraqesin një përjashtim nga monitorimi që kryhet nga shoqëria civile: vetëm disa OSHC/OJQ janë duke ndërmarrë iniciativa të kësaj fushe, në mesin e tyre janë KMLDNJ dhe Qendra Juridike e Kosovës – të përkrahura nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. EULEX-i, gjithashtu ka kontaktuar me Institutin e Kosovës për Drejtësi, një organizatë e themeluar rishtazi që ka për qëllim monitorimin e funksionimit të gjykatave dhe të zbatimit të kornizës ligjore dhe si e tillë mund të jetë një bashkëbisedues i mundshëm për këtë mision; Fondi për të Drejtën Humanitare – dega në Kosovë, sipas mandatit që e ka, i monitoron gjykimet e lidhura për krime të luftës; ndërsa në zhvillim e sipër janë edhe disa aktivitete më të vogla.

LLOGARIDHËNIA

Shumë OSHC/OJQ po zhvendosen nga aktivitetet e tyre të asistencës krejtësisht humanitare në aktivitete të monitorimit, një trend ky i shënuar gjatë disa viteve të kaluara. Në raportin e ATRC-së thuhet se “roli i OSHC/OJQ-ve ka lëvizur nga të qenit ofrues shërbimesh në partneritet me institucionet qeveritare në monitorues dhe korrigjues të performancës së shtetit. Disa OSHC/OJQ të reja (...), së fundi kanë shtuar aktivitetet e tyre monitoruese dhe kritikant ndaj qeverisë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal”. Një evolucion i tillë mund të jetë i lidhur edhe me konsolidimin e shërbimeve publike në Kosovë, duke pasur parasysh faktin se në të kaluarën disa shërbime ishin ofruar nga OSHC/OJQ-të. Përderisa autoritetet publike i kanë shtuar kapacitetet e tyre në ofrimin e shërbimeve publike, shoqëria civile burimet e saja më shumë ia ka dedikuar matjes së rezultateve të institucioneve të Kosovës. Në Kosovë shoqëria civile ende përbën një numër relativisht të kufizuar të këshillave konsultative që janë në gjendje të zhvillojnë vlerësime të thella të organeve publike; megjithatë, rritja e kapaciteteve analitike e disa organizatave joqeveritare i ka dhënë hapësirë analizave dhe raporteve (veçanërisht në fushën e gjyqësorit dhe policisë) të cilat ofrojnë sugjerime interesante për një menaxhim më efikas të autoriteteve të sundimit të ligjit.

Një shenjë për mospërhapjen e monitorimit të pavarur të institucioneve publike është edhe numri i vogël i organizatave të cilat marrin mbështetje financiare nga qeveria: një sondazh i kryer nga ATRC-ja tregon se “82% e OSHC/OJQ-ve të intervistuar kanë deklaruar se nuk do të preferonin të financoheshin nga institucionet qeveritare”. Mirëpo, a shihen autoritetet publike, veçanërisht ato të cilat merren me çështje ligjore, si llogaridhënëse nga shoqëria civile e Kosovës dhe përgjithësisht nga opinioni publik? Prezenca e vazhdueshme e hisedarëve ndërkombëtarë në këto fusha do të nxiste besimin në përmirësime, mirëpo gjithashtu mund të prodhojë edhe konfuzion: Raporti i publikuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) për vitin 2007 paralajmëron se “ndarja jo e qartë e kompetencave ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare krijon konfuzion lidhur me faktin se kush është përgjegjës dhe për cilat aspekte të sigurisë dhe të sistemit ligjor, duke e bërë më të vështirë që institucionet të mbahen llogaridhënëse dhe kjo njëkohësisht lejon hapësirë edhe për paraqitjen e korrupsionit”.

Një pengesë tjetër, e cila shkakton vështirësi për institucionet publike që të jenë plotësisht llogaridhënëse qëndron në reagimet osciluese të organeve të sundimit të ligjit ndaj aktiviteteve të monitorimit që kryhen nga OSHC/OJQ-të. Një shembull me rëndësi del nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), një organizatë joqeveritare, e cila merret me implementimin e programeve të ndryshme monitoruese, duke përfshirë edhe një numër vizitash të

kryera në qendrat e paraburgimit nëpër Kosovë, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregulloreve vendore për të burgosurit. Të gjitha përpjekjet qenë finalizuar në raportin e publikuar në dhjetor 2008, në të cilin janë paraqitur gjetjet nga vizitat dhe intervistat e zhvilluara me të burgosurit në Kosovë. Hulumtimi ishte kryer me lejen e Ministrisë së Drejtësisë dhe në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues të Kosovës: kontaktet me të burgosurit ishin realizuar pa ndonjë ndërmjetësim, me qëllim të arritjes së pajtimit për një shkëmbim të informacionit dhe pa kurrfarë ndikimi të ndonjëres prej palëve në fjalë. Mirëpo, menaxhmenti i Shërbimit Korrektues të Kosovës e kishte cilësuar raportin si mospërfillës dhe në shumë pjesë të tij si i bazuar në pohime, që për pasojë solli një urdhër për të gjitha qendrat korrektuese që në rast të vizitave të burgosurve nga punëtorët e QKRMT-së, ato të mbikëqyreshin nga ndonjë zyrtar korrektues ose punëtor social. Kjo nënkupton një nivel më të ulët të parashtrimit të pyetjeve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me një ndikim të qartë në kualitetin e raporteve të ardhshme; ndërmjetësimi në mes të palëve të përfshira është në vazhdim e sipër dhe ka për qëllim tejkalimin e këtij problemi. Kjo ngjarje, ndonëse nuk paraqet ndonjë shqetësim serioz, tregon për pengesat drejt llogaridhënies së organeve publike për shoqërinë civile dhe arsyeton punën e monitoruesve të EULEX-it në terren. Disa nga komentet e paraqesin PK-në si institucionin më të besueshëm në Kosovë në sferën e sundimit të ligjit. Një sondazh i kryer nga FIQ e renditë Shërbimin Policor të Kosovës në vend të dytë për nga besueshmëria në institucionet e Kosovës, ndërsa në vend të parë renditen Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Megjithatë, disa OSHC/OJQ të cilat analizojnë praktikat policore kanë vërejtur se ka vend për përmirësime: për shembull, niveli i besimit në PK nga komunitetet jo shumicë, veçanërisht nga serbët e Kosovës, është më i ulët sesa niveli i besimit nga grupimi kryesor etnik në Kosovë. Takimet me përfaqësuesit vendorë serbë të shoqërisë civile kanë ndihmuar në zbulimin e disa arsyeve praktike prapa këtij diskreditimi; si çështje e parë paraqitet ofrimi jo i mjaftueshëm i informacionit dhe përmes dokumenteve të përkthyer në mënyrë të dobët si dhe hezitimin e supozuar të PK-së që t'ju drejtohet serbëve në gjuhën e tyre. Bashkëbiseduesit gjithashtu mendojnë se PK-ja nuk i njih haptazi dhe nuk ka kapacitete për t'i adresuar krimet ndëretnike dhe kështu i përjashton ato duke i konsideruar si lloje të tjera të shkeljeve të ligjit.

Në një dokument tjetër, i njëjti sondazh i kryer nga FIQ e renditë komunitetin serb të Kosovës si më së paku të shqetësuar për krimet, një gjetje kjo e cila mund të shihet nga aspektet e ndryshme. Raporti i FIQ citon një student 23 vjeçar nga Mitrovica: “njerëzit e pranojnë se kriminelët gjenden rreth nesh dhe se kriminaliteti është biznesi më i zhvilluar në shoqërinë tonë. Ai u bë pjesë e realitetit tonë, një pjesë e jetës sonë të përditshme”. Aty ku perceptimi për krimin është më i përhapur, veprimet e kundërligjshme nuk konsiderohen më të jenë të pazakonshme, prandaj nuk merren parasysh në mënyrë të duhur gjatë hulumtimeve kuantitative. Duhet pasur parasysh se,

krimet që lidhen me bandat kanë pak ndikim në jetën e përditshme të qytetarëve të zakonshëm dhe për pasojë këto edhe mund të kalojnë pa u vërejtur.

Një arsye tjetër për pakënaqësi është perceptimi i ulët i nivelit të komunikimit ndërmjet PK-së dhe gjyqësorit: hetimet rrallëherë përfundojnë me gjykime, ose paraqiten në gjykatë pas një kohe të gjatë dhe këto arsye e irritojnë opinionin publik, veçanërisht nëse informacioni për përpunimin e rasteve është i pamjaftueshëm. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKKS) - një këshill konsultativ vendor që merret me çështjet e sigurisë në Kosovë – i ka sugjeruar EULEX-it që të paraqes një sistem të fuqishëm të verifikimit për të shmangur përkatësitë partiake brenda strukturave të policisë, duke përfshirë edhe kontrollimin në hollësi të biografive brenda PK-së për dhjetë vjetët e fundit nëpër komponentët e ndryshme të saj.

Situata bëhet më e turbullt gjatë shqyrtimit të vlerësimit të shoqërisë civile për gjyqësorin e Kosovës: një numër ankesash të cilat u qenë drejtuar gjykatave ishin mbledhur me lehtësi nga OSHC/OJQ-të. Numri i konsiderueshëm i lëndëve të grumbulluara, zbatimi i dobët i vendimeve të gjykatave, rreziku i lartë për dëshmitarët gjatë kohës së gjykimeve, infrastruktura e dobët dhe burimet njerëzore të papërshtatshme paraqesin arsyet më të shpeshta për kritika ndaj mënyrës së udhëheqjes së gjykatave në Kosovë. Mirëpo, korrupsioni në mënyrë të pakontestueshme është arsyeja kryesore e pakënaqësisë që lidhet me sistemin e drejtësisë, si një shkaktar i padrejtësive të vendimeve gjyqësore dhe në veçanti i mungesës së mbikëqyrjes së autoriteteve të zgjedhura.

Korrupsioni

Shoqëria civile në Kosovë është veçanërisht aktive në luftimin e korrupsionit, i cili konsiderohet të jetë cak parësor për shumë OSHC/OJQ dhe nga shumica e organizatave joqeveritare konsiderohet të jetë problemi numër një. Iniciativat e qeverisë kundër korrupsionit hasin në vlerësime të pakta, të cilat shihen si masa të imëta, me ndikim të vogël dhe me një paraqitje të madhe nëpër medie, e që janë të dobishme për ta shmangur vëmendjen e opinionit publik nga rastet serioze të përvetësimeve. Disa OSHC/OJQ tubojnë gazetarë hulumtues si anëtarë të tyre dhe publikojnë analiza të shpeshta për praktikën e këqija të autoriteteve vendore gjatë menaxhimit të fondeve publike. Këto organizata i shprehin fuqishëm mendimet e tyre dhe shpesh marrin qëndrime publike kundër qeverisë; shumica prej tyre përdorin mënyra provokuese për ta tërhequr vëmendjen për hulumtimet e tyre dhe kjo, sipas qëndrimeve të tyre, paraqet një lloj garancie e sigurisë nga rreziqet që mund të paraqiten gjatë punës së tyre. QOHU!, Fol'08 dhe KDI janë ndër bashkëbiseduesit kryesor për aktivitetet kundër korrupsionit.

QOHU! i vlerëson disa nga veprimet e fundit të policisë si të frymëzuara nga domosdoshmëria politike e jo të udhëhequra nga kriteret hetimore objektive: raporti i fundit i kësaj organizate për korrupsionin i përmend “një numër arrestimesh spektakulare të kryera nga policia” gjatë pjesës së dytë të vitit 2008, si bie fjala, burgosja e ish menaxherit ekzekutiv të Aeroportit të Prishtinës në muajin mars të vitit të shkuar, ndalimi i gjashtë doganierëve, ku thuhet se, në të njëjtën ditë Qeveria është dashur ta anulojë vendimin e vet për largimin e Drejtorit të Doganës, si dhe arrestimi i gjashtë personave për tregtim të paligjshëm me karburante, në kohën kur presioni publik ndaj qeverisë që të veprojë kundër tregtimit të paligjshëm në veri ishte duke u rritur. QOHU! përmend se, të gjithë të ndaluarit ishin liruar pas një kohe të shkurtë, kryesisht për shkak të mungesës së provave, ndërsa këto raste kurrë nuk kishin arritur të përfundojnë në gjykata.

OSHC/OJQ-të janë shumë të ndjeshme ndaj transparencës për të ardhurat e zyrtarëve të zgjedhur, komentet e të cilëve nuk përkojnë gjithmonë me pritjet e hulumtuesve. FOL '08, një organizatë që angazhohet për shtimin transparencës në administratën publike, pati kërkuar nga pesë institucionet kryesore në Kosovë (Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës, Kryeministri, Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit dhe Ministria për Energji dhe Miniera) që të ofrojnë informacion në përputhje me Kapitullin Katër të Ligjit kundër Korrupsionit, të miratuar më 22 prill 2008 (lidhur me dhuratat formale dhe zyrtare për personat zyrtarë); informacionet për këto përfitime duhet të gjurmohen nga institucionet përkatëse dhe t'i ofrohen Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK) dhe t'i vihen në dispozicion cilido kërkuesi që e ka këtë të drejtë, në pajtim me Ligjin nr. 2003/12 mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Nga këto pesë kërkesa, tre kanë mbetur pa përgjigje, përderisa dy përgjigjet e dhëna në asnjë mënyrë nuk i kanë përfshirë të dhënat për dhurata: AKK kishte informuar se në vitin 2008, vetëm tre prej tetëmbëdhjetë institucioneve të cilat janë të obliguara t'i paraqesin regjistrat e dhuratave, e kishin përmbushur obligimin e tyre (mirëpo nuk është shpalosur informacioni se cilat ishin këto institucione dhe për çfarë dhuratash bëhej fjalë), kurse Zyra e Kryeministrit ishte përgjigjur se e kishte dërguar informacionin në AKK (por këtë listë nuk ia kishte dërguar edhe FOL'08-it).

Financimi i partive politike paraqet çështje për të cilën shoqëria civile insiston se gjyqësori duhet të tregojë më shumë interesim, ndonëse lidhur me këtë ekziston një vetëdijësim për procesin legjislativ që është ende i pakompletuar: QOHU! përmend se, nga muaji maj 2008 Ligji mbi Deklarimin e Prejardhjes së Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, sikurse edhe Ligji mbi Financimin e Partive Politike në Kosovë janë kthyer në procedura fillestare, duke ua marrë kështu gjykatësve mjetin për luftim të efektshëm të dukurisë së keqpërdorimit. Disa nga gjetjet lidhur me aktivitetet kundër korrupsionit të paraqitura edhe në Raportin e Progresit të BE-së për vitin 2008, si bie fjala, cilësimet për një korrupsion në shkallë të gjerë, i cili e pengon funksionimin e duhur të

institucioneve, ose për një kornizë ende të paqartë institucionale në luftimin e korrupsionin, të cilat diskutohen haptazi nga shoqëria civile vendore.

OSHC-të/OJQ-të nuk e kanë në shënjestër vetëm korrupsionin në nivel të lartë: projektet të cilat nxisin sensibilizim të përbashkët për këtë problem janë duke u realizuar në Kosovë, siç është demonstruar edhe nga Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore. QAKL është themeluar me anë të një projekti 15 mujor, i cili përfundon në dhjetor 2009 dhe realizohet nga Instituti Demokratik i Kosovës -IDK; iniciativa bazohet në një model me të cilin ishte eksperimentuar në 19 shtete të tjera, kryesisht të Evropës Lindore, i cili qytetarëve u ofron mjete të ndryshme për informim dhe sensibilizim, në mënyrë që të ndihmojnë në zbulimin e keqberjeve nëpër institucione publike: për shembull, një numër i telefonit pa pagesë të cilin mund ta përdorin dëshmitarët e korrupsionit. Këto burime të informacionit mund të shërbejnë për të plotësuar informacionin, i cili tashmë është në dispozicion të zyrtarëve të EULEX-it.

QASJA E LIRË NË SHËRBIME

Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të kenë qasje të barabartë në shërbimet e sundimit të ligjit, ndërsa shoqëria civile në mënyrë intensive është duke i vështruar raportet ndërmjet institucioneve për sundimin e ligjit dhe grupeve sociale të cilat janë në situatë të pafavorshme kur i drejtohen gjykatave ose policisë. Perspektiva gjinore e qasjes në drejtësi i ka nxitur OSHC/OJQ-të që ta përgatisin një material të bollshëm, si dhe ka qenë edhe objekt i një hulumtimi të publikuar nga Asociacioni i Gjykatësve të Kosovës (AGJK) në vitin 2009. Asociacioni është një organizatë vullnetare joqeveritare, e cila i përfaqëson më shumë se 300 gjykatës aktiv, të cilët shërbejnë nëpër të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe janë prej të gjitha rajoneve të Kosovës. Bordi menaxhues i asociacionit përbëhet prej një gjykatësi nga komuniteti serb i Kosovës ndërsa një gjykatës tjetër është nga bashkësia ndërkombëtare – që aktualisht është edhe Kryetar i Kuvendit të Gjykatësve të EULEX-it. AGJK evidencon studentet e regjistruara në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës e që përbëjnë rreth një të tretën e numrit të përgjithshëm të studentëve në vitin akademik 2008/2009; kandidatet të cilat e kanë kryer me sukses provimin e jurisprudencës në vitin 2008 ishin pak më shumë se gjysma e kolegëve të tyre meshkuj, ndërsa shifrat aktuale për punësimin e tyre nëpër gjykatat e Kosovës flasin për 218 gjykatës meshkuj kundrejt pranisë së 83 femrave që udhëheqin me gjykime. Tendencat e ngjashme janë regjistruar edhe në mesin e prokurorëve dhe avokatëve dhe këto dëshmojnë për mungesën e punësimit të femrave nëpër institucionet për sundimin e ligjit në Kosovë.

Shqetësimet e tilla nuk janë e vetmja brengë e shoqërisë civile: trafikimi dhe dhuna ndaj gruas janë çështje për të cilat janë bërë përpjekje prej disa OSHC/OJQ-ve dhe janë konceptuar si prioritete për çfarëdo agjende të sundimit të ligjit në Kosovë. Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) njofton për themelimin e një Koalicioni kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale, i cili tubon një numër organizatash përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për vitin 2009, duke përfshirë edhe fushatat për sensibilizim ndaj rreziqeve që paraqiten nga dhuna kundër grave, rekomandimin për kompletimin e kornizës së përshtatshme ligjore dhe shtimin e kapaciteteve të strehimoreve. Koalicioni mban takime të rregullta për të cilat mund të ketë interesim për pjesëmarrje nga ana e zyrtarëve të EULEX-it, të cilët interesohen për iniciativat e shoqërisë civile lidhur me çështjet gjinore.

RRGK në mënyrë aktive monitoron tendencat e dhunës në familje në nivel vendor dhe këto krime i konsideron të jenë kërcënim i drejtpërdrejtë për sigurinë në Kosovë. Deri më tash janë vlerësuar iniciativat që janë ndërmarrë nga ligjvënësit vendorë, të cilat RRGK-së i mundësuan të deklarojë se “Kosova ka një numër ligjesh të sofistikuara për t’i ndjekur rastet dhe për t’i mbrojtur viktimat e dhunës në familje.” Nëse ligjet si: Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Familjen dhe Ligji për Shërbimet Sociale të miratuara nga Kuvendi i Kosovës konsiderohen të jenë ngjarje me rëndësi për nxitjen dhe mbrojtjen e barazisë gjinore dhe të parimeve të mos-diskriminimit në Kosovë, zbatimi i kornizës ligjore në fuqi rezulton të jetë jo i kënaqshëm. Duke e pranuar se “Që nga miratimi i Ligjit mbi Dhunën në Familje, kapaciteti i Policisë së Kosovës për t’i mbrojtur viktimat e dhunës në familje është përmirësuar dukshëm”, RRGK raporton për një numër të vështirësive gjatë zbatimit të legjislacionit aktual nga gjykatësit dhe prokurorët vendor, ndërsa viktimat e dhunës në shumë raste ende jetojnë bashkë me keqbërësit e dënuar.

Faktorët social dhe mangësitë në ofrimin e shërbimeve publike janë konfirmuar të kenë një ndikim kryesor në pamundësinë e adresimit të dhunës në familje: një studim nga viti 2006, i kryer nga Qendra për Mirëqenien e Gruas – QMG ka gjetur se “gjashtëdhjetë e një për qind e grave të cilat e kanë raportuar dhunën gjithashtu kanë kërkuar edhe ndihmë; me përjashtim të tri grave, të gjitha të tjerat kishin kërkuar ndihmë prej familjes ose miqve. Është i vogël numri i atyre që kanë përjetuar dhunë e që më parë do të kërkonin ndihmë prej këtyre qendrave sesa prej familjes ose miqve. Arsyet për këtë mungesë të kërkimit të ndihmës prej burimeve të jashtme për përkrahje kërkojnë hulumtim të mëtejshëm, mirëpo ka gjasa që kjo ndodhë për shkak të mungesës së shërbimeve në dispozicion: më shumë se gjysma e respondentëve të intervistuar kishin përmendur shërbimet mjekësore, shërbimet e shëndetit riprodhues dhe policinë, e cila vështirë depërton nëpër komunitetet e tyre”. Që prej atëherë gjërat kanë mundur të përmirësohen, ndërsa sistemi i drejtësisë me gjasë nuk mund të zëvendësojë ose të merr mbi vete barrën e shërbimeve

të tjera publike, siç është asistenca sociale. Prej policisë dhe gjykatave nuk kërkohet që të përballen me botëkuptimin e përhapur sipas të cilit dhe në bazë të hulumtimit të kryer nga RRGK, dy të tretat e qytetarëve të intervistuar pajtohen se “marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse kryhet prej dy personave madhorë të cilët janë të martuar.” Megjithatë, përmirësimet në menaxhimin e sundimit të ligjit mund të frenojnë sjelljet e këqija ndaj grave, kurse vonesat gjatë procedurave gjyqësore konsiderohen si një prej faktorëve kryesor që i pengojnë përpjekjet për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Burimet e pakta për të ndihmuar gratë dhe fëmijët nëpër strehimore janë theksuar të jenë pjesë e reagimit të dobët ndaj kësaj dukurie sociale. Ndërsa RRGK raporton se, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale mbulon vetëm 50 për qind të shpenzimeve për strehimoret të cilat udhëhiqen nga OSHC/OJQ-të, duke mos përfshirë këtu edhe stafin dhe shpenzimet operative.

Zgjidhjet e sugjeruara nga RRGK përfshijnë emërimin e më shumë gjykatësve për t'u marrë me lëndët e dhunës në familje, emërimin e prokurorit që do të merret vetëm me lëndët e dhunës në familje, organizimin e trajnimeve specifike për gjykatësit që merren me lëndët e dhunës në familje në mënyrë që të zbatojnë ligjet përkatëse; për shumicën e këtyre rekomandimeve ishte arritur pajtimi nga institucionet e Kosovës, si bie fjala Ombudspersoni, por zbatimi i tyre ende mungon. Strehimoret e udhëhequra nga OSHC/OJQ-të janë të interesuara për një bashkëpunim më të ngushtë me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që nënkupton vazhdimësi më të gjatë të financimit dhe kriteret të qarta për licencim të OSHC/OJQ-ve (pohimet e keqpërdorimeve të fondeve të jashtme nga strehimoret e udhëhequra nga OSHC/OJQ-të i janë raportuar këtij misioni). Në përgjithësi, shoqëria civile tregon një përkushtim të shquar për këto çështje, ndërsa propozimet që dalin prej organizatave të angazhuara në mënyrë aktive në luftimin e dhunës në familje mund të krijojnë një bazë të qëndrueshme për partneritet të ardhshëm, duke përfshirë këtu edhe EULEX-in dhe institucionet vendore.

Qasja në drejtësi e pakicave etnike në Kosovë, gjithashtu paraqet një shqetësim të përbashkët për shoqërinë civile. Shumica e OSHC/OJQ-ve të konsultuara për këtë raport kanë anëtarësi një-etnike, ndonëse shumë prej tyre deklarojnë se kanë raporte të rregullta me OSHC/OJQ-të e grupeve të ndryshme etnike. Megjithatë, komentet dhe reagimet për gjyqësorin e Kosovës, policinë dhe doganën ndryshojnë ndjeshëm, nëse merret parasysh përkatësia etnike. Një fushatë për informim dhe kontaktim, e organizuar nga EULEX-i në bashkëpunim me Programin për Dialog Rinor nëpër komunitetet e serbëve të Kosovës gjatë tre mujorit të parë të viti 2009, mundësoi grumbullimin e qëndrimeve kryesore lidhur me pritjet nga institucionet e Kosovës dhe vetë EULEX-i. Kjo fushatë ishte vlerësuar pozitivisht nga bashkëbiseduesit.

Përkundër një rezistence fillestare për të bashkëpunuar me EULEX-in, e cila shkaktoi disa vonesa në organizimin e fushatës së lartpërmendur për shoqërinë civile të komunitetit serb të Kosovës, gjatë këtyre takimeve u ripërsëritën disa kërkesa, si çështja e personave të zhdukur dhe të drejtat pronësore. Tema e fundit u bë objekt i një analize të saktë të kryer nga Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, e cila kishte ndërlidhur shkaktarët historik, vlerësimet mbi madhësinë e problemit dhe përfundimisht ka sugjeruar mënyra që t'i ndihmojë EULEX-it për t'u ballafaquar me çështjet pronësore: “në të kaluarën, Policia e Kosovës nuk ka reaguar shumë për krimet kundër pronës. Ata, gjithashtu nuk ishin të gatshëm të zhvillojnë hetime penale për krimet kundër pronës. Raportet e EULEX-it për Këshillin e Sigurimit dhe për Brukselin duhet të përmbajnë edhe një pjesë rreth aktiviteteve të policisë në parandalimin e krimit kundër pronave të PZH-ve dhe të zbatimit të Kodit Penal të Kosovës kundër shkelësve të ligjit. Qëllimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme është që të sigurohet një presion dhe nxitje për Policinë e Kosovës për të qenë më proaktive në zbatimin e plotë të Kodit Penal të Kosovës, kundër uzurpatorëve dhe ri-uzurpatorëve të pronave të PZH-ve dhe në hetimin e mënyrave të deklaruara të mashtrimeve pronësore”. Çështjet e lidhura me prona, një shqetësim i përbashkët për të gjitha komunitetet, rregullisht janë përmendur si një prej pengesave kryesore për integrimin e serbëve në Kosovë. Vështirësitë për sigurimin e një zbatimi të duhur të vendimeve gjyqësore shpesh perceptohen si masa diskriminuese kundër serbëve.

Qasja e kufizuar në drejtësi tashmë ka shkaktuar një lloj të shtrembërimit të mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve: mekanizmat e drejtësisë joformale janë pasojë e qartë e dështimeve të organeve publike në administrimin e drejtësisë dhe aktualisht në Kosovë mund të vërehen në shumë sfera. Raporti i mëhershëm nga FIQ shpalos forma të ndryshme të mekanizmave të drejtësisë joformale në Kosovë, duke filluar prej një komisioni të përbashkët, të përbërë prej shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës nga një fshat në Ferizaj, i cili merret me çështje pronësore, e deri te përdorimi i Kanunit nëpër mjedise rurale, veçanërisht për rastet e hakmarrjes për të cilat burgosja nuk shihet si ndëshkim i mjaftueshëm, ndërsa marrja e hakut mund të vazhdojë përkundër faktit se është kërkuar falje publikisht dhe nëse falja është pranuar. Raporti në mënyrë interesante përmend autoritetet me interes të cilat lehtësojnë menaxhimin e drejtësisë në mjediset ku gjykatat nuk funksionojnë në mënyrë të duhur, këtu përfshihet edhe “Kisha Ortodokse Serbe, veçanërisht manastiret, të cilat jo vetëm që kanë rolin e tyre kulturor, fetar dhe tradicional, por në masë të shtuar kanë edhe rolin e këshilltarëve dhe ndërmjetësuesve, duke bërë që Kisha Ortodokse Serbe të jetë një prej mekanizmave më të fuqishëm dhe nëse jo më i fuqishëm, atëherë është një mekanizëm joformal për adresimin e problemeve të përbashkëta të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës”.

LIRIA NGA NDËRHJRJET POLITIKE

Shoqëria civile në Kosovë në masë të madhe ndanë të njëjtin mendim për institucionet publike të Kosovës: përkatësisht, depërtueshmërinë e ndërhyrjeve nga politikanët. Shembujt e OSHC/OJQ-ve që kanë tërhequr vëmendjen e EULEX-it janë të shumtë, ndërsa disa sish qartazi ndërlidhen me tensionimet etnike.

Sipas pikëpamjeve të OSHC/OJQ-ve përkitazi me ndërhyrjet politike gjatë emërimit të anëtarëve të gjyqësorit, përvoja e punës së shumë gjykatësve dhe prokurorëve vendorë nëpër ish gjykatat jugosllave paraqet kërcënim për pavarësinë e gjyqësorit të Kosovës. Përfaqësuesit nga Instituti Juridik i Kosovës sugjerojnë se, me përshpejtimin e zëvendësimit të gjykatësve të vjetër dhe përmes mbajtjes së provimeve të jurisprudencës mund të ndihmohet në tejkalimin e këtij problemi, megjithëse provimi i fundit i jurisprudencës ishte organizuar në muajin janar të vitit 2008 dhe mbajtja e provimit të radhës varet prej kompetencave të zyrtarëve të zgjedhur dhe kjo më shumë është çështje e politikave sesa çështje teknike.

Shumë OSHC/OJQ e konsiderojnë afrinë e nëpunësve civilë dhe të zyrtarëve të zgjedhur me avokatët si shkak të konfliktit të interesave; nëse dikush është i afërm i një zyrtari të lartë në Ministrinë e Drejtësisë, ai person mund t'i favorizojë avokatët privatë që të kenë më shumë klientë. Kërkesat e shpeshta nga OSHC/OJQ-të janë për më shumë transparencë në rrjetet private të nëpunësve civilë dhe të zyrtarëve të zgjedhur, në veçanti të atyre që janë përgjegjës për administrimin e institucioneve për sundimin ligjit.

REKOMANDIME

Shoqëria Civile e Kosovës është heterogjene dhe i pasqyron ndryshimet e vazhdueshme në sferat e ndryshme të jetës në Kosovë. EULEX-i ka potencial që të ndërtojë raporte të dobishme me organizatat e përfshira në aktivitetet e sundimit të ligjit dhe të strukturojë iniciativa të përbashkëta për detyrat e monitorimit. Shumë OSHC/OJQ kanë kërkuar nga misioni që të ketë programe bashkë-monitoreuese, duke pasur parasysh faktin se qasja në informacion mund të lehtësohet përmes prezencës së EULEX-it. Gjetjet sugjerojnë se, shoqëria civile e vendit ofron kapacitete specifike të monitorimit për fushat si, korrupsioni, trafikimi dhe dhuna në familje dhe shërbimet korrektuese; megjithatë, ndihmesat për aktivitetet e MMK do të kërkohen edhe në sfera tjera të lidhura me EULEX-in në përputhje me prioritetet e identifikuara nga secila prej komponentëve të EULEX-it.

Strategjitë e ndryshimit do të formulohen dhe zbatohen gjatë periudhës në vazhdim nga drejtësia e EULEX-it, kurse monitoruesit e policisë dhe të doganës do t'i përfshijnë të dhënat që do të vijnë nga shoqëria civile, ndërsa aty ku është e mundur do të përfshihen edhe modalitetet për bashkëpunim me OSHC/OJQ-të përkatëse për aktivitetet në fjalë. Afrimi ndërmjet stafit të EULEX-it për MMK dhe OSHC/OJQ-ve vendore do të shpie deri te të dhënat më të shpeshta nga shoqëria civile dedikuar misionit në bazë të rasteve specifike; dërgimi i rasteve të tilla në institucionin përkatës dhe analizimi i brendshëm i rasteve, do të bëjë të mundur që misioni të lehtësoj mekanizmat për sundimin e ligjit në Kosovë dhe t'i vërejë kërkesat kryesore të shoqërisë civile. Përfitimi i tretë nga partneriteti i ardhshëm me OSHC/OJQ-të buron nga aftësia e tyre për ta përcjellë informacionin deri te opinioni i gjerë: aktivitetet e bashkë-monitorimit do të pajtohen që ta bëjnë punën e EULEX-it sa më të dukshme, me theks të veçantë për sundimin ligjit në Kosovë që është me rëndësi për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve.

Nuk është vetëm EULEX-i ai që do të përfitoj nga bashkëpunimi i ngushtë me OSHC/OJQ-të vendore: këto të fundit do t'i rrisin kapacitetet e tyre për t'i monitoruar institucionet publike përmes vështirimit të metodologjive që përdoren në EULEX; nuk përjashtohet edhe mundësia që aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen të tërheqin interesimin e donatorëve tjerë, ose të shpijnë në zbulimin e zbrazëtirave, të cilat duhet të plotësohen nga organizatat ndërkombëtare të interesuara.

Gjetja e partnerëve të përshtatshëm nga radhët e OSHC/OJQ-ve vendore nuk do të jetë detyrë e lehtë për EULEX-in. Disa OSHC/OJQ duket se posedojnë kapacitete për zbatim të monitorimit në gjithë Kosovën, kurse shumica prej tyre janë shumë të vogla për të pasur ndonjë ndikim mbi çështjet e lidhura për misionin. Nxitja e iniciativave të përbashkëta paraqet zgjidhje efektive për të këtij problemi, bie fjala me anë të nxitjes së raporteve përmes memorandumeve të bashkëpunimit me rrjete të gjera të organizatave joqeveritare vendore.

REKOMANDIMI I EULEX-it

Synimi: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Monitorimi i Drejtësisë në Kosovë dhe OJQ-të vendore për të Drejtat e Njeriut

1) Të inkurajojë dialog dhe shkëmbim të informacionit me qëllim të identifikimit dhe fuqizimit të qëllimeve dhe synimeve të përbashkëta.

2) MD dhe SHKK të fusin politikatat e llogaridhënies dhe me këtë të sigurojnë publikun se ato janë në përputhje me procedurat.

REKOMANDIMI I EULEX-it

Synimi: Policia e Kosovës, OSHC-të dhe OJQ-të e serbëve të Kosovës.

Përmirësimi i dialogut dhe komunikimit me qëllim të adresimit të shqetësimeve dhe të përmirësimit të llogaridhënies për komunitetet e serbëve të Kosovës

REKOMANDIMI I EULEX-it

Synimi: OSHC-të ndëretnike dhe OJQ-të e interesuara për sundimin e ligjit

Inkurajimi i dialogut dhe i shkëmbimit të informacionit me qëllim të identifikimit të qëllimeve dhe synimeve të përbashkëta

REKOMANDIMI I EULEX-it

Synimi: Kryetarët e gjykatave të qarkut , OSHC-të dhe OJQ-të e interesuara për sundimin ligjit.

Të iniciojnë mekanizma të konsultimit formal me qëllim të adresimit të shqetësimeve të banorëve lokal.

Falënderim

Raporti i Programit të EULEX-it – Korrik 2009, u përgatit nga:

Alessio Zuccarini – Shef i Zyrës për Programe

Zyra për Programe:

**Emel Abazxhik, Arben Abdurahmani,
Jesper Stig Andersen , Francis Harris,
Amir Kovaci, Annachiara La Greca,
Ardian Latifaj, Richard Lundgren,
Venera Mehmeti, Ilknur Öztürk,
Stephen Smith, Alessandro Tedesco,
Dirk Teerlinck**

Falënderim i veçantë për Zyrën për Politika të EULEX-it

Faqosja:

Faton Hasani & Amir Kovaci – Disenjator grafik

Është bërë çdo përpjekje për verifikimin e saktësisë së informacionit që e përmban ky raport. Deri në qershor 2009 i gjithë informacioni besohet të ketë qenë i saktë. Megjithatë, EULEX-i nuk mund ta merr përgjegjësinë për pasojat e përdorimit të tij për qëllime tjera ose në kontekste tjera.

© 2009 EULEX. Të gjitha të drejtat e rezervuara.